AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

4
Gj 78

Jorgji Gjinari

DIALEKTET E GJUHES SHQIPE

SHKURTIMET

SF	«Studime filologjike»
SA	«Studia Albanica»
GJA	«Gjurmime albanologjike»
BUSH, SShSh	«Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës - seria shkencat shoqërore».

Bul. për shk. shoq. — «Buletin për shkencat shoqërore».

SISTEMI I TRANSKRIPTIMIT

ZANORET

i	y					u
e	ɣ					
ɛ	ø	ɔ	ɜ	ʌ	o	
æ		a				ɑ

i	zanore e përparme e ngritjes së sipërme	mik	
e	zanore e përparme e ngritjes së mesme	dele	
ɛ	zanore e përparme e ngritjes së mesme më e hapur se zanorja ə	fɛmən	
æ	zanore e përparme e ngritjes së ulët më e mbylur se a dhe më e hapur se ɛ	præp	«prap»
y	zanore e klasës së mesme e ngritjes së sipërme buzore	ky	
ɣ	zanore e klasës së mesme me e hapur se y	atɣ	aty»
ø	zanore e klasës së mesme e ngritjes së mesme buzore	tøm	«tym»
ə	zanore e klasës së mesme (qendrore) e ngritjes së mesme	hənə	«hënë»
a	zanore e klasës së mesme e ngritjes së ulët	dal	
ɜ	zanore e klasës së mesme më e prapme se ə	bɜj	«bëj»
ʌ	zanore e klasës së mesme më e përparme se o , jobuzore	sʌt	«sot»
u	zanore e prapme e ngritjes së sipërme buzore	mur	

o	zanore e prapme e ngritjes së mesme buzore	**lopə**	«lopë»
a	zanore e prapme e ngritjes së ulët jobuzore	**katər**	«katër»

SHENJAT DIAKRITIKE

˘	zanore e shkurtër	**plăk**	«plak»
:	zanore e gjatë	**pla:k**	«plakë»
~	zanore hundore	**hũ**	«hu»
v	zanore e hapur	**vɐtɬa**	«vetulla»
>	zanore më e përparme	**l o̞p**	«lopë»
<	zanore më e prapme	**ɟ ɑ̟**	«gjë»
°	zanore e buzorëzuar	**ma°l**	«mal»
‿	gjysmëzanore	**mi̯eɬ**	«miell»
‿	diftong	**duar**	«duar»

BASHKËTINGËLLORET

P		**t**	**ts**	**tʃ**	**tc,**	**c**	**k**
b		**d**	**dz**	**dʒ**	**dz,**	**ɟ**	**g**
m		**n**				**ɲ**	**ŋ**
	f	θ	**s**	ʃ	φ	ɣ	χ	
	v	δ	**z**	ʒ	z,	ʝ	ɣ	**h**
			ɬ	l		**j**		
			r	r̄				

P	bashkët.	mbylltore	e shurdhët	buzore	**pi**	
b	bashkët.	mbylltore	e zëshme	buzore	**bel**	
m	bashkët.	mbylltore	sonante	hundore	**mal**	
f	bashkët.	shtegore	e shurdhët	buzore	**fil**	«fill»
v	bashkët.	shtegore	e zëshme	buzore	**veʃ**	«vesh»
θ	bashkët.	shtegore	e shurdhët	dhëmbore	**θua**	«thua»
δ	bashkët.	shtegore	e zëshme	dhëmbore	**δi**	«dhi»
t	bashkët.	mbylltore	e shurdhët	dhëmbore	**tre**	
d	bashkët.	mbylltore	e zëshme	dhëmbore	**dy**	

n	bashkët. hundtre	mbylltore	sonante	dhëmbore	**natə**	« natë»
ts	bashkët. -dhëmbore	afrikate	e shurdhët	alveolare	**matse**	«mace»
dz	bashkët. dhëmbore	afrikate	e zëshme	alveolare	**dzidza**	«xixa»
s	bashkët. -dhëmbore	shtegore	e shurdhët	alveolare	**sy**	
z	bashkët. -dhëmbore	shtegore	e zëshme	elveolare	**zog**	
tʃ	bashkët.	afrikate	e shurdhët	alveolare	**tʃaj**	«çaj»
dʒ	bashkët.	afrikate	e zëshme	alveolare	**dʒep**	«xhep»
ʃ	bashkët.	shtegore	e shurdhët	alveolare	**ʃi**	«shi»
ʒ	bashkët.	shtegore	e zëshme	alveolare	**ʒele**	«xhele
tc,	bashkët. -qiellzore	afrikate	e shurdhët	alveolare-	**tc,a:f**	«qafë»
dz,	bashkët. -qiellëzore	afrikate	eɲzëshme	alveolare-	**dz,a:ʃt**	«gjash të»
φ	bashkët. qiellëzore	shtegore	e shurdhët	alveolare-	**φa:f**	«qafë»
z,	bashkët. qiellzore	shtegore	e zëshme	alveolare-	**z,a:ʃt**	«gjash-të»
c	bashkët.	nbylltore	e shurdhët	qiellzore	**cep**	«qep»
ʒ	bashkët.	mbllltore	e zëshme	qiellzore	**ʒak**	«gjak»
ɲ	bashkët. hundore	mbylltore	sonante	qiellzore	**ɲeri**	«njeri»
ɻ	bashkët.	shtegore	e shurdhët	qiellzore	**ɻa:f**	«qafë»
ʝ	bashkët.	shtegore	e zëshme	qiellzore	**ʝa:ʃt**	«gjash të»
k	bashkët.	mbylltore	e shurdhët	prapagjuhore	**kokə**	«kokë»
g	bashkët.	mbylltore	e zëshme	prapagjuhore	**gojə**	«gojë»
ŋ	bashkët. hundore	mbylltore	sonante	prapagjuhore	**ŋuʃt**	«ngus-shtë»
χ	bashkët. hore	shtegore	e shurdhët	prapagju-	**χem**	«them
ɣ	bashkët.	shtegore	e zëshme	prapagju-hore	**ɣa:ʃ**	«dha-shë»
h	bashkët.	shtegore	faringale		**ha**	
ɫ	bashkët.	anësore	sonante	e velarizuar	**vɫa**	«vëlla»
I	bashkët.	anësore	sonante		**laj**	
j	bashkët.	shtegore	sonante	qiellzore	**jap**	
r	bashkët.	dridhëse	sonante		**rosə**	«rosë»
r̄	bashkët.	dridhëse e fortë	sonante		**r̄uʃ**	«rrush

PARATHËNIE

Mungesën e një traktati për dialektet e gjuhës shqipe, i cili mund të hartohet më vonë si një vepër kolektive, mendojmë se vjen dhe e plotëson për një kohë punimi ynë i pranishëm. Punimin e kemi titulluar *Dialektet e gjuhës shqipe*, por nuk ka trajtuar gjithçka për dialektet e aq më tepër në hollësira, ai ka karakter përgjithësimi. Në fillim jepen arritjet e dialektologjisë shqiptare që nga mesi i shekullit të kaluar, kur kanë zënë fill studimet e saj, e deri sot; pastaj vjen kapitulli i dytë ku trajtohet degëzimi dialektor i gjuhës shqipe duke u ndalur më gjatë në historinë e këtij degëzimi; në kapitullin e tretë, që përbën pjesën kryesore dhe më të madhe të punimit, jepet sistemi fonologjik i sotëm i dialekteve dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë historisë së tij ky sistem; në kapitullin e katërt ishte dashur të bëhej përshkrimi i sistemit morfologjik të dialekteve, por ne këtu u kufizuam vetëm në paraqitjen e dallimeve dialektore të kësaj sfere të gjuhës në mënyrë të përgjithshme sipas kriterit strukturor; në kapitullin e fundit, i cili merr pak a shumë edhe karakterin e një përmbylljeje, bëhet fjalë për marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare shqipe duke u ndalur pak te përbërja e gjuhës letrare në krahasim me dialektet në sistemin fonetik dhe në sistemin gramatikor dhe disi pastaj në ndryshimet që pësojnë sot dialektet nën ndikimin e gjuhës letrare dhe në procesin e pasurimit të mëtejshëm të gjuhës letrare me lëndën që vijon të marrë nga dialektet.

Pas botimit të *Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe*, i cili është

duke përfunduar së hartuari, do të jetë më i mundshëm një punim i hapur, një traktat që të trajtojë në tërësi dhe në hollësi çështje të ndryshme të dialekteve të gjuhës shqipe. Veç «Atlasit», dialektologjia shqiptare ka edhe arritje të tjera të rëndësishme, sidomos nga ato të fazës së hetimit të përgjithshëm të dialekteve, që u bë pas Çlirimit nga mesi i viteve '50 deri në mesin e viteve '70. Kjo fazë, që parapriu «Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe», solli shumë të dhëna me vlerë të madhe për njohjen e të folmeve të të gjithë truallit të shqipes (brenda RPS të Shqipërisë dhe jashtë saj). Me anë të kërkimeve të organizuara, që u bënë në terren në më tepër se 300 pika të banuara dhe me anë të studimeve dialektologjike të shumta në numër (më shumë se 70) u bënë të njohura veçoritë dalluese dialektore të të gjitha të folmeve, u përcaktuan më tej kufijtë e shtrirjes së këtyre veçorive dalluese dhe të degëzimeve dialektore të shqipes, sidomos të grupeve të të folmeve të shkallëve të ndryshme. Njohja e të folmeve të gjuhës shqipe nuk mund të ishte e plotë pa kërkimet dhe studimet e gjuhëtarëve shqiptarë në Jugosllavi për të folmet shqipe të atyre anëve dhe të studiuesve arbëreshë të Italisë për të folmet e ngulimeve të veta.

Bashkë me disa punime të tjera për disa të folme të veçanta, të hartuara këto kohët e fundit, tiparet dalluese dialektore janë parë brenda sistemit (fonetik, në punimin tonë edhe brenda sistemit gramatikor). Çdo dukuri dialektore është analizuar nga aspekti strukturor dhe funksional, sipas parimeve të N.S.Trubeckojt të parashtruara për dallimet dialektorefo netike në veprën e tij «Principes de phonologie» (për analogji me klasifikimin e dallimeve fonetike është bërë edhe klasifikimi i dallimeve morfologjike po sipas kriterit strukturor dhe funksional).

Vlera e një analize të tillë është e madhe, sepse nxjerr në dukje shkallën reale të ndryshueshmërisë dhe të njësisë (unitetit) së dialekteve të një gjuhe, i paraqit dallimet dialektore sipas një shkallëzimi, ndan thelbësoret nga ato që nuk janë thelbësore për sistemin e gjuhës, nuk i jep ato të barasvlershme. Kjo analizë e mbështetur në kriteret strukturore i nxjerr objektivisht më të gjera hapësirat dialektore me tipare të njëjta, ndryshe nga analiza tradicionale, e cila, duke i vlerësuar të barasvlershme të gjitha dallimet dialektore, e jep shumë të copëzuar nga ana dialektore truallin e një gjuhe. Përfundimet e një analize të tillë kanë rëndësi edhe për të njohur më mirë dhe objektivisht raportin që ekziston midis sistemit të gjuhës letrare dhe sistemit të dialekteve: kriteri strukturor dhe funksional nxjerr në shesh se baza e përbashkët e tyre është më e madhe nga ç'mendohet.

Autori i këtij punimi nuk mund të mos çmojë vlerën e madhe që patën për të dhënat e kërkimeve e të studimeve të bëra sidomos në fazën e hetimit të përgjithshëm të dialekteve nga kolegët

dialektologë të RPS të Shqipërisë, nga kolegët dialektologë shqiptarë të Kosovës e të Maqedonisë dhe nga gjuhëtarët arbëreshë të Italisë, gjithashtu ai nuk mund të lerë pa nënvizuar vlerën mbështetëse dhe pjesërisht rektifikuese të të dhënave, sado paraprake, të «Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe». Veçanërisht autori falenderon për ndihmën e dhënë gjatë diskutimit të punimit recensuesit e disertacionit të doktoratës me titull «Sistemi fonologjik i dialekteve të gjuhës shqipe» dhe të punimit të pranishëm: prof.Mahir Domin, prof. Shaban Demirajn, doc.Anastas Dodin, doc.Mehmet Çelikun dhe kandidatin e shkencave filologjike Gjovalin Shkurtaj.

AUTORI

KREU I

KËRKIMET DHE STUDIMET PËR DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE

1.1.1. Historia e dialektologjisë shqiptare zë fill që në mesin e shekullit të kaluar. Ka më shumë se një shekull që po lëvrohet kjo fushë e gjuhësisë sonë, por ashtu si gjithë gjuhësia shqiptare, në mënyrë të veçantë dialektologjia si degë e saj u rrit dhe u formua në epokën e Partisë, në vitet pas Çlirimit. Në etapën që nis në fillim të viteve '50 dialektologjia shqiptare u ngjit shkallë-shkallë në rrafshin e një shkence me arritje të shumta e të rëndësishme në mbledhjen e materialeve të pasura dialektore për të folmet e gjuhës shqipe, sidomos në truallin e RPSSH, në njohjen e tipareve dalluese e të përbashkëta të të folmeve me studime të shumta përshkruese të tyre, në njohjen më të plotë, të saktë e të thelluar të degëzimit dialektor të shqipes, d.m.th. të dialekteve e të grupeve të të folmeve si sisteme dialektore të shkallëve të ndryshme me lidhjet, varësitë dhe shtrirjen e tyre gjeografike, në njohjen e historisë së zhvillimit të disa dukurive dielektore e të strukturës së dialekteve në përgjithësi dhe të raporteve të sotme të dialekteve me gjuhën letrare të njësuar shqipe.

Që nga vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar e deri në vitet dyzet të shekullit tonë, kur triumfoi revolucioni popullor në vendin tonë dhe u çlirua Shqipëria, studimi i dialekteve të shqupes u bë me hope e me një ritëm shumë të ngadalshëm. Gjatë kësaj kohe rezultatet e studimeve qenë të pakta dhe dialektologjia shqiptare nuk mundi të zhvillohej as edhe në shkallën që arritën atëherë disa degë të tjera të gjuhësisë sonë. Kjo prapambetje nuk mund të mos shkaktohej në kush-

tet e errësirës së regjimeve antipopullore, kur mungonin interesimi dhe mundësitë për zhvillimin e shkencës në përgjithësi dhe të albanologjisë në veçanti. Vetëm pas Çlirimit, me vendosjen e pushtetit popullor, si çdo fushë e jetës ekonomike e shoqërore, morën një zhvillim të madh edhe degët e ndryshme të albanologjisë, ndërmjet të cilave edhe dialogjia.

Etapa e parë e dialektologjisë shqiptare, që nis me «Albanesische Studien» II, 1854 të J.G.Hanit e që shkon deri në fillim të viteve '50 pas Çlirimit, karakterizohet nga të dhëna të pjesshme prej burimeve të ndryshme dhe nga disa studime dialektologjike të rastit e pa ndonjë synim të përcaktuar. Dijetarë të veçuar për qëllime të ndryshme dhe të diktuara herë-herë nga rasti botuan materiale dialektore, vërejtje e shënime mbi të folme të shqipes dhe aty-këtu edhe disa studime të mirëfillta dialektologjike për një numër të vogël të folmesh. Një pjesë e mirë e atyre dijetarëve që u morën me studimin e dialekteve të shqipes, kryesisht të huaj, duke u nisur më tepër nga qëllimi që të nxirrnin të dhëna për gjuhësinë historiko-krahasuese, të shumtën e herës u drejtuan te të folmet anësore dhe te të folmet e ngulimeve shqiptare jashtë atdheut.

Nga ajo etapë kemi që më 1855 prej K.H.Rajnholdit[1] një gramatikë të vogël me tekste e me një glosar mbi të folmen e arbëreshëve të ishujve të Greqisë; në fillim të shekullit tonë dy punime të M. Lambercit[2] mbi të folmet e arbëreshëve të Italisë, ku jepen kryesisht veçori fonetike e morfologjike të këtyre të folmeve dhe prej G.Vajgandit[3] një skicë të shkurtër mbi disa tipare karakteristike të së folmes së shqiptarëve të Dalmacisë; pak më vonë një skicë tjetër prej G.Vajgandit[4] dhe disa vërejtje e shënime prej A.P.Furiqit[5] mbi të folmen e shqiptarëve të Atikës (Greqi) dhe prej K.Taliavinit[6] një fjalor etimologjik me disa tekste e pak shënime gramatikore mbi të folmen e shqiptarëve të Dalmacisë.

Në fund të shekullit të kaluar N.Pederseni[7] botoi për çamërishte

1. C.H.Reinhold, *Noctes Pelasgicae*, Athen, 1855.
2. M.Lambertz, *Albanische Mundarten in Italien*, në «Indogerm. Jahrbuch», dhe *Italoalbanische Dialektstudien*, në «Zeitschr. f. vergleichende Sprachforschung», 51, 52, 53.
3. G.Weigand, *Der gegisch Diale(t von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien*, «Jahresverichten des Institutes für Rumänische Sprache in Leipzig», 17, 1911.
4. G.Weigand, *Das albanische in Attika*, në «Balkan-Archiv», 2, 1926.
5. A.P.Furiki, *Ien Attiki Elibnalvaniki dialektos*, në «Athina». 44 (1932), 45 (193
6. C.Tagliavini, *l'albanese di Dalmazia*, Firenze, 1939 (shih dhe recensionin e Joklit, *Zur Erforschung der albanesischen Mundart von Borgo Erizzo in Dalmation*, Firenze 1940).
7. H.Pedersen «*Albanesiche Texte mit glossar*», Leipsig, 1895.

disa tekste dialektore me një glosar e shënime gjuhësore, dhe në vitet dyzet të shekullit tonë K.Taliavini[8] duke përmbledhur sidomos të dhëna të pjesshme e të shpërndara në botime të ndryshme, bëri objekt studimi të folmet shqipe të Kosovës e Maqedonisë, duke u ndalur kryesisht në sferën e fonetikës.

Për të folmet e brendshme të Shqipërisë, si studim të plotë e me karakter të mirëfilltë dialektologjik, mund të përmendim vetëm monografinë e V.Cimokovskit[9] mbi të folmen e Dushmanit (Dukagjin), në të cilën, me përjashtim të sintaksës, që jepet pjesërisht, fonetika dhe morfologjia e së folmes përshkruhen në mënyrë tërësore. Veçoritë dialektore të disa të folmeve të brendshme u dhanë në atë periudhë edhe nëpërmjet një numri gramatikash, botimi i të cvilave kishte më fort për qëllim njohjen e strukturës gramatikore të shqipesh prej të huajve. Këto gramatika nuk përshkruanin aq shqipen e përbashkët sa një të folme ose një grup të folmesh të afërta mbi të cilat u mbështetën. Kështu në gramatikën e J.G.Hanit[9] gjejmë të dhëna mbi të folmen e Rrëzës së Tepelenës, tek O.Dozoni[10] për të folmen e zonës së Përmetit e të Zagorisë dhe tek G.Vajgandi[11] për të folmet e Shqipërisë së Mesme, në mënyrë të veçantë për të folmen e qytetit të Elbasanit. Janë botuar në atë periudhë edhe gramatika me një bazë dialektore më të gjerë, siç është ajo e K.Kristoforidhit[12] për dialektin toskë, ajo e J.Piskos[13] për gegërishten veriore e ndonjë tjetër.

Me një vlerë sinjalizuese dhe orientuese janë edhe disa njoftime të shkurtra në formë vëzhgimesh[14] të dhëna më tepër për një numër veçorish fonetike të të folmeve të shqipes dhe të botuara andej e këtej brenda dhe jashtë Shqipërisë, si edhe disa relacione[15], me anë të të cilave jepen të dhëna mbi disa tipare karakteristike të një të fol-

8. C.Tagliavini. *Le parlate albanesi di tipo Ghego orientale (Dardania e Macedonia nordocidentale)*, Roma, 1942.
9. I.G.Hahn, *Albanesische Studien II*, 1954.
10. Au.Dozon, *Manuel de la langua chkipe ou albanaise*, Paris, 1879.
11. G.Waigand, *Albanesische Grammatik*, Leipzig, 1913.
12. K.Kristoforidhi, *Gramatiki tis albanikis glossis kata tin toskikin dialektos*, Konstandinopolis, 1882.
13. J.Pisko, *Kurzgefasste Handbuch der nordalbanischen Sprache*, Wien, 1896.
14. A.Imami, *Disa trajta dialektore të krahinës së Dibrës*, në «Edukata e Re», 3, 1930; Po ai, *Mbi disa trajta dialektore të shqipes*, në «Edukata e Re», 12, 1930. Shteku nga Luma (pseudonim), *Vërejtje dialektesh*, në «Edukata e Re», 1, 1931.
15. G.Pekmezi, *Vorlaufiger Bericht über das Studien des albanesiche Dialektes von Elbbsan*, në «*Vorlaufiger Bericht der Balkan-kommision*», VIII, Wien, 1908 N.Jokl, *Vorlaufiger Bericht die im, Auftrag der Balkankommision der k.Akad*; *D.Jiss.* in Wien *Durchge furten nordostgegischen Dialektstudien*, në «Anzeiger», 1, 1915; M.Lambertz, *Bericht über maine linguistischen Studien in Albanien, von Mittel Mai bis Ende August* 1916, në «Anzeiger, d.k.Akad.Wiss. in Wien, Phhist. klasse», XX, 1916, f. 122-146.

meje ose të një dialekti të nxjerra nga disa hetime gjugësore të shpejta të bëra në një numër krahinash të vendit tonë.

Në atë periudhë disa veçori të dialekteve e të të folmeve të shqipes janë bërë të njohura edhe nëpërmjet botimeve të folklorit shqiptar, nëpërmjet letërsisë artistike, nëpërmjet disa gramatikave e botimeve të tjera, por, duke mos qenë ato punime dialektologjike të mirëfillta, kuptohet vetvetiu se të dhënat e tyre janë të përgjithshme dhe jo të përpikta.

Për punime dialektologjike përgjithësuese, ku të vështroheshin në mënyrë tërësore dallimet dialektore të shqipes, as që mund të bëhet fjalë, mbasi atëhere ekzistonin shumë zbrazëti në njohjen e të folmeve dhe dialekteve të gjuhës sonë. Vetëm për ndarjen dialektore të shqipes u dhanë mendime. Kuptohet vetvetiu se, duke qenë në atë kohë të mangëta njohuritë mbi veçoritë dialektore të të folmeve dhe mbi shtrirjen e tyre gjeografike, edhe konkluzionet gjithashtu qenë të mangëta e jo të sakta.[16]

Veç M.Lambercit dhe J.Rrotës[17], që janë ndalur posaçërisht dhe që e kanë trajtuar disi më gjerë këtë problem, shumë dijetarë të tjerë nuk kanë dhënë veçse disa konstatime për ndarjen e shqipes në dy dialekte kryesore, ndonjë aty-këtu edhe për degëzimin e dialekteve, por vetëm në vija të përgjithshme.

M.Lamberci është marrë me këtë çështje qysh më 1916 në «*Bericht über meine linguistischen Studien...*»

Më vonë ai është rikthyer disa herë te kjo temë, por në një formë më të përpunuar e më të zhvilluar mendimet e veta i dha në veprën «Lehrgang des Albanischen», T. III, 1959. Si J.Rrota edhe M.Lamberci nuk japin karakteristika dalluese për të gjitha degët dialektore të shqipes, por vetëm për dy dialektet kryesore; veç kësaj, ata sjellin si veçori të dialekteve edhe ato tipare që nuk janë të përbashkëta, por që janë karakteristike për grupe të folmesh ose për të folme të veçanta.

Vonë, nga fillimi i viteve dyzet të shekullit tonë, lindën edhe mendime për të ndërmarrë hartimin e një atlasi dialektologjik të shqipes, por u realizua prej E.Çabejt[18] vetëm përgatitja e një pyetësori, i cilin as arriti të përdorej për mbledhjen e materialeve dialektore në terren.

---

16. Edhe mendimet e dhëna në sesionin mbi gjuhën letrare kombëtare të zhvilluar në Tiranë më 1952 për ndarjen dialektore të shqipes u mbështetën mbi njohuritë që ekzistonin deri para Çlirimit (shih referatin e Dh.S.Shuteriqit dhe diskutimet e O.Myderrizit e të Z.Sakos në «Buletin të Institutit të Shkencave» 4, 1952).
17. *Sintaksa e gjuhës shqipe*, botim II, Shkodër, 1943.
18. *Atllas gjuhësor shqiptar — Atlante lingiuishtica albanese*, 1-V, Grottaferrata, «S.Nilo», 1943.

Siç shihet, të folmet që u bënë objekt studimi në etapën e parë ishin jo vetëm të pakta në numër, por edhe të zgjedhura sipas rastit në zona të veçuara të trevës së shqipes. Në të folmet që u bënë objekt hulumtimi nuk u vëzhguan kudo të njëjtat dukuri dialektore, gjithashtu, hulumtimet nuk u bënë për të gjitha sferat e gjuhës, por të shumtën e herës duke u përqendruar kryesisht në sferën e fonetikës dhe aty-këtu, në një masë më të vogël, edhe në sferën e morfologjisë, sintaksa pothuajse u la mënjanë dhe leksiku u vëzhgua shumë rrallë. Si rrjedhim, me të dhënat e asaj etape nuk përvijohen dot isoglosa të plota të veçorive dialektore të të gjithë trevës së shqipes, me anë të tyre merren vetëm njoftime të shkëputura dhe mund të formohet në vija të përgjithshme një ide për ndarjen dialektore. Përveç kësaj, disa studime dialektologjike të asaj etape duhen marrë me rezervë, sepse materialet dialektore mbi të cilat janë mbështetur ato nuk janë mbledhur krejtësisht në terren nga gjuha e gjallë e folur, por janë nxjerrë edhe nga botime folklorike, nga libra shkollorë, nga gramatika, nga tekste të përkthyera etj.

Gjithë kjo që u tha për gjendjen e dialektologjisë shqiptare në etapën e parë është e shpjegueshme, sepse gjatë asaj kohe kërkimet dhe studimet gjuhësore për shqipen në pjesën më të madhe u bënë nga të huaj, pa një plan unik e të përcaktuar, u kryen sipas rastit, me metoda të ndryshme, herë-herë edhe të pasakta, u drejtuan nga qendra të ndryshme shkencore e politike dhe u bënë për interesa të veçanta të studiuesve të ndryshëm.

1.1.2. Krejt ndryshe nga etapa e parë, pas Çlirimit puna kryesore për hetimin dhe studimin e dialekteve të shqipes u përqendrua në një qendër të vetme që ndodhej tashti jo jashtë, por në Shqipëri. U ngrit më 1947 Instituti i Shkencave, brenda tij më 1955 u krijua Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë me sektorë të ndryshëm, ndërmjet të cilëve edhe sektori i dialektologjisë. Ishin të qarta nevojat dhe u përcaktuan detyrat e afërta, pak më vonë edhe ato të perspektivës.

Ndër detyrat aktuale e me rëndësi që i shtroheshin gjuhësisë shqiptare pas Çlirimit ishin edhe kërkimet e studimet në lëmin e dialekteve të shqipes. Kjo doli qartë dhe u përcaktua mirë sidomos në dy sesionet kombëtare të gjuhësisë shqiptare që u zhvilluan në vitin 1952, i pari për problemet e gjuhësisë në dritën e veprës së J.V.Stalinit «Marksizmi dhe çështjet e gjuhësisë»[19] dhe i dyti për problemin e gjuhës letrare kombëtare shqipe.[20]

Nga punimet e këtyre dy sesioneve shkencore dilte në dukje mungesa e njohurive të mjaftueshme e të sakta për dialektet e shqipes dhe shtrohej detyrë e ngutshme që, me anë të një pune intensive dhe

19. Shih *Bul. për shk. shoq.*, 1, 1952.
20. *Bul. për shk. shoq.* 4, 1952.

BIBLIOTEKA E INSTITUTIT
SHKENCAVE
Nr. 1401

sistematike, të njiheshin mirë veçoritë dialektore të të folmeve të shqipes në sferat e ndryshme të gjuhës, duke u bërë kërkime në terren në gjuhën e gjallë të folur, të njihej më thellësisht ndarja dialektore e gjuhës sonë, të studiohej shkalla e afërsisë dhe e largësisë së dialekteve, si dhe zhvillimi historik i tyre.[21]

Nëpërmjet përshkrimit e studimit të kujdesshëm të dialekteve do të dilnin materiale me interes për hisotorinë e gjuhës shqipe, në mënyrë të veçantë të gramatikës historike të saj, si edhe për zhvillimin e gjuhës letrare. Për historinë e gjuhës shqipe, që është shkruar relativisht vonë dhe për të cilën burimet letrare për shekujt e parë nuk japin materialin gjuhësor të dëshirueshëm e të mjaftueshëm, të dhënat dialektore marrin një rëndësi të dorës së parë.

Për shkak se gjuha jonë letrare kombëtare në atë kohë ishte ende në procesin e formimit, duke marrë një rrugë të përcaktuar drejt njësimit, kërkimet dhe studimet dialektologjike shtroheshin atëhere si detyrë edhe për sqarimin e disa problemeve të saj. Ndoshta jo në atë masë si më 1952, kjo detyrë për dialektologjinë shqiptare do të qëndronte edhe dhjetë vjet më vonë, më 1962, kur gjuha letrare kombëtare shqipe po kristalizohej. Këtë e shohim në detyrat që u caktoheshin shkencave tona shoqërore në *Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike*, ku për dialektologjinë shqiptare thuhej: Drejtimi i përgjithshëm i kërkimeve dialektologjike do të ndjekë dy qëllime: Nga njëra anë, t'u shërbejë studimeve historike si një element vendimtar dhe, nga ana tjetër, *t'i shërbejë sqarimit të problemeve të ndryshme të gjuhës së sotme letrare shqipe, sidomos atyre që kanë të bëjnë me bazën e saj dialektore dhe me bashkëveprimin ndërdialektor*[22] (nënvizuar nga J.Gj.).

Si detyrë e afërt u caktua vëzhgimi i përgjithshëm në gjerësi i veçorive të të folmeve të shqipes, përcaktimi i kufijve të përhapjes territoriale të tyre dhe përshkrimi i dukurive më pak të njohura. Me plotësimin e kësaj detyre do të ndryshonte nga pikëpamja sasiore dhe cilësore gjendja e prapambetur e dialektologjisë shqiptare.

Rezultatet e kërkimeve do të bëheshin të njohura nëpërmjet skicave dialektologjike përshkruese-diferencuese, të cilat do të jepnin tiparet karakteristike dialektore të një të folmeje të marrë veçmas ose të disa të folmeve të afërta nga pikëpamja gjuhësore dhe territoriale.

Hetimi dhe studimi i dialekteve të shqipes do të bëhej sipas një metode të përcaktuar e të vetme të mbështetur në metodologjinë e gjuhësisë marksiste: materiali dialektor do të mblidhej i gjithë në

21. *Bül. për shk. shoq.*, 1, 1952, f. 91.
22. A.Kostallari, *Gjendja e studimeve albanologjike. Probleme dhe detyra të reja* në «Konferenca e Parë të Studimeve Albanologjike», Tiranë, 1965, f. 59.

terren nga gjuha e gjallë e folur dhe duke e drejtuar vëmendjen në të gjitha sferat e gjuhës, për ta parë kështu gjuhën në tërësinë e saj e jo në mënyrë të pjesshme e të shkëputur në hallka të veçanta. Në fillim u caktuan tetëdhjetë qendra të banuara, ku do të bëheshin kërkimet, më vonë ky numër u shtua. Materiali dialektor do të mblidhej kryesisht me metodën direkte, d.m.th. me anë të vrojtimit të drejtpërdrejtë të bërë nga specialistët, por nuk do të përjashtohej edhe përdorimi i metodës së anketës kryesisht nga arsimtarë. Probleme të tjera më të vogla, që lidheshin me punën konkrete, do të përcaktoheshin dalngadalë gjatë procesit të punës. Këto probleme i liheshin praktikës për t'i zgjidhur më mirë. Të tilla ishin: përcaktimi i mëtejshëm i rrjetit të pikave (qendrave) të banuara ku do të bëheshin hetimet, gjë që varej nga lloji i terrenit në zona të ndryshme të Shqipërisë dhe nga kushtet pak a shumë të dallueshme, nëpër të cilat kishin kaluar gjatë historisë së tyre banorët e krahinave të ndryshme; krahas kësaj do të bëhej përcaktimi më i mirë i dukurive dialektore që do të hetoheshin, do të shihej problemi i zgjedhjes dhe i numrit të subjekteve që do të përdoreshin gjatë hetimit në një pikë të banuar, plotësimi dhe përcaktimi i shenjave të transkriptimit që varej nga njohja më e saktë e tingujve, e nuancave dhe e timbreve të tyre të pazbuluara, problemi i përsosjes së vazhdueshme të mënyrës së përpunimit të materialit dialektor të mbledhur në terren etj. Këto probleme e të tjera të kësaj natyre u zgjidhën kënaqshëm dalngadalë me rritjen e përvojës së kuadrit specialist gjatë hetimit dhe studimit të dialekteve.

Puna e parë që u bë për zbatimin e këtij programi të hetimit të dialekteve të shqipes qe hartimi i një pyetësori[23] dialektologjik në vitin 1953 prej M.Domit dhe E.Çabejt. Pyetësori ishte i nevojshëm për të ndihmuar dhe për të drejtuar në mënyrë të njëjtë të gjithë mbledhësit e materialeve dialektore. Ky pyetësor u hartua kryesisht për t'u përdorur nga mbledhës jospecialistë (arsimtarë, punonjës të kulturës etj.), por, megjithatë, në fillim ai u përdor si ndihmës edhe nga specialistët. Ai përbëhej nga dy pjesë: nga një pjesë e përgjithshme, ku përfshihen 63 pyetje (20 për fonetikën, 30 për morfologjinë e sintaksë e 13 për leksikun) për çështje që do të hetoheshin në të gjitha të folmet, dhe nga një pjesë e veçantë me 41 pyetje (20 për fontikën e 21 për morfologjinë e sintaksën) për hetimin e veçorive me një shtrirje të kufizuar gjeografike.

Vëllimi i gjithë pyetësorit ishte i vogël, përmbante sidomos pak pyetje për sintaksën dhe leksikun. Kjo varej në një farë mase edhe nga qëllimi për të cilin ishte hartuar ai (do të përdorej edhe nga an-

23. Ai është botuar prej M. Lambertzit në *Lehrgang des Albanischen*, T. III, Halle (Saale), 1959, f. 53-59.

ketues jospecialistë), por më tepër kushtëzohej nga gjendja e studimeve dialektologjike të asaj kohe. Megjithatë, hartimi i këtij pyetësori qe një hap me rëndësi që bënte gjuhësia jonë jo vetëm nga pikëpamja e dobisë praktike, për ndihmën që do të jepte ai në mbledhjet e materialeve dialektore të shqipes, por edhe nga pikëpamja teorike, sepse për herë të parë bëhej në vendin tonë nga gjuhëtarë shqiptarë një punë e tillë me karakter përgjithësuese e me vlerë programi. Nga pikëpamja teorike hartimi i këtij pyetësori pati rëndësi edhe për faktin se autorët e tij u mbështetën në metodologjinë e shëndoshë marksiste: me anë të pyetjeve të formuluara posaçërisht për çështje të fonetikës, morfologjisë, sintaksës, leksikut kërkohej zbulimi i dallimeve dialektore në të gjitha sferat e gjuhës, jo vetëm për leksikun për të ndjekur historinë e fjalës si njësi të veçuar.

Katër vjet më vonë, më 1957, pasi ishte mbledhur material dialektor në disa krahina dhe kur kërkimet e studimet për dialektet e shqipes po hynin në fazën e një pune më sistematike e më intensive, u hartua një pyetësor tjetër prej S.Floqit[24]. Për nga metoda ky pyetësor nuk ndryshonte nga i pari. Ai dallohej në ndërtimin e tij si një i tërë, i pandarë në një pjesë të përgjithshme dhe në një tjetër të veçantë, dallohej gjithashtu edhe se u thellua më tepër, i shtjelloi më gjerë disa çështje dhe shtoi në një masë të madhe numrin e pyetjeve për sintaksën e leksikun, që ishin të pakta në pyetësorin e parë. Pa llogaritur këtu numrin e madh të nënpyetjeve, pyetësori i dytë përmbante gjithsej 304 pyetje, nga të cilat: 70 për fonetikën, 54 për morfologjinë, 20 për sintaksën dhe 60 për leksikun (për leksikun pyetjet janë tematike e jo për fjalë të veçanta).

Pyetësori i vitit 1957 qe një plotësim dhe një zhvillim i mëtejshëm i pyetësorit të vitit 1953. Ky pyetësor ishte i nevojshëm për drejtimin që po merrnin në atë kohë kërkimet dhe studimet dialektologjike në vendin tonë dhe bëhej i mundshëm, sepse, veç pyetësorit të parë që ekzistonte, mbi të cilin edhe u mbështet ky i dyti, ishin grumbulluar të dhëna të reja për të folmet e shqipes.

Për nga qëllimi i përdorimit pyetësori i dytë i kalonte disi caqet e metodës së anketës, prandaj ai u përdor diçka më tepër se i pari edhe prej mbledhësve specialistë, të cilët, sigurisht, në terren ndiqnin edhe fenomenet e panjohura, që nuk pasqyroheshin në pyetësor, dhe thelloheshin në zbulimin e specifikës së të folmes që hetohej.

Të dy pyetësorët u hartuan si programe ndihmëse për fazën e hetimit të përgjithshëm të dialekteve të shqipes dhe u përdorën si të këtillë. Qëllimi i tyre nuk i kalonte kufijtë e kësaj faze. Për faza të mëtejshme të dialektologjisë shqiptare do të duheshin pyetësorë të

24. Botuar në «Dialektologjia shqiptare», I, Tiranë 1971, f. 371-447.

tjerë të përshtatshëm për detyrat e reja që do të dilnin, si p.sh. për ndryshimet e reja që do të pësonin dialektet në vendin tonë, për hartimin e atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe etj.

Pas një pune sistematike e intensive që zgjati deri në fillim të viteve '70 u plotësua detyra që i kishte vënë vetes gjuhësia shqiptare për këtë etapë, përfundoi hetimi i përgjithshëm i të folmeve pothuaj në gjithë territorin e RPSSH. U bënë hetime në rreth 300 qendra të banuara, ku u mblodh një material dialektor i pasur. Po sipas një programi dhe disa kritereve të caktuara është bërë edhe regjistrimi në shirita magnetofoni i teksteve dialektore në një numër të mirë pikash në Veri dhe në Jug. Me këto të dhëna është ngritur një fonotekë dialektore ku përfshihen edhe regjistrimet e bëra për «Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe». Gjithë puna në fazën e hetimit të përgjithshëm të dialekteve u drejtua nga prof. M.Domi.

Krahas regjistrimit në terren është bërë edhe përpunimi i materialit në qendër, janë skeduar dhe janë sistemuar sipas kërkesave shkencore veçoritë dialektore të shumicës së pikave të banuara që u hetuan. Është formuar kështu një kartotekë e pasur dialektologjike, në të cilën gjatë fazës së parë materiali është sistemuar vetëm sipas parimit territorial, d.m.th. duke vendosur së bashku tiparet dalluese të çdo qendre të banuar, kurse më vonë filloi edhe sistemimi i tij sipas kriterit tematik, një fenomen dialektor për të gjithë qendrat e hetuara.

Hetimi i dialekteve nuk u bë sipas zonave administrative, por sipas krahinave ku shtrihet një e folme ose disa të folme të afërta nga pikëpamja gjuhësore. Gjatë fazës së hetimit të përgjithshëm të dialekteve materiali dialektor u mblodh kryesisht me metodën e vrojtimit të drejtpërdrejtë të bërë nga gjuhëtarët, duke marrë pjesë në disa ekspedita edhe studentë të degës gjuhë-letërsi shqipe të Universitetit dhe një numër mësuesish të rretheve.

Në pjesën më të madhe materiali dialektor është mbledhur me metodën e bisedës së lirë dhe në një masë më të vogël me pytje të tërthorta.

Me qëllim që materiali i regjistruar në terren të ishte sa më i krahasueshëm për çdo pikë të hetuar, që të formohej kështu një ide e saktë mbi shtrirjen gjeografike të veçorive dialektore, në shumicën e pikave u synua nxjerrja sa më e plotë e të dhënave që kërkonte pyetësori dhe e disa të dhënave të tjera për probleme të panjohura mirë, që i dilnin specialistit gjatë hetimit. Por në një numër të vogël qendrash banimi hetimi u bë i pjesshëm, sepse ato qendra u caktuan si pika plotësuese në trevën e një të folmeje. Sigurisht, në vitet e para të dhënat e kërkimeve nuk qenë gjithaq të plota, por dalngadalë, me njohjen më të mirë të të folmeve dhe me rritjen e përvojës së specialistëve, u arrit që dallimet dialektore të një të folmeje të kapeshin në mënyrë më të plotë e më të thellë.

Gjithmonë është synuar që të vëzhgoheshin dallimet dialektore në të gjitha sferat e gjuhës, por, megjithatë, janë hetuar më mirë dallimet në fonetikë e në morfologji, po ashtu në një farë mase edhe në leksik, kurse dallimet në fushën e sintaksës janë ndjekur më pak.

Për shkak se gjuhësia jonë në këtë periudhë i kishte vënë vetes si qëllim hetimin e përgjithshëm të dialekteve të shqipes dhe duke qenë se dialektet e gjuhës sonë nuk ishin fare të panjohura, në terren u bënë kërkime dhe u regjistruan vetëm tiparet dalluese të të folmeve edhe për këto pa hyrë tepër në hollësira. Me këtë shpjegohet edhe tipi përshkrues-diferencues i shumicës së studimeve dialektologjike të bëra gjatë fazës së hetimit të përgjithshëm. Nëpërmjet këtyre studimeve janë përshkruar veçoritë dialektore të një të folmeje ose të një grupi të folmesh të afërta nga pikëpamja gjuhësore dhe janë lënë mënjanë anët e përbashkëta të të gjitha të folmeve të shqipes.

Në fazën e hetimit të përgjithshëm objekt vëzhgimi u bë kryesisht gjuha e brezit të vjetër. Sigurisht, në këtë mënyrë dialekti shihet si diçka statike, por kjo ka pasur në atë kohë shkaqet e veta: nga njëra anë, kjo shpjegohet me faktin se ndikimi më intensiv i dialekteve mbi njëri-tjetrin e sidomos ndikimi i gjuhës letrare mbi to ka filluar vonë, nga ana tjetër, me faktin se në atë fazë dialektologjia shqiptare i kishte vënë vetes si qëllim të bënte një hetim të përgjithshëm e të shpejtë të të folmeve të shqipes, në mënyrë që të formohej një pamje pak a shumë e plotë mbi dallimet dialektore për të plotësuar nevojat imediate të studimit të gjuhës shqipe e të historisë së saj edhe për t'u shërbyer kërkimeve e studimeve të thelluara që do të bëheshin në fazën e dytë për hartimin e atlastit e për qëllime të tjera.

Një synim tjetër i dialektologjisë shqiptare në vendin tonë gjatë fazës së hetimit të përgjithshëm ishte edhe studimi i të folmeve kryesisht me anë skicash dialektologjike përshkruese-diferencuese. Studimet dialektologjike të këtij tipi u bënë krahas hetimit të të folmeve.

Janë hartuar më shumë se dyzet skica që përshkruajnë veçoritë dalluese të të folmeve të shumicës së krahinave të RPS të Shqipërisë dhe rreth 15 skica të tjera të tilla nga gjuhëtarë shqiptarë të Kosovës e të Maqedonisë për të folme të atyre zonave. Prej këtyre punimeve janë botuar[25] tashmë rreth 40. Janë studiuar shumica e të folmeve të të dy dialekteve dhe të grupit të të folmeve kalimtare. Kështu prej të folmeve të dialektit jugor janë përshkruar nga Q.Haxhihasani të folmet e Çamërisë (me materiale të mbledhura në çamët e larguar prej Çamërie më 1945 e që banojnë sot në RPS të Shqipërisë); nga M.Totoni e folmja e Muzinës (Delvinës), e Bregdetit të Poshtëm (Sarandë), e Gjirokastër (qytet), e Zagorisë, Kurveleshit; nga S.Floqi

25. Referencat për çdo punim gjenden sipas autorëve në bibliografinë që është vendosur në fund të këtij punimi.

e folmja e Dangëllisë (Përmet); nga J.Gjinari e folmja e Beratit (qytet), të folmet e Myzeqesë, (aty përfshihet edhe e folmja kalimtare e Lushnjës), e folmja e Mallakastrës, e Skraparit, e folmja e Devollit, e Korçës dhe e fushës së Korçës dhe e Pogradecit, nga J.Thomaj e folmja e Semanit (Myzeqe); prej të folmeve të dialektit verior janë bërë objekt përshkrimi nga M.Çeliku e folmja e Peqinit, e Kërrabës, e Kavajës, e Durrësit, e Ndroqit, nga J.Gjinari e folmja e Krujës dhe e Malësisë së saj, e folmja e Krasniqit, Gashit e Bytyçit të rrethit të Tropojës, e folmja e Bregut të Bunës, nga B.Beci e folmja e Matit, e Reç-Dardhës, e Zerqanit, e Luznisë, e Grykës së Madhe (Peshkopi), e e Shkrelit; nga Q.Haxhihasani e folmja e Lurës; nga Xh.Topalli e folmja e Pukës, nga E. Lafe e folmja e Nikaj-Mërturit, nga Gj. Shkurtaj e folmja e Hotit, e Kastratit, e Rranxave (Shkodër), e Kelmendit, e Bregut të Matit, nga Xh.Gosturani e folmja e Çeremit dhe e Valbonës, e Hasit, e Ragamit, e Berishës, nga T.Osmani e folmja e Shirokës, nga Sh.Hoxha e folmja e Vilë-e-Kalisit; nga L.Mulaku e folmja e Bajgorës (Kosovë); nga L.Mulaku e M.Bardhi e folmja e Peshterit (afër Novi Pazarit); nga M.Halimi e folmja e Moravës (M. e Poshtme, dhe e M. Sipërme); nga F.Raka e folmja e Kaçanikut, nga R.Nesimi e folmja e rrethit të Tetovës; nga H.Kelmendi e folmja e Turiçevit (Drenicë); nga T.Kelmendi e folmja e Balincës (Prekorupë), nga R.Mulaku e folmja e Vuçiternit etj., prej të folmeve kalimtare janë përshkruar nga Q.Haxhihasani e folmja e Sulovës, nga M.Çeliku e folmja e Dumresë dhe e folmja e Shpatit.

Veç skicave e monografive të përmendura, janë botuar ndërkohë edhe artikuj me vëzhgime e shënime të pjesshme për shumë të folme të territorit të RPS të Shqipërisë, të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë Jugore dhe për disa të folme të diasporës shqiptare, si ato të Italisë, Greqisë, Bullgarisë e BS[26].

Duke filluar nga viti 1972, u bënë ekspedita dialektologjike të përbashkëta me gjuhëtarë shqiptarë të Kosovës në gjithë krahinën, me përjashtim të Gollakut dhe Moravës. Me këto ekspedita, me anë të të cilave u mblodh material në rreth 80 pika, vijoi plotësimi i hetimit të përgjithshëm të dialekteve në territoret e shqiptarëve jashtë kufijve të RPS të Shqipërisë, duke u mbledhur të dhëna të rëndësishme e të shumta në një zonë të gjerë, ku shtrihet pjesa më e madhe e të folmeve të gegërishtes verilindore.

Hetimin e përgjithshëm të dialekteve për trojet e shqiptarëve në Jugosllavi e plotësuan kohë pas kohe gjatë këtyre 20 vjetëve të fundit me kërkimet dhe studimet e ndryshme, me skica e monografi dialektologjike të bëra nga vetë gjuhëtarët shqiptarë të atyre anëve

26. Shih më hollësisht *Gjendja dhe perspektiva e dialektologjisë shqiptare*, në «Dialektologjia shqiptare» I, Tiranë 1971, f. 20-29.

nën drejtimin e prof. Idriz Ajetit. Studime të këtilla janë botuar për një numër të mirë të folmesh shqipe t ë sKoovës, tëSerbisë Jugore, të Maqedonisë e të Malit të Zi.[27] Ato janë një ndihmesë me vlerë të madhe për dialektologjinë shqiptare, sepse plotësojnë nga pikëpmaja dialektologjike njohjen e shqipes në territoret e saj që vijojnë matanë kufijve të RPS të Shqipërisë.

Në të folmet e diasporës deri tashti janë bërë pak kërkime në fshatrat arbëreshe të Italisë: është bërë një ekspeditë në disa fshatra të Kozencës për një njohje të përgjithshme të të folmeve të tyre, janë bërë edhe anketa për «Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe» në gjashtë fshatra (tre në anët e Kozencës, dy në anët e Katahxaros dhe një në Sicili). Këto kohët e fundit është gjallëruar interesimi i vetë studiuesve arbëreshë për të folmet e ngulimeve shqiptare në Itali, ndër të cilët dallohet sidomos prof. F.Solano.

Skicat dhe monografitë për të folme të krahinave të mëdha e të vogla dhe për të folme të një pike të vetme të banuar fshati ose qytet mbuluan gati gjithë territorin e Shqipërisë në Veri dhe në Jug; *«rrallë (ose vështirë) mund të gjesh për ndonjë gjuhë tjetër një rrjet jo më të dendur, por as po aq të dendur hulumtimesh dhe përshkrimesh të degëzimeve dialektore»*[28].

Hetimi i përgjithshëm i dialekteve të shqipes, që u arrit me këto hulumtime e përshkrime, plotësoi, zgjeroi dhe thelloi njohuritë mbi veçoritë dalluese të të folmeve. Dolën në pah tipare dalluese të panjohura deri atëhere, si fonema e variante të fonemave të ndryshme bashkë me kushtet fonetike ku dalin, kategori e forma të ndryshme gramatikore bashkë me paradigma të tëra klasash të caktuara gramatikore, disa dallime në ndërtimet sintaksore dhe shumë dallime të sferës së leksikut. Ndjekja e këtyre dukurive dialektore në të folmet që vijnë në hapësirë njëra pas tjetrës zbuloi në përgjithësi edhe arealet e tipareve dalluese dialektore të gjuhës shqipe.

Gjatë fazës së hetimit të përgjithshëm dialektologjia jonë nuk u kufizua vetëm me përshkrimin e të folmeve, por u ndal edhe në studimin e disa dukurive dialektore të trevave të veçanta ose të mbarë truallit të gjuhës shqipe, të cilat japin gjendjen e sotme dhe shpjegojnë shkaqet dhe rrugët e zhvillimit historik të këtyre dukurive, si për inovacionin e *i*-së, *y*-së, *g*-së e grupeve *tj*, *dj* në të folmet e gegërishtes qendrore (nga B.Beci), për rotacizmin në të folmet kalimtare, për togje

27. Për studimet e të folmeve të kësaj treve shih më hollësisht: B.Beci, *Realizime në studimin e të folmeve lindore të dialektit verior të shqipes*, në «SF», 1, 1971; f.165-176 dhe L.Mulaku, *Realizimet e studimeve dialektologjike shqipe në Jugosllavi*; në «Seminar ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqipe». Prishtinë, 1979.
28. M.Domi, *Gjendja, problemë dhe detyra të dialektologjisë shqiptare në fazën e sotme*, në «Dialektologjia shqiptare» IV, 1982, f.4.

foljore leksikalisht të kufizuara, për zanoiet e gjata (nga M. Çeliku), për trajtën e pjesores që i mbaron tema me bashtingëllore lëngëzore në toskërishte (nga T.Totoni), për diftongjet *ua*, *ie*, *ye*, grupet *kl*, *gl*, grupet me bashkëtingëllore + n, zanoret hundore të gegërishtes dhe *ë* e toskërishtes (nga J.Gjinari). Çështje të fonetikës së dialekteve janë trajtuar e shpjeguar në disa punime historike të E.Çabejt, si te punimi për historinë e konsonantizmit, për kuantitetin e zanoreve, për diftongjet, për nazalizmin etj.

Në këtë fazë të dialektologjisë shqiptare, sidomos nga fundi i saj, u bënë edhe disa studime përgjithësuese të shkallëve të ndryshme, të cilat, me të dhënat e hetimeve të asaj kohe, bënin edhe një përmbyllje të kërkimeve të fazës së parë të etapës së dialektologjisë shqiptare të Pasçlirimit. Në disa artikuj është trajtuar grupimi i të folmeve sipas degëzimit dialektor të sotëm të shqipes, si për grupin e të folmeve të toskërishtes veriore (J.Gjinari, në Konf. I e Stud. Alban.), për gegë rishten Jugore (M.Çeliku, në «SF», 2, 1986), për gegërishten veriperëndimore (B.Beci, në «SF», 1970), për gegërishten verilindore (Xh. Gosturani, në «SF», 4, 1983 dhe B.Beci në shtyp). Aty përcaktohen për herë të parë kufijtë gjeografikë të disa grupeve të folmesh, jepen edhe veçoritë gjuhësore karakteristike të tyre. Studime të këtij lloji janë dhe ato që trajtojnë ndarjen dialektore të gjuhës shqipe[29] dhe veçoritë karakteristike të dy dialekteve të saj. Njëri nga këto punime, duke u mbështetur në të dhënat e kërkimeve të reja, jep degëzimin dialektor të gjuhës shqipe në dialekte, nëndialekte e grupe të folmesh me shtrirjen e tyre gjeografike dhe me veçoritë dalluese në bazë të kriterit territorial, kurse i dyti[30], në bazë po të këtij kriteri, përpiqet të përcaktojë se cilat nga karakteristikat e dy dialekteve janë dalluese absolute (njëgjymtyrëshe) dhe cilat janë joabsolute (dygjymtyrëshe). Në disa studime të tjera përgjithësuese me karakter historik, për aq sa lejonin të dhënat e kohës, janë analizuar kronologjia dhe shkaqet e lindjes e të zhvillimit të disa veçorive dalluese dialektore të shqipes dhe e degëzimit të saj në dialektet dhe në grupet e të folmeve që arritën deri në ditët tona.[31] Duke u mbështetur në rindërtimin e brendshëm

29. J.Gjinari, *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, në «SF», 4, 1966, f. 99-117.
30. *B.Beci, Rreth tipareve karakteristike të dy diaekteve të shqipes*, në «SF», 4, 1983. f. 53-87.
31. E.Çabej, *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, në «Dialektologjia shqiptare» II, 1974, f.429-438; J.Gjinari, *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, në «SF», 4, 1986, f. 127-144; *Struktura dialektore e shqipes e parë në lidhje me historinë e popullit*, në «SF», 3, 1976, f.127-144; *Dëshmi të historisë së gjuhës shqipe për kohën dhe vendin e formimit të popullit shqiptar*, në «SF», 3, 1982, f. 41-53; B.Beci, *Lashtësia e dialekteve të shqipes - dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve*, në «SF», 4, 1982, f. 54-75.

të disa veçorive dalluese kryesore të dy dialekteve dhe në marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit janë nxjerrë përfundime të argumentuara se degëzimi i shqipes në dy dialektet është i hershëm, i fundit të kohës antike e i fillimit të mesjetës, dhe e ka burimin në zhvillimin e vet të brendshëm e jo në ndikimin e gjuhëve të tjera, sllave, siç është shprehur në mënyrë subjektive e për qëllime joshkencore V.Polaku[32].

Përgjithësimi i kërkimeve dhe i studimeve të deriatëhershme të dialekteve u bë edhe me monografi të gjera e studime të tjera që trajtojnë një grup të folmesh, si monografia për të folmet e Çamërisë (Q.Haxhihasani, në «Dialekt. shqip.» I, II), ajo për të folmet e gegërishtes qendrore (B.Beci, tezë disertacioni për gradën «Kandidat i shkencave», e pabotuar), ajo për gegërishten e Shqipërisë së Mesme (M.Çeliku, tezë disertacioni për gradën «Kandidat i shkencave», e pabotuar), studimi për të folmet e arbëreshëve të Italisë (E.Çabej, në «SF», 2, 1975).

Përgjithësimi dhe sintetizimi i kërkimeve dhe studimeve i shumëvjeçare dialektologjike, duke përfshirë të gjitha të folmet e shqipes, është bërë në tekstin universitar «Dialektologjia shqipatare» (J.Gjinari, botimi I më 1963, botimi i fundit i rishikuar, i plotësuar dhe i përpunuar më 1975). Aty janë dhënë dallimet e të folmeve në sistemin fonetik e në sistemin gramatikor duke përcaktuar arealet sipas inventarit e sistemit të fonemave, sipas varianteve fonetike të tyre dhe sipas veçorive të tjera gramatikore; janë bërë krahasime midis tipareve të gjuhës letrare kombëtare dhe tipareve dalluese të dialekteve, është trajtuar ndarja e sotme dialektore e shqipes me ndryshimet që ka pësuar gjatë historisë së saj dhe çështje të tjera të lidhura me dialektet.

Rritja e vijueshme e studimeve dialektologjike solli nevojën e nxjerrjes së serisë «Dialektologjia shqiptare» ku botohen përgjithësisht punime e materiale dialektore. Botimi i kësaj përmbledhjeje, prej së cilës deri tashti kanë dalë pesë numra, është një arritje tjetër e shënuar e dialektologjisë shqiptare në vitet e Pasçlirimit. Po kështu edhe nga Instituti Albanologjik i Prishtinës ka filluar botimi i përmbledhjes *Studime gjuhësore* (dialektologji), ku përfshihen përgjithësisht studime për të folmet shqipe në Jugosllavi.

Në mungesë të një atlasi dialektologjik, i cili as mund të projektohej pa u bërë hetimi i përgjithshëm i dialekteve, hartimi i skicave e i monografive përshkruese dhe i punimeve të tjera dialektologjike ndihmoi gjuhësinë tonë në studimin e gjendjes së sotme të shqipes e të historisë së saj dhe në zgjidhjen e disa problemeve të normës së gjuhës letrare. Të dhënat e dialektologjisë sonë të kësaj faze u shfrytëzuan

32. *Albanci a slované* (Vznik e pocarky dnešnich narečnik variant albanskych), në «Časopis pro moderni filologii» XXXIX, 2-3, f. 85-90.

në punime gjuhësore të ndryshme, si në gramatika, fjalorë, tekste, në rregullat e drejtshkrimit e në artikuj e monografi të ndryshme.

1.1.3. Pas plotësimit të detyrës së hetimit të përgjithshëm të dialekteve, aty nga mesi i viteve 70 dialektologjia shqiptare hyri në fazën e dytë të etapës së saj të Pasçlirimit. Qëllimi i kësaj faze është që të çohen më tej studimet për dialektet e shqipes, duke u thelluar në kërkimet për të njohur nga aspekte të ndryshme sistemet fonetike, gramatikore dhe leksikore të dialekteve e të të folmeve të veçanta, duke bërë përgjithësime më të plota e më të ngritura dhe duke ndjekur proceset e sotme të marrëdhënieve të dialekteve me gjuhën letrare, sidomos rrugën e tërheqjes dhe të ndryshimit të kufijve të tyre gjeografikë e shoqërorë nën veprimin e gjuhës letrare. Si detyrë e parë dhe themelore e kësaj faze është hartimi i «Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe».

Duke u mbështetur në të dhëna të kërkimeve të fazës së parë dhe në të dhëna të kërkimeve të reja, vijoi studimi i të folmeve me përshkrime të plota e të thelluara, sidomos në aspektin strukturor e funksional. Detyrë e re dhe e rëndësishme e studimeve të këtilla është njohja e thelluar e sistemit fonetik dhe e sistemit morfologjik të dialekteve. Ky synim ka filluar të plotësohet me disa punime dialektologjike të plota për të folme të veçanta[33], që janë bërë këta dhjetë vjetët e fundit krahas punës për hartimin e «Atlasit». Një ndër këto studime është monografia për të folmen e Shkodrës (B.Beci), që përshkruan sistemin fonetik të kësaj të folmeje në aspektin fonologjik duke i studiuar tingujt edhe me metodën e fonetikës eksperimentale. Është një monografi e gjerë dhe e hapur ku autori ka zgjedhur për objekt studimi vetëm sferën e fonetikës të kësaj të folmeje veriore të shqipes. Aty bëhet një analizë e hollësishme e sistemit të fonemave zanore e bashkëtingëllore të serive të ndryshme me vlerat dhe funksionet e tyre fonologjike dhe e dukurive të tjera fonetike që janë karakteristike për të folmen e Shkodrës. Veç kësaj, janë punimet për të folmene qytetit të Lezhës dhe për të folmen e Rranxave të Mbishkodrës (Gj.Shkurtaj), që rrokin të gjitha sferat e gjuhës, por në mënyrë më të plotë sistemin fonetik dhe sistemin morfologjik. Edhe në këto dy

33. B.Beci, *Le systeme vocalique et consonantique dy parler de la ville de Shkodra (Albanie du Nord), these pour le doctorat d'université*, Paris, 1977) me disa plotësime më vonë ajo u mbrojt edhe si tezë për gradën «Doktor i shkencave filologjike: Gj.Shkurtaj, *E folmja e qytetit të Lezhës*, tezë disertacioni për gradën «Kandidat i shkencave», 1981 (e pabotuar); po ai, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, në «Dialektologjia shqiptare» IV, 1984, f. 144-274; Xh.Gosturani, *Struktura gramatikore e së folmes së qytetit të Elbasanit*, tezë disertacioni për gradën «K.Shkencave» 1982 (e pabotuar)

punime të tjera për të folme të aealit veriperëndimor të shqipes përshkruhet sistemi fonologjik i të folmeve përkatëse, duke dhënë inventarin e fonemave nëpërmjet identifikimit të tyre, duke dhënë vlerën funksionale të fonemave dhe për disa tinguj realizimin fonik sipas pozicioneve fonetike të ndryshme. Një punim tjetër si këta është ai për të folmen e qytetit të Elbasanit (Xh.Gosturani), i cili bën përshkrimin e plotë të sistemit morfologjik të kësaj të folmeje, duke dhënë në fillim dhe një vështrim të shkurtër të sistemit fonologjik, kryesisht inventarin e fonemave.

Bashkë me këto monografi, që trajtojnë të folme të veçanta, u hartua dhe një punim përgjithësues mbi *sistemin fonologjik të dialekteve të gjuhës shqipe*[34] (J.Gjinari). Duke u analizuar me metodën strukturore dhe funksionale sistemet fonologjike të të folmeve, janë klasifikuar dallimet fonetike të tyre sipas funksionit dhe vendit që zenë në sistem, janë nxjerrë arealet që formohen sipas këtij shkallëzimi dhe është vënë në dukje shkalla reale e njësisë dhe e ndryshueshmërisë së dialekteve të shqipes në sistemin fonetik. Një analizë e këtillë, në krahasim me metodën tradicionale, ka dhënë mundësi për një grupim të njësive dialektore në zona të mëdha, sepse zakonisht një hapësirë dialektore me ndryshueshmëri thjesht fonetike (në timbre, nuanca e variante fonetike të fonemave) paraqitet e njësishme (pa dallime) nga ana fonologjike (në organizimin e fonemave në sistem në inventarin e fonemave dhe në funksionin e tyre). Përfundimet e kësaj analize kanë rëndësi edhe për faktin se njihet më mirë dhe objektivisht raporti i sistemit fonetik të gjuhës së sotme letrare shqipe me sistemet fonetike të dialekteve: del se baza e përbashkët e tyre është më e madhe nga ç'mendohet dhe shpjegohet gjithashtu mundësia e madhe që kanë sot për të hyrë nga dialektet në gjuhën letrare shumë elemente që nuk e prekin sistemin e saj (shih § 5.3.1.).

Me një metodë të këtillë strukturore e funksionale është bërë përmbledhtas edhe një vështrim mbi *klasifikimin strukturor* të dallimeve morfologjike të dialekteve të gjuhës shqipe[35] (J.Gjinari).

Për t'u shënuar si një arritje tjetër e rëndësishme këto vitet e fundit është edhe pjesëmarrja në «Atlasin e gjuhëve të Evropës (Atlas Linguarum Europae — ALE). Me një nivel të ngritur shkencor, sipas kërkesave të kritereve të këtij «Atlasi», u bënë anketa të poasçme për pjesën e leksikut (550 pyetje) në dhjetë pika përfaqësuese (dialektore) të gjuhës shqipe në territorin e RPS të Shqipërisë. I gjithë materiali i mbledhur u përpunua për t'u hedhur e botuar në hartat e vëllimit përkatës të këtij «Atlasi». Të dhënat e shumta e me interes, që dolën nga anketat dhe përpunimi i materialit të mbledhur, janë

34. Tezë disertacioni për gradën «doktor i shkencave filologjike»
35. Në «SF», nr. 3, 1984.

me vlerë për historinë e fjalëve nga ana gjuhësore (për variacione dialektore, për semantikën, trajtën dhe anën fonetike të tyre) në veçanti, si edhe për historinë e kulturës së popullit tonë në përgjithësi.

Detyra kryesore e fazës së dytë të dialektologjisë shqiptare, pas hetimit të përgjithshëm të dialekteve, është hartimi i *Atasit dialektologjik të gjuhës shqipe*[36], që do të jetë një nga veprat themelore të gjuhësisë sonë të periudhës së Pasçlirimit.

Në këtë «Atlas» do të bëhet për herë të parë studimi i dialekteve të shqipes me metodën e gjeografisë gjuhësore. Ai do të japë në mënyrë më të plotë e më të saktë dukuritë dialektore të shqipes me kufijtë e shtrirjes së tyre gjeografike. Të dhënat e hartave të «Atlasit» do të zgjerojnë e do të thellojnë më tej njohuritë për dialektet e shqipes, do të japin më saktë arealet e ndryshme dialektore, degëzimet dialektore të gjuhës shqipe dhe do të lejojnë të nxirren përfundime për gjendjen e sotme të dialekteve dhe për historinë e tyre. «Atlasi» do të japë mundësi më të mëdha për studime të reja jo vetëm në lëmin e dialektologjisë, por edhe të gjuhësisë sonë në përgjithësi. Është një atlas i përgjithshëm e jo krahinor. Ai synon të përfshijë gjuhën shqipe në tërësinë e saj gjeografike: të folmet e RPS të Shqipërisë, të folmet që vijojnë në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Serbinë Jugore e në Greqi dhe të folmet e arbëreshëve të Italisë, të Greqisë dhe të Zarës në Dalmaci.

Një ndihmesë me rëndësi po japin edhe bashkëpunëtorët e jashtëm me plotësimin e anketave në pikat e ndërmjetme të rrjetit të «Atlasit», ashtu si kanë dhënë ndihmesë me vlerë edhe në kërkimet e studimet e të folmeve gjatë fazës së hetimit të përgjithshëm të dialekteve të shqipes.

Njohja më e thelluar e dialekteve në fazën e tanishme dhe në të ardhmen do të bëhet jo vetëm me «Atlasin» dhe me monografi përshkruese më të ngritura për disa të folme të veçanta, por edhe me studime e kërkime të tjera, siç janë ato për leksikun dialektor, punime të ndryshme për hisotrinë e dialekteve e të dukurive të veçanta të tyre, studimet për të folmet e diasporës, që pak janë trajtuar nga ne deri tashti; punimet përgjithësuese për grupet e të folmeve dhe për mbarë dialektet e shqipes, studimet për marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare etj., të cilat janë parashtruar gjerë nga prof. M. Domi në referatin e mbajtur në Seminarin II Kombëtar të Dialektologjisë e të Onomastikës në 2 dhjetor 1977[37].

36. Qëllimi, tipi i Atlasit dhe puna që është bërë për hartimin e tij janë thënë përmbledhtazi në një artikull tonin të botuar në revistën «Gjuha jonë», nr. 2, 1982, f. 50-55.
37. M.Domi, *Gjendja, probleme dhe detyra të dialektologjisë shqiptare në fazën e sotme* në «Dialektologjia shqiptare» IV, 1982 f. 3-19.

Tashti që po përvijohet më mirë lëvizja e dialekteve me ndryshimet që pësojnë nën ndikimin e gjuhës letrare duhet të vijojë e të vijë duke u shtuar puna që sapo ka filluar për studimin e rrugës së konvergjimit të dialekteve me gjuhën letrare. Të studiohet në mënyrë më të thelluar e të njihen ligjësitë e rrugës që ndjekin për largimin e tyre nga të folmet disa dialektalizma dhe rrugët që ndjekin disa dialektalizma të tjera që hyjnë në gjuhën letrare për pasurimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj. Kështu do të njihen kohë pas kohe kufijtë e gjuhës letrare, që vijnë duke u zgjeruar, dhe kufijtë e dialekteve, që vijnë duke u ngushtuar, në grupe të moshave e në shtresa shoqërore të ndryshme dhe në hapësirën gjeografike.

Kërkimet dhe studimet e dialektologjisë në fushën e shqipes do të vijnë duke u shtuar, duke u thelluar e duke u ngritur gjithmonë e më shumë nga ana shkencore, do të jenë të shumëllojshme dhe me synime të ndryshme në vitet e ardhshme.

ATLASI DIALEKTOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE (ADGJSH)

1.2.4. «Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe» është një arritje shumë e rëndësishme e gjuhësisë shqiptare. Në këtë vepër studiohen për herë të parë dialektet e shqipes me metodën e gjeografisë gjuhësore. Vepra të këtilla me vështirësi të karakterit shkencor e organizativ bëhen të realizueshme vetëm në një kohë kur kanë shkuar shumë përpara studimet në lëmin e dialektologjisë.

ADGJSH, ashtu si vepra të tjera themelore të gjuhësisë shqiptare, si «Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe» dhe «Fjalori i gjuhës së sotme shqipe», mundën të hartoheshin në epokën e Partisë, kur u krijuan kushtet për zhvillimin e gjuhësisë dhe të shkencave të tjera.

Shoku Enver Hoxha, duke e vlerësuar rëndësinë e atlasit gjuhësor, ia caktoi atë si detyrë gjuhësisë shqiptare që në vitin 1962: «Që gjuhësia shqiptare të ndihmojë me studimin e saj në problemin e madh të normalizimit të gjuhës letrare shqipe, duhet vazhduar më tej puna e filluar për të përpiluar gramatikën shkencore shqipe, fjalorin e mesëm të gjuhës sonë me orientim normativ, *duhen bërë studime më të thelluara në fushën e dialektologjisë dhe të hartohet «Atlasi dialektologjik»* (Vepra, vëllimi 23, f.447 — 548).

«Atlasi» u parapri nga një punë e gjatë për hetimin e përgjithshëm të dialekteve me anë të kërkimeve të reja në gjithë truallin e gjuhës shqipe dhe me përshkrimin e të folmeve. Të dhënat e kërkimeve të fazës së parë të dialektologjisë shqiptare pas Çlirimit bënë të njohur më me saktësi dhe në mënyrë më të thelluar veçoritë dalluese dialektore të shqipes dhe kufijtë e shtrirjes territoriale të tyre.

Ndryshe nga monografitë e skicat përshkruese, ADGJSH jep

me anë të hartave shtrirjen e një veçorie dialektore në gjithë hapësirën e shqipes. Në këtë mënyrë dalin arealet dialektore të gjuhës shqipe për dukuritë që pasqyrohen nëpër harta, dalin qartë me shtrirjen e tyre edhe degëzimet dialektore (dialektet, nëndialektet, grupet e të folmeve), prej hartave të «Atlasit» del gjendja e sotme e dialekteve dhe nxirren përfundime edhe për historinë e tyre. Në çdo hartë të «Atlasit» pasqyrohet dhe trajtohet një tipar gjuhësor me dallimet territoriale, por në të njëjtën kohë del edhe uniteti i gjuhës sonë kombëtare. Harta, duke dhënë ndryshueshmërinë territoriale të një dukurie gjuhësore, paraqitet në vetvete analitike, por njëkohësisht ajo është edhe përgjithësuese, po të kemi parasysh se në të jepet dukuria dialektore për gjithë truallin e shqipes. Veç kësaj, «Atlasi» ka një numër të mirë hartash që paraqitin së bashku disa tipare dialektore të lidhura midis tyre. Në të vërtetë çdo atlas gjuhësor është përgjithësues, në kuptimin që bën përgjithësimin e asaj që është bërë e njohur para tij për dialektet me anë të përshkrimeve e studimeve të llojeve të tjera.

ADGJSH është fryt i një pune të thelluar, sepse, veç njohjes së mëtejshme që u bëhet dialekteve nëpërmjet anketave të reja e të posaçme, bëhet edhe një analizë e thelluar kur përcaktohen dukuritë dialektore që do të pasqyrohen në hartat e tij.

«Atlasi» ka rëndësi shumë të madhe për studimin e gjuhës shqipe nga anë të ndryshme. Së pari, ai ka rëndësi për njohjen dhe studimin e dialekteve në gjendjen e sotme, sepse nxjerr në dukje me qartësi dhe në mënyrë më objektive shkallën e dallimit të sotëm të dialekteve të gjuhës shqipe.

Së dyti, rëndësia e tij është shumë e madhe për historinë e gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të dialekteve të saj në veçanti, sepse, siç dihet, monumentet e shkruara të gjuhës sonë janë relativisht të vona, janë të shekullit XVI. Dialektet me veçoritë e tyre dalluese ruajnë gjurmë të ndryshimeve që kanë pësuar kohë pas kohe dialektet e gjuhës shqipe. Hartat e ADGJSH ndihmojnë në shpjegimin e shkaqeve të brendshme gjuhësore të ndryshimeve që ka pësuar gjuha shqipe në krahina të ndryshme, nga ana tjetër ato ndihmojnë edhe në shpjegimin e disa shkaqeve jashtëgjuhësore të këtyre ndryshimeve, si faktorët ekonomikë të lidhur me grupe të ndryshme të popullsisë, ndikimet që kanë ushtruar në masa të ndryshme, sipas krahinave, gjuhët e tjera gjatë kohës së marrëdhënieve me popujt fqinjë ose me pushtuesit etj. Nga kjo pikëpamje «Atlasi» dialektologjik i gjuhës shqipe» ka rëndësi për historinë e popullit tonë në përgjithësi dhe të kulturës së tij në veçanti.

Së treti, «Atlasi» ka rëndësi të madhe për gjuhën letrare shqipe, për të shpjeguar e kuptuar formimin dhe rrugën e mëtejshme të zhvi-

limit të saj. Duke qenë se hartat e ADGJSH për paraqitjen e dallimeve dialektore kanë si bazë krahasimi tiparin normë të gjuhës letrare, ato, në të njëjtën kohë, vënë mirë në dukje raportet e sotme të gjuhës letrare me dialektet.

1.2.2. «Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe» është mbështetur mbi parime teorike e kritere të përgjithshme (hartuar nga J.Gjinaridrejtues, B.Beci, GJ.Shkurtaj). Mbi këto parime e mbi këto kritere janë mbështetur pyetësori, përmbajtja gjuhësore e hartuve, metoda e punës në terren gjatë anketimit për «Atlasin,» përpunimi i hartave të punës dhe i hartave përfundimtare për botim, ana teknike e përpunimit të hartave etj.

«Atlasi» përshkohet tej e ndanë nga metologjia jonë marksiste-leniniste, ashtu si edhe gjithë gjuhësia jonë. Në ADGJSH dialektet konceptohen si kategori historike që ndryshojnë në mënyrë të pandërprerë bashkë me shoqërinë, gjithashtu ato merren si variante territoriale të gjuhës kombëtare me sisteme të shkallëzuara të ndryshme.

Veç kësaj, edhe lënda gjuhësore që është trajtuar në «Atlas» është parë në lidhje me sistemin gjuhësor (fonologjik, morfologjik etj.), nuk janë parë në mënyrë të shkëputur veçoritë dialektologjike, por në lidhje me vendin që kanë në strukturën fonetike e gramatikore dhe në lidhje me funksionin që luajnë në gjuhë; p.sh., tingujt janë parë si njësi të inventarit të fonemave, janë parë në kundërvënien dhe në vendin që zënë në sistem, janë parë si variante fonetike të fonemave dhe si variante etimologjike të tyre, d.m.th. si dallime dialektore në përbërjen fonematike të fjalëve; po ashtu edhe dallimet morfologjike janë parë të lidhura me strukturën, d.m.th. në lidhje me inventarin e kategorive të ndryshme gramatikore me variantet territoriale të formave gramstikore, në lidhje me dendurinë e përdorimit të tyre në një areal dhe, së fundi, në lidhje me ndryshueshmërinë fonetike, me të cilën paraqitet një formë gramatikore në areale të ndryshme (variante fonetike të lidhura me morfema të një forme gramatikore, jo të kushtëzuara fonetikisht). Nga kjo pikëpamje, ndryshe nga shumë atlasë gjuhësorë të botuar deri tanti në vende të tjera, që ndjekin vetëm fakte leksikore të shkëputura dhe historinë e tyre, ADGJSH ka një metodë bashkëkohore të gjeografisë gjuhësore. Ai e jep dialektin me veçoritë e të gjitha sferave të gjuhës, me veçoritë fonetike, gramatikore (morfologjike, sintaksore) dhe leksikore dhe, siç thamë, i sheh këto veçori brenda sistemit, të lidhura me strukturën dhe funksionimin që kanë në gjuhë (dialekt).

«Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe» është i tipit të përgjithshëm e jo atlas krahinor. Ai pasqyron në hartat e veta të njëjtadukuri gjuhësore në të gjitha të folmet e shqipes. Atlasët krahinorët që zakonisht hartohen pas atlasëve të përgjithshëm, kufizohen në,

një hapësirë të vogël të truallit të një gjuhe, janë më të hollësishëm dhe kanë një rrjet më të dendur pikash të banuara ku bëhen anketa gjuhësore. Për fazën e tanishme të dialektologjisë shqiptare tipi i ADGJSH është më i mundshëm dhe i domosdoshëm, atlasët krahinorë mund të vihen si detyrë për të ardhmen.

«Atlasi» ynë quhet *gjuhësor*, sepse ai është vetëm gjuhësor dhe jo gjuhësor dhe etnografik njëkohësisht, si disa atlasë të tjerë, ai i ka përjashtuar fjalët dialektore që lidhen me veçoritë etnografike të krahinës, veç kësaj, quhet *dialektologjik*, sepse nuk trajton ligjërimin shqip në përgjithësi, por dialektet territoriale të gjuhës shqipe.

Pasqyrimi i plotë dhe i thellë i tipareve dalluese dialektore është synimi kryesor i «Atlasit», por, sigurisht, masa e realizimit të këtyre dy kërkesave, sidomos ajo e paraqitjes sa më të plotë të tipareve dalluese të dialekteve, është e varur edhe nga tipi i atlasit. Veç kësaj, për sferën e leksikut asnjë lloj atlasi nuk do të ishte në gjendje të jepte të gjitha dallimet dialektore që ka një gjuhë në këtë sferë, sepse numri i tyre është relativisht i madh dhe është vështirë të përfshihen në hartat e një atlasi.

Në ADGJSH dialektet shihen në gjendjen e tyre të sotme, me të gjiha ndryshimet që kanë pësuar sidomos në këtë dhjetëvjeçar pas Çlirimit. Ashtu si gjithë atlasët e tjerë gjuhësorë, edhe «Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe» kufizohet në dialektin e një brezi, kryesisht të brezit të vjetër.

Në ADGJSH gjuha dialektore shqipe vështrohet me tiparet e përdorimit të saj tek ata bartës e përdorues që nuk e zotërojnë gjuhën letrare. Të këtillë bartës ka sot kudo, ka në fshat, por ka edhe në qytet, ashtu si ka bartës e përdorues të gjuhës letrare jo vetëm në qytet, por edhe në fshat. Por kjo nuk do të thotë se «Atlasi» do të japë vetëm gjendjen e ruajtur të dialektit, sepse dialekti, edhe në bartës të moshës së vjetër, sidomos në kushtet e shoqërisë sonë socialiste, pëson përditë ndryshime nga ndikimi i gjuhës letrare nëpër mjet radios, televizionit, shtypit, librit, fjalës publicistike dhe veprimtarisë politike e shoqërore.

Çdo atlas gjuhësor ka karakter krahasimtar, ai i vë përballë të folmet e dialektet dhe bën krahasimin e tyre. Për të arritur këtë, ADGJSH ka marrë si pikënisje për krahasim gjuhën e sotme letrare shqipe. Duke u krahasuar në çdo hartë faktet dialektore me tiparin normë të gjuhës letrare, dalin në dukje dallimet që kanë dialektet ndërmjet tyre, dalin në të njëjtën kohë dhe anët e përbashkëta dhe dallimet e tyre me gjuhën letrare.

1.2.3. Të dhënat dialektore për ADGJSH u mblodhën të gjitha në terren me anketa të posaçme. Pyetësori i ADGJSH, që u përdor nga dialektologët, specialistët e grupit të punës (J. Gjinari - drejtues-,

B.Beci, GJ.Shkurtaj, Xh.Gosturani, M.Totoni, A.Dodi), u ndërtua duke u mbështetur në kriteret e përgjithshme teorike të «Atlasit» (u hartua nga J.Gjinari, Gj.Shkurtaj, Xh.Gosturani). Ky pyetësor përbëhet nga 405 pyetje të sferave të ndryshme të gjuhës, shumëprej të cilave kanë edhe nënpyetje (rreth 250 nënpyetje, nga të cilat 111 për çështje të fonetikës, 98 për çështje të morfologjisë dhe 40 për çështje të leksikut).

Në pjesën e fonetikës ka 29 pyetje me 44 nënpyetje për veçori dialektore që lidhen me inventarin e fonemave e të grupeve të fonemave, me organizimin e fonemave në sistemin dhe me funksionin e fonemave (me kombimet e tyre); ka 8 pyetje me 2 nënpyetje për veçori që lidhen me variantet fonetike të fonemave dhe 28 pyetje me 65 nënpyetje për çështje që lidhen me përbërjen fonematike të fjalëve (janë nga ato veçori dalluese të cilat quhen dhe *dallime dialektore etimologjike*).

Në pjesën e gramatikës ka 20 pyetje për emrin me 28 nënpyetje; 27 pyetje me 34 nënpyetje për mbiemrin dhe përemra të ndryshëm; ka 24 pyetje me 36 nënpyetje për sistemin foljor, ku kërkohen edhe paradigma të plota për format e disa kohëve; ka 9 pyetje për sintaksën (për konstrukte dhe funksione); ka dhe 260 pyetje me 40 nënpyetje për leksikun nga fusha e astronomisë, e natyrës dhe e terrenit në përgjithësi (kafshët, shpendët, bimët, kohën hapësirën), nga fusha e bujqësisë, blegtorisë, nga termat për familjen dhe marrëdhëniet familiare e farefisnore, për njeriun (trupin, veprimet, marrëdhëniet në shoqëri) etj.

Me çdo pyetësor u përdorën në terren dhe që të mernin gjatë anketave kudo nga çdo subjekt përgjigjet që kërkohen për «Atlasin», në pyetësorin e përdorur në terren për shumicën e çështjeve janë formuluar edhe pyetje që i bëhen subjektit.

Veç këtij pyetësori, është hartuar edhe një tjetër i dytë, vetëm me çështje të leksikut (960 pyetje nga J.Gjinari e GJ.Shkurtaj), që është përdorur nga bashkëpunëtorë të jashtëm për anketa të ADGJSH në disa pika të ndërmjetme. Këto anketa janë bërë për t'i ndihmuar specialistët që të heqin izoglosa sa më të përpikta në «Atlas», sepse rrjeti i pikave të ADGJSH është relativisht i rrallë.

1.2.4. Që të pasqyrohet e plotë tërësia territoriale e gjuhës shqipe, «Atlasi» i përfshin të gjitha të folmet, ato të territorit të RPS të Shqipërisë, të folmet shqipe që vijojnë matanë kufijve, si të folmet e Kosovës, të Malit të Zi, të Maqedonisë, të Peshterit afër Novipazarit, të Jabllanicës, të Preshevës, të folmet e diasporës shqiptare prej të cilave janë përfshirë ato të arbëreshëve të Italisë, të arbëreshëve të Greqisë dhe e folmja e Zarës në Dalmaci, të cilat janë edhe

nga më të vjetrat dhe paraqesin më tepër interes për historinë e gjuhës shqipe.

Duke u mbështetur në kriterin gjeografik dhe në kriterin gjuhësor, u caktuan 175 pika të banuara për anketat e ADGJSH. Ky numër pikash është shpërndarë në këtë mënyrë: 85 në RPS të Shqipërisë, 72 në Kosovë, në Mal të Zi, Maqedoni në anët e Peshterit, Jabllanicës dhe Preshevës, në Çamëri dhe 19 në të folmet e diasporës arbëreshe. Përfshirja e gjithë tërësisë së territorit ku shtrihet gjuha shqipe i jep «Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe» rëndësi të madhe kombëtare për historinë e popullit tonë, tregon se grupe të popullsisë në krahina të ndryshme kanë ecur së bashku dhe arritën me një konstitucion shpirtëror dhe në një unitet gjuhësor e kulturor.

1.2.5. I gjithë trualli i shqipes që përfshiht në ADGJSH do të paraqitet në një hartë me shkallë 1 : 1.250.000. Brenda kësaj harte do të zënë vend në një hapësirë të vijueshme të folmet e RPS të Shqipërisë dhe ato të Jugosllavisë e të Çamërisë në Greqi, të ndara me shenjat e kufijve shtetërorë; në qoshet e hartës janë vendosur hapësirat e diasporës së Italisë, të Greqisë dhe të Dalmacisë, duke u dhënë me shkallë tjetër, me shkallë më të madhe. «Atlasi» do të ketë disa harta jogjuhësore në hyrjen e tij (hartën fizike, hartën administrative, hartën historike, hartën entografike, hartën me emrat e lokaliteteve ku janë bërë anketat etj) dhe rreth 700 harta gjuhësore.

Përgjithësisht hartat do të jenë dy llojesh: harta sqaruese dhe harta josqaruese, d.m.th. harta me faktin gjuhësor (me fjalën, formën, tingullin) të shkruar pranë numrit të çdo pike të banuar dhe harta me simbole të llojeve të ndryshme. Nga të dyja llojet e hartave do të ketë harta analitike dhe harta përgjithësuese. Hartat japin dukuritë gjuhësore duke pasqyruar veçoritë dialektore në mënyrë të përgjithësuar sipas sferës përkatëse, p.sh., harta leksikore pasqyron me shenjat e veta dallimet leksikore (semantike), i lë mënjanë dallimet gramatikore dhe dallimet fonetike etj.

Në shumë harta leksikore dhe në disa harta morfologjike dallimet gramatikore dhe dallimet fonetike, që nuk janë objekt i tyre pasqyrohen në një tregues (indeks) që do të ketë në shpinë harta paraprirëse. Në tregues pasqyrohen sipas një renditjeje të shkallëzuar variantet e ndryshme gramatikore, fjalëformuese e fonetike për hartën leksikore dhe variantet fonetike për hartën gramatikore. Sigurisht, kjo bëhet për disa harta, kur shihet e domosdoshme, Po ashtu, kur duhet, edhe komentari jepet brenda hartës përkatëse.

«Atlasi» do të botohet në dy pjesë, një për fonetikën e gramatikën dhe një për leksikun; më pas do të botohet edhe një vëllim me

tekste dialektore të regjistruara enkas gjatë anketave që u bënë për ADGJSH.

Këtu dhamë shkurt disa nga parimet dhe kriteret e këtij «Atlasi», sa për të pasur lexuesi një ide të përgjithshme mbi të. Parimet e përgjithshme teorike të ADGJSH dhe *Pyetësori* i tij janë botuar tërësisht në përmbledhjen «Dialektologjia shqiptare», VI.

KREU II

DEGËZIMI DIALEKTOR I GJUHËS SHQIPE

A. NDARJA E SOTME DIALEKTORE E GJUHËS SHQIPE

STUDIMET E DERISOTME

2.1.1. Konstatime mbi degëzimin e gjuhës shqipe dhe përpjekje për të dhënë ndonjë mendim për këtë çështje kanë filluar të bëhen qysh nga mesi i shekullit të kaluar, porse shumica e atyre që e kanë prekur këtë temë kanë pasur qëllime të tjera, jo për ta trajtuar posaçërisht ndarjen dialektore të shqipes. Kështu disa nëpër gramatikat[38] e tyre të gjuhës shqipe për të bërë të njohur ekzistencën e dialekteve të kësaj gjuhe, disa në diskutimet mbi problemin e gjuhës letrare konbëtare shqipe[39] dhe ndonjë kur ka trajtuar çështje të orto-

38. J.G. von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena 1854; D.Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorna, 1864; 1882. κ. κριστοφοριδις, Γραμματικη της αλβανικής κατα τιν τοσκικήν σίαλεκτον, 1982; G.Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache*. Wien 1908; I.Dilo Sheqeri, *Gramatika e sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927; J. Rrota, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, bot. II,Shkodër 1943.

39. Dh.S.Shuteriqi *Mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe*. në «Bul. për shk shoq. 4 1953 f. 3-55. Z.Sako *Dialktet e gjuhës shqipe* në Bul. për shk. shoq. 4 1952 f. 76-80.

grafisë së shqipes[40]. Këto konstatime kanë pasur rëndësinë e vet orientuese në kërkimin dhe studimin e të folmeve të gjuhës shqipe, por kanë qenë dhe mbeten konstatime të mbështetura në disa njoftime të përgjithshme, të pjesshme dhe herë-herë jo fort të përpikta. Ndër këto punime kufijtë tokësorë dhe tiparet dalluese jepen vetëm për dialektet, kurse për degët e tyre, me përjashtime të pakta, pothuajse mungojnë fare.

Posaçërisht me ndarjen dialektore të shqipes së peri është marrë disa herë M.Lambertzi[41], në fillim tek relacioni i vitit 1916, ku flet kryesisht vetëm për ndarjen e dialektit verior, pastaj në dy punime të tjera[42] dhe më në fund më 1959 në «Lehrgang des Albanischen»[43] te kapitulli «Die Mandarten der abanesichen Sprache», ku shihet një trajtim më i gjatë e më i plotë i këtij problemi. Po të merret parasysh gjendja e dialektologjisë shqiptare e kohës kur janë bërë këto studime, duhet pohuar se rezultatet në grupimin e të folmeve të gjuhës shqipe, sidomos për të folmet e dialektit verior, janë të mira. Në veprën e fundit jepet ndarja në dy dialekte, duke dhënë veçori dalluese të tyre, jepet ndarja në nëndialekte ose grupe të folmesh, siç i quan ngandonjëherë autori, por pa vendosur kritere e pa dhënë tipare dalluese për secilin nëndialekt; aty bëhet fjalë edhe për të folmet e kolonive që janë jashtë atdheut, duke thënë se cilit dialekt i përkasin. Ky dijetar, ashtu si edhe të tjerë para tij, nuk ka mundur t'i shmanget barazimit të njësive dialektore (degëve dialektore) të shkallëve të ndryshme dhe nuk ka dhënë qartë konceptin e të folmeve kalimtare.

Ne edhe më parë[44] e kemi trajtuar këtë temë, por po e rimarrim me qëllim që të bëjmë një ndarje dialektore të shqipes më të përcaktuar si në drejtim të një shkallëzimi më të drejtë të njësive dialektore, duke vendosur edhe disa kritere, po ashtu edhe në drejtim të caktimit sa të jetë e mundur më të përpiktë të kufijve gjeografikë të këtyre njësive.

Hulumtimi i të folmeve dhe përshkrimi i tyre gjatë fazës së hetimit të përgjithshëm të dialekteve të shqipes bëri të mundur që të hidhet një vështrim përgjithësues për të nxjerrë kufijtë e shtrirjes së

40. O.Myderrizi, *Çështja e zanores ë në ortografinë tonë* në «Bul. për shk. shoq» 4 1955 f.215-228.

41. M.Lambertz *Bericht uber meine linguistischen Studien in Albanien von Mitte bis Ende August 96* in «Anzeiger d.k. Akad. Wise. in Wien Ph. His. Klasse» 1916 nr. XX f.122-146.

42. Po ai *Die Mundarten des Albanischen*, Leipziger Vierteljahrvsschrif fur Sudosteuropa 7 (1943), 123-160 dhe *Albanisches Lesebuch* I, 1943, f.12-21.

43. Po ai, *Lehrgang des Albanischen T.III*, Halle (Saale), 1959.

44. J.Gjinari, *Dialektologjia shqiptare* (dispensë), Tiranë, 1963, f. 73-97; *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, në «SF», 4, 1966, f. 99-117 dhe «Dialektologjia shqiptare» (dispensë, Tiranë 1975).

veçorive dalluese dialektore e pas kësaj për të bërë grupimin e të folmeve brenda dialekteve. Në disa artikuj të posaçëm janë bërë objekt studimi grupe të mëdha të folmesh të shqipes, ku janë dhënë tiparet e përbashkëta karakterizuese të grupit dhe degëzimet më të vogla të tij. Studime të këtilla janë bërë për toskërishten veriore[45], për gegërishten e Shqipërisë së Mesme[46], për gegërishten qendrore[47], për gegërishten verilindore[48] dhe për gegërishten veriperëndimore[49]. Për labërishten dhe çamërishten dhe për të folmet kalimtare, për të cilat ende nuk ka studime përgjithësuese si ato të grupeve të tjera të të folmeve, mund të nxirren të dhëna disi të mjaftueshme nëpërmjet disa studimeve të tjera[50]. Sot, mbi të gjitha, janë të dhënat e «Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe» që është duke u bërë gati për shtyp.

Në veprën «Albanskij jazyk i jego dialekty» (1968) A.Djesnicjkaja veçon një kapitull të tërë për gjendjen e sotme dialektore të gjuhës shqipe. Kapitulli ka më tepër një karakter përshkrimi dhe nuk është bërë aty ndonjë hap me synim përgjithësimi për ndarjen dialektore të shqipes. Nuk jepen kritere për grupimin e të folmeve dhe, veç dy dialekteve, për degëzimet e tjera, për grupe të mëdha dhe të vogla të folmesh. nuk jepen as veçoritë që i dallojnë njëra nga tjetra, por brenda grupeve renditen të folmet duke dhënë përmbledhtazi tiparet e çdo të folmeje bashkë me ato që gjenden edhe në të folmet fqinje.

Veçoritë dalluese vetëm të dy njësive më të mëdha dialektore të shqipes, të gegërishtes dhe toskërishtes, janë trajtuar në artikullin e B.Becit *Rreth tipareve karakteristike të dy dialekteve të shqipes*, (në «SF», 4, 1978, f.53-85). Artikulli ka dy pjesë kryesore: në pjesën e parë jepen përgjithësisht numri i karakteristikave që kanë konsideruar si tipare dalluese të dy dialekteve studiues të ndryshëm, duke filluar që nga J.G.Hani, kurse në pjesën e dytë jepen ato që mendon vetë autori. Si kriter bazë për përcaktimin e një tipari dallues të njërit e të tjetrit dialekt të shqipes merr po kriterin territorial që kemi marrë ne me 1966 në artikullin *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës*

45. J.Gjinari, *Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, në «I konferenca e studimeve Albanologjike (nëntor 1962)», Tiranë, 1965, f. 241-254.
46. M.Çeliku, *Mbi grupimin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi tipare të tyre*, në «SF», 2, 1968, f. 123-136.
47. B.Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, në Dilektologjia shqiptare», V, 1987, f. 3-92.
48. I.Ajeti, *Rreth disa tipareve gjuhësore të ligjërimeve shqiptare të Kosovës*, në «GJA», 1, 1969; Xh.Gosturani, *Veçori gjuhësore të gegërishtes verilindore* në «SF», 3, 1984, f. 57-79.
49. B.Beci, *Grupi perëndimor i nëndialekteve veriore të gegërishtes*, në «SF», 3, 1970, f. 125-145.
50. M.Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në «Dialektologjia shqiptare» I, 1971, f. 31-116; Q.Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në «Dialektologjia shqiatare» I, 1971, f. 118-191.

shqipe (në «SF», 4, 1966, f. 99-117), por me një dallim në zbatimin e këtij kriteri: B.Beci konsideron si tipar dallues të një dialekti atë që ka shtrirje të plotë në atë dialekt, kur mbulon vetëm atë dialekt ose kur veç atij dialekti, mund të shtrihet edhe në disa të folme të dialektit tjetër, megjithëse për rastin e dytë nuk është treguar gjithmonë konseguent. Ne, më 1966, veç këtyre kemi përfshirë në këtë kriter bazë edhe rastet kur dukuria dialektore përfshin pjesën më të madhe të territorit të një dialekti, d.m.th. kur ka lënë jashtë vetëm pak të folme të atij dialekti dhe nuk gjendet në asnjë të folme të dialektit tjetër. P.sh., ndërmjet të tjerave, prej nesh është konsideruar si një tipar i gegërishtes struktura e së pakryerës të foljeve pësore me pjesëzën *u* dhe të pakryerën veprore të atij dialekti (*u lajſa*, «lahesha»), dhe si tipar i toskërishtes forma e veçantë pa pjesëzën *u* (*laheſa* me variante të ndryshme). Forma *laheſa* vërtet gjendet edhe në disa të folme të gegërishtes, por ajo përfshin gjithë toskërishten, e cila nuk ka formë tjetër veç asaj për të pakryerën e pësores. Në këtë rast, duke u nisur nga toskërishtja, kemi të bëjmë me dukuri që përfshin plotësisht një dialekt dhe që shtrihet edhe në disa të folme të dialektit tjetër.

DEGËZIMI DIALEKTOR: DIALEKTET, NËNDIALEKTET, GRUPET E TË FOLMEVE

2.2.1. **Dialektet.** - Në gjuhën shqipe dallohen dy dialekte, të cilë t nga pikëpamjet territoriale ndahen përafërsisht prej lumit Shkumbin. Në anën e djathtë të këtij lumi shtrihet dialekti verior ose gegërishtjai kurse në anën e majtë shtrihet dialekti jugor ose toskërishtja. Lum Shkumbin është kufi i përafërt, sepse përgjatë bregut të majtë të tij, në një zonë pak a shumë të madhe, shtrihen të folmet kalimtare (shih hartën nr.1).

Hapësirat e të dy dialekteve vijojnë të shtrihen matanë kufijve të RPS të Shqipërisë. Toskërishtja vijon në Greqi, në krahinën e Çamërisë, që arrin deri te gjiri i Prevezës, vijon në anët e Prespës, Ohrit e Strugës, shkon deri në Manastir. Gegërishtja vijon të shtrihet në një territor shumë të madh në Jugosllavi. Të folme të këtij dialekti ka në zonën midis Strugës e Dibrës, Kërçovës e Gostivarit, në anët e Krushevës e Prilepit, në anët e T.Velesit, në tërë luginën e Vardarit, prej Gostivarit deri në Shkup, në Karadakun e Shkupit, në anët e Kumanovës, Preshevës, Bujanovcit, Jabllanicës në anët e Vranjës, në Kosovë, në Peshter afër Novipazarit, në Plavë e Guci, në anët e Tuzit, Krajës dhe Ulqinit.



Harta nr 1

G. Hani për diferencimin e dy dialekteve të shqipes kufizohet vetëm në sferën e fonetikës. Edhe G.Pekmezi kryesisht tipare dalluese fonetike sjell, por jep vetëm disa nga ato më karakteristiket. J.Rrota e M.Lamberci[51] shtrihen më tej, japin edhe tipare nga sfera e morfologjisë e ndonjë nga sintaksa, por si këta, edhe dy të parët, sidomos G Hani, nuk caktojnë kritere kur marrin njërin ose tjetrin fenomen si tipar të dialektit, nuk i ndajnë fenomenet që janë karakteristike

51. M.Lambertz, *Die Mundarten des albanischen...*; *Albanischen Lesebuch* dhe në *Lehrgang des Albanischen.*

vetëm për një grup të folmesh. Mbi dy dialektet e shqipes duke sjellë edhe karakteristika të veçanta të tyre ka folur edhe E.Çabej në «Elemente të gjuhës e të literaturës shqipe» Tiranë, 1936 f.16-19. Tipare që dallojnë dy dialektet e shqipes janë dhënë prej tij edhe nëpër punim të tjera[52] ku trajtohen probleme të zhvillimit historik të gjuhës shqipe.

Ne diferencimin e dy dialekteve do ta bëjmë duke i parë të gjitha sferat e gjuhës, por duke u përqendruar më tepër në fonetikë e në morfologji, sepse aty janë edhe më të shumta në numër dallimet midis tyre. Pjesërisht ky kufizim do të bëhet edhe për shkak se gjer më sot mungojnë të dhëna të bollshme e studime të veçanta për leksikun e sintaksën e dialekteve.

Si tipare të qenësishme të njërit dialekt do të marrim ato që janë karakteristike për të gjitha të folmet e tij ose për shumicën e tyre. Po të merret për krahasim si pikënisje gegërishtja, del se prej tipareve dalluese të këtij dialekti ka të atillë që nuk janë ekskluzivisht karakteristike vetëm për atë, por që shtrihen edhe në disa të folme të dialektit jugor. E kundërta konstatohet më pak.

Tiparet më qenësore që diferencojnë dy dialektet janë: seria e fenomave zanore hundore, që është karakteristike për gegërishten dhe që mungojnë në toskërishte[53] (*hũ, rẽ, hĩ* etj.), rotacizmi i toskërishtes (*vera/ vẽna, syri/sỹni, prura/prũna* etj.), zanorja *ə*[54] e theksuar e toskërishtes, që i përgjigjet në gegërisht një ã-je ose ẽ-je (*a* dhe *e* që kanë qenë të ndjekura prej një bashkëntingëlloreje hundore: *ləmi/lãmi, nəna/nãna, dhən/dhẽn, zəmər/zẽmər*), grupi nistor *vo* - i gegërishtes, që në toskërishte është shndërruar në *va-* (*voĩ/vaĩ, i vorfən/ /i varfən, voj/vaj*) dhe paskajorja perifrastike gege me pjesëzën parafjalore me, që nuk ekziston në toskërishte (*me ʃkue*).

Zaten këto e ndonjë tjetër dalin si dallime dialektore të formuara që në traditën dialektore më të vjetrën[55], ndërsa shumë prej tipareve të tjera dalluese kanë lindur më vonë, pas periodës letrare[56]. Tiparet

---

52. Shih sidomos *Gjon Buzuku*, në «Bul. për shk. shoq.» 2 (1955), 71-100, 3 (1955 f. 38-50; *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe*, në «EUSH, S.Sh.Sh, 2, (1957) f. 207-215; *Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe*, në «EUSh, SShSh 3 (1958), f. 71-85;
53. I.Dilo Sheperi — *vep. e cit.* f.10 pohon se zanore hundore ka edhe në disa vise të Shqipërisë Jugore, si në Kurvelesh e në Himarë, por të dhënat dialektologjik sot nuk e vërtetojnë këtë. Vetëm për një nazalitet të dobët në disa raste tepër të kufizuara në një të folme të skajit jugor (në katurdin Borsh) flet M.Totoni në studimin e vet «*E folmja e bregdetit të Foshtën*», në «SF», 1, 1964, f. 136,
54. Variant kryesor i kësaj foneme në toskërishte është një zanore e radhës së përzier dhe e ngritjes së mesme [ə].
55. E.Çabej, «*Rreth disa çështjeve të hitorisë së gjuhës shqipe*, në «EUSh, SShSh», 3, 1963, f. 70-71.
56. Po ai, *Gjon Buzuku*», 2 (1955), f. 80 dhe «*Rreth disa çështjeve. . .*, f. 70.

e tjera dalluese të rëndësishme në pjesën më të madhe, nga pikëpamja kronologjike janë relativisht më të reja se ato që renditëm më lart dhe tregojnë se më tepër inovues ka qenë dialekti verior:

Në sferën e fonetikës shihet se në përgjithësi në dialektin verior është ruajtur ligji i rregullimit mekanik të theksit në fjalët e huazuara prej turqishtes: *tenéce, bákəɾ, ʃiʃe* etj. (ver.) *tenecé, bakəɾ, ʃiʃé* tj. (jug.), kjo si tendencë, sepse në disa raste konstatohet edhe e kundërta në të dy dialektet: *bojə, sefte, odə* (jug.) *dyɲá, siní* (ver.); gegërishtja i ka ruajtur zanoret e gjata, bile për shkak të fenomeneve fonetike kanë lindur edhe në ato raste ku s'ka pasur *de:t, be:, ka: tu:*f, *me la:* tj.), toskërishtja, përkundrazi, i ka humbur ato, i kanë ruajtur vetëm të folmet e Labërisë e në një masë më të vogël edhe ato të Çamërisë; diftongu i vjetër *uo* ka marrë dy rrugë të ndryshme zhvillimi: në dia, lektin jugor ka dhënë *ua* (*ftua, duar*), kurse në dialektin verior *ue*, i cili në shumë vise edhe është monoftonguar në *u* (*ftua, duer* ose *ftu, dur*). Gegërishtja është larguar prej toskërishtes edhe për shkak të ndryshimeve që kanë pësuar aty bashkëtingëllorja ɲ dhe grupet *mb, nd, ng*. Bashkëtingëllorja mbylltore ɲ ka dhënë *j* në fund të fjalës te format e shumësit të emrave e mbiemrave dhe ndërmjet dy zanoreve: *hũj, ftoj, laj, rãja* «rrënja», *brĩ:j* «brinjë»; grupet *mb, nd, ng* janë reduktuar në pjesën më të madhe duke dhënë *m* < *mb, n* < *nd*, dhe *ŋ* < *ng*: *kãma* «këmba, *vẽni* «vendi», *hãŋra* «hëngra».

Dallime të qenësishme që prekin sistemin e fonemave, sidomos inventarin, janë seria e zanoreve hundore, seria e zanoreve të gjata, *ə*-ja e toskërishtes dhe mungesa e grupeve *mb, nd, ng* në gegërishte.

Në strukturën gramatikore dallime më të rëndësishme janë ato që lidhen me praninë ose mungesën e një numri kategorish gramatikore. Kështu në dialektin jugor mungojnë përmerat pronorë vetvetorë (*i vet, e vet, të vet*), forma foljore e së kryerës së dytë dhe ajo e së kryerës së plotë e dytë (*kam pas vojt* dhe *kiʃa pas voit*). dhe mbiemrat me prapashtesën *-shëm*, që tregojnë mundësi, aftësi (*i punueʃem i θyeʃem* tj.). Dallimet e tjera të qenësishme në strukturë shkaktohen prej mënyrave të ndryshme të ndërtimit të formave të disa pjesëve ligjëratës (strukturën e brendshme të formës, mbaresat ose anën fonetike të tyre) dhe herë-herë edhe prej funksionit të ndonjë forme gramatikore: mjaft emra mashkullorë që mbarojnë me bashkëtingëllore e formojnë shumësin në dialektin verior me mbaresën *a*, ndërsa në dialektin jugor me *ə, e* ose me mënyra të tjera: *brina* (brirə), *demela* (dembelə), *pusa* (puse), *drapna* (drapriɲ ose dərpəɲ), *giʃta* (giʃtriɲ) etj.; në gegërishte mbiemrat femërorë të ardhur nga pjesorja dallohen prej mashkullorëve edhe nga nyja e përparme edhe nga mbaresa *-e*, kurse në toskërishte vetëm nga nyja: *i lam* (*m*) ~ *e lamə* (*f*) (geg.) dhe *i larə* (*m*) ~ *e larə* (*f*) (tosk.); dialekti verior është largu

ar prej jugorit, sepse në shumicëne të folmeve të tij e pakryera e foljeve veprore formohet me mbaresa më të reja[57], që në fakt paraqesin fo rma të reduktuara të së pakryerës të foljes «*jam*»[58] - *ʃa* (- *jʃa*) veta I nj., -*ʃe*(-*jʃe*) veta II nj., -*te* (-*nte* ose -*jte*) veta e III nj., -*ʃim* (-*jʃim*) -*ʃit* (-*jʃit*) -*ʃim* (-*jʃim*) tri vetat e shumësit: *kapʃa, lajʃa* etj.; në dialektin jugor[59] janë ruajtur mbaresat më të vjetra, të cilat sot paraqiten me variante dialektore të ndryshme: -*ɲa*, -*ɲe*, -*te* (-*nte*) për tri vetat e njëjësit dhe -*nim*, -*nit*, -*nin*, për tri vetat e shumësit etj. (shih § 4.1.1.) *happa, laɲa* etj.; e pakryera e pësoreve, përveç të folmeve të Elbasanit e ndonjë të folmece tjetër anësore, në gegërisht formohet nga e pakryera e veproreve duke i paravënë pjesëzën përemërore *u*: *u lajʃa* etj., ndërsa toskërishtja ka një formë të posaçme më të thjeshtë, që formohet nga tema dhe mbaresat -(*h*)*eʃa*, (*h*)*eʃe*, -(*h*)*eʃ* ose -(*h*)*e j*, -(*h*)*eʃim*, -(*h*)*eʃit*, (*h*)*eʃin*: *laheʃa* etj.; gegërishtja e ka formuar paskajoren nga pjesorja dhe pjesëza *me* (me punue), kurse toskërishtja nga emri foljor asnjanës dhe parafjala *për* (për të punuar), ekzistojnë dallime në funksionimin e këtyre dy formave; sot përgjithësisht në dialektin verior pjesorja në format foljore të përbëra del e reduktuar në mbaresat: *maɾ* «marrë», *liθ* «*lidhur* », *la*: «*larë*» *pi*: «*pirë*» *nëjt* «*ndejtur*» etj. Për shkak të analogjisë gegërishtja është treguar inovuese duke i përdorur edhe në funksion predikativ mbiemrat me nyjën e parme *e*: *e kemi venin e fiɛft na ktu* (geg.) *e kemi vendin tə ftohtə ne kətu* (tosk.).

Ndryshimet që janë bërë në dialektet kanë prekur edhe asferën e leksikut, por është me rëndësi të thuhet se dallimet më të shumta në këtë fushë vërehen ndërmjet të folmeve e grupeve të të folmeve dhe për më tepër, një pjesë e mirë e këtyre dallimeve u takojnë fjalëve që lidhen me profilin ekonomik, me terrenin e klimën dhe me zakonet e banorëve të krahinave, janë pra dallime të atilla që nga pikëpamja dialektologjike janë të dorës së dytë. Numri më i madh i fjalëve që janë konsideruar si toske ose gege në të vërtetë është karakteristik për një pjesë të të folmeve të njërit e të tjerit dialekt të shqipes. Mendojmë se është vështirë të formosh një listë të madhe fjalësh që të jenë karakteristike për gjithë të folmet e një dialekti ose për pjesën më të madhe të tyre dhe që ato t'u kundërvihen plotësisht fjalëve të dialek-

---

57. Për moshën e formave gege e toske të së pakryerës shih. S. Riza, *Tri monografina albanologjike*, Tiranë, 1944, f. 182-193
58. Shih M.Domi, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (dispensë), Tiranë, 1961, f.50.
59. Në dialektin verior kanë ruajtur format me *-nja* ose *-nje* Dibra, Larja dhe Shestani (Krh. C.Tagliavini, *L'albanese di Dalmazia* dhe E.Çabej, *Për historinë e konsonantizmit* . . . , f. 45) dhe në të folmet e Elbasanit format me *-je* etj. (krh. G.Weigand, *Albanesiche Grammatik*, Leipzig, 183.

tit tjetër. Kështu për gegërishten janë karakteristike *tʃel, tʃeləs, drȳn, fik, fty:r* ose *fytyr* «*fytyrë*», *tʃerδe, heret, katun,* «*katund*», *krejt, mīij* «*mbërrij*», *midis, rēj ren* «*rend*», *ʃpin, ʃupla:k, tãməl, tinəz, tlyn, nīoj* «*ndërroj*», *krye, cokθ, hut(i), mzat* «*mëzat*», *cerpik* etj. Në toskërishte këtyre fjalëve përkatësisht u përgjigjen: *hap, kytʃ* ose *haps*; *kytʃ* ose *katinar* etj., *ʃuaj, sūat* ose *face* (sipas rastit), *fole, ʃpejt* (në kuptimin kohor), *fʃat, fare, arīj, nə mes, gəɲej, breθ* ose *vrapoj, kurīs, pələmbə, cumətʃ, fʃehurazi, ʒalpə, kəmbej, kokə, ʒon, buf, dem, cepalə* etj.

Disa fjalë të një dialekti nuk dalin sot gjëkundi në dialektin tjetër, për shembull fjalët gege: *drȳn, herət, katun, midis, rēj, ʃpi:n, tãməl tinəz* dhe fjalët toske; *kytʃ,* «*celës, dry*», *fʃat, məngoj* «ngrihem herët në mëngjes», *mergoj* «largoj, dëboj nga atdheu», por ndodh që në njërin dialekt, sidomos kjo më shumë në gegërishte, krahas fjalëve të veta dialektore karakteristike, të ekzistojnë edhe disa fjalë që në dialektin tjetër janë të vetme, pa sinonime, ato ekzistojnë me atë kuptim ose me një kuptim tjetër: *hap, face* (me kuptimin e parë), *ʃpejt, cumətʃ,* «hirrë» etj. (në geg.), *tʃel* «e bëj në një ngjyrë më të hapët» *ə fikət* «alivan», *lyrə* «yndyrë», në ndonjë krahinë edhe *tlyer* «gjalpë» në tosk.).

Nga sa u parashtrua gjer këtu shihet qartë se dy dialektet e shqipes dallohen më tepër në fonetikë e në morfologji dhe se shkalla e diferencimit të tyre nuk është madhe[60], sepse, sidomos në strukturë, ky diferencim nuk është thelluar edhe aq shumë. Përveç bartësve të ndonjë të folmeje që është larguar në fonetikë, banorë të tjerë të Veriut dhe të Jugut mund të merren vesh midis tyre pa shumë vështirësi.

2.2.2. **Të folmet kalimtare.** - Në një zonë të ndërmjetme, midis dy dialekteve të shqipes, gjenden të folmet kalimtare. Ato shtrihen në një brez tokë përgjatë krahut të majtë të Shkumbinit, që nga Qafa e Thanës në lindje e deri në bregdet, te derdhja e Shkumbinit në perëndim. Në këtë zonë përfshihen Rajca, Përzeshta, krahina e Vërçës, e Shpatit, e Polisit, e Sulovës, e Dumresë, e Darsisë së Peqinit, Bregdeti

60. Këtë mendim e kanë dhënë shumë studiues të shqipes e të dialekteve të saj shih G.Meyer, *Della lingua e della leteratura albanese*, në «Nouve Antologia» 50 (1885), 588 (sipas citimit të E.Çabejt në *Gjon Buzuku*, II (1955) 9, f. 80, *M.Lambertz, Bericht...* dhe *Lehrgang...* T, III, f. 2; I. Dilo Sheperi, *vep. e cit.* f. 4 etj. Këtë mendim e kanë shprehur edhe shumë diskutues në Konferencën e Dytë Shkencore të zhvilluar në Tiranë më 1952 mbi problemin e gjuhës letrare kombëtare shqipe (shih «Bul. për shk. shoq». 4, 1952.)

i Poshtëm i Kavajës dhe pjesa veriore e fushës së Lushnjës (shih hartën nr. 2).



Harta nr 2

Të folmet e kësaj treve formojnë vetëm grup të folmesh e jo dialekt,sepse nuk kanë tipare të vetat të ndryshme nga ato të toskërishtes e të gegërishtes, por kanë të përziera tipare të njërit dhe tjetrit dialekt. Në të vërtetë si kalimtare nuk duhet marrë patjetër çdo e folme që ka të përziera çdo lloj tiparesh të dy dialekteve, por vetëm ajo që ka të përziera tiparet më qenësore të tyre. Në gjuhën shqipe

karakteri kalimtar i të folmeve përcaktohet më mirë nga fakti se gjenden apo jo të përziera pesë nga tiparet kryesore që diferencojnë toskërishten e gegërishten, sidomos dy nga më kryesoret: hundorësia dhe rotacizmi (kur janë të pranishëm hundorësia e rotacizmi ose kur mungon hundorësia dhe është e pranishme *n*-ja intervokalike krahas rotacizmit, pra jo vetëm bashkekzistenca e hundorësisë dhe e rotacizmit, si ka shprehur mendimin M.Çeliku[61], sepse kështu ngushtohet kriteri, dhe, si rrjedhim, nuk duhej të ishin marrë prej tij si kalimtare disa të folme ku mungon hundorësia). Së bashku me këto gjenden të përziera edhe tipare të tjera të dy dialekteve të shqipes dhe në varësi të këtyre përcaktohet shkalla e afrimit të një të folmeje me toskërishten ose me gegërishten. Në mënyrë të përgjithshme mund të themi se të folmet e skajit lindor kanë më tepër tipare toske, ndërsa ato të qendrës e sidomos ato të skajit perëndimor kanë më tepër tipare gege.

Po japim disa nga veçoritë kryesore të të folmeve kalimtare dhe shtrirjen e përafërt gjeografike të tyre:

1. Zanore hundore gjenden në Vërçë, Bërzeshtë, Shpat, Polis, Dumre, Darsi dhe në Bregdetin e Poshtëm të Kavajës (*zãri, pẽri, uɫĩri*), kurse në zonat e tjera ato pothuajse mungojnë fare.

2. Zanorja e theksuar *ã* gege del me variante fonetike të ndryshme: *ã* në Polis e Shpat (*zãri, ʒ ã*), *a* në fushë në Lushnjës (*zari, ʒ a*), *ã* në Dumre, Darsi dhe në B.P. të Kavajës (*za˜ri, ʒ a˜*) dhe *o* në Sulovë (*zori*, ʒ o), gjegjësja e saj toske, ə-ja, me variantin kryesor del në Sulovën jugore, herë-herë edhe në Vërçë e në Rajcë, kurse si *ə* e prapme e ngritjes së ulët (që i afrohet *a*-së) ndeshet më tepër në Vërçë dhe në Rajcë.

3. Togzanori *ua* i toskërishtes gjendet në të gjitha rastet në Vërçë e në Rajcë (*ftua, duar*), kurse në të folmet e tjera ai vërehet vetëm në rrokje fundore të hapët (*ftua, grua*), në pozitat e tjera, ashtu si në gegërishten jugore, ka *u* të përftuar nga monoftongimi i *ue*-së (*dur* «*duar*», *ʃulli*, «shualli», *i martur* «i martuar», *e haɾur* «e harruar»).

4. Grupi *va-* gjendet në qendër dhe në lindje (*Vërçë, Rajcë*, Bërzeshtë, Shpat, Polis, Sulovë), ndërsa *vo-* në perëndim (Dumre, Darsi, fusha e Lushnjës, B.P. i Kavajës).

5. Rotacizmi shihet dendur në të gjitha të folmet kalimtare[62], ai ka hyrë thellë gjer në krahinat e Shpatit dhe të Polisit, nuk mungojnë edhe rastet me *n* intervokalike, por këto janë më të rralla në krahasim me të parat: *rãra* (*rãna*), *ʃuɫãri* (*ʃullãni*) *lakrur* (*laknur*), *ɾeʃtra* (*ɾeʃtna*), *kam bãr* (*kam bã:m*), *kam larur* (*kam lərum*) dhe: *dimn, plecni, e ʃkurtən* etj.

---

61. *Rotacizmi në të folmet kalimtare të gjuhës shqipe*, në «SF», nr.1, 1964, f.162.
62. Më hollësisht shih M.Çeliku, *Rotacizmi në të folmet kalimtare...*

6. Infinitivi gegë (me punue) ekziston në shumicën e të folmeve, por ka një përdorim shumë të vogël, bile edhe në ato të folme që kanë më tepër tipare gege përdoret më shumë si folje - kallëzues i një fjalie qëllimore dhe objektore: do ʃkoj *me punur*: deʃa *me dal* etj.

2.2.3. **Nëndialektet.** Brenda çdo dialekti dallohen grupe të folmesh që, sipas shkallës së afërsisë që kanë midis tyre, formojnë njësi dialektore të madhësive të ndryshme.

Të dhënat e sotme të dialektologjisë shqiptare të çojnë doemos te ndarja e secilit dialekt në dy nëndialekte[63]: *gegërishja veriore* dhe *gegërishtja jugore* në dialektin gegë dhe *toskërishtja veriore* dhe *toskërishtja jugore* në dialektin toskë. O.Myderrizi (vep. e cit. f. 216), duke mos marrë fort parasysh edhe ato kritere që ka vendosur për ndarjen e shqipes në gegërishte e toskërishte, e veçon grupin e të folmeve të Shqipërisë së Mesme si një dialekt të tretë të shqipes dhe e quan «dialekt i mesëm, ... dialekt tranzicioni» (!)

Dy nëndialektet e gegërishtes gjeografikisht ndahen te lumi i Matit. Gegërishtja veriore shtrihet në të djathtë të Matit: në Mirditë, në Pukë, në Lumë, në Has, në Malësi të Gjakovës, në Kosovë, në anët e Preshevës e Bujanovcit, në Dukagjin, në Malësi të Madhe në të dy anët e kufirit, në Shkodër e në rrethinat e saj, në krahinën e Krajës dhe të Ulqinit; ndërsa gegërishtja jugore shtrihet në të majtë të Matit: në zonat e Elbasanit, të Durrësit, të Tiranës, të Krujës, të Matit, të Lurës, të Peshkopisë e të Maqedonisë Perëndimore, prej Dibre deri në Shkup e Kumanovë. Toskërishtja veriore shtrihet në rrethet e Beratit, të Fierit, të Skraparit, të Pogradecit, të Korçës, të Kolonjës, në ato zona të rretheve të Përmetit e të Tepelenës që ndodhen në krahun e djathtë të Vjosës dhe në Vlorë e në fshatrat veriore e verilindore të saj, kufiri në këtë anë arrin pak në jug të qytetit të Vlorës. Toskërishtja jugore shtrihet në Labëri, në anët e Gjirokastrës e të Delvinës dhe në Çamëri (shih hartën nr 3).

Nëndialektet dallohen mirë ndërmjet tyre prej një sërë veçorish, por nuk duhet kuptuar sikur kufijtë e të gjitha tipareve karakteristike të një nëndialekti përputhen plotësisht me njëri-tjetrin, ndonjë prej tyre bën edhe përjashtim në zonat kufitare, sepse, siç dihet, nuk ka kufij dialektorë idealë të prerë.

Shumica e tipareve kryesore që dallojnë sot dy nëndialektet e

---

63. Për herë të parë këtë ndarje e kemi bërë në *Dialektologjia shqiptare*, 1963, f. 76, 81; aty kemi dhënë edhe karakteristikat e çdo dege, por pa i quajtur ato si nëndialekte. Shih edhe M.Çeliku, *Mbi grupimin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi tipare të tyre*, në «SF», 2, 1968; B.Beci, *Grupi perëndimor i nën dialektit nverior të gegërishtes*, në «SF», 3, 1970; po ai, *Grupi lindor i nëndialektit verior të gegërishtes* (në shtyp të «Dialektologjia shqiptare», VI).



Harta nr 3

gegërishtes janë formuar relativisht vonë për shkak të inovacioneve jo të njëjta që kanë përfshirë të folmet e njërit dhe tjetrit grup të folmesh. Në këtë drejtim të folmet e nëndialektit verior janë treguar më inovuese si në fonetikë, ashtu dhe në morfologji: ë-ja shqiptohet e hapët [ę] (vę̈na / fę̈mən), *ə*-ja e pastheksuar nuk shqiptohet edhe në rrokje fundore që mbyllet nga një bashkëtingëllore josonante: *babs* «*babës*» *θast* «thasët», ndërsa, kur në këtë pozitë ndodhet pranë një bashkëtingëlloreje sonante, shqiptohet *e* e hapët [ę]: *motęs*, *i ãmęl*, të folmet e këtij nëndialekti nuk e kanë çiftin e fonemave bashkëtingë-

llo e qiellzore *c*, *ʒ*; ndërsa në gegërishten veriore kalimi i *h*-së në *f* është një ndërrim fonemash, që ndodh rregullisht kur *h*-ja vjen para *t*-së (*i ftoft* < *i ftohtə*), në gegërishten jugore kjo dukuri është shtrirë edhe në raste të tjera, ku nuk është e kushtëzuar fonetikisht, d.m.th. është vetëm një tipar dallues etimologjik, nuk lidhet me funksionin e fonemave (*ɾof* «njoh», *nifəm* «ndihmë» etj.), një kategori e caktuar foljesh me bashkëtingëllore dalin me mbaresë vetore në vetën I njëjës të dëftores së tashme (*kapi, goditi*); foljet me zanore të tipit *ha, fle* etj. në shumicën e të folmeve zgjedhohen sipas foljeve të tipit *punoj*: *haj, flę̃j* v. I nj., *han, flę̃n* v. II dhe III nj. *hajm, flę̃jm* v. I sh., *hajn, flę̃jn* v. III sh.; foljet e mënyrës lidhore koha e tashme veta e III njëjës për nga forma dalin njësoj me ato të vetës së tretë shumës: *ai̯ t liδin, ai̯ t presin, ai̯ t lajn, ai̯ t hajn*. Për gegërishten jugore është për t'u theksuar se gjatë kohëve ka ecur krah për krah me mbarë të folmet e toskërishtes ose me të folmet veriore të saj; kështu grupet e vjetra *kl, gl* kanë përfunduar në *c*, *ʒ* (*caj, ʒûni*); emrat mashkullorë që mbarojnë me diftong (*thua, krua*), kur shquhen, ndryshe nga të folmet e skajit verior, nuk e nxjerrin *n*-në me të cilën ka mbaruar dikur tema (*ftue-ftoi, krue-kroi*); disa funksione te paskajores gege kryhen nga lidhorja ose nga paskajorja e tipit *për të punuar*: *sun t ʃkoj, kam pər t vojt ke i̯ mik* etj. Është me interes të vihet në dukje se nëndialekteti i gegërishtes jugore, ashtu si me disa veçori fonetike, edhe me një numër fjalësh bashkohet me toskërishten dhe veçohet nga gegërishtja veriore: *rəkoj, deɾ̄, məɾʒes, ŋrohem, tʃati, ʒem«gjemb», patate, preʃ ose pras, dyzet* etj., të cilave në geg. veriore u përgjigjen përkatësisht fjalët: *ʒi̯moj, θi, natje* dhe *sabah, dzehem, puɫaz mlo;j* dhe *kulm, fe:ɾ̄* ose *θe:ɾ̄, kərtoɫa* ose *kompir, puɾ̄ī, k̄atərδet* etj.

Në përgjithësi tiparet qenësore që diferencojnë sot dy nëndialektet e toskërishtes duket se janë formuar diçka më heret se ato që diferencojnë dy nëndialektet e gegërishtes. Nëndialekti i toskërishtes jugore ka qenë më pak inovues, sidomos në strukturën gramatikore, tek ai janë ruajtur zanoret e gjata (në Çamëri në një masë të vogël); zanorja e theksuar, që ka qenë ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore (ajo së cilës gegërishtja i përgjigjet me ẽ), ka kaluar në *ə* në të gjitha rastet (*pə-ri, frə-ri, fəmər, ʒəj*), ndërsa në toskërishten veriore ky fenomen nuk i ka përfshirë të gjitha fjalët (*pe-ri, fre-ri, femər, ʒeɾ, e eɾte*); në sistemin vokalik nuk bën pjesë zanorja *y*[64]: *di* (dy), *iɫ* (yll), *birek* ose *burek* (byrek); nuk ka diftongje, por vetëm togje zanoresh *ua, ie* (*duar, grua, dieɫ, bie*), kurse në toskërishten veriore diftongjet janë kthyer në togje zanoresh vetëm në rrokje fundore të hapura[65]

64. Kjo zanore ekziston në disa të folme kufitare me toskërishten veriore.
65. Në një numër të vogël të folmesh ka diftongje në të gjitha pozitat.

(*dua, mua, bie, ʃtìe, u θye*), bashkëtingëllorja qiellzore mbyllore *ɲ* ka evoluar duke u kthyer në shtegore *j* në fund të fjalës te mbaresa e foljeve (*punoj, laj, tə ʃkoj* etj.); këmbimi i bashkëtingëlloreve të zëshme me të shurdhëtat në pozicion fundor nuk është tipar i qenësishëm sikurse në nëndialektin verior; aty mungon forma e rasës vendore; format e së pakryerës të foljeve dëftore janë më të vjetra se ato të pjesës veriore të toskërishtes: *jeʃə, jeʃe, iʃ, keʃə keʃe kiʃ, kərkopə kərkope, kərkon* ose *kərkonej* (tosk. jugore) dhe *iʃa, iʃe, iʃte, kərkopa. kərkope, kərkonte* (tosk. veriore).[66]

Grupet e të folmeve. - Po ta ndjekim më tej ndarjen dialektore të shqipes, pas nëndialekteve do të dallojmë disa grupe të mëdha të folmesh. Në dialektin verior si grupe të tilla janë: *gegërishtja veriperëndimore, gegërishtja verilindore, gegërishtja qendrore* dhe *gegërishtja e Shqipërisë së Mesme*. Të folmet e dy grupeve të para janë të nëndialektit të gegërishtes veriore. Kufiri që ndan këto dy grupe kalon te Thethi, duke e lënë këtë në anën perëndimore, më poshtë ky kufi vazhdon pak në lindje të lumit të Shalës, aty ku fillojnë tokat e Nikaj-Mërturit, e folmja e të cilit është verilindore, dhe më poshtë akoma, në të majtë të Drinit, ai kalon ca më në perëndim të Pukës. Gegërishtja qendrore përfshin të folmet e Lurës, të Lumës, të rrethit të Dibrës dhe të folmet shqipe të Maqedonisë Perëndimore, si ato të Dibrës, Kërçovës, Tetovës, Gostivarit, Shkupit e Kumanovës. Disa nga veçoritë më karakteristike të këtij grupi i ka edhe e folmja e Mirditës, prandaj kjo e folme në këtë drejtim afrohet mjaft me grupin e gegërishtes qendrore dhe përgjithësisht bën pjesë në këtë grup. Të gegërishtes së Shqipërisë së Mesme janë të folmet e Tiranës, të Durrësit dhe të Elbasanit.

Brenda dialektit toskë grupe të mëdha të folmesh dallohen vetëm në nëndialektin jugor të tij, dallohen aty *labërishtja* dhe *çamërishtja*. Këto dy grupe ndahen gjeografikisht të lumi i Shalësit, aty në jug të Delvinës. Grupi i parë përfshin të folmet e Labërisë e të krahinave të rrethit të Gjirokastrës, ndërsa grupi i dytë përfshin të folmet e zonë

66. Ka edhe variante fonetike të tjera të mbaresave të së pakryerës.

së Konispolit dhe ato të Çamërisë, shkon deri te Gjiri i Preveçës (shih hartën nr. 4).–



Harta nr 4

Ndarja e gegërishtes në katër grupe, që bëmë këtu ngjan me atë që ka bërë M.Lamberci (sidomos në «Lehrgang ...» T. III), por ndryshon prej tij në emërtimin e grupeve e në përcaktimin e kufijve gjeografikë të tyre, në bashkimin nga ana jonë të grupeve dy e nga dy në nëndialektet e gegërishtes, ndryshon gjithashtu edhe për faktin se ky dijetar nuk parashtron kritere në ndarjen dhe nuk jep veçoritë dalluese të grupeve. M.Lamberci grupin veri-prëndimor e quan gegërishte veriore dhe përfshin në të edhe një numër të madh të folmesh verilindore, duke e shtrirë në Nikaj-Mërtur, Krasniqe, Has, Berishë, Iballë, Qerret e Mal të Zi[67], grupin e gegërishtes qendrore e quan gegërishte e mesme dhe nuk flet se ku shtrihet (në «Bericht. . . » te ky grup shtie Matin, Lurën, Mirditën), ndërsa në gegërishten jugore ai përfshin edhe Krujën. Dumrenë e Mokrën. Për toskërishten nuk bën ndonjë grupim të të folmeve, por vetëm përmend një numër të madh prej tyresh si variante të këtij dialekti që fliten në lokalitete të ndryshme.

Një ndarje të gegërishtes në katër degë ka bërë edhe O.Myderrizi[68], por duke i quajtur këto degë nëndialekte pa dhënë kufijtë e shtrirjes së tyre dhe pa përmendur të folmet që përfshihen në to, bën një ndarje në vija të përgjithshme duke dalluar një nëndialekt për zonën Shkodër-Dukagjin, një për Kosovën, një për zonën Tiranë-Elbasan e një për Dibrën. B.Beci[69] dhe A.Desniskaja[70] mendojnë se gegërishtja duhet ndarë në tri nëndialekte, sipas tyre, grupi i të folmeve të gegërishtes qendrore formon një nëndialekt më vete. Pavarësisht nga largimi i këtyre të folmeve në disa veçori fonetike, megjithatë në tiparet që karakterizojnë nëndialektet ato bashkohen me gegërishten e Shqipërisë së Mesme dhe nuk formojnë dot një nëndialekt të veçantë brenda gegërishtes.

I pari, që ka vënë re ndarjen e toskërishtes në ato grupe që pranohen edhe sot, ka qenë K.Kristoforidhi (vep. e cit. f. 1.). E meta e tij është se labërishten dhe çamërishten i konsideron si variante të toskërishtes veriore, të cilën, me sa duket, e identifikon me gjithë dialektin jugor të shqipes dhe nuk e përmend fare si një degë të tretë të këtij dialekti. Një mendim të këtillë e shohim edhe tek I.Dilo Sheperi (vep. e cit. f. 4), i cili labërishten dhe çamërishten i ndan si «*nëndialekte*» ose «idioma» të toskërishtes. G.Pekmezi (vep. e cit. f. 2), ndryshe nga K.Kristoforidhi e I.Dilo Sheperi, veç labërishtes e çamërishtes, dallon edhe të folmet e Dangëllisë e të Kolonjës, duke mos marrë

67. Territori që ndodhet midis Pukës e Kukësit.
68. O.Myderrizi, *vep. e cit.*, f. 216.
69. B.Beci, *Mbi katër inovacione fonetike . . .*, f.261.
70. A.Desnickaja, *Albanskij jazyk i jego dialekty*, Leningrad, 1968.

parasysh ndryshimin e shkallës së madhësisë midis njësive dialektore që formojnë të folmet e Dangëllisë e të Kolonjës dhe ato të Labërisë e të Çamërisë. Më pas Dh.Shuteriqi (vep. e cit. f. 27) dhe O.Myderrizi (vep. e cit. f. 2—25) e ndajnë toskërishten në tri njësi të barabarta[71] duke i quajtur i pari të folme (toskërishte në kuptimin e ngushtë të fjalës, labërishte e çamërishte) dhe i dyti nëndialekte (toskërishte, labërishte, çamërishte).

Për të karakterizuar grupet e të folmeve të të dy dialekteve po sjellim këtu veçoritë e tyre dialektore, më të qenësishme.

2.2.4. **Gegërishtja veriperëndimore.** Në përgjithësi diftongjet e vjetra *ae* dhe *oe* nëpër një krasis kanë përfunduar i pari në æ (*a* e përparme e mbyllur) dhe i dyti në ø (*e* e mbyllur e labializuar) ŋæ: < < *ngae* «nge», *ti m* θæ: < *thae* «*the*» dhe *vø*: < voe «ve»), *vø:s* «vesë; grupet e vjetra *kl* e *gl* kanë dhënë përkatësisht *kl* e *gl* (*klumʃt* «qumësht» dhe *glũni* «gjumi», grupi *ʃh* është thjeshtuar në *ʃ*: *ʃijse* «fshesë», *munaʃ* «mëndafsh», *klosa* «qofsha»; rrjedhorja e emrave femërore njëjës të shquar për nga forma (por e pashquar nga kuptimi) del me *-et*: *miʃ lopet* «mish lope», forma e së kryerës së thjeshtë veta I sh. ka mbaresën *-mę* (*dulmę* «dolëm», kurse veta III sh. *-nę* (*dulnę* «dolën»).

2.2.5. **Gegërishtja verilindore.** Diftongjet e vjetra *ae, oe* në shumë të folme kanë dhënë përkatësisht: *a:, o:* (θ*a:* < *thae, vo:* < *voe*); grupet e vjetra *kl* e *gl* janë reduktuar duke mbetur vetëm elementet e para *k* e *g* (*kumʃt* dhe *gũni* «*gjuri*»); emrat mashkullorë që mbarojnë me *k, g, h*, kur shquhen, marrin mbaresën shquese *i*: *miki* «miku», *zogi* «zogu», *krahi* «krahu»; në shumë të folme e pakryera formohet nga tema e pjesores me mbaresat *-ʃna* (*-jʃna*) për vetën e parë njëjës (*arδʃna, vrajʃna*) dhe në të gjitha të folmet me mbaresën *-ke* (*-ijke*) për vetën e tretë njëjës (*arδke, vrajke* «vinte», «vriste»).

2.2.5. **Gegërishtja qendrore.** Ky grup është larguar mjaft në fonetikë prej tipit të përbashkët të gegërishtes. Po të lëmë mënjanë disa dukuri me një shtrirje më të kufizuar territoriale, si tipare të përbashkëta do të ishin këto: *i*-ja e theksuar është diftonguar dhe ka dhënë *ei̯, ei̯, əi̯, ai̯, oi̯*, (në një zonë mbizotëron njëri ose dy nga këto variante): *δei* «dhi», *mẽi̯r* «mirë», *təi̯* «ti», *ʃpai̯* «shtëpi», *ʃoi̯* «shi» etj.; atje ku shqipja e përbashkët ka *y*, në këto të folme gjejmë *i* (në Dibër e Peshkopi kryesisht) dhe *e* të mbyllur të labializuar [ø] ose *e* të hapët të labializuar [œ] (sidomos në Krujë, Mat, Mirditë, Lurë, Lumë): *dʒims* «gjymës» *krøp* «krypë», *u* θœ:, «u thy < u thye», bashkëtingëllorja *g* është kthyer në ʒ gati në të gjithë këtë trevë dialektore, me

71. Edhe ne në *Dialektologjia shqiptare*, 1963, duke ndjekur traditën, i kemi quajtur nëndialekte (toskërishte veriore, labërishte, çamërishte).

përjashtim të zonës së Krujës: *ʒur* «gur,» *ʒoja* «goja» dhe duke përjashtuar gjithashtu Krujën, në të folmet e tjera grupet *tj, dj* nëpërmjet palatalizmit kanë dhënë *c, ʒ*: *cetər* «tjetër», *ʒaθ* «djathë».

2.2.7. **Gegërishtja e Shqipërisë së Mesme.** Të folmet e këtij grupi nuk kanë ndonjë tipar tjetër specifik veç formave të përemrave pronorë *im, ime, tat, tate* (*tʃuni im, gotsa ime, tʃunin tat, gotsən tate*) dhe aoristit sigmatik (*u loðəʃ, u laʃ*), formës së rasës vendore (*n malt, n gropət* etj.), por, megjithatë, duhet thënë se monoftongimi i diftongjeve *ue* > *u, ye* > *y, ie* > *i, oe* > *e*, që sollëm si karakteristika të nëndialektit të gegërishtes jugore, për këtë grup janë më tipike.

Siç e kemi thënë, në dialektin toskë vetëm nëndialekti i toskërishtes jugore ndahet në dy grupe të mëdha të folmesh (labërishte, çamërishte), prandaj edhe ne këtu vetëm veçoritë dalluese të tyre do të japim.

2.2.8. **Labërishtja.** Bërthamën e saj e përbëjnë të folmet e Labërisë, prandaj edhe tiparet dalluese më karakteristike që po sjellim këtu u përkasin këtyre të folmeve, ndërsa të folmet e tjera afrohen shumë me to, por nuk janë krejtësisht të njëjta.

Zanoret e gjata këtu ndeshen më dendur se në të folmet e çamërishtes; *ə*-ja e theksuar ka një timbër të veçantë, është një *ə* e shtytur më prapa [*ɜ*], e cila në disa vise (Himarë), në raste të caktuara, arrin deri në një zanore të prapme jobuzore [ʌ] (*nʒna* «nëna», *bɜri* «bëri» dhe *nʌna, bʌri*); grupet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng* janë asimiluar në *m, n, ŋ*: *mərθej* «mbërthej», *ner* «nder», *ŋrɜ* «ngre» dhe pjesoreve me *ë -në* u ngjitet një mbaresë e dytë *ur*: *dalur* «dalë», *maɾur* «marrë», *θɜnur* (thënë»; *lɜnur* «lënë» etj.

3.2.9. **Çamërishtja.** Këtu janë ruajtur grupet e vjetra *kl* e *kl* (*kluməʃt* «qumësht», *gliʃt* «gjisht»; është ruajtur *-l'* -(sot *l*) që në mbarë shqipen ka dhënë -j-: *val* «vaj»; *milə* «mijë», *golə* «gojë»; trajtat analitike të kohës së shkuar të foljeve pësore formohen nga veprorja duke i paravënë pjesëzën përmërore *u*: *u ka bërë* «është bërë», *u ka larë* «është larë», *u kish frirë* «ishte fryrë»; ekziston prapashtesa *-lə*>, me të të cilën formohen emra foljorë veprimi (*maɾələ* «marrje») dhe emra mocioni (*mbretələ* = «mbretëreshë», *priftələ* «priftëreshë»). Ndonjë veçori kryesore, si ruajtja e *-l*-së, e ndonjë tjetër e dorës së dytë gjenden edhe në të folmen e Gjirokastrës.

Nuk po ndalemi te të folmet e kolonive shqiptare, por po mjaftohemi duke thënë se të folmet e arbëreshëve të Italisë[72] dhe të Greqisë[73].

72. M.Lambert, *Albanische Mundarten in Italien*, në «Indogerm. Hahrbuch» 2, 1-130; *Italoalbanische Dialektoktstudien*, në «Zeitschr. f. vergleichende Sprachforschung» 51, 52, 53, E.Çabej, *Nguli met shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre, në* «Konferenca II e Stud. Alban.» vëll. III, 1969, f. 107-115; Gj.Shkurtaj, *Shpirti arbrit rron*, Tiranë, 1984.

73. C.H.Reinhold, *Noctes Pelasgicae*, Athen, 1955; G.Weingand, *Das albanische in Attika*, në «Balkanarchiv», 2 (1926);

janë toske dhe se kanë më shumë pika takimi me toskërishten jugore, ato të shqiptarëve të Ukrainës[74] dhe të Mandricës[75] (Bullgari) janë gjithashtu toske, por që afrohen në disa pika me të folmet e anëve lindore të Toskërishtes, kurse e folmja e shqiptarëve të Dulmacisë[76] është gege e krahut veriperëndimor. Të folmet e këtyre kolonive rujnë mjaft tipare arkaike që nga koha kur u shkëputën prej trungut të atdheut të tyre, por gjatë kohëve kanë pësuar edhe ndryshime për shkak të një zhvillimi të mëtejshëm të mëvetesishëm dhe të një ndikimi nga ambjenti gjuhësor i huaj ku jetojnë.

74. S.Islami, *Material gjuhësor nga kolonitë shqiptare të Ukrahinës*, në «Bulet. për Shk. Shoq.», 2, 1955, f. 163.180.

75. M.Domi — Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, në «aSFn, 2, 1965, f.103-118; B.Sokolova, *Die albanische Mundart von Mandrica*, Berlin, 1983

76. G.Weigand, *Der gegisch Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien*, në Jahresberichten des Instituts für Rumänische sprache in Leipzig, 17, 18 (1911); G.Tagliavini, *L'albanese* di Dalmazia; I.Ajeti, *Istrojski razvitak gegijs ko'g govora Arbanasa kod Zadra*, Sarajevo, 1961.

B. DEGËZIMI DIALEKTOR I SHQIPES GJATË HISTORISË

2.3.1. Dialektet e një gjuhe në një kohë të dhënë ruajnë gjurmë të mëparshme të zhvillimit të tyre. Për historinë e shqipes dokumentet e shkruara të së cilës janë të shekullit XVI, burimet e dialekteve marrin një rëndësi të madhe. Dialektet e shqipes me të dhënat e veta e bëjnë shumë të mundshëm studimin dhe njohjen e historisë së tyre, sepse ruajnë ende veçori që kanë lindur në etapa të ndryshme të zhvillimeve që kanë pësuar, bile disa prej tyre, megjithëse të pakta në numër, por të rëndësishme, janë mjaft të hershme, të paktën të fundit të kohës antike. Në shumë raste veçoritë dalluese të të folmeve të shqipes ndihmojnë për shpjegimin e njëra-tjetrës. Duke u vështruar në mënyrë të lidhur, në radhë të parë, vetë tiparet dialektore që kanë lindur kohë pas kohe dhe duke u shfrytëzuar edhe të dhënat e gjuhës së shkruar dhe të historisë së popullit shqiptar, mund të gjendet koha e përafërt e lindjes së njërit ose të tjetrit tipar dialektor, si dhe rrethanat dhe kushtet e ndryshme në të cilat kanë lindur dhe janë zhvilluar ato.

Në këtë mënyrë, duke filluar me veçoritë më të reja dhe duke shkuar shkallë-shkallë gjer tek ato më të vjetrat, mund të arrihet me sukses në një masë të mirë rindërtimi i gjendjes që kanë pasur dialektet në etapa të ndryshme të zhvillimit të tyre.

Kjo mënyrë procedimi ka vështirësitë e veta objektive, sepse mungojnë dokumente gjuhësore të shkruara për të gjitha kohët, por. megjithatë, nuk është e pamundshme për t'u përdorur.

Për periudhën që nga shekulli XVI e këtej studimi i historisë së shqipes mund të ndihmohet prej të dhënave të dokumenteve të shkruara. Këtë e shohim në rindërtimin me sukses të gjendjes së dialekteve

të shqipes të periudhës letrare që ka bërë E.Çabej[77]. Për periudhën më të hershme vërtet mungojnë dokumentet e shkrimitm, por mund të mbështetemi në radhë të parë në krahasimet brenda shqipe dhe, përveç kësaj, mund të ndihmohemi shumë edhe prej të dhënave që dalin nga historia e marrëdhënieve që ka pasur shqipja që nga kohët historike me gjuhë të tjera, si me greqishten e vjetër dhe me latinishten, me greqishten e mesme e të renë, me gjuhët romane, me sllavishten dhe me turqishten. Këto rrethana historike të periudhës paraletrera të gjuhës shqipe janë po aq të rëndësishme për historinë e dialekteve të shqipes, sa edhe dokumentet e shkrimit. Siç dihet, studiues të ndryshëm janë mbështetur në këto marrëdhënie të shqipes me gjuhët e tjera dhe kanë nxjerrë përfundime të rëndësishme për historinë e kësaj gjuhe në tërësi dhe të ndonjë ose të disa veçorive dialektore të saj.

Rezultatet e metodës së rindërtimit të brendshëm të dialekteve të shqipes të çojnë deri në kohën e marrëdhënieve të saj me latinishten.

Duke qenë se historia e zhvillimit të dialekteve të shqipes mund të ndiqet në mënyrë retrospektive deri në një kohë kaq të largët, siç është ajo e periudhës së marrëdhënieve të shqipes me latinishten, atëherë themi se të dhënat dialektore ndihmojnë shumë dhe për ndriçimin e çështjes nëse ka pasur apo jo që nga ajo kohë ndërprerje dhe ndërhyrje të jashtme gjatë zhvillimit të shqipes së përbashkët dhe të dialekteve të saj. Në këtë rast fjala është për ndërprerje e ndërhyrje të rëndësishme që të kenë shkaktuar ndryshime cilësore në strukturën gjuhësore të shqipes dhe në degëzimin dialektor të saj e jo për ndikime të huaja që vërehen në pjesë të veçanta të njërës ose tjetrës sferë të gjuhës së përbashkët dhe të të folmeve të ndryshme të saj.

Duke u mbështetur në këto mundësi që jep vetë historia e shqipes, ne do të përpiqemi këtu të analizojmë shkaqet që çuan në ndarjen e shqipes në fillim në dy grupe të mëdha dialektore: në grupin verior, gegërishten, që shtrihet në Veri, dhe në grupin jugor, toskërishten, që shtrihet në Jug.

Për studimin e kësaj çështjeje duhen pasur parasysh si elemente të ndjdomosdoshme disa të dhëna gjuhësore e historike, të cilat duhet të merren të lidhura me njëra-tjetrën. Duhen parë të gjitha veçoritë dalluese dialektore, jo vetëm ato të dy dialekteve, por edhe veçoritë e nëndialekteve, të grupeve të të folmeve dhe të të folmeve të veçanta, duhet bërë shtresëzimi kronologjik i tyre, duhen njohur e duhen pasur parasysh ligjet e zhvillimit të shqipes, gjuhët me të cilat ka

77. E.Çabej, *Gjon Buzuku*, në «Bul. për shk. shoq.», 2, 1953, f. 71-100; *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, në «Bul. për shk. shoq.», 3, 1963, f. 69-116 dhe *Disa faza më të moçme të Ihqipes në dritën e guhëëve fqinje*, në «Revistë shkencore e Inst.Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», 1, 1964, f. 5.27.

pasur marrëdhënie dhe koha kur i ka zhvilluar kontaktet me to, duhet pasur parasysh gjithashtu edhe hisotiria e Shqipërisë dhe e krahinave të saj. Analiza e të gjitha këtyre të dhënave të çon në zbulimin e kushteve dhe të shkaqeve të vërteta gjuhësore e shoqërore të ndryshimeve që kanë pësuar dialektet kohë pas kohe dhe të shtrirjes gjeografike të tyre.

Këto të dhëna janë të nevojshme, sepse vetëm pas një analize të këtillë mund të veçohen tiparet dialektore me relevante që dallojnë sot dy dialektet e shqipes, ndërmjet tyre, tiparet më të hershme që kanë shkaktuar në fillim degëzimin e shqipes në këto dy dialekte.

STUDIMET E DERISOTME

2.3.2. I pari që është marrë me këtë çështje ka qenë J.G.Hani[78]. Ky dijetar, duke u mbështetur vetëm në faktorë historikë dhe gjeografikë, pa bërë analiza gjuhësore, dha një mendim sipas të cilit ndarja e shqipes në dy dialekte e ka burimin te ndarja e dikurshme e territorit të sotëm të Shqipërisë në Iliri dhe Epir, me kufi të përafërt Vjosën. Pas tij dijetarë të tjerë, si G.Majeri[79], N.Jokli[80] G.Petrota[81], M.La Piana[82] etj. kanë shprehur mendimin se diferencimi i dy dialekteve të shqipes është më i vonë se ai që mendon I.G. Hani. E.Çabej[83], pasi jep kohën e përafërt të lindjes së një tipari dallues të dy dialekteve ose kohën e lindjes së njërit tipar në lidhje me një tipar tjetër dialektor, arrin në këtë përfundim: «Struktura e sotme (dialektore-J.G j.) me dallimet e saj më të vjetrat rrjedh pas gjase prej formimesh mesjetare e më të rejat prej formimesh të kohës së re. Pothuaj një shekull pas I.G.Hanit vetëm V.Polaku[84] e preku në disa artikuj, por sidomos te *Albanei a slované...*, problemin e shkaqeve të lindjes së dy dialekteve të gjuhës shqipe. V.Polaku, ndryshe nga G.Hani, duke u nisur nga faktorë historikë (marrëdhëniet e shqiptarëve me sllavët në mesjetë) kërkon ta mbështesë edhe gjuhësisht mendimin e vet mbi ndarjen e shqipes në dy dialektet që ekzistojnë sot.

Në artikullin e përmendur V.Polaku përpiqet të shpjegojë se egëzimi i shqipes në dy dialekte është rezultat i veprimit të dyfishtë

78. *Albanesiche Studien*, Jena, 1854, f. 219.
79. *Nuova Antologia* 50, 1835, f. 538.
80. *Në Geschichte der idy. Sprachwiss seit ihrer Begrundung durch.* F.Bopp, II, III, 1917, f. 125.
81. Rivista *indo-greco-italica* XVI, 1923, f. 43.
82. *Studi lingvistici albanesi*, 1949, f. 40.
83. *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, në «Dialektologjia shqiptare II, 1974, f. 429-438.
84. *Albanci a slované (vznik a počatky dnéšnich nařečnich variant albanskych*, në «Časopis pro moderni filologii», XXXIX, 2-3

të substratit sllav: të bullgarishtes në Jug, ku u formua toskërishtja, dhe të serbishtes në Veri, ku u formua gegërishtja. Sipas tij, elementi shqiptar, duke zbritur prej trevave të Shqipërisë Veriore, u grumbullua në pjesën jugore «*sidomos mbi substratin sllav dhe adstratin grekë, nga fillimi*»[85].

Kjo tezë, që tjetërkujt nuk i ka shkuar ndër mend gjer tashti, është mbështetur prej V.Polakut në radhë të parë në disa rrethana kulturore e politike të historisë së Shqipërisë dhe pastaj në disa të dhëna gjuhësore që ai i merr si argumente për mendimin e vet.

V. Paloku, duke u dhënë përparësi faktorëve jashtëgjuhësorë dhe ndikimeve të huaja në shpjegimin e shkaqeve të ndarjes dialektore të një gjuhe dhe duke u bazuar konkretisht në marrëdhëniet e shqiptarëve e të sllavëve gjatë mesjetës në Shqipëri, për të vërtetuar ndarjen e shqipes në dy dialekte prej ndikimit të dyfishtë sllav sjell si prova nomenklaturën gjeografike *me pak emra me prejardhje sllave*[86] në veri të Shkumbinit dhe *me origjinë sllave relativisht të dendur*[87] në jug të Shkumbinit, formën e së ardhmes perifrastike *kam me ʃkue*, që në Veri është e rëndomtë[88] kundrejt *do të koj* të toskërishtes, *përdorimin e të ashtuquajturit infinitiv në dialektin verior*[89], formën e së pakryerës, dallimin fonetik ã geg. /ë tosk., megjithëse për këtë ai shfaq edhe rezerva, artikulimin e bashkëtingëlloreve c e ʒ në gegërishte që është më afër me ɲ-në e ɲ në së serbishtes sesa me tingujt gjegjës të toskërishtes, ekzistemcën e zanoreve të gjata në gegërishte, të cilat me zanoret e mesme kanë në intonacion *diferenca kualitative* dhe se ky *diferencim fonologjik gegë hyri në ambjentin shqiptar nga ambjenti bilinguistik shqiptaro-sllav*, më në fund sjell si provë edhe rotacizmin, ndryshimin e *n*-së intervokalike në *r* në dialektin toskë, të cilin ai e mendon *si pasojë e substitucionit të lindur nga imitimi i n*-së *kakuminale shqipe prej sllavëve*[90].

Ne mendojmë se konkluzione të këtilla nuk rrjedhin prej materialit faktik dialektor të shqipes dhe prej historisë së popullit shqiptar, siç do të shihet edhe në poshtë, ato përshkohen qartazi nga një tendenciozitet prej pansllavisti dhe ky qëndrim subjektiv e ka çuar V.Polakun te ndërtimi i artikullit mbi një metodë jo të saktë për zgjidhjen e problemit të shkaqeve të ndarjes së gjuhës shqipe në dy dialekte.

---

85. V.Polak, *Albanci a slované*... f. 87.
86. Po ai, *Po aty*, f. 86
87. Po ai, *Po aty*, f. 86-87
88. Po ai, *Po aty*, f. 88
89. Po ai, *Po aty*, f. 88
90. Po ai, *Po aty*, f. 88

Tej e ndanë në artikullin e përmendur shihet se, së pari, është ndërtuar teoria prej aotorit të tij dhe pastaj është bërë përpjekje për të gjetur argumente nga dialektet e shqipes që të vërtetonte atë teori. V. Polaku, duke mos marrë parasysh dallimet që ekzistojnë në rrugën e historisë së zhvillimit të dialekteve në gjuhën të ndryshme, ka marrë si shkaqe të vetme rrethanat kulturore e politike të jashtme për historinë e dialekteve të shqipes. Në gjuhën shqipe dallime dialektore kanë ekzistuar në çdo periudhë për shkaqe jashtëgjuhësore e gjuhësore të brendshme. Njësitë dialektore dhe veçoritë dalluese të tyre kanë ndryshuar fytyrë kohë me kohë për shkak të lindjes së tipareve të reja e të ruajtjes së disave nga ato që ekzistonin më parë, për shkak të zhvillimit jo të njëkohshëm të tipareve konstitutive të përbashkëta në zona të ndryshme, për shkak të ngushtimit e të zgjerimit të territorit të përhapjes së ndonjërit ose të disa veçorive dialektore, për shkak të ndikimeve që pësojnë të flomet nga veprimi mbi njëra-tjetrën prej fqinjësisë, prej përzierjes nga shtegtimet e prej procesit të konvergimit në rrethana historike të caktuara të zhvillimit historik të popullit, si dhe për shkak të ndikimeve që kanë ardhur nga gjuhë të ndryshme të huaja në njërën e në tjetrën zonë. Mendoj se nga pikëpamja teorike për shpjeginin e lindjes e të zhvillimit të dialekteve dhe të shpërndarjes gjeografike të tyre këto shkaqe duhen marrë parasysh të gjitha së bashku e në mënyrë të lidhur me njëra-tjetrën.

V.Polaku, siç e treguam edhe më sipër, mendimin e vet për diferencimin e shqipes në dy dialekte për shkak të veprimit të dyfishtë sllav e mbështet në radhë të parë në gjurmët që kanë lënë gjuhët sllave të jugut në gjuhën shqipe, kryesisht në leksik, pak në fjalëformim[91] dhe në toponimi. Duke iu mbajtur mendimit të A.M.Selishçevit,[92] sipas të cilit karakteri kryesisht bujqësor i fjalëve sllave të hyra në gjuhën shqipe treguaka se shqipëtarët në kohën e kontakteve me sllavët paskan qenë barinj shtegtarë, dhe duke u mbështetur në numrin relativisht të madh ët nonenklaturës gjeografike sllave në jug të Shqipërisë, ka parashtruar tezën, që nuk është e re, se djepi historik i shqipes është Shqipëria Veriore.

Fakti që në gjuhën shqipe gjendet një shtresë leksikore sllave e sferës së bujqësisë nuk vërteton dot mendimin mbi shtegtimin e shqiptaëve nga Veriu, sepse, edhe sikur të provohej në mënyrë bindë

---

91. Për një ndikim shumë të pakët të sllavishtes në strukturën gramatikore të shqipes (edhe këto të kufizuara në fjalëformim), bile edhe në trevën veriorer e të Shqipërisë Jugore, ku mendohet se ka pasur kontakte më të mëdha midis sllavëve dhe shqiptarëve, shih artikullin tonë *Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore*, në «SF» 1965, f. 129-136.
92. A.M.Selišćev, *Slavianskoe naselenije v Albanii*, Sofija, 1931.

se me këtë se shqiptarët kanë qenë blegtorë, kjo nuk do të thotë se këta blegtorë duhet të kenë shtegtuar prej Veriu në Jug të Shqipërisë.

Për sa i përket emërtesës gjeografike sllave, së pari, duhet thënë se ende nuk janë fort të qarta rrethanat historike, shkaqet dhe rrugët e formimit të saj në territorin e Shqipërisë. Analiza gjuhësore e toponimeve me prejardhje sllave të çon te mendimi se një nunër shumë i vogël i tyre, që është i kohës së kontakteve të para të shqiptarëve me sllavët, janë të lidhura me vendbanime në formën e kolonive të veçuara sllave, kurse të tjerat janë të vonshme si rezultat i pushtimeve të mbretërive serbe.[93] Përveç kësaj, ekzistenca e kësaj emërtese gjeografike nuk shpjegohet doemos vetëm me shtegtimin e shqiptarëve nga Veriu në ato vende të Shqipërisë Jugore që i përkëshin pasur më parë sllavët.

Për autoktoninë e shqiptarëve dhe për formimin e shqipes në këto vende që kanë sot shqiptarët, duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë Jugore, janë dhënë mjaft argumente gjuhësore e historike. Ndërmjet këtyre argumenteve janë edhe faktet bindëse nga fusha e toponimisë, sidomos ato që ka sjellë E. Çabej[94].

Ndër argumentet gjuhësore që ka sjellë për të vërtetuar tezën mbi ndikimin e presionit sllav në diferencimin e dialekteve të shqipes V. Polaku duhet të kishte marrë vetëm tiparet dalluese më të hershme e më relevante, të cilat janë të domosdoshme për zgjidhjen e këtij problemi, kurse në fakt shihet se ai, duke mos i njohur mirë dialektet e shqipes dhe historinë e tyre, ka sjellë disa veçori të reja, siç janë dallimet e sotme në gjatësinë e zanoreve dhe dallimet në formën e së pakryerës të foljeve veprore, ka sjellë gjithashtu disa veçori jorelevante, të cilat ose janë karakteristike për një zonë të ngushtë dialektore, si afrikatja megjuhore tc, variante e c-së së shqipes së përbashkët, ose janë të atilla që nuk janë fare si veçori dalluese dialektore, si p.sh. forma foljore e së ardhmes.

VEÇORITË MË TË HERSHME QË DALLOJNË DIALEKTET E SHQIPES

2. 3. 3. Po të ndiqet hap pas hapi lindja dhe zhvillimi i tipareve të dy dialekteve të shqipes, duke nisur nga ato më të rejat e duke

93. J.Gjinari, *Dëshmi të historisë së gjuhës shqipe për kohën dhe vendin e formimit të popullit shqiptar*, në «SF», 3, 1982, f. 42, 43 dhe 44.

94. E. Çabej, *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në gadishullin e Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve*, në «BUSH, SShSh 1, 1962, f. 22-223 krahasimin *Çamëria* me *Thyamis* së pari e gjejmë te Martin Leake në «Researches in Grecce». 13.

shkuar tek ato më të lashtat, shihet se ato së bashku me shumë veçori të të folmeve të veçanta janë forma të ndryshme që ka marrë kohë më kohë brumi i vetë gjuhës shqipe.

1. — Mendimi i V.Polakut se dallimi i dy dialekteve për shkak të zanoreve të gjata që ekzistojnë në gegërishte është rezultati i presionit sllav (i ndikimit të serbishtes në veri të Shqipërisë) nuk mbështetet në realitetin gjuhësor të sotëm të dialekteve të shqipes dhe në historinë e tyre. Së pari, siç e ka provuar edhe A. Dodi[95], në këtë rast, në gjuhën shqipe nuk ekzistojnë diferenca kualitative, në intonacione, së dyti, duhet thënë se diferencimi në gjatësinë e zanoreve nuk është absolut e për pasojë as relevant, sepse zanore të gjata gjenden sot dhe në të folmet e labërishtes, të çamërishtes dhe të kolonive të arbëreshëve të Italisë (të gjitha këto janë të folme të toskërishtes)[96], nga të cilat shihet qartë se zanore të këtilla kanë ekzistuar dikur në mbarë shqipen[97] ; përsa u përket zanoreve të gjata në ato raste ku janë krijuar për shkak të rënies së *ə*-së së patheksuar, të cilat gjithashtu nuk mungojnë në toskërishte[98], dihet tashma se janë fare të reja[99].

2. — V.Polaku, duke parë një ngjashmëri fonetike midis disa të folmeve të gegërishtes, ku qiellzoret *c* e *ʒ* kanë kaluar në afrikate mesgjuhore *tc*, e *dz*, dhe serbokroatishtes, në të cilën ekzistojnë bashkëtingëllore të këtilla *ћ* e *ђ*, ka nxjerrë përfundimin se edhe në këtë rast shihet ndikimi i serbishtes në dialektin verior të shqipes. Së pari, siç e thamë edhe më sipër, kjo veçori nuk është karakteristike për gjithë dialektin gegë, por vetëm për disa të folme të tij. Së dyti, parimisht nuk është e drejtë që të nxirret një konkluzion i tillë duke u mbështetur vetëm në një ngjashmëri fonetike që mund të kenë dy gjuhë. Vështrimi i gjërave duhet bërë në një mënyrë më të gjerë dhe më të thelluar, duhet parë se ç'përfaqësojnë *tc*, e *dz*, në bashkësinë e varianteve të tjera gege të qiellzoreve, *c* e *ʒ*, duhet parë historia e përftimit të tyre në kuadrin e qillzoreve të gjuhës shqipe, nuk po përmendim këtu edhe faktin që duhet pasur gjithashtu parasysh historia e formimit të *ћ* e *ђ* në serbokroatishte.

---

95. A.Dodi, *Rreth sistemit vokalik të shqipes*, në «SF», 3, 1967,.
96. E Çabej, *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, në «Bul. për shk. shoq.,» 2.1957, f. 213; M. Totoni, *E folmja e Bregedtit të Poshtëm*, në «SF», 1, 1964, f. 134. 135.
96) Po ai, *Po aty* f.88-89
97. Po ai, *Po aty*, f. 89
98. Po ai, *Po aty*, f. 89
97. E.Çabej, *Kuantiteti i zanoreve...*, f. 213.
98. M. Totoni. *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, f. 134-135.
99. E.Çabej, *Gjon Buzuku*, në «Bul për shk. shoq.»; 2. 1955.

Në të folmet veriore të gegërishtes vërehen disa variante të qiellzoreve c e ɟ: në të folmet e Tropojës ka qiellzore shtegtore ɟ e ɟ̑ në shumicën e të folmeve veriore gege, sidomos në ato të anës veriperëndimore, ka afrikate mesgjuohore *tc*, e *dz*, në disa të folme të tjera, sidomos në ato të anës verilindore dhe qendrore, ka afrikate paragjuhore *tʃ* e *dʒ* dhe në disa të folme të izoluara[100], si ato të Rajës, të Lurës e ndonjë tjetër ka spirante të zbtura φ e z, .

Të gjitha këto variante dialektore të gegërishtes veriore, që përfaqësojnë shkallë të ndryshme të zhvillimit të mëtejshëm të sërës së tretë të tingujve *c* e ɟ të shqipes, të përftuara nga palatalizimi i grykoreve *k* e *g*, që ndiqeshin prej zanoreve të përparme *i* dhe *e*, nuk mund të shkëputen nga rruga që kanë ndjekur gjatë zhvillimit të tyre sëra e parë e qiellzoreve e ardhur prej guturaleve palatale ie *k* e *g*, të cilat dhanë respektivisht *th* [θ] e *dh* [δ] dhe sëra e dytë e palataleve, të ardhura prej labiobvelareve ie *kw* e *gw*, të ndjekura nga *i* ose *e*, që dhanë *s* e *z* [101].

3. — Për të vërtetuar mendimin se edhe format e së pakryerës *punoɲa* ose *punoja* në Jug e *punojʃa* në Veri qenkan pasojë e ndikimit të dyfishtë sllav në të dy dialektet e shqipes V. Polaku nuk sjell asnjë provë në artikullin e vet.

Edhe një njohje sado e shpejtë me dialektet e shqipes dhe me historinë e tyre të informon me faktin se forma *punoɲa*, që sot merret si variant i së pakryerës së dialektit jugor, ka qenë e përhapur në mbarë shqipen. Sot ka akoma të folme të dialektit verior që e ruajnë këtë formë të së pakryerës. të tilla janë të folmet e Dibrës[102], të Larjes e të Shestanit [103], të Elbasanit dhe ajo e Borgo Ericos[104]. Gjithashtu këtë formë e gjejmë mjaft të përdorur edhe te autorët veriorë të letërsisë së vjetër shqipe, sidomos te Gj. Buzuku.

Forma *punojʃe*, që sot është karajteristike vetëm për të folme gege, ka shumë të ngjarë që të jetë shtrirë në përdorim e të ketë mbetur si forma e vetme e së pakryerës në pjesën më të madhe të gegë-

---

100. Shih M. Lambertz, *Bericht über meine linguistichen Studien in Albanien von Mittel Mai bis Ende August* 1916, në «Anzeiger d.k. akad. Wiss, in Wien Ph, Hist. klasse», XX, 1916, f. 122-146; për Lurën shih Kartotekën e dialektologjisë së Institutit të Gjuhësis dhe të Letërsisë (material i mbledhur prej M.Çelikut) dhe Q. Haxhihasani. *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*, në «BUSH, SShSh» 4, 1963, f. 123.
101. Lidhjen midis zhvillimit të të tri sërëve të palataleve në gjuhën shqipe e kemi trajtuar në një punim tjetër, këtu nuk është vendi që ta shtjellojmë këtë çështje.
102. E. Çabej. *Për historinë e konsonantizmit të shqipes*, në «BUSH,. SShSh» 1, 1958
103. Po ai, *Po aty*,
104. C. Tagliavini, *L'albanese di Dalmacia*, Firenze, 1937.

rishtes, për shkak të homofonisë që duhet të jetë krijuar në këtë dialekt ndërmjet formës të së pakryerës *punoɾə* > *punojə* > *punoj(ə)* dhe formës të së tashmes *punonj* > *punoj*, ashtu sikurse shihet sot në të folme të toskërishtes jugore ku e pakrera *laj(ə)* është bërë e afërt ose e njëjtë me të tashmen *laj*. Në jug forma *punoɾa* është ruajtur më fort në të folmet e toskërishtes veriore, atje ku bashkëtingëllorja *ɾ* nuk ka pësuar ndryshime fonetike dhe ku vërehet se e pakryera e vetës së parë njëjës ka në mbaresë zanoren *a* e jo zanoren *ə* që është e reduktueshme.

4. — Bindja se dy dialektet e shqipes dallohen në mënyrë absolute për shkak të dyllojshmërisë së ndërtimit të futurit, me sa duket, është formuar më tepër nga shqipja e shkruar në dy variante dialektore. Të dhënat e të folmeve të shqipes nuk flasin për ekzistencën e një futuri të tipit ballkanik në Jug e të një tjetri të tipit romano-perëndimor në Veri. Futuri i tipit *do tə punoj* gjendet kudo në shqipen e folur, bile ai përdoret shumë edhe në gegërishten veriore[105].

Dallime ekzistojnë në një lloj tjetër futuri, në formën *kam* + + *infinitiv*: *kam me punue* dhe *kam pər tə punuar*. Por edhe ky nuk është një dallim relevant e aq më tepër absolut.

Së pari, i ashtuquajturi tip toskë (*kam per tə punuar*) i kalon kufijtë e dialektit jugor, përdoret edhe në shumë të folme të Veriut, bile në Shqipëri të Mesme, prej Matit deri në Shkumbin, me përjashtim të ndonjë të folmeje kufitare veriore, ai është tipi i vetëm i këtij lloji futuri[106].

Së dyti, varianti dialektor *kam me pune* që krahas tipit *do tə punoj* përdoret më shumë në gegërishten veriore, megjithëse edhe këtu jo kudo, nuk përbën një dallim kategorie me variantin *kam pər tə punuar*, sepse në të dyja formulat komponetet janë të barabarta: kam+ +formë foljore me vlerë infinitivi, dallimi që shihet këtu është po ai që ekziston në ndërtimin e infinitivit gegë *me punue* dhe formës foljore të shqipes së përbashkët me vlerë infinitivi *pər tə puniar* / *pər tə punue*.

---

105. J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, në «BUSh, SShSh», 2, 1962, f. 1987; po aty shih edhe shënimin Nr. 30; E. Lafe. *E folmja e Nikaj-Merturit*, në «SF» 3, 1964, f. 128; Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*, në «SF» 2, 1967, f. 58.

106. B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat.* në «Bulet, USHT — SSS», 2, 1963, f. 224; M. Çeliku, *Vërejtje mbi të folmen e Dumresë*, në «*BU*Sh., SShSh», 3, 1963, f. 218-219; Q. Haxhihasani, *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*, në «BUSh, SShSh», 4, 1963, f. 131; J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Krujës dhe të Malësisë së Krujës*, në «SF», 4, 1964, f. 122; B.Beci, *E folmja e E Reç-e-Dardhës së* Dibrës, në «Stud. filol.», 4, 1964, f. 156; M. Çeliku *Vëzhgime mbi të folmen e Peqinit*, në «SF», 4. 1965, f. 112; Po ai, *Vëzhgime mbi të folmen e Krrabës*, në SF», 2. 1966, f. 146.

Në qoftë se mendimi mbi ndikimin e greqishtes [107] në formimin e futurit *do* + *lidhore* bazohet në bindjen se ky tip është vetëm i toskërishtes, atëherë fakti që ai ekziston në të gjithë shqipen besoj se ja heq bazën mbështetëse këtij mendimi.

Tek Buzuku futuri *do* + *lidhore* del vetëm një herë[108]. Tek arbëreshët e Italisë[109] pjesëza *do*, megjithëse është e ngurosur, ruan akoma kuptimin *dua* (*do martohem* «*dua të martohem*»), pra e ruan karakterin e një futuri voluntatis.

Si nga struktura edhe nga funksioni duket qartë se ky futur (do+lidhore) është formuar nga gramatikalizimi i një fraze ose i një togu fjalësh dhe ka mundësi të jetë relativisht i ri.

Në toskërishte (dhe në Shqipëri të Mesme) sot shihet se po merr funksionin e një futuri të detyrimisë fraza e përbërë prej foljes modale *dua* (me format e saj përkatëse) dhe *pjesores*: *do larë* (mungon forma për vet. I njëjës). Për nga struktura duket se ajo akoma nuk e ka marrë formën e një futuri, sepse folja modale i ruan format e saj të zgjedhimit. Këtë funksion, pothuaj kudo, e luan edhe futuri *do* + + *lidhore* kur jepet një urdhër ose dëshirë, kjo duket qartë edhe në të folmen e Korçës ku ndërmjet pjesëzës *do* dhe lidhores futet pjesëza e mohimit *mos* : *to mos viʃ sonte* «nuk duhet të vish sonte».

Tek arbëreshët e Italisë funksionin e futurit e detyrimitë e kryen forma e foljes *kam* (e ngurosur ose jo) + *lidhore* : *u kam tə piesə* «unë duhet të pyes», *tʃə ka t bəmi me kəto dru*? «çfarë duhet të bëjmë me këto dru?». Një formë e këtillë futurti ekziston edhe në rumani shte[110]: *amă să spun, am să fac* etj.

Format dialektore *kam*+*infinitiv* herë kanë pasur funksionin e një futuri të detyrimisë, herë të një veprimi që do të kryhet në një të ardhme më të largët, kurse kohët e fundit po barazohet për nga funksioni me formën *do* + *lidhore*, sepse funksionet e detyrimitë po i merr fraza *duhet* (në formën njëvetore) + *lidhore* (me të gjitha format përkatëse): *duhet të shkoj*.

Në ndonjë të folme veriore të Shqipërisë së Mesme[111] ekziston edhe një formë e kontaminuar: *kam pər me punue*.

---

107. Kr.Sandfeld, Linguistique balkanique — Problemes et résultats, Paris, 1930.
108. Kumtim i është i E.Lafes, i cili ka bërë vjeljen dhe inventarizimin tërësor të fjalëve dhe të formave te Meshari.
909. M.Lambertz, *Albanische Munderten in Italien*, në «Indogerm. Jahrb.», 2, f. 1-30 dhe *Italoalbanische Dielektstudien*, në «Zeitsechrift für vergleischende Sprahforschung», 51, 52, 53.
110. J. Coteanu, *Elemente de dialetctologie a limbii romîne*. f. 81, 89, 155 për dokorumanishten, moldavishten dhe meglenorumanishten.
111. M.Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, f. 70; B.Beci, *E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës*, në «SF» 4, 1964, f. 156.

Siç shihet, shqipja, me pak dallime dialektore ka formuar gjatë kohëve një larmi formash futuri me funksione të ndryshme që kanë lëvizur gjatë formimit të kësaj pjese të sistemit foljor. Shihet qartë se rruga kryesore për formimin e këtyre trajtave foljore ka qenë gramatikalizimi i frazave ose i togfjalëshave. Për shkak të formës më të ngulitur, deri diku edhe për shkak të funksionit, duket se më të vjetra janë format *kam* + *lidhore* dhe *kam* + *infinitiv*.

5. — Si veçori relevante e absolte që dallon dy dialekter e shqipes kanë marrë infinitivin e gegërishtes *me punue*, i cili i mungon toskërishtes. Në idialektin jugor funksionet e tij i luajnë forma e tipit *pər tə punuar* dhe lidhorja.

Dihet mirë se forma foljore *pər tə punuar* nuk është vetëm e toskërishtes, por edhe e gegërisjtes; kërkimet dialektologjike që janë bërë në Shqipëri këto kohët e fundit vërtetojnë më së miri se forma *pər tə punuar* (*pər tə punue*) gjendet kudo, por që përdoret më shumë në Jug dhe në Shqipëri të Mesme, kurse forma *me punue* gjendet vetëm në dialektin verior dhe përdoret më shumë në të folmet e skajit verior të atij dialekti.

Ekziston një mendim se infinitiv *me* + *pjesore* e ka pasur edhe toskërishtja, por mendoj se H.Pederseni[112], me të drejtë dyshon për këtë.

Mendimin mbi karakterin e mirëfilltë e të vërtetë të infinitivit gegë *me punue* H. Pederseni e ka mbrojtur duke thënë se nuk sheh në gjuhën shqipe një formë tjetër foljore që ta ketë zëvendësuar atë që nga humbja e tij e deri në përdorimin e emrit foljor të ardhur nga pjesorja dhe duke thënë gjithashtu se identiteti (tingëllor) i infinitivit me pjesoren është sekondar.

Po të lëmë mënjanë çështjen se ka pasur apo s'ka pasur infinitiv shqipja e se cila gjuhë e Ballkanit e ka humbur më parë atë, nga krahasimi formal i strukturës dhe i funksioneve sintaktike që kanë sot varianti gegë *me punue* edhe forma e përbashkët *pər tə punuar*, *pər tə punue*. duket se ato janë të krahasueshme dhe jo të mirëfillt[113] Megjithëse forma *per te punuar* nuk i mbulon funksionet e variantit *me punue*, prapseprapë mund të thuhet se të dyja format luajnë sot funksione të infinitivit[114] dhe të dyja janë formuar në mënyrë perifrastike: me pjesëza parafoljore që kërkojnë rasën kallëzore

---

112. H.Pedersen, *Recension për punimin e Sandfeld-Jensenit mbi infinitivin në, gjuhët ballkanike, sidomos në rumanishte*, në «Indogerm. Fordchung.». XII 1901, Anzeiger, f. 90-93.
113. Si formime sekondare i mendon edhe M.Domi (*Morfologjia historike e shqipes*, f. 67).
114. Sh.Demiraj, Forma gramatikore perifrastike *për* + *emër foljor i gjinisë asnjanëse në rtrajtë të pashquar*, në «Konferenca I e Studimeve Albanologjike (15-21 nëndor 1962)», Tiranë, 1965, f. 213-220.

(*me* geg. dhe *për* tosk.), duke u bashkuar *me*-ja geg. me formën foljor që sot quhet pjesore dhe *për*-i me emrin foljor të ardhur nga pjesorja.

Duke u nisur nga fakti se në formën *pər tə punuar* ka emër foljor, kurse në formën *me punue* ka pjesore. mund të mendohet që varianti i dytë kronologjikisht të jetë më i vjetër se i pari. Kjo duket edhe në faktin se varianti gegë i ka të plota dhe të kristalizuara tiparet e foljes.

Në formulën *me punue*, nga vetë ndërtimi i saj me një pjesëz parafoljore, duket se kemi të bëjmë me një fjalë që në origjinë është karakterizuar nga tiparet e substantivit. Dihet se emrat e veprimit nuk i humbasin plotësisht tiparet e foljes, kjo duket edhe sot në gjuhën shqipe, bile edhe në emrat e veprimit të formuar me prapashtesë: *Duhet ecur më shpejt për përfundimin me sukses të aksionit pranveror*[115] etj.

Ka mundësi që forma me *për* të pasqyrojë përgjithësimin e një plotësori me funksione finale, kurse forma me *me* përgjithësimin e një plotësori me funksione të tjera.

Në disa të folme veiore, sidomos në gegërsihten jugore, përdoren edhe forma me të dyja pjesëzat: *pər me punue* (gjendet sidomos në formën e futurit), e cila mund të jetë një riformim për të karakterizuar funksionin final ose mund të jetë një kontaminim[116] i thjeshtë. Riformime të këtilla ka edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit, p.sh. në rumanishte[117].

Nuk duhet marrë si lajthitje fakti që G. Hahni, G. Majeri e ndonjë tjetër ia kanë mohuar infinitivin shqipes po të kemi parasysh se ata kërkonin infinitivin e vërtetë, infinitivin e mirëfilltë.

Pra, meqenëse variantit dialektor *me punue* i mungon karakter i mirëfilltë i infinitivit dhe meqenëse është i krahasueshëm me formën *pər tə punuar / pər tə punue*, mund të themi se edhe formimi i tij e gjen shpjegimin brenda shqipes. Gjithashtu, duke u mbështetur në këto që thamë, mund të pohojmë se midis dy dialekteve të shqipes nuk ka ndonjë dallim anbsolut strukturor (gramatikor) në formë të infinitivit (të paktën për origjinën e këtyre formave që luajnë sot funksionet e infinitivit).

6. — Grupet *vo-va* — (*voj*-geg. / *vaj* — toks.), të cilët V. Polaku i ka lënë jashtë vështrimit në artikullin e vet dhe që përbëjnë një

115. Gazeta lokale «Kushtrimi» viti II, Nr. 42 (58), datë 25.5.1968.
116. Shih edhe M.Domi, Morfologjia historike e shqipes, f. 10
117. J.Coteanu, *Elemente de dialectologia a limbii romîne*, Bucuresti, 1961, f. 110 sjell për dialektin krishean: de-a scortere, de-a vulturare, të cilat në gjuhën letrare jepen me *de* + *participp*.

dallim relevant, absolut dhe të hershëm[118] e gjejmë shpjegimin brenda shqipes. Nga të dyja variantet primar është grupi *vo-*, të cilin N. Jokli[119] e krahason me fazën *uo* të diftongut *ua/ue.*

Krahasimi i fjalëve me variantet *vo- / va*: *voɾ̄ / vaɾ̄*, *voj / vaj*, *i vorfən / i varfər*, *i vokət / i vakət* me fjalët *valə*, *vale*, *vate*, *var*, *varg*, *vajzə*, (*varz*, *vaʃə*) etj. ku grupi *va-* (edhe *vo-*) është në po ato kushte fonetike, si edhe fakti që *vaj*, *i varfər* vijnë prej lat. *oleum*, *orfanus* tregojnë se edhe grupi *vo-* në vetvete nuk është primar. Ky grup ose është formuar duke iu parashtruar *o*-së një *u* [uo], siç mendon N. Jokli[120] ose nëpërmjet një rruge tjetër, prej diftongut të *o*-së që arriti një shkallë *ou-* e kjo e fundit u diferencua sikurse diftongjet *uo / ua* (*kruo / krua*), por që mbetën gjatë zhvillimit në *vo- / va-* pas konsonantizimit[130] të *u*-së për shkak të pozitës në fillim të fjalës që kishte ky diftong te fjalët *voj / vaj* etj.

7. Rotacizmi, hundorësia dhe kalimi i ã-së në *ə* janë tri nga tiapret më të lashta që dallojnë dialektet e shqipes. Të tria këto dukuri janë zhvilluar afërsisht në një kohë njëra pas tjetrës duke qenë ndërmjet tyre edhe me lidhje varësie.

Shtysën e lindjes dhe të zhvillimit të tyre këto dukuri e kanë brenda vetë gjuhës shqipe, janë zhvillime të brendshme të sajat, nuk janë pasojë e një presioni të bullgarishtes e serbishtes si medon V.Polaku. Rotacizmi është pasojë e ndryshimeve që pësoi *n*-ja primare ndërmjet dy zanoreve në një kohë kur ende nuk ishte bërë një me të *n*-ja që vinte nga zhvillimet që po pësonin grupet e përbëra nga një bashkëtingëllore çfarëdo dhe një *n*. Ky proces, që formoi një nga tiparet e hershme dalluese të toskërishtes, kishte përfunduar në kohën kur shqipja ra në kontakt me sllavishten, pra nuk mund të mendohet për presionin e kësaj gjuhe mbi shqipen në këtë rast. Një zanore të tipit të *ə*-së të toskërishtes e gjejmë edhe në bullgarishte dhe në rumanishte, por rumanishtja është një gjuhë romane e ngritur mbi shtratin e një gjuhe të vjetër të Ballkanit, kurse bullgarishtja, sipas dokumenteve të shkruara, filloi ta nxjerrë zanoren e tipit të *ə*-së aty nga shekujt XII-XIII, gjashtë-shtatë shekuj më vonë se shqipja, pra bullgarishtja nuk mund t'i jepte toskërishtes zanoren *ə* në një kohë kur vetë ende nuk e kishte. Analizën e hollësishme të zhvillimit të kë-

---

118. E.Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, në «BUSh, SShSh», 3, 1963, 7. 71.
119. N.Jokli, *Zur Geschichte des alb. Diphtongs* -ua. -ue, në «Indogerm. Forschungen», 50, f. 49.
120. Po ai, *Po aty.*
121. Krahaso raste të ngjashme, si *va ðaʃe* < *ua ðaʃe* etj. dhe rum. *vacră* (vënë në dukje së pari prej Candrea, në Gr. S. VII, 281 dhe pranuar dhe prej E. Çabejt, në SF», 2, 1967, f. 7,

tyre proceseve të hershme të shqipes e kemi bërë[122] së pari në një artikull të botuar më 1968 në «SF» dhe këtu në punimin e pranishëm (hundorësia dhe zanorja *e* në § 3.15.1 — § 3.15.5, kurse rotacizmi në § 3.19.1).

NDRYSHIMET E STRUKTURËS DIALEKTORE NË LIDHJE ME HISTORINË E POPULLIT

2.4.1. Gjuha, si dukuri shoqërore, duke qenë e lidhur me bashkësitë etniko-politike, është e ndryshme në bashkësi të ndryshme dhe zhvillohet e ndryshon bashkë me to. Ajo ndryshon dalngadalë për shkak të prirjes së zhvillimit të saj të brendshëm e ndërlidhur kjo edhe me veprimin e faktorëve shoqërorë, të faktorëve jashtëgjuhësorë, siç janë dobësimi i kontakteve midis grupeve të ndryshme të një bashkësie, përzierja e grupeve të popullsisë në disa zona, kontaktet dhe përzierja ose edhe shkrirja e disa grupeve me grupe të një bashkësie të huaj etj.

Këta faktorë jashtëgjuhësorë ndikojnë për shpejtimin ose për ngadalësimin e zhvillimit të një dukurie gjuhësore në një grup të popullsisë, mund ta ndalin zhvillimin e një dukurie në një grup tjetër, bëjnë të lindë një dukuri e re dhe në ndonjë grup shkaktojnë ndërrimin e disa tipareve me tipare të gjuhës së një bashkësie të huaj nëpërmjet zëvendësimit të plotë ose me anë të përshtatjes etj. Kjo është arsyeja që çdo bashkësi etniko-politike nuk është gjuhësisht homogjene, qoftë ajo edhe me një shtrirje të vogël territoriale.

Dialektet janë forma të ndryshme që ka marrë i njëjti brumë gjuhësor i një bashkësie gjatë kohëve në territore të ndryshme. Të para kështu, dialektet janë rezultatet i zhvillimit të një gjuhe në formacionet e mëparshme të shoqërisë, para formimit të kombit.

Dialektet nuk janë zhvilluar nëpër një vijë të drejtë. Ka pasur ndarje e veçime njësish dialektore, por ka ndodhur që në të njëjtën kohë edhe të bashkohen dy a më shumë njësi për të formuar një njësi të re, e cila gjithashtu diferencohej nga të tjerat; diku kanë lindur njësi të reja, diku kanë humbur, diku është zgjeruar hapësira e shtrirjes e një njësie e diku është ngushtuar, një tipar, që mund të ketë qenë i përbashkët për një sistem të madh dialektor, është rrudhur në një territor më të vogël, herë-herë një tipar karakteristik i një sistemi më të vogël është shtrirë dhe është bërë tipar i një sistemi më të madh.

---

122. J. Gjinari, *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, në 122. «SF», 4. 1968, f. 127.

Dialektet janë kategori historike, kanë lindur në kushte të caktuara të zhvillimit të shoqërisë dhe herë pas here kanë pësuar ndryshime

Si në çdo gjuhë. edhe në gjuhën shqipe dallime dialektore kanë ekzistuar që në kohë të hershme, por ato gjithmonë kanë pësuar ndryshime dhe nuk kanë arritur deri në ditët tona, sepse janë tretur gjatë kohëve pa lënë gjurmë. Sot në të folmet e shqipes përgjithësisht dallojmë tipare që kanë lindur gjatë mesjetës dhe një numër të vogël nga ato që vijnë prej periudhës së vonë antike. Tiparet dalluese më të hershme ndajnë dy dialektet e shqipes dhe kanë një shtrirje të plotë në territorin e secilit dialekt. Ndonjë tipar i hershëm është sot karakteristik edhe për një grup të folmesh me shtrirje territoriale të kufizuar, por raste të tilla janë më të pakta. Tipare dalluese më të reja, ato që kanë lindur këto dytre ose edhe katër shekujt e fundit kanë shtrirje të ndryshme gjeografike. Disa prej tyre, kanë ardhur duke u përhapur dhe janë bërë tipare të një dialekti duke iu shtruar kështu tipareve dalluese të hershne, por pa marrë të gjitha një shtrirje të plotë në truallin e dialektit të tyre, disa kanë marrë një shtrirje më të kufizuar, kurse disa të tjera janë bërë tipare të disa të folmeve të njërit dialekt dhe disa të tjera tipare të dialektit tjetër.

Në degëzimin dialektor pasqyrohen gjurmët që ka lënë gjatë kohëve zhvillimi i bashkësisë sonë shqiptare. Gjurmët e këtij zhvillimi duken edhe në mënyrën e orgnaizimit të jetës shoqërore, në doket e në zakonet, në kulturën materiale dhe në kulturën artistike, të cilat, së bashku me gjuhën, përbëjnë shfaqjet e jetës së popullit tonë.

Përgjithësisht degëzimet dialektore të gjuhës dhe degëzimet e dukurive të tjera të jetës shoqërore, shpirtërore e materiale, kanë pasur zhvillime e përhapje paralele në treva të caktuara sipas ndarjes territoriale të grupeve të bashkësisë etniko-politike, por. megjithatë, është e natyrshme që ndonjëherë edhe të mos shihen përputhje nga pikëpamja gjeografike, sepse secila nga këto shfaqje të jetës në shoqëri ka specifikën e vet të zhvillimit, ndonjëra i ndien me shpejt ndryshimet që ndodhin në shoqëri, kurse ndonjë tjetër i ndien ato vonë, ka prej tyre që lidhen drejtpërdrejt me bazën ekonomike të një rendi shoqëror, duke u lidhur disa drejtpërdrejt me marrëdhëniet në prodhim e disa me mjetet e prodhinit, ka prej tyre që lidhen me superstrukturën e rendit, por ka edhe prej atyre, si gjuha, e cila, megjithëse i ndien ndryshimet që ndodhin në jetën e shoqërisë, nuk lidhet as me bazën, as me superstrukturën.

Vështrimi në mënyrë të ndërlidhur i këtyre anëve të ndryshme të jetës së popullit tonë do të ndihmonte për njohjen e rrugës së zhvillimit të secilës nga këto shfaqje në veçanti dhe për njohjen gjithashtu edhe të ndryshimeve që ka pësuar vetë bashkësia jonë etniko-poliitike

e marrë në tërësinë e saj; kërkimet e derisotme në fushën e gjuhësisë, të etnografisë, të folklorit, të arkeologjisë de të historisë kanë sjellë të dhëna të rëndësishme për këtë çështje, por, megjithatë, do të duhen edhe studime të mëtejshme, këtu një atlas etnografik e një atlas gjuhësor do të jepnin një ndihmë të madhe.

Ndryshimet që ka pësuar gjuha shqipe gjatë zhvillimit të vet nëpër territore të ndryshme nuk kanë çuar në krijimin e varianteve dialektore me dallime shumë të thella, ndryshe nga ajo që ka ndodhur në disa gjuhë të tjera të Evropës. Shkalla e dallimit të dialekteve të shqipes dhe e sistemeve më të vogla brenda tyre nuk është e madhe. Kjo nuk është rezultat i hapësirës relativisht të vogël të shtrirjes gjeografike të gjuhës sonë, sepse nuk janë largësitë gjeografike ato që përcaktojnë largimin e dialekteve të një gjuhe, por me sa duket, për gjuhën tonë dobësimi i kontakteve midis grupeve të popullsisë dhe koha e zgjatjes së tij nuk kanë qenë të asaj mase sa të thellonin hendekun e ndarjes së dialekteve.

Shkalla e madhe e unitetit që përshkon tejendanë dialektet e gjuhës sonë nuk shfaqen vetëm nëpërmjet tipareve që janë krejt të përbashkëta edhe nga forma edhe nga përmbajtja, d.m.th. nga ana e tyre tingëllore e strukturore dhe nga ana e funksionit, ajo duket edhe në shumë tipare divergjente po të vështrohen ato dialektikisht, jo thjesht nga forma, por në radhë të parë nga ajo që është thelbësore, nga funksioni, pastaj edhe nga zhvillimi, si në vijë të prejardhjes, po ashtu edhe në vijën e prirjes së zhvillimit të sotëm.

Uniteti që përshkon dialektet e gjuhës sonë duket në trajtimin e njëjtë që i është bërë kudo në bashkësinë tonë fondit gjuhësor të lashtë indoevropian, si p.sh. reflekset θ, δ dhe *d* të guturaleve palatale *k'*, *g'*, reflekset *s*, *z* të guturaleve labiovelare *kw*, *gw* të ndjekura nga *i* ose *e*, refleksi *a* i *o*-së së shkurtër, monoftongimi i diftongjeve dhe reduktimi i shumë grupeve bashkëtingëlloresh e shumë të tjera[123]. Ky unitet i përshkon dialektet tona edhe në zhvillimet e brendshme që ka pësuar shqipja pas fazës indoevropiane: kjo duket te prirja e përbashkët për reduktimin e zanoreve në rrokje të patheksuara, sidomos reduktimi i zanoreve në fillim të fjalës (*amicus*: *mik*, *imperator*: *mbret*), duket te karakteri i theksit të fjalës, theksi dinamik dhe te rregullimi mekanik i tij, te diftongimi i zanoreve në rrokje që mbyllen nga bashkëtingëllore sonante (**fton* > *ftua*, **del* > *diell*, **fel* > > *fyell* etj.), te ndërrimi fonetik *a* > *e* (metafonia) (*marr* > *merr*), te krijimi i kundërvënies gramatikore *trajtë e shquar* ~ *trajtë e pashquar*,

123. Shih më hollësisht për këtë E. Çabej, *Hyrje në historinë e hjuhës shqipe* — *Fonetika historike*, Tiranë, 1959.

te struktura e formimit të përemrave pronorë, tek e ardhmja me *do* + + *lidhore*, format e mënyrave të foljeve etj.; te trajtimi i njëjtë i elementeve të huazuara nga greqishtja, latinishtja, sllavishtja e turqishtja dhe, së fundi, te dukuritë relativisht më të reja, si palatalizimi i grykoreve para zanoreve *i, e* (ose më saktë para j-së) (**miki* > > *miq*, **zogi* > *zogj*, bashkë me këto edhe zhvillimi i grupeve *kl, gl* në *q, gj* [c, ɟ] nëpër një *kj, gj*; *klumësht* > *qumësht, glu* > *gju*); mund të përmendim si veti të përbashkët edhe prirjen e reduktimit të zanores *ë*[ə] të patheksuar etj.

Ky unitet gjuhësor shkon krah për krah me unitetin në konstitucionin shpirtëror dhe me unitetin në kulturën materiale e artistike, që shihet te *guna* (me variantet e saj) [124], *te fustanella*[125] dhe te motivet e lëvizjet në vallet tona: vallja me *përmbajtje plastike, tipi asimetrik*[126] *i valles, trehapëshi i dyzuar.*

2.4.2 Në çdo kohë, në gjuhën shqipe, ashtu si në të gjitha gjuhët e tjera, brenda unitetit ka ekzistuar edhe një diversitet që shfaqej nëpërmjet tipareve dalluese dialektore me shtrirje të caktuara gjeografike. Tiparet e përbashkëta dhe tiparet dalluese të një gjuhe kanë formuar gjithmonë një tërësi në sisteme dialektore të shkallëve të ndryshme derisa nuk ndodhte n dërrimi me një gjuhë tjetër, derisa bartësit e dialekteve (të varianteve të gjuhës) mbeteshin brenda një bashkësie etniko-politike e nuk ndaheshin për të formuar bashkësi të ndryshme. Kështu ka ndodhur edhe me gjuhën shqipe të asaj pjese të bashkësisë sonë që arriti deri në ditët tona.

Tiparet dalluese dialektore që ekzistojnë sot në gjuhën shqipe kanë lindur në kohë të ndryshme. Tiparet dalluese më të hershme, që u ruajtën dhe erdhën deri në ditët e sotme, janë të një numri shumë të vogël. Disa prej tyre ndajnë ato dy variante të mëdha dialektore që ne i quajmë sot gegërishte dhe toskërishte. Të këtilla janë: prania e fonemave zanoreve hundore në njërin dialekt dhe mungesa e tyre në disalektin jetër, *ə*-ja e thkesuar dhe rotacizmi në toskëiishte (*vera* toksk. / *vëna* geg.). Jo shumë më vonë, menjëherë pas këtyre, dy dialekteve iu shtua si tipar dallues edhe kundërvënia e grupeve nistore *vo-* / *va-* (geg. *voter*~ tosk. *vatər*). Ka të ngjarë që të hershme të jenë edhe disa dukuri që karakterizojnë sot njësi më të vogëla dialektore brenda dialekteve të gjuhës sonë, si delabializimi i zanores *y* në

---

124. Rr.Zojzi, *Guna në veshjet tradicionale të populli t shqiptar dhe të popujve të tjerë të Ballkanit*, në «Etnografia shqipatre» III, 1966, f. 3-44.

125. Kumti m nga A. Gjergji.

126. R.Bogdani, *Sprovë për një klasifikim shkencor të folklorit koreografik...*, në «SF», nr. 2. 1975, f. 183.

i[127] (*dy*: > *di* et.) në të folnet jugore të toskërishtes (në çame ishte dhe në disa të folme të labërishtes), labializimi në masa të ndryshme i zanores *ã*[128] në shumë të folme të gegërishtes (*zã*, *zã°*, *zo*, etj.) dhe hapja e zanores *u*[129] në *o* (*duket*: *doket* etj.) që vihet re sot në disa arste në të folmet lindore të gegërishtes.

Për lashtësinë e këtyre tipareve dalluese dialektore, të paktën për ato që ndajnë dy dialektet, japin të dhëna historia e brendshme e shqipes dhe gjurmët e marrëdhënieve të saj me gjuhë të tjera. Prej këtyre del se procesi i kalimit nga ã në *ə* dhe rotacizmi, siç thamë edhe më sipër, ishte duke përfunduar aty nga fundi i kohës antike. Brenda shqipes kjo zbulohet nga fakti se këto procese kanë përfshirë fjalë të fondit autokton të shqipes dhe fjalë të huazuara nga greqishtja e vjetër e nga latinishtja dhe nuk kanë vepruar përgjithësisht në fjalë të huazuara më vonë prej sllavishtes, prej greqishtes së mesme e të resë, prej gjuhëve neolatine dhe prej turqishtes.

Përcaktimi vetëm i kohës kur nisën të marrin formë dy dialektet e sotme të shqipes nuk do të ishte i mjaftuehëm për problemin e gjenezës së shqiptarëve në qoftë se nuk do të përcaktohej bashkë me të edhe vendi ku u krye ky proces.

Sot kufiri gjeografik i dy dialekteve kalon përafërsisht gjatë rrjedhjes së lumit Shkumbin, njëri dialekt shtrihet në veri të këtij lumi, kurse tjetri në jug të tij.

Nuk mund të mos shkojë mendja e të pyesësh: ky kufi i dialekteve a është që nga koha kur lindën dhe po merrnin formën e tyre këto dialekte apo u formuan dialekte diku në një vend tjetër dhe më vonë erdhën e zunë vend përballë njëri-tjetrit këtu ku janë sot në brigjet e Shkumbinit. Kësaj pyetjeje i jep përgjigje vetë mënyra e vendosjes së izoglosave të tufës që formon kufirin e dialekteve.

Ferdinand dë Sosyri[130] ka vënë në dukje se atje ku është i prerë kufiri midis dy gjuhëve, atje ku kalimi bëhet përnjëherë nga një gjuhë në tjetrën, ai kufi është relativisht i ri, kurse atje ku kalimet bëhen shkallë-shkallë nga një gjuhë në tjetrën, kufiri është i lashtë, sepse ka pasur kontakte të vazhdueshme, nuk kanë ndodhur lëvizje dhe zhvendosje të popujve që i flasin ato gjuhë. Këtë mendim të F. dë Sosyrit të thënë

---

127. Delabializimi i plotë i *y*-së në *i* dhe kthimi i saj në një *e* të labializuar (*ø*) kanë ndodhur edhe në gegërishten qendrore, por është më vështirë të përcaktohet se kur është kryer ky proces në këto të folme.
128. E Çabej, toponimin e lashtë *Omla* të Dalmacisë e lidh me fjalën *am(b)ël* të shqipes, shih *Disa faza më të moçme të shlpes në dritën e gjuhëve fqinjël*, në «Revista e Inst. Ped. 2-vjeçar Shkodër», 1964, f. 6.
129. Me këtë është lidhur ndërrimi i emrit *Scupi* (Shkupi) në *Skople* te sllavët shih E. Çabej, *Disa faza më të moçme...*, f. 7.
130. F. de Sosur, *Cours de linguistique générale*, Paris, 1972, f. 200.

për gjuhë të ndryshme mund ta zbatonim edhe për dialekte të një gjuhe, në rastin tonë për dialektet e gjuhës shqipe.

Te Shkumbini nuk bëhet përnjëherë kalimi nga njëri dialekt në tjetrin. Përgjatë bregut të majtë të këtij lumi shtrihet një zonë të folmesh ku dalin të përziera tiparet dalluese qenësore më të vjetra të dialekteve. Izoglosat e këtyre tipareve dalluese nuk formojnë një tufë të ngjeshur vijash, ato kalojnë aty disi të larguara nga njëra-tjetra, duke u shtrirë pak a shumë në këtë mënyrë: rotacizmi shkon pothuaj puq me rrjedhën e Shkumbinit, në pjesën më të madhe gjatë bregut të majtë, vetëm pak në lindje dhe në perëndim e kalon bregun e djathtë, afërsisht aty pranë kalon edhe izoglosa e togut *ua* të dialektit jugor, por e mpleksur me *u*-në (< *ue*), ashtu si rotacizmi që është aty i mpleksur me *n*-në intervokalike dhe hundorësinë (*duar* dhe *dur*, *zãri* «*zëri*» dhe *pleqni* «*pleqëri*» etj.); izoglosa e zanores *ə* të theksuar të toskërishtes shkon krahas izoglosës së rotacizmit deri në anët e Gramshit, kurse prej atje e deri në Adriatik ajo ndahet, zbret në më jug, i lë vendin ã-së së gegërishtes , ose *a*-së pa ngjyrim hundor; fare pranë izoglosës së *ə*-së kalon edhe ajo e grupit *va-* (*vatər*) e dialektit jugor (shih hartën nr. 5).

Kjo tufë e hapur izoglosash, disa prej të cilave edhe mpleksen me një ra.tjetrën, tregon qartë se zona pak a shumë e gjerë e të folmeve kalimtare ndërmjet dy dialeteve është formuar prej kohësh dialngadalë në brigjet e Shkumbinit, ku ka qenë i vazhdueshëm komunikimi midis grupeve të popullsisë së dy zonave dialektore.

Lindjen e dy dialekteve të shqipes G. Hahni[131] e shpjegon me ndarjen e territorit të ilirëve në Iliri dhe në Epir. Një shpjegim i këtillë do t'i binte ndesh faktit që Epiri, d.m.th. treva jugore e Ilirisë, që arrinte në veri deri tek bregu i majtë i Vjosës, përfshinte një territor tepër të ngushtë në krahasim me atë të toskërishtes së sotme. Kësaj ndarjeje të vjetër të Ilirisë do t'i qëndronte më afër veçimi i të folmeve jugore të toskërishtes me arealin e delabializimit të *y*-së në *i* (*dy*: *di*), që me sa duket, është gjithashtu një dukuri e hershme në këto të folme.

Me ndarjen administrative të vjetër, të shekujve I-IV të erës sonë, mund të përqasen territoret e disa ndarjeve të tjera dialektore të gjuhës shqipe. Kështu shtrirja e gegërishtes veriore deri te lumi i Matit të kujton pikërisht provincën e Prevalit (shek. I-IV), toskërishtja jugore arrin deri te Vjosa ku shtrihej Epiri (shek. I-III) dhe Epiri i Vjetër (shek. IV-VI) dhe, së fundi, të folmet e toskërishtes veri

131. J.G.Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854.



Harta nr 5

dhe ato të gegërishtes jugore [132] shtrihen sot në territorin e provin cës Makedonia (shek. I-III) dhe të Epirit të Ri (shek. IV-VI).

132. Të folmet e gegërishtes jugore kanë sot disa tipare që i dallojnë nga të fomet e tjera të gegërishtes dhe i afrojnë herë vetëm me toskërishten veriore dhe herë me gjithë dialektin e toskërishtes. Shih më hollësisht J. Gjinari, *Tipare të toskërishtes veriore të njëjtë me ato të gegërishtes jugore*, në «SF», 2, 1965. Sipas një kumtimi nga sh. A. Gjergji në zonën fushore prej Vjosës deri në Mat është karakteristike për gratë veshje si ajo e Dumresë me fund të gjatë feri te këmbët, me shami koke të bardhë shumë të gjatë që lëshohet prapa deri poshtë belit

Tiparet dalluese të këtyre grupeve të folmesh jo se vijnë prej asaj kohe të hershme kur ishte kjo ndarje në tre provinca të mëdha të administratës pushtuese romake, por ka të ngjarë që lëvizjet e marrëdhëniet e grupeve të bashkësisë sonë etnike dhe, për sasojë, edhe ndryshimet që kanë pësuar të folmet e shqipes kohë pas kohe të jenë bërë përafërsisht brenda këtyre territoreve, duke përfshirë këtu edhe ato të Dardanisë. Lëvizje të grupeve të popullsisë shqiptare nga njëri skaj në tjetrin nuk njihen.

Është me interes të përmendet fakti se edhe principatat dhe shtet e para feudale shqiptare të kohës së sundimit bizantin (shekulli XIII-XIV) shtrihen gjithashtu përafërsisht brenda kufijve të këtyre tri provincave të dikurshme, kështu Balshajt në Veri, që arrinin deri te Mati, Topiajt, në fillim shtriheshin në qendër, prej Matit në Shkumbinin, e që më vonë u shtrinë në Jug deri te Vjosa, dhe Shpatajt në Jug, duke filluar prej bregut të majtë të Vjosës.

Për të njohur faktorët shoqërorë që shkaktuan në fillim lindjen e dy dialekteve të shqipes është mjaft e vështirë sot, sepse janë procese që kanë ndodhur në kohë shumë të shtyra, nga të cilat nuk kanë arritur në ditët tona dokumente të shkruara jo më të gjuhës, por as edhe të historisë.

Ndarja dialektore e shqipes në një zonë me rotacizëm e me zanoren *ə* dhe në një zonë tjetër pa rotacizëm e me ã përputhet me ndarjen në mënyrën e të kunduarit të popullit tonë. Në Jug, duke filluar prej Shkumbinit, është karakteristike polifonia (të kënduarit me shumë zëra), në Veri është karakteristike homofonia (të kënduarit me një zë). Sipas muzikologëve kjo ndraje në fushën e muzikës popullre është shumë e vjetër[133]. Gjithashtu edhe për veglat muzikore shihet se në Jug janë ruajtur më mirë veglat aerofone (fyelli), kurse në Veri veglat kordofone (lahuta, çiftelia).[134]

Muzika polifonike e Jugut të Shqipërisë nuk është një dukur e izoluar, ajo është e njohur edhe në Kalabri, në Sicili e deri në Kaukaz[135]. Një strirje e këtillë e gjerë në Jug të Evropës tregon se polifonia është e një kohe të lashtë e lidhur, me sa duket, me një popullsi anase të këtyre vendeve të Mesdheut.

I parë në këto lidhje, veçimi i dialektit jugor të shqipes që në kohë relativisht të hershme u shtohet të dhënave të toponimisë, të arkeologjisë e të etnografisë si argument për tezën e autoktonisë së shqiptarëve në trojet ku jetojnë sot.

---

133. R.Sokoli, *Disa veçori të muzikës sonë popullore*, në «Konferenca I e Studimeve Albanoligjike» , f. 336-337.
134. Rr.Zojzi, *Nëndarjet e vjetra krahinore të popullit shqiptar* në «Konferenca e Stud. Alb., » Tiranë 1965, f. 547.
135. Kumtuar nga muzikollogu B. Kruta.

Në periudhën e gjatë të mesjetës në zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të dialekteve të saj veprojnë dy forca të kundërta historike-shoqërore: nga njëra anë, sistemi feudal me copëzimin ekonomiko-politik të tij vepron si forcë divergjuese, që sjell dallime në gjuhë, nga ana jtetër, njësia etnike e kombësisë vepron si forcë konvergjuese, si forcë që e ruan dhe e forcon njësinë në gjuhë. Zakonisht forca e parë, forca divergjuese, gjatë mesjetës është një forcë mbizotëruese, është forcë me prirjen kryesore, por për gjuhën shqipe edhe forca e dytë, forca konvergjuese, nuk ka qenë më pak e vogël në këtë periudhë

Në vështrim të parë duket sikur dialektet me ndryshueshmërinë e tyre gjuhësore dhe territoriale nuk mund të dëshmojmnë njësinë e kombësisë të pasqyruar në gjuhë, Por, në qoftëse i largohemi vështrimit mekanik të gjërave dhe i shohim ato dialektikisht, del se dialektet e kanë edhe vlerën e një dëshmie të këtillë. Kjo shpjegohet me faktin se dialektet në përgjithësi, me gjithë diferencat që kanë ndërmjet tyre, përshkohen në pjesën më të madhe edhe nga tipare të përbashkëta; përveç kësaj, kombësia arbëreshe, ndryshe nga ajo e disa popujve të Evropës Perëndimore, që kaluan nëpër një feudalizëm klasik, u zhvillua brenda kuadrit të Perandorive të mëdha Bizantine dhe Osmane.

Forca konvergjuese në zhvillimin e dialekteve shihet në disa drejtime: gjatë mesjetës nuk shohim të lindin dialekte të reja në gjuhën shqipe dhe nuk ndryshon vendosja gjeografike e dy dialekteve të nëparshme. Tashti janë shumë të pakta rastet kur një veçori dialektore e re mbulon plotësisht territorin e njërit e të tjetrit dialekt. Në dialektin jugor pushon së vepruari procesi i rotacizimit të *n*-së ndërmjet dy zanoreve, nuk kthehet më në *ə* zanorja *a* e ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore, edhe kundërvënia e grupeve *vo*~*va* mbeti në fjalët që kishte përfshirë dikur dhe nuk u shtri më tej; të gjitha këto ndodhën sepse në sistemin e fonemave të dialekteve tashti kishin zënë vend ndryshimet e mëparshme fonetike. Sigurisht, këto ishin kryesisht rezultatete të zhvillimit të brendshëm të gjuhës, por në përhapjen e mëtejshme të një veçorie dalluese dialektore, në ngushtimin e në zgjerimin e territorit të saj ndikojnë shumë edh faktorët shoqërorë, faktorët jashtëgjuhësorë.

Disa ndryshime, që ndodhin gjatë kësaj periudhe në gjuhën shqipe, shohim se mbulojnë treva të mëdha që përfshijnë zona të të dy dialekteve. Kështu kalimi i *l'* -së në *j* (*gol'ə* > *gojə*, *val'* > *vaj* etj.) shtrihet pothuaj në gjithë truallin e shqipes, me përjashtim të zonës së Çamërisë ku *l*-ja mbeti e pandryshuar (*golə*, *val* etj.), zhvillimi i grupeve *kl* e *gl*, veç çamërishtes, ku ato u ruajtën, merr fill në të gjitha të folmet e tjera dhe reflekset e tyre *c*, *ʒ* (*kluməʃt* > > cuməʃt, *gluha* > ʒuha) shtrihen prej lumit të Shalësit afër Ko-

nispolit në Jug deri te lumi Drin në Veri; seria e zanoreve të gjata bëhet tipar i gegërishtes edhe i toskërishtes jugore; reduktimi i grupeve *mb*, *nd*, *ng*, në *m*, *n*, *ɲ* përfshin pothuaj gjithë gegërishten në Veri dhe labërishten në Jug etj.

Forca divergjuese e copëzimit feudal duket së pari në gjuhën shqipe në thellimin e mëtejshëm të dallimit të dy dialekteve, në lindjen dhe në zhvillimin e disa tipareve dalluese të tjera gjatë mesjetës, megjithëse këto nuk janë të gjitha aq qenësore sa rotacizmi, *ə*-ja e theksuar dhe grupi *va* të periudhës së mëparshme. Veç kësaj, kjo forcë divergjuese shihet edhe në formën që morën gjatë kësaj kohe brenda dy dialekteve grupet e të folmeve me zhdukjen e disa tipareve të mëparshme dalluese, me lindjen e tipareve të reja për shkak të ndryshimeve në gjuhë dhe me zgjerimin ose ngushtimin e kufijve të këtyre tipareve në zona të ndryshme. Formohen degëzime dialektore, që arrijnë deri në të folme të veçanta, të cilat shpesh shtrihen brenda territoreve të krahinave mesjetare.

Që nga koha kur po merrnin formë këto dy dialektet (shek. V-VII, VIII) në jetën e popullit tonë herë pas here kanë ndodhur procese të ndryshme historike. U thellua procesi i shpërbërjes së rendit fisnor për t'u kryer edhe në zona të brendshme. diku më shpejt e diku më vonë, në zona të veçuara malore duke u mbajtur edhe për një kohë më të gjatë. Lindi dalgadalë dhe u zhvillua sistemi i bashkësive fshatare, me zhvillimin e mëtejshën ekonomiko-shoqëror ky proces shkoi më tej, lidhja e disa bashkësive fshatare çoi në formimin e krahinave.

Duke u kryer procese të këtilla, dalngadalë vendin e emrave të fiseve të dikurshme ilire e zunë emrat e krahinave (Pult etj.), kurse më vonë, pas formimit të kombësisë shqiptare , u përhap dalngadalë emri i përbashkët *arbën/arbër*, duke filluar nga Shqipëria e Mesme dhe duke u shtrirë shkallë-shkallë në të gjitha drejtimet (shek. XII-XV). Krahas tij, më vonë u përdor herë-herë edhe emri *epirot*.

Është koha kur krahinat e arbërve (arbëreshëve) bëjnë pjesë në Perandorinë e Bizantit. Duke filluar nga shekujt VII, VIII-X, bashkësia e shqiptarëve bie në kontakt me bashkësinë sllave, e cila dalngadalë ngushtonte territorin e bashkësisë sonë duke asimiluar një pjesë të popullsisë dhe duke zhvendosur një pjesë tjetër. Zhvendosje të këtilla të elementit shqiptar kanë ndodhur edhe në kohë shumë të vona[136].

136. Mark Krasniqi, *orahovac, antropogeografska nonografija vorosiee* në «Glasnuk Muzeje Kosova i Metohije», II, Prishtinë, 1957. (Sipas H. Aganit, *Cila është treva gjuhësore e fjalorit të Kujunxhiçit*, në «GJA», «GJA», 1, 1968, 1968, f. 146): «Duke filluar nga kryengritja e parë serbe (1804), pastaj pas-Kongresit të Berlinit (1878) e tutje, shqiptarët që banonin në qendra të zhvi-

Grupet që zhvendoseshin vinin e përziheshin me grupe të tjera shqiptarësh në trevat ku janë sot. Vende-vende grupe të bashkësisë së huaj sllave hynë edhe në territoriet që kanë sot shqiptarët, si-domos në verilindje dhe në lindje. Gjurmë të këtyre kontakteve e marrëdhënieve, që zgjatën për disa shekuj, janë një numër fjalësh sllave si dhe toponimia sllave në disa zona. Në zonat anësore kufitare këto kontakte e marrëdhënie zgjatën edhe më shumë në kohë dhe ishin edhe më të dendura. Në disa vende ato vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, prandaj shihen aty ndikime më të mëdha, ndikime që formuan disa dallime dialektore, sidomos më tepër në fushën e leksi-kut, diçka në fjalëformim dhe aty-këtu edhe në strukturën fonetike e gramatikore me ndonjë element të veçuar.

Në zonat anësore, atje ku edhe sot jetojnë të përziera grupe të botës shqiptare me grupe të botës sllave, ndikimi i shoqishoqtë është disi më i dukshëm, sidomos në strukturën sintaksore, por, megjithatë, për tërësinë e gjuhës shqipe këto ndikime nuk kanë veçse karakterin e një adstrati për shkak të një simbioze të gjatë të dy bashkësive etnike në këto territore, pjesërisht edhe për shkak të ushtrimit të ndikimit autoritativ nga ana e administratës së sllavëve në këto anë. Vetë lënda gjuhësore e shqipes, e parë edhe në format e saj dialektore, nuk të çon jo më te një *shtypje e ushtruar nga një substrat sllav*, siç do të men-donte gjuhëtari çek V. Polak[137], por as edhe te *një precipitim i thellë i elementit sllav në gjuhën shqipe*, siç është shprehur gjuhëtarja sovje-tike A.V.Desnickaja[138].

Proceset që ndodhen në popullsinë shqiptare gjatë periudhës kur sllavët zunë vend në Ballkan, sidomos lëvizjet e grupeve në territore të ndryshme, nuk janë shënuar në dokumente historike, por, megjithatë, ato nuk kanë kaluar pa lënë gjurmë në vetëdijën e bano-rëve të disa krahinave veriore. Të dhënat e etnografisë vënë në dukje se aty nga fillimi i këtij mijëvjeçari vijnë nga Veriperëndimi masa bleg-torësh e zënë vend pranë elementit të tyre etnik në Malësi, *në krahinën e Pultit* mesjetar.[139] Aërsisht në këtë kohë (shek. XII-XIV) lëvizin grupe të popullsisë shqiptare nga Jugu i Shqipërisë dhe Zënë vend në anët e Peloponezit, në rrethet e Atikës dhe në ishuj të

---

lluara të Serbisë në disa valë, nga presioni, dhuna e pasiguria braktisën vend-banimet e tyre në Serbi dhe zunë vend në Kosovë, në mesin e elementit të tyre etnik. Këto përbëjnë sot atë element shqiptarësh të Kosovës që quhet gjithkund *muhaxher*, të ardhur nga anët e Nishit, të Kralevës etj.»

137. V. Polak, *po aty.*

138. A.V.Desnickaja, *Slavjanskie zaimstvovanija v albanskom jazyke*, në «V mež-dunarodnyj sjezd slavistov», Moskva, 1963.

139. Rr.Zojzi, *Ndarja krahinore e popullit shqiptar.* në «Etnografia shqiptare» I, 1962, f. 35.

Egjeut.[140] Këto janë grupet që formuan diasporën e arbëreshëve të Greqisë, e cila ruan edhe sot e kësaj dite tiparet dialektore të Jugut që nga koha kur u shkëput prej trungut të shqipes.

Këto lëvizje e të tjera të panjohura, si edhe lëvizjet e brendshme që ndodhën pas pushtimit turk nga shekulli XV e këtej sollën, sigurisht, ndryshime edhe në të folmet e shqipes. Nga pushtimi turk u shkaktuan në përgjithësi në periudhën e parë lëvizje nga fusha në mal brenda zonave ku ekzistonin marrëdhënie dhe lidhje midis malit dhe fushës. Nga sa njihet prej kërkimeve dhe studimeve etnografike, në këtë periudhë, aty rreth shek. XV-XVII, për shkak të presionit të pushtuesit turk, grupe të popullsisë, që dikur kishin ardhur prej Rrafshit të Dukagjinit e kishin zënë vend diku aty te Puka, në të dy anët e rrugës Shkodër-Prizren, pësojnë një zhvendosje të dytë: një pjesë futet si pykë në Malësi për të formuar krahinën e Dukagjinit dhe krahinën e Merturit, një pjesë tjetër u shty më nga jugu dhe formoi bërthamën e Mirditës së sotme[141]. Këto grupe të popullsisë ruajnë edhe sot vetëdijën e prejardhjes së tyre nga anët e Rrafshit të Dukagjinit, ruajnë gjithashtu ato anë edhe ndonjë element të kulturës së tyre shpirtërore. Me kalimin e kohës, me përjashtim të ndonjë elementi që ruajtën, hynë dhe morën po atë rrugë zhvillimi që kishin marrë edhe të folmet e trevave ku zunë vend. Edhe Malësia e Vogël (zona e rrethit të Tropojës[142]) që u shkëput prej Malësisë së Madhe pasi hyri në mes Dukagjini, ndoqi zhvillimin gjuhësor të të folmeve të grupit verilindor.

Në këtë periudhë shkëputen nga trungu i shqipes së atdheut të folmet e diasporës së arbëreshëve të Italisë (nga Jugu sidomos në shek. XV-XVI, por edhe në shek. XVIII), e folmja e Zarës në Dalmaci (nga anët e Krajës në shek. XVIII) dhe më vonë e folmja e shqiptarëve të Ukarinës dhe ajo e Mandricës në Bullgari (nga Jugu në shek. XVIII-XIX) etj.

Të folmet e ngulimeve të hershme shqiptare, ato të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë dhe dokumentet e vjetra të shkrimit shqip nxjerrin në shesh se aty nga fundi i mijëvjeçarit të parë ose fillimi i mijëvjeçarit të dytë ishin formuar edhe dy tipare dialektore që ndajnë sot toskërishten nga gegërishtja. Të këtilla ishin: grupet nistore *va-* (*vaī*) në Jug e *vo-* (*voī*) në Veri dhe degëzimi i diftongut të vjetër *ou*, duke dhënë *ua* (*duar*) si të vetëm e me shtrirje të plotë në Jug dhe *ue* (*duer*) me një shrirje të përgjithshme në Veri, krahas ruajtjes së *uo*-së në disa zona skajore (sidomos veriperëndimore, ku nuk mungojnë edhe raste me variantin *ua*).

---

140. *Historia e Shqipërisë*, I, Tiranë, 1967.
141. Rr.Zojzi, *po aty*, f. 36.
142. Rr.Zojzi, *po aty*, f. 42.

Dokumentet e vjetra shqip dhe të folmet e diasporës shqiptare tregojnë se dy dialektet, që njohim sot si gegërishte e toskërishte, në atë kohë qëndronin më afër njëri-tjetrit. Sigurisht, atëhere do të kenë ekzistuar edhe diferenca të tjera brenda çdo dialekti, por ne nuk i njohim mirë sot. Në një farë mase edhe disa dallime midis të folmeve të arbëreshëve të Italisë, me sa duket, lidhen me gjendjen dialektore të krahinave të atdheut në kohën kur u shkëputen; po ashtu edhe dallimet midis gjuhës së Gj. Buzukut, F. Bardhit e P. Budit ka shumë gjasë që të lidhen më tepër me pozitën gjeografike të të folmeve të tyre, sesa me distancën në kohë midis njërit e tjetrit autor[143].

Proceset ekonomike-shoqërore që zhvillohen sidomos në këta pesë shekuj e fundit në grupet e ndryshme të bashkësisë sonë etnike thellojnë me tej ndarjen e dy dialekteve dhe u japin dalngadalë formë degëzimeve më të vogla dialektore që rititen deri në ditët tona.

Disa dukuri dialektore, që zhvillohen në këtë periudhë, shtrihen duke mbuluar gjithë territorin e një dialekti, disa të tjera vijnë e bëhen tipare të nëndialekteve, disa të grupeve të të folmeve e disa të tjera tipare të veçanta të të folmeve.

Kështu dy dialekteve u shtohen gjatë kësaj kohe tipare dalluese të reja, të cilat vijnë kryesisht për shkak se dialekti verior tregohet më inovues. Në dialektin verior vazhdoi të vepronte ligji i rregullimit mekanik të theksit edhe në huazimet që hyjnë nga turqishtja (*bákeř*, *bab*, *tenéce*, *daj* etj.); u krye kalimi i bashkëtingëllores *h* në *f* nëpërmjet labializimit, duke u përgjithësuar në mbarë gegërishten si këmbim fonemash në grupin *ht* (*ɾofta*, *i ftoft*, *i ŋroft* etj.) dhe duke sjellë në gegërishten jugore një dallim fonetik etimologjik; mbylltorja qiellzore ɾ kaloi në *j* në një pozitë të dobët ndrëmjet dy zanoreve dhe në fund të fjalës (*rãja* «rrënja», *ftoj* «ftonj», *laj* < «lanj» etj.)[144]; në pjesën më të madhe të dialejtit verior u asimiluan grupet *mb*, *nd*, *ng* duke u thjeshtuar në *m*, *n*, ŋ, (*mbaθ* > *maθ*, *ndal* > *nal*, *ngre* > *ŋre* etj.) (veçse ky nuk është një tipar relevant për dialektin verior, sepse një zhvillim i këtillë i këtyre grupeve ndodhi edhe në Jug në malësinë e Kurveleshit); dalin disa forma gramatikore të reja, sidomos në sistemin foljor, si forma e së pakrerës me -(*j*)*ʃa* (*kapʃa*, *lajʃa* etj.) për foljet veprore dhe forma me pjesëzën përemërore *u* (*u kapʃa*, *u lajʃa*) për foljet pësore; reduktohet mbaresa e formës së

143 E.Çabej, *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, në «BUSh, SShSh» 1, 1958, f. 44.

144. Në anët e Dibrës dhe në ato të Krrabës është ruajtur në format foljore të së pakryerës. Zhvillimi *ɾ* > *j* vetëm në sistemin foljor është kryer edhe në toskërishten jugore.

pjesores (*la*: «larë», *kap* «kapur», *vjel* «vjelë» etj.);mbiemrat prejfoljorë të gjinisë femërore, përveç nyjës së përparme, dallohen edhe nga mbaresa *-e* (*i lam / e lame*), del një formë e veçantë për përemrin pronor vetvetor (*i vet, e vet, të vet*) e ndonjë tjetër.

2.4.3. Tipare të tjera dialektore, që dalin në këtë periudhë, marrin një shtrirje më të kufizuar territoriale. Me lindjen e këtyre tipareve brenda gegërishtes marrin formë dy variante që ndahen gjeografikisht te lumi Mat: gegërishtja veriore dhe gegërishtja jugore, kurse brenda toskërishtes kristalizohen më tej toskërishtja jugore e toskërishtja veriore.

Dy nëndialektet e gegërishtes dallohen ngaqë në të folmet veriore zanorja a hundore është më ę hapet dhe dysi më ę prapmë (ę) (*sę̃ni, fę̃mna* etj.), kurse në të folmet e gegërishtes jugore ajo është e tipit të zakonshëm të shqipes, por hundore (*sẽni, fẽmna* etj.), diftongjet *ue, ye, ie* në gegërishten jugore u monoftonguan kudo dhe plotësisht (*dur* «duar», *byj* «thyej», *dit* «dielli»), kurse në Veri në shumë të folme të zonave malore u ruajtën si togje zanoresh, sidomos në rrokje fundore të hapur (*due, mue* etj.); grupet *kl, gl* në gegërishten jugore dhanë kudo *c, ɟ* (*caj* «qaj» *ɟuha* «gjuhë»), kurse në Vrei diku dhanë *ki̯, gi̯*, (*ki̯aj*, «qaj», *gi̯uha* «gjuha») e diku dhanë, *k, g* (*kaj* «qaj», *guha* «gjuha»); gegërishtja veriore u largua prej gegërishtes jugore për shkak se atje lindën disa forma gramatikore analogjike: trajta e shquar e emrave të tipit *ftua* me temë të zgjeruar (*ftoni* «ftoi»), forma me mbaresën vetore *i* për foljet me bashkëtingëllore të vetës së parë të mënyrës dëftore koha e tashme (*kapi, goditi*) e ndonjë tjetër.

Edhe në dialektin jugor vijnë e diferencohen dy nëndialektet duke lindur ndonjë tipar i ri në njërin dhe duke humbur ose duke u ruajtur në tjetrin ndonjë tipar që dikur ka qenë i përbashkët. Kështu të folmet e toskërishtes jugore, ku prej kohësh mungonte zanorja *y*, vazhdojnë të ruajnë zanoret e gjata, [146] të cilat në toskërishten veriore u zhdukën; në toskërishten jugore diftongjet *ua, ie* (*ye* mungonte) kthehen kudo në togje zanoesh, kurse në shumë të fome të toskërishtes veriore u mbajtën si diftongje në rrokje brenda fjalës (*dūar, blūaɲa*); zanorja *e*, ajo që i përgjigjet ẽ-së në gegërishte, u shndë, rrua në *ə* përgjithësisht në toskërishten jugore (*zəmər, fəmər, pə*

---

145. Me sa duket, është një tipar i vjetër për zonat skajore, sepse edhe në toskërishten jugore kjo ę̃ ka dhënë kudo ə në të gjitha rastet.

146. Shih më hollësisht M.Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në, «Dialektologjia shqiptare» I, f.31-136; Q. Haxxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folemt e banorëve të Çamërisë*, në «Dialektologjia shqiptare» I, f. 118-156.

frə); po kështu në këto të folme edhe bashkëtingëllorja qiellzore p pësoi një zhvillim të mëtejshëm duke kaluar në *j* te mbaresat e foljeve të së tashmes dhe të së pakryerës (*laр* > *laj*, *laрə* > *lajə* «laja» etj.); në toskërishten veriore lindi një formë e veçantë e rasës vendore (*nə malt*, *nə gropət* etj.).

Vërehet se kufijtë që ndajnë nëndialektet përputhen me kufijtë e shtrirjes së disa veçorive dalluese të kulturës popullore materiale dhe artistike. Kështu në territorin e gegërishtes veriore janë karakteristike qeleshja sferike (plisi) dhe tirqët. Veçimi i këtij blloku në Veri e gjen shpjegimin e vet në lëvizjet e banorëve brenda këtij territori nga Rrafshi i Dukagjinit në Malësi e prej Malësisë në ultësirat në Verilindje e në Perëndim. Kanë luajtur një rol edhe qendrat ekonomike të vjetra të kësaj zone, si Shkodra, Prizreni, Gjakova dhe Shkupi.

Zona e gegërishtes jugore njihet nga etnografia me emrin *Gegëri* ose *Malet e Gegëve*.[147] Baza e vjetër territoriale e saj është Arbëria mesjetare; edhe *kisha Albanense* me qendër Krujën në këtë zonë i kishte famullitë e veta.[148] Ndryshe nga Veriu, këtu qeleshja është e rrafshët (rrashatake) me dy variante: e lartë në anët e Tiranës, të Durrësit e të Kavajës dhe e ulët në zonat e tjera. Në Mat, në Krujë, në Dibër, në Malësi të Tiranës, në Polis për burrat është karakteristike vallja me formacion *dyshe* që shoqërohet me curle e me lodër.[149]

Në krahinat ku shtrihet sot toskërishtja veriore ka pasur kontakte të ngushta e të vazhdueshme midis banorëve për shkak të shpërnguljeve e nguljeve të bujqve nga një vend në tjetrin,[150] sidomos nga zonat malore, duke u përzier kështu me banorët e zonave fushore. Në një farë mase kanë luajtur rol edhe kontaktet gjatë dimërimit të dhenve, sidomos në ultësirën e Myzeqesë. Polifonia toske në këtë zonë është e ndryshme nga polifonia labe,[151] ndryshe nga ajo e Labërisë që është zakonisht *katërzëshe*. Nga krahu i majtë i Vjosës, në zonën e toskërishtes jugore, është karakteristike qeleshja e njohur e Labërisë dhe vallja me *strukturë njëpjesëshe*.[152]

2.4.4. Relativisht të reja, të këtyre dy-tre shekujve të fundit, janë edhe disa veçori dalluese dialektore që ndajnë sot grupet e të folmeve, grupin e *gegërishtes veriperëndimore*, grupin e *gegërishtes veri-*

147. Rr.Zojzi, *Ndarja krahinore e popullit shqiptar*, në «Etnografia shqiptare» I 1962, f. 27.
148. Po ai, *po aty*, f. 27.
149. R. Bogdani, *Sprovë për një klasifikim shkencor të folklorit koreografik*, në «SF», 2, 1975, f. 136.
150. Rr.Zojzi, *po aty*, f. 49.
151. B.Kruta, *Polifonia e Skraparit dhe disa çështje tipologjike të saj*, në «SF» nr. 2. *ü973, f. 209, 210.
152. R. Bogdani, *vep. cit.*, . 136.

lindore, grupin e *gegërishtes qendrore* dhe *labërishten e çamërishten* në dialektin jugor.

Çamërishtja erdhi e u dallua për shkak se tek ajo u ruajtën grupet *kl* e *gl* (*klumə∫t*, «qumësht», *gluha* «gjuha») dhe *l*-ja palatale (*val* «*vaj*», *golə* «*gojë*», *bilə* «*bijë*») etj.

Labërishtja, sidomos bërthama e saj (Kurveleshi) dhe ndonjë fshat i zonës së Himarës, ruajtën në disa raste timbrin e veçantë të zanores *ə* të theksuar, si një *ə* e prapme [3], që diku i afrohet edhe *o*-së një zanore e prapme e hapur jobuzore [ʌ] e *jɜma* ose e *jʌma* «e ëma», *vʌθ* «*vëth*», etj.), ndryshojnë edhe grupet *mb*, *nd*, *ng*, të cilat nëpërmjet asimilimit, dhanë respektivisht *m*, *n*, *ŋ* (*maj* «*mbaj*» *funi* «*fundi*», *məŋa* «*mënga*») etj.

Në të folmet e gegërishtes veriperëndimore zhvillimi i grupeve *kl*, *gl* shkoi deri në *kɻ*, *gɻ* (*kɻaj* «*qaj*», *gɻũni* «*gjuri*»), ndryshimet që pësuan grupet *ae*, *oe* sollën këtu fonemat e reja të gjata æ:, ø:, të cilat formuan një sistem katërkëndësh në zanoret e gjata gojore, gupi *ʃʃ* u reduktua në ʃ (*ko:ʃ* «*ko*fshë», *kɻoʃ* *ʃnoʃ* «qofsh shëndoshë), aty u ruajt mbaresa *-mə* e vetës së parë shumës e së kryerës së thjeshtë (dulmę «dolëm», lamę «lamë» etj.), doli një formë e veçantë me *-t* për rrjedhoren e emrave femërore të numrit njëjës (*miʃ* *lopet* «mish lope») etj.

Në gegërishten verilindore grupet e vjetër *kl*, *gl* dhanë *k*, *g* (*kaj* «*qaj*», *guha* «*gjuha*»), nuk u palatalizua *k*-ja në *q* në raste si këto: *kep* «*qep*», *keř* «*qerre*», *lkę̃* «*liqen*», *kie* «*qe*» (shum. i *ka-u*)[153], u përhap trajta e shquar me nyjën -i për emra mashkullorë që mbarojnë me *k*, *g*, *h* (*miki* «*miku*» *zogi* «*zogu*», *krahi* «krahu»); lindi dhe u shtri në të gjitha të folmet e këtij grupi forma e së pakryerës veta e tretë njëjës me nbaresën (*-j*)*ke* (*hapke* «hapte», *lajke* «lante») e donjë veçori tjetër.

Në qendër të gegërishtes, në një zonë midis Pukës e Malësisë së Tiranës dhe prej Ishmi deri në Shkup, erdhën u formuan disa të folme të cilat u larguan në mënyrë të dukshme prej të folmeve të tjera të shqipes për shkak të një zhvillimi të veçantë që morën aty disa tinguj. Në gjithë këtë trevë zanorja *i* e theksuar u diftongua e dha diftongjet *e̯i̯*, *ę̯i̯*, *ə̯i̯*, *a̯i̯*, *o̯i̯* (*me̯ik*, *ma̯ik*, «mik», *dhə̯i̯*, *dha̯i̯* «dhi» etj.); në anën perëndimore (Mat, Lurë, M. e Krujës, Mirditë) zanorja *y*, nëpërmjet hapjes së saj, dha si variante kryesore e të labializuar të mbyllur [ø] ose të hapur [œ] (*tøm*, «*tym*», *u θ œ* < *u thy* «u thye»), kurse në lindje, ndoshta prej kohësh[154] *y*-ja është delabializuar duke

153. Për sh,aqet e kësaj dukurie jemi përohekur të japim një mendim në artikullin *Për zhvillimin e grupeve kl, gl...*, në «GJA», 1, 1971, f. 57-65.

154. Delabializimi *y* > *i* ka të ngjarë të jetë më i hershëm se hapja e *y*-së në ø, sepse fonetikisht është i vështirë kalimi nga ø në *i*.

kaluar në *i* (*di* «*dy*», *sai* < *si* «sy») ;në M. të Krujës dhe në anën lindore të këtij grupi të folmesh (prej rrethit të Peshkopisë e deri në Shkup) zanorja *u* e theksuar, nëpërmjet hapjes, u diftongua duke dhënë *o͡u* dhe *a͡u* (*no͡use* / *na͡use* «*a͡use*», *nouk* /*na͡uk* «nuk»); në të folmet veriore dhe lindore të këtij grupi bashkëtingëllorja *g* është palatalizuar dhe në shumë raste ka dhënë ʒ (ʒ*oja* «*goja*», ʒ*uri* «*guri*»), kurse grupet *tj*, *dj*, nëpërmjet palatalizimit, kanë përfunduar në *c*, ʒ (*cetri* «*tjetri*», ʒ*a*θ «*djathë*»)

Lëvizja vertikale nga lart poshtë e disa zanoreve (*i* > *e͡i*, *a͡i*: *u* > > *o͡u*; *y* > ø) e dallon shumë këtë grup të folmesh, sepse në të gjitha të folmet e tjera të shqipes, si rregull, lëvizja e zanoreve është bërë në drejtim të kundërt (krah.: *o* > *ou* / *ua*, *e* > *ie*). Shkaku i kësaj lëvizjeje mbetet për t'u bërë objekt i gjurmimeve të veçanta. [k]

Për kronologjinë e këtyre dukurive është vështirë të jepet një gjykim i saktë, sepse mungojnë dokumente të shkruara të hershme të këtyre të folmeve.

Sigurisht, këto veçori të gegërishtes qendrore në fillim kanë pasur shtrirje të kufizuar territoriale dhe më vonë do të jenë përhapur për të marrë dalngadalë këto shtrirje që kanë sot. Ndonjë prej këtyre veçorive dalluese mund ta ketë marrë relativisht vonë pamjen e plotë që ka sot, duke kaluar nga një ndërrim fonetik në tjetrin për shkak të prirjes karakteristike të tyre të zhvillimit. Ka të ngjarë që këtë rrugë të ketë ndjekur zhvillimi e grupeve *pl*, *bl*, (*fl*), njëherë në *pj*, *bj*, (*fj*), duke u shtrirë jotizimi i *l*-së palatale edhe në këto grupe bashkëtingëlloresh, ndryshe nga shumica e bashkësisë shqiptare, ku si rregull kjo normë fonetike pati fuqi vetëm mbi grupet *kl*, *gl*; pastaj për shkak të normave të veta të këtyre të folmeve, bashkëtingëllorja *j* në grup me buzoret *p*, *b*, nëpërmjet asimilimit kaloi në qiellzore mbylltore *c*, ʒ (*pc*, *bʒ*), pastaj në afrikate, deri sa vende-vende thjeshtimi i grupeve çoi në *c*, ʒ. (*cak* «*plak*», ʒ*eta* «bleta»), ashtu sikurse veproi kjo normë këtu edhe për grupet *tj* > *c* (*tjetri* > *cetri*), *dj* > ʒ (*djali* > ʒ*ali*), *mj* > ɲ (*mjegul* > ɲ*egul*).

Përsa i përket kronologjisë së zhvillimit të kësaj dukurie fonetika, treguese për një cak relativ mund të jenë edhe reflekset *pj* < *pl*, *bj* < *bl* në të folmen e Dukagjinit, e cila zuri vend këtu në Malësinë e Madhe aty nga shekujt XVI-XVIII, kur u zhvendos nga anët e Pukës[155] ai grup i popullsisë që formoi Dukagjinin e sotëm.

Gjatë kësaj periudhe, krahas formimit të grupeve të mëdha që u përmendën, erdhën dhe u dalluan edhe njësi më të vogla dialektore.

---

155. R.Zojzi, *Ndarja krahinore...*, f. 36.

Afërsisht një shtrirje të këtillë gjeografike kanë marrë edhe disa veçori dalluese të kulturës popullore shpirtërore, materiale dhe artistike. Kështu në Labëri kanë qenë ruajtur deri vonë mbeturina të kanunit të Papa Zhulit ose të Idriz Sulit, nga veshjet aty ka qenë karakteristike *bërruca*, ndërsa në Myzeqe *guna lare* dhe në anët e tjera të Toskërisë *guna çile*. Këto zona dallohen edhe nga vallet: vallja *labe*, vallja *myzeqare* dhe vallja *toske*.. Në veriperëndim, në Malësi, është qendra e *xhubletës*, aty kanë vatrën raspsoditë e kreshnikëve etj. Për zonën qendrore të Gegërisë (Mirditë, Mat etj.) është karakteristike *kulla* dhe në veshjen e gruas *xhupa*. Ana perëndimore e Shqipërisë së Mesme dallohet për qeleshen e gjatë dhe xhokën e zezë. Këto grupime, ose disa prej tyre. lidhen në një farë mase edhe me një bazë territoriale të vjetër, me disa krahina të hershme mesjetare a me principata e zotërime feudale, si me Pultin në Veri, me principatën e Dukagjinëve (Pukë-Prizren-Gjakovë), me provincën dhe krahinën Ematia (Mati) ose me zotërimet e Kastriotëve[156] dhe Sanxhakun e Ohrit në qendër, Myzeqeja me zotërimet e Muzakajve etj. Por ,duke qenë se vendi ynë kaloi në feudalizmin klasik si disa vendeve të Evropës Perëndimore, ka shumë të ngjarë që në këtë ndarje të kenë luajtur rol edhe lëvizjet e popullsisë pas pushtimit turk brenda territoreve pak a shumë të ngushta, atje ku edhe më parë ekzistonin lidhjet me emigrimet e brendshme në fushat dhe në malet e afërta.

Kështu grupi veriperëndimor i gegërishtes u formua aty ku shtrihen masivi i Malësisë së Madhe dhe ultësira e Shkodrës; në zonën ku është Malësia e Gjakovës (rrethi i Tropojës) me Hasin dhe Rrafshi i Dujkagjinit e ai i Kosovës u veçua grupi verilindor i gegërishtes; në qendër, atje ku shtrihen masivi i Sharrit e i Korrabit dhe lugina e Pollogut (Gostivar-Tetovë), lugina e Drinit të Zi dhe ajo e Matit u dalluan të folmet e gegërishtes qendrore, kurse në zonën e Malësisë së Tiranës, të Martaneshit, të Çermenikës, të Malësisë së Qukësit dhe të ultësirave të Tiranës, të Durrësit, të Kavajës e të Elbasanit u veçuan të folmet e Shqipërisë së Mesme me nëndarjet në perëndim dhe në lindje. Më në jug, atje ku shtrihen masivi i Gramozit, i Ostrovicës, i Malit të Thatë dhe ultësira e Myzeqesë, u formuan të folmet e toskërishtes veriore; më poshtë, te zoma malore e Kurveleshit mori formë labërishtja dhe, së funid, në ultësirën e Çamërisë, e lidhur me masivin e Kurveleshit, por, me sa duket, edhe me masivin e Toskërisë Lindore, mbeti çamërishtja në skajin jugor të shqipes me disa tipare gjuhësore konservative.

Për kontaktet e banorëve brenda këtyre zonave kanë luajtur një rol edhe disa qendra ekonomike, si Shkodra në VP., Prizreni e

156. B.Beci, *Mbi katër inovacione fonetike të t folmeve të Gegërishtes së Mesme.* në «Konferenca I e Studimeve Albanologjike», 1965, f. 265.

Gjakova në VL, Dibra e Shkupi në qendër, Elbasani, Durrësi e Tirana, në Shqipërinë e Mesme , Berati, Vlora dhe Korça e Manastiri në VP e VL të Toskërisë dhe Gjirokastra, Delvina dhe Janina në skajin jugor.

Këto zona ku dallohen grupet e të folmeve përbëhen nga krahina të vogla, që janë si mbeturina të ndarjeve të mëparshme, kryesisht të mesjetës. Zona të tilla janë Zadrima. Dukagjini, Kelmendi, Hasi, Mirdita, Çermenika, Martaneshi, Mokra. Devolli, Skrapari, Mallakastra, Zagoria, Myzeqeja, Kurveleshi e shumë të tjera. Shumë prej tyre dallohen për ndonjë veçanti etnografike që u formua gjatë kohëve. Edhe nga ana gjuhësore, në disa prej tyre dallohen njësi të imëta dialektore, dallohen të folme me disa tipare të tyret karakteristike. Në disa raste e folmja me krahinën nuk përputhen: disa krahina të afërta kanë një të folme, ose pjesë të ndryshme të një krahine përfshihen gjuhësisht në të folme të krahinave fqinje.

Ndarja fetare për gjuhën qe shumë sipërfaqësore, ashtu sikurse edhe në vetëdijën kombëtare të shqiptarëve. Veç disa dallimeve kryesisht leksikore e fare të vogla që lidhen me kulturën dhe zakonet, dallime të tjera gjuhësore nuk mundën të formoheshin për shkak të dasisë fetare. Në disa raste, si në qytetin e Shkodrës e në ndonjë krahinë, si ajo e Devollit, ai dallim i vogël në fushën e fonetikës, që ekziston midis të folmeve të banorëve që kanë pasur fe të ndryshme, është i lidhur me prejardhjen e grupeve të banorëve nga krahina të ndryshme,

2.4.5. Kjo ndarje dialektore e gjuhës shqipe dhe kjo ndarje krahinore e popullit tonë morën formën që kanë sot aty nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX, para Lëvizjes sonë Kombëtare. Në këtë kohë erdhën e u dalluan dy ndarje të mëdha krahinore: *Toskëria* në Jug dhe *Gegëria* në Veri, që përbëheshin nga njësi të tjera krahinore më të vogla, deri në krahina të veçanta. Nga pikëpamja gjuhësore në këto dy zona dalloheshin dy ndarje të mëdha dialektore: gegërishtja në Veri dhe toskërishtja në Jug me nënndarjet e tyre.

Në fushën politike dhe ekonomike, në përputhje me këto ndarje, që nga fundi i shekullit XVIII shihen përpjekjet e Ali Pashë Tepelenës në Jug dhe të Bushatllinjve në Veri për të formuar dy shtete feudale të shkëputura nga Turqia. Këto qenë përpjekje për një përqendrim politiko-ekonomik përsëri brenda kuadrit feudal separatist.

Përqendrimi i plotë politik dhe ekonomik i popullit tonë do të kryhej me Lëvizjen Kombëtare Çlirimtare që përfshiu gjithë masat popullore në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar e në fillim të këtij shekulli dhe që u kororëzua me fitoren e pavarësisë dhe me krijimin e shtetit shqiptar më 1912. Me këtë bashkësia e shqip-

tarëve hyri në etapën e bashkësisë kombëtare. Përqendrimi politik dhe ekonomik, me krijimin e kombit, solli kushte të reja shoqërore. Pas kësaj për dialektet e vetmja prirje e zhvillimit ishte afrimi i tyre. Kjo arrihej prej kontakteve të papenguara që kishin pas kësaj anëtarët e bashkësisë sonë kombëtare. Dialektet, si mbeturina të periudhës parakombëtare, bien tashti në kontradiktë me bashkësinë kombëtare që kërkon njësi gjuhësore.

Njësia gjuhësore kombëtare nuk lindi rishtas, ajo pjesërisht (në pjesën më kryesore) u trashëgua nga e kaluara dhe pjesërisht formohet duke u tërhequr nga dialektet dalngadalë tiparet dalluese dhe duke marrë ato tiparet e përbashkëta nën ndikimin gjuhës letrare.

Në periudhën prej Rilindjes e deri në vitet e para pas Çlirimit, për shkak të vetë kushteve ekonomike-shoqërore të asaj kohe, gjuha letrare që po foromej (me dy variante kryesore) ndikonte me rimte shumë të ngadalshme në afrimin e dialekteve. Rendi socialist, me epërsinë e tij të madhe ndaj rendit të mëparshëm feudo-borgjez, çoi në një zhvillim të shpejtë e të gjithanshëm ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit tonë dhe për pasojë çoi edhe në shtimin e ritmeve ët konvergjimit të dialekteve të shqipes.

Është e kuptueshme se ky konvergjim i dialekteve të gjuhës sonë do të kryhet shkallë-shkallë nën ndikimin gjithmonë e më të madh të gjuhës letrare. Kjo do të arrihet nëpërmjet tërheqjes së plotë të dialektit dhe zëvendësimit të tij me gjuhën letrare në disa shtresa të popullsisë (në shtresat e arsimuara) dhe nëpërmjet hyrjes herë pas here të elementeve të veçanta të gjuhës letrare në dialektin lokal, te disa shtresa të tjera dialekti «do të mbahet» për një kohë edhe më të gjatë.

Marrëdhëniet socialiste në prodhim, që janë vendosur kudo, dhe superstruktura e rendit tonë të ri kanë çuar dhe çojnë drejt afrimit të krahinave dhe të shtresave të gjera të popullit në mënyrën e jetës dhe në botëkuptim, ato çojnë me shpejtësi drejt njësimit të kulturës popullore që integrohet në kulturën socialiste të bashkësisë sonë të sotme.

Sigurisht kultura materiale, dhe kultura shpirtërore i ndiejnë më shpejt këto ndryshime, sepse lidhen me bazën dhe superstrukturën, por edhe dialektet, si variante territoriale të gjuhës kombëtare, që është pjesë përbërëse e kulturës popullore, do të pësojnë ndryshime duke u afruar mbi bazën e gjuhës letrare kombëtartashmë të njësuar. Rezultatet të këtij procesi kanë filluar të dalin në mënyrë të dukshme që tashti.

KREU III

SISTEMI FONOLOGJIK NË DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE

I. SISTEMI FONOLOGJIK NË GJENDJEN E SOTME

VËSHTRIM MBI STUDIMET E DERISOTME

3.1.1. Të dhënat për kapitullin e sistemit fonologjik të dialekteve janë nxjerrë kryesisht nga skicat e monografitë përshkruese që janë botuar sidomos këto njëzet vjetët e fundit[157], nga kërkimet e ndryshme dialektologjike të bëra në terren dhe nga «Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe» (ADGjSh), i cili është duke përfunduar.

Këto studime përgjithësisht nuk kanë pasur si qëllim të veçantë analizën e sistemit fonologjik të të folmeve të gjuhës shqipe, por, siç dihet, kanë kapur e kanë dhënë tiparet diferencuese të të folmeve

157. Shumë prej tyre janë cituar në kapitujt e ndryshëm të këtij punimi. Hartat që ndryshojnë nga botimet tona të mëparshme dhe që janë ndrequr sipas «Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe» do të shoqërohen me shënimin (ADGjSh

të vështruara kryesisht nga ana fonetike për të nxjerrë dallimet midis të folmeve të dialekteve. Më të plota janë monografia e V. Cimokovskit për të folmen e Dushmanit,[158] ajo e L. Mulakut për të folmen e Shalës së Bajgorës[159] dhe, në një farë mase, edhe gramatikat e J.G. Hahnit, [160] O. Dozonit[161] dhe G. Vajgandit[162], të cilat kanë marrë në vështrim një zonë më të gjerë të disa të folmeve të afërta.

Për punimin tonë, në mënyrë të veçantë për krahasimin e dialekteve në gjuhën letrare, janë parë edhe disa vepra që përshkruajnë sistemin fonetik të gjuhës letrare shqipe, si *Gramatika e gjuhës shqipe* e K. Cipos, e botuar në Tiranë më 1949, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë) e A. Dodit, botuar në Tiranë më 1963 dhe pjesa *Fonetika* e veprës *Fonetika dhe gramatika gjuhës së sotme eltrare shqipe* (1983) e hartuar nga A. Dodi dhe J. Gjinari.

Këto vitet e fundit janë hartuar katër punime[163] që e përshkruajnë në mënyrë të plotë sistemin fontik të së folmes duke e vështruar në aspektin fonologjik. Janë punimet e para të këtij lloji për të folmet e Shqipërisë. Tri prej tyre janë teza disertacionesh për të folmet e Shkodrës, të Lezhës e të Elbasanit, kurse e katra është një studim monografik për të folmen e Rranxave të Mbishkodrës.

Punimi për të folmen e Shkodrës, që ka si objekt vetëm sistemin fonetik të asaj të folmeje, veç përcaktimit të sistemit të fonemave të zanoreve e fonemave bashkëtingëllore, jep edhe rezultatet e analizave eksperimentale të realizimit fonetik të fonemave të ndryshme me. Punimet për të folmet e Leszhës dhe të Rranxave të Mbishkodrës rrokin së bashku të gjitha sferat e gjuhës, por edhe këto, sado që jo eksperimentalisht, bëjnë një përshkrim të gjerë të sistemit fonetik me identifikimin e fonemave nëpërmjet kundërvënies së çifteve minimale të fjalëve, me realizimin fonetik dhe me pozicionet ku dalin fonemat zanore dhe fonemat bashkëtingëllore. Punimi për të folmen e Elbasanit trajton në mënyrë të plotë sistemin morfologjik

---

158. W. Chimochwski, *Le dialecté de Dushmani*, Poznan, 1951 (materiali është mbledhur më 1937).
159. L. Mulaku, *Govor albanaca Bajgorske Salje*, Pristina, 1968.
160. J.G.Hahn, *Albanesische Stuidien* II, 1854.
161. Au.Dozon, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, Paris, 1970.
162. G.Weinganrd, *Albanesische Grammatik*, Leipzig, 1913.
163. B.Beci, *Le systéme vocalique et consonantique du parlet de la* ville de Shkodra (Albanie du Nord), theze pour le doctorat d'université, Paris, 1977; Gj. Shkurtaj, *E folmja e qytetit të Lezhës*, tezë disertacioni për gradën «Kandidat i shkencave filologjike», 1981 (e pabotuar), *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, në «Dialektologjia shqiptare» IV, 1982, f. 144-274; Xh. Gosturani, *Struktura gramatikore e së folmes së qytetit të Elbasanit*, tezë disertacioni për gradën «Kandidat i shkencave filologjike». 1982 (e pabotuar).

të së folnes, por, megjithatë, në kapitullin e parë, pa analiza të imëta, jep një pamje të plotë, sidomos për inventarin e fonemave të së folmes që ka për objekt studimi.

Ndërkohë, herë pas here, mbi bazën e të dhënave të kohës, janë hartuar e botuar edhe studime që trajtojnë në mënyrë të veçantë nga aspekti fonologji çështje të ndryshme të sistemit fonefik të dialekteve të shqipes. disa nga këto studime japin karkaeristitka të përgjithshme të sistemit të fonemave zanore e bashkëtingëllore të shqipes e të dialekteve të saj dhe disa të tjera analizojnë në masa të ndryshme nënsiteme dhe probleme të veçanta të sistemit të fonemave.

A. Dodi (*Rreth sistemit vokalik të shqipes*, në «SF», nr. 3, 1967 dhe *Phenomènes du système phonètique de l'albanais littèraire durant la formation de la langue nationale albaneaise*, në «SA» 2, 1970) jep organizimin e fonemave zanore në sistem për shqipen e përbashkët me disa nga dallimet midis dialekteve. Kërkimet e mëvonshme dialektologjike kanë nxjerrë të dhëna që e plotësojnë më tej këtë studim për invetarin e fonemave zanore, për vendin që zënë disa prej tyre në sistem në disa të folme, për funkisonin dhe variantet e ndryshme të fonemave zanore.

M. Çeliku (*Kuantiteti i zanoreve të theksuara në të folmet e shqipes*, në «SF» 1, 1971, f. 137-162) trajton në përgjithësi zanoret e gjata në të folmet e gjuhës shqipe duke u përqendruar sidomos tek evidentimi i zanoreve të gjata në të folmet ku ekzistojnë ato dhe, me anë të çifteve të fjalëve, vë në dukje funksionin kuptimdallues të tyre. Nuk janë dhënë fonemat zanore të gjata dhe të shkurtrat me sistemet e tyre në të folmet, me llojet e kundërvënies dhe raportet e tyre dhe, përveç këtyre, analiza është bërë jo sipas kriterit fonetik, por shpesh sipas kriterit morfologjik, duke i dhënë zanoret e gjata e të shkurtrat në format e ndryshme gramatikore e jo në kushte fonetike brenda fjalëve e formave të tyre.

R.Ismajli (*A propos de la quantité vocalique de l'albanais*, kumtesë e botuar në «Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl», f. 367--373), duke rimarrë gjatësinë e zanoreve të gjuhës shqipe si objekt të veçantë të kumtesës së vet, bashkohet me A. Dodin (*Rreth sistemit vokalik....*)dhe me shpjegime më të hollësishme e me argumente të mbështetura kundërshton mendimin e G.S. Loumanit, N.S. Trubetckojt dhe Vaclav Polakut se shqipja ka tri shkallë gjatësie zanoresh; vërteton se ajo ka vetëm dy shkallë gjatësie, ka zanore të gjata e të shkurtra me vlera fonologjike, të pakushtëzuara fonetikisht në asnjë rast. Edhe këtu, ashtu si te studimi i A. Dodit (*Rreth sistemit vokalik*) jepet sistemi i fonemave zanore për gegërishten në përgjithësi, pa dallimet që kanë të folmet e këtij dialekti, janë dhënë si të gjithë gegëri-

shtes æ: dhe ø:, të cilat në fakt janë karakteristike vetëm për gegërishten veriperëndimore. Për zanoret hundore jep përballë njëratjetrës një seri me të gjata dhe një tjetër e të shkurtra, por më vonë (te *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes* në «Gjurmime Albanologjike-seria filologjike» VII, 1977) shohim se heq dorë nga ky mendim, pranon vetëm serinë e fonemave hundore të gjata.

Po ky studius, në dy artikuj të tjerë (*Ndërlidhësi kundërvëniesh të sistemit bashkëtingullor të shqipes*, në «Përparimi», 1, 1973, f.32--39 dhe *Fonemat margjinale të sistemit bashkëtingëllor të shqipes*, në «Përparimi», 5, 1973, f. 441-444), duke vështruar përmbledhtazi sistemin e bashkëtingëllor të gjuhës letrare, aty-këtu bën edhe krahasime me të flomet e shqipes, nëpërmjet të cilave jepen mendime për disa çështje të sistemit bashkëtingëllor në dialekte, sidomos për disa kundërvënie fonemash.

S.S. Shirokov (*Balkanskije mežjazykovye shoždenije v vokalizmje*, kumtesë e mbajtur në Kongresin e Studimeve Ballkanike më 1974 në Bukuresht) duke bërë krahasimin e sistemeve të zanoreve të gjuhëve të Ballkanit, përfshin edhe sistemin e zanoreve të gjuhës shqipe (në të vërtetë sistemet vetëm të disa varianteve dialektore), Prej këtij vështrimi krahasues autori i kumtesës nxjerr përfundime për zhvillimin që kanë pësuar sistemi i zanoreve të gjuhëve të Ballkanit, sidomos ai i gjuhëve sllave. Duhet thënë se, të paktën për gjuhën shqipe, trajtimi është bërë me të meta në metodën dhe pa e njohur mirë gjendjen e sotme dhe historinë e dialekteve të shqipes, sepse shihet se autori nuk ka ndjekur në radhë të parë vijën e zhvillimit të brendshëm në disa të folme të shqipes, por është nisur gjithmonë nga mendimi se në zhvillimin e tyre ka pasur ndikime nga jashtë; veç kësaj, janë përzier e nuk janë ndarë njësitë fonetike të serive gojore të gjata e të shkurtra etj.

Në tekstin tonë (*Dialektologjia shqipatare*, dispensë, Tiranë, 1975) janë dhënë inventari i fonemave zanore e bashkëtingëllore, skemat e sistemeve të fonemave zanore sipas arealeve dialektore, disa dallime të dialekteve në kundërvëniet e fonemave bashkëtingëllore, është bërë një vështrim i shpejtë për kundërvëniet e zanoreve të gjata e të shkurtra dhe të zanoreve hundore e gojore, jepen realizimet fonetike të fonemave zanore e bashkëtingëllore, gjithashtu janë përcaktuar tingujt e ndryshëm që dalin në dialekte kur funksionojnë si fonema e si variante të fonemave. Këto dhe çështje të jera të sistemit të fonemave të dialekteve të shqipes janë trajtuar posaçërisht me një vështrim më të thelluar e më të gjerë në dy studime të veçanta (*Sistemi i foneamve bashkëtingëllore të dialekteve të shqipes i krahasuar me sistemin e gjuhës letrare*, në «SF», 4, 1977, f. 3-27

dhe *Sistemi i fonemave zanore të dialekteve të gjuhës shqipe*, në «SF» 2, 1983.)

Në një punim tjetër tonin (*Zanoret hundore të gegërishtes dhe ë-ja e theksuar e toskërishtes*, në «SF», 3, 1981, F. 48-60) është trajtuar veçmas sistemi i zanoreve hundore të gegërishtes duke u dhënë gjendja e sotme me dallimet në arealet e ndryshme dialektore dhe lindja e zhvillimi i tij. Duke qenë se *ə*-ja e theksuar e toskërishtes është e lidhur me sistemin e zanoreve hundore, ajo është trajtuar këtu së bashku me këtë sistem, jepet historia e shkaqet e lindjes së saj dhe ndryshimet që ka sjellë ajo në sistemin e fonemave zanore të toskërishtes,

Çështje të ndryshme e të veçanta të sistemit fonologjik të dialekteve, si kundërvënie dhe identifikime fonemash, neutralizime kundërvëniesh të fonemave, ndryshime të pjesshme në sistemin e fonemave të dialekteve gjatë historisë së tyre etj. ne kemi trajtuar aty-këtu edhe në disa punime të tjera të botuara kohë pas kohe (*Për historinë e dialkteve të gjuhës shqipe*, në «SF», 4, 1986, f. 127-144; *Ndërrime tingujsh në gjuhën letrare shqipe*, në «SF», 3, 1971, f. 21-28; *Për zhvillimin e grupeve* **kl** e **gll** në *të folmet e gjuhës shqipe*, në «Gjurmime Albanologjike, seria fiologjike» 1, 1971, f.52-65; *Gjuha letrare, drejtshkrimi dhe dialektet e shqipes*, në «Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe» (20-25. XI. 1972), I, 1973, f. 299-307; *Resultats et problemes de la dialectologie albanaise à la lumiere des nouvelles données*, në «Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl», 1977, f. 539-556 dhe *Grupe bashkëtingëlloresh të shqipes që kanë si element të dytë hundoren sonante* **n**. në «GJA, seria fololog jike» VII, 1077, f. 75-87).

B. Beci në dy studime[164] (*Vlera funksionale e gjatësisë së zanireve të theksuara në shqipen e Veriut* (në bazë të të dhënave të së folmes së Shklodrës), në «SF», 3, 1979, f. 89-133 dhe *Vëzhgime për hundorësinë e zanoreve në të folmet veriore të shqipes* (në bazë të të dhënave të së fomes së Shkodrës), në «SF», 3, 1981, f. 143-152), duke u nisur nga analiza e parametrave të zanoreve të gjata dhe zanoreve hundore në të folmet e qytetit të Shkodrës, nxjerr përfundime me metodën eksperimentale për vlerën linguistike (rolin kuptimdalluese) të tiparit të gjatësisë dhe tiparit të hundorësisë në të folmet veriore të gjuhës shqipe. Me studimin *Vlera funksionale e gjatësisë*. . . B. Beci vërteton edhe një herë eksperimentalisht, së pari, kundërshtimin që i bëjnë A. Dodi[165] dhe R. Ismajli[166] mendimit të G.S. Loumanit [167] për

164. *Le système vocalique et consonantique du parler de la ville de Shkodra (Albanie du Nord)*. . .
165. *Rreth sistemit vokalik*. . . , f. 146.
166. *A propos de la quantité vocalique*. . ., f. 368. 363.
167. G.S. Lowman, *The phonetics of albanian*, Language, vol. VIII, 1932, f. 268.

tri shkallë të gjatësisë së zanoreve të shqipes, të pasuar pastaj prej R. Jakobsonit[168], N.S. Trubetckojt[169] dhe V. Polakut[170] dhe, së dyti, ç'ka është edhe më kryesorja, kundërshtimin që i bëjnë V. Cimohovski,[171], A.Dodi[172] dhe R.Ismajli[173] mendimit për ekzistencën e theksit muzikor në shqipen e Veriut të shprehur po nga ata studiues të huaj që u përmendën këtu më sipër, V.Cimohovski, që më 1951, kishte dhënë mendimin se shqipja nuk duhet të barazohet me gjuhët që kanë theks muzikor, kurse A.Dodi më 1967, që u mbështet pastaj edhe nga R. Ismajli më 1972, kishte theksuar se melodia nuk është karakteristikë themelore për vokalizmin e gegërishtes dhe se themelore në zanoret janë dallimet kuantitative (sasiore), kurse dallimet e tjera janë irelevante nga pikëpamja fonologjike.

Në artikullin *Vëzhgime për hundorësinë e zanoreve...* autori jep rezultatet e studimit për variacionet e presionit hundor që përftohen gjatë nyjëtimit të fonemave zanore hundore. Nga analizat ka dalë se ngjyrimi hundor i fonemave zanore hundore nis në fillim dhe vazhdon deri në fund të artikulimit të tyre, ndryshe nga zanoret e hundorëzuara, variante fonetike (hundore) të fonemave gojore, në të cilat ngjyrimi hundor nuk arrin deri në fund të gjatësisë së zanores.

Në një artikull tjetër, në atë *Mbi disa veçori fonetike të të flomeve të gjuhës shqipe në përqasje me gjuhën letrare.* (në «SF», 4, 1982, 52-72) B. Beci ka synuar të vërë në dukje disa dallime fonetike që kanë dialektet me gjuhën letrare. Me gjithë synimin e autorit për të bërë një përqasje të dialekteve me gjuhën letrare në lëmin e sistemit fonetik. veç ndonjë mendimi për ndonjë çështje të dhënë, në studim kanë dalë si trajtime të veçanta e në vetvete çështjet për dialektet dhe çështjet për gjuhën letrare. Përveç kësaj, duke u nisur nga mendimi i vet se *përcaktimi i modeleve të sistemeve të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve të dialekteve bashkë me shtrirjen e tyre është vështirë të jepet, sepse kanë nevojë të argumentohen më tej me të dhëna konkrete nga të folmet*, nuk jep modele të këtilla me arealet e tyre veç atij të së folmes së Shkodrës (qytetit), të cilin, në kundërshtim edhe me mendimin e shprehur prej tij dhe gjithashtu më kundërshtim me realitetin gjuhësor, e paraqet edhe si model *të shqipes së Vriut.* Çështjet e tjera që jepen për veçoritë fonetike të të folmeve janë dukuri të pjesshme e të shkëputura të sistemit të fonemave të dialekteve e të

168. R,Jakobson, *Sur la théorie des affinitées phonologiques entre les ! ang ues* Selected Writings, I, 1962, f. 244.
169. N.S. Troubetzkoy, *Principes de phonologie,* Paris, 1949,
170. V.Polak, *Sytèmes vocaliques en albanais,* në «Studi si cercetări kinguistice», 3, 1960, f.
171. W.Cimohowski, *Le dialecte de Dushmani,* Poznan, 1951, f. 27,
172. A.Dodi, *vep. cit,* f. 146.
173. R.Ismajli, *vep. cit.* f. 369.

të folmeve, si korrelacione e kundërvënie fonemash, njësi fonematike, realizime fonetike të zanoreve e të bashkëtingëlloreve etj., të cilat janë trajtuar në studime të mëparshme për dialektet ose për gjuhën shqipe në përgjithësi.

KRITERET E KLASIFIKIMIT TË DALLIMEVE DIALEKTORE FONETIKE

4.2.1. Ky kapitull i sistemit fonologjik ka më tepër karakterin e një punimi rezlltativ, ai është një punim përgjithësues për fonetikën e dialekteve të gjuhës shqipe. Studimi i anës fonetike të dialekteve këtu do të bëhet me metodën strukturore duke i analizuar në aspektin funksional veçoritë fonetike të të folmeve. Kjo mënyrë vështrimi bën që veçoritë dialektore të shihen më mirë në sistem, të shihen me vlerat e tyre funksionale brenda sistemeve përkatëse dialektore e jo të shkëputura dhe thjesht nga ana fonetike. Në këtë mënyrë del më mirë në dukje dhe në mënyrë më objektive shkalla e ndryshueshmërisë dhe shkalla e njësisë së dialekteve, dallimet fonetike të dialekteve dalin të kategorizuara sipas rëndësisë dhe vendit që kanë nga pikëpamja funksionale në sistem, dalin qartë ato tipare fonetike që lidhen me dallimet në sistemin e fonemave dhe ato që nuk e prekin sistemin. Përfundimet e analizës së bërë sipas kësaj metode kanë rëndësi të madhe edhe për të njohur më mirë raportin real objektiv të sotëm të dialekteve me gjuhën letrare shqipe, sepse kështu del në pah se baza e përbashkët e tyre është e madhe po të mënjanohen dallimet fonetike jofunksionale dhe shpjegohen më mirë arsyet pse gjuha letrare ka mundësi të pranojë elemente të shumta dialektore nga do që t'i vijnë e të mos e prekin sistemin e saj.

Për kategorizimin e dallimeve dialektore fonetike sipas kriterit funksional jemi mbështetur në parimet e N.S. Trubeckoit të shtruara në kapitullin «Fonologjia dhe gjeografia gjuhësore» të veprës «Principes de phonologie» (Paris, 1949). N. S.Trubetckoi i ndan në tri grupe dallimet fonetike të dialekteve; 1) *dallime fonologjike*, që lidhen me inventarin dhe funksionin e fonemave, 2) *dallime fonetike* që lidhen me variantet fonetike të fonemave dhe 3) *dallime fonetike etimologjike*, që lidhen me përbërjen fonematike të një fjale në dialekte të ndryshme. Si plotësues kemi përdorur edhe zbatimin e skemave dhe të formulave të A. Martinesë në krahasimin tipologjik të gjuhëve (A. Martinet, *Langue et fonction*, 1971). Ky kriter është zbatuar në analizën e sistemit të fonemave për të vënë në dukje njësinë dhe diferencat e të folmeve sipas numrit të klasave dhe të radhëve në sistemin e zanoreve e të bashkëtingëlloreve, duke shtuar në kllapa edhe numrin e përgjithshëm të fonemave.

Për ndryshinet fonetike të dialekteve gjatë historisë së tyre analiza është bërë mbi bazën e parimeve të fonologjisë historike të R. Jakobsonit që janë përfshirë në veprën e N.S. Trubetckoit «Pricipes de phonologie». Sipas këtyre parimeve gjithë ndryshimet fonetike që janë bërë trajtohen në funksion të sistemit fonologjik, duke parë pasojat që kanë sjellë ato në sistemin e fonemave, nëse janë të karakterit funksional apo janë thjesht ndryshime fonetike dhe etimologjike.

4.2.2. Dallimet dialektore të sistemit fonetik janë të llojeve të ndryshme dhe jo të një rëndësie nga ana funksionale për shkallën e largimit të dialekteve. Për të dalë më e qartë shkalla e njësisë dhe e ndryshueshmërisë së dialekteve të shqipes në këtë kapitull do t'i paraqitim dallimet fonetike sipas kategorive, duke i ndarë në dallime që lidhen me inventarin e fonemave, pra në dallime që kanë të folmet në numrin e fonemave zanore e bashkëtingëllore, në dallime që lidhen me organizimin e fonemave në sistem, në kundërvëniet dhe korrelacionet e tyre sipas veçorive të arealeve të ndryshme, në dallime që lidhen me mënyrën e funksionimit të fonemave (neutralizimet e kundërvënieve të tyre në kushte të caktuara), në dallime që lidhen vetëm me përshtatjen (modifikimin) e fonemave nën ndikimin e tingujve fqinjë ose të pozitës në fjalë dhe, së fundi, në dallimet që lidhen me përbërjen fonetike të një fjale në të folne të ndryshme, Nga pikëpamja funksionale më të rëndësishme prej këtyre dallimeve për ndarjen e dialekteve janë ato që lidhen me sistemin dhe me funksionin e fonemave dhe më pak të rëndësishme, si dallime që nuk lidhen me anën funksionale, janë ato që lidhen me variantet fonetike dhe ato që lidhen me përbërjen fonematike të një fjale në të folme të ndryshme.

Dallimet e llojit të fundit nuk lidhen me diferencat që kanë dialektet në inventar, në sistem dhe në funksionin e fonemave, por me ndryshimet fonetike që kanë shkaktuar në kohë të ndryshme zëvendësimin e një foneme ose të një grupi fonemash me një fonemë ose me një grup tjetër fonemash, që ka ekzistuar edhe më parë në ato të folme, pra nuk kemi të bëjmë në këtë rast me fonologjizime, me zhdukjen e një foneme nga sistemi, P.sh. diku gjejmë *val*, me fonemat *v*, *a*, *l*, kurse në të folme të tjera gjejmë *vaj*, me fonemat *v*, *a*, *j*. Në të folmet ku është bërë ndryshimi i *l*-së në j në raste si kjo fjalë (p.sh. *gojə* < *golə*, *mijə* < *milə* etj.), nuk ka lindur fonemë e re, sepse *j*-ja ka ekzistuar, ndryshimet kanë bërë vetëm që të pakësohet denduria e përdorimit të *l*-së dhe të shtohet ajo e *j*-së. Dallime të këtilla që lidhen me përbërjen fonetike të një fjale pasqyrojnë faza të ndryshme të zhvillimit të një procesi fonetik në boshtin kohor. Nga kjo pikëpamje disa të fomle pasqyrojnë gjendjen e hershme të përbërjes fonematike të fjalës, kurse disa të folme të tjera pasqyrojnë gjendjen më të re.

Si të gjitha ndryshimet e tjera në gjuhë, edhe këto mund të jenë zhvilluar në mënyrë të vetvetishme në një të folme, d.m.th. të jenë bërë për shkak të zhvillimit të brendshëm të gjuhës në një të folme, por mund të jenë edhe përfundim i një ndikimi nga jashtë, të jetë shtrirë tipari i një të folmeje në të folme të tjera për shkaqe të ndryshme shoqërore, historike, bile kjo rrugë është më e mundshme për këto lloje dallimesh dialektore.

Me funksione të fonemave kemi parasysh këmbimet e fonemave me njëra-tjetrën për shkak të normave të gjalla të sotme të shqiptimit në dialekte. Në kushte të caktuara fonetike e njëjta morfemë e një fjale del me përbërje fonematike tjetër, ndryshe nga përbërja që ka po sot në një kusht tjetër fonetik, p.sh. *elbi* → *elp* ku shihet këmbimi i bashkëtingëllores së zëshme *b* me bashkëtingëlloren gjegjëse të shurdhët *p* në një pozitë fundore absolute të fjalës. Në këto raste nuk ka rrugë tjetër zgjedhjeje për shqiptimin e falës. Këtu bëhen ndryshime fonetike që i kalojnë kufijtë e fonemës, kalohet nga një fonemë në tjetrën, nuk ndodhin modifikime fonetike të fonemës brenda kufijve të saj.

Në kushte të këtilla fonetike, ku ndodhin këmbime fonemash, inventari del më i vogël në sistemin e pjesshëm të fonemave, sepse nuk realizohen njësitë e një serie të caktuar korrelative, p.sh., në një pozitë fundore absolute të fjalës nuk dalin bashkëtingëllret e zëshme, sepse këmbehen me gjegjëset e tyre të shurdhëta.

Në punimin tonë, në raste si këto, nuk do të pranojmë konceptin e *arkifonemës*, sepse një koncept i këtillë të bën të pranosh vetëm raporte fonemash të shkëputura nga vetë fonemat që ekzitojnë realisht në një tërësi tiparesh dalluese të përcaktuara e të pandashme.

Sipas konceptit të arkifonemës te *zok* «zog» del arkifonema *K*, e cila nuk përfaqëson fonemën *k* si njëra nga njësitë e çiftit korrelativ *k* ~ *g*, por diçka tjetër të abstraktuar, jo reale, që karakterizohet nga tërësia e tipareve relevante të të dyja fonemave të çiftit *k* ~ *g*. Fonema *g* (bashkëtingëllore e zëshme) nuk realizohet te *zok* «zog», *burk* «burg» etj., sepse në fund të fjalës ajo këmbehet me fonemën *k* (bashkëtingëllore gjegjëse e shurdhët), por duhet pranuar se në këto kushte fonetike ekziston realisht vetëm fonema *k* e jo një arkifonemë *K*. Është e vërtetë se në raste të këtilla fonema *k* nuk formon kundërvënie njëgjymtyrëshe me fonemën *g*, sepse kjo e fundit nuk realizohet në fund të fjalës, por, megjithatë, *k*-ja hyn në kundërvënie shumëgjymtyrëshe me fonemat bashkëtingëllore të shurdhëta, sonante etj., të cilat realizohen, ashtu si *k*-ja, në një pozitë fundore absolute, p.sh. *zok* «zog» dhe *zot* etj. Pra për raste si këto, ku nuk ekziston korrelacioni i zëshmërisë, do të pranojmë neutralizim kundërvënie sh të fonemave, por jo ekzistencën e arkifonemës.

A. SISTEMI I ZANOREVE

INVENTARI I FONEMAVE ZANORE

4.3.1. Përshkrimin e sistemit të fonemave zanore të të folmeve po e fillojmë me inventarin për të vënë në dukje së pari numrin e njësive të këytre fonemave, që kanë të folmet. Si për çdo anë tjetër të sistemit gjuhësor, edhe për inventarin e fonemave, për organizimin e tyre në sistem, për funksionin e tyre etj. paraqitja nuk do të bëhet veç e veç për çdo të folne, por sipas arealeve dialektore që formojnë një numër të folmesh me karakteristika të përbashkëta në secilën anë të sistemit të fonemave.

Në fillim po japim gjithë pasurinë e fonemave zanore të theksuara të dialekteve të gjuhës shqipe. Sigurisht, këtë e bëjmë me rrugë abstraksioni vetëm sa për të dhënë llojet dhe numrin e përgjithshëm të fonemave zanore të shqipes, sepse dihet se në të vërtetë ato nuk i gjejmë realisht të gjitha në çdo të folme, mbasi çdo e folme ka një sistem të përcaktuar e të ndryshëm nga ai i të folmeve të tjera që dallohen prej saj. Diferencat në inventarin e fonemave zanore midis të folmeve mund të jenë të vogla, por ka raste që janë edhe shumë të mëdha. Për disa të folme, në krahasim me të folme të tjera, diferenca arrin edhe në një raport gati një me tre.

Tërë variantet dialektore të gjuhës shqipe kanë një inventar të përbashkët prej 23 fonemash zanore, që hyjnë në tri seri të ndryshme të ndara në këtë mënyrë: 8 prej tyre janë zanore gojore të shkurtra, 9 janë zanore gojore të gjata dhe 6 zanore hundore (të gjata):

të shkurtra /ĭ/, /ў/, /ø̆/, /ĕ/, /ă/, /ŏ/, /ŭ/, /ə̆/,
gojore

të gjata /i:/, /y:/. /ø:/, /e:/, /æ:/, /a:/, /o:/, /u:/, /ə:/, *hundore* /ĩ/, /ỹ/, /ø̃/, /ẽ/, /ã/, /ũ/,

Nga ky inventar i përgjithshëm disa të folme kanë një numër të caktuar zanoresh vetëm të një serie, p.sh. vetëm të serisë gojore të shkurtra, disa të tjera kanë nga të dyja seritë e zanoreve gojore, të shkurtra dhe të gjata, kurse disa të tjera kanë nga të tri seritë: gojore të shkurtra e të gjata, kanë edhe hundore (shih, § 4.3.3., § 4.3.4., § 4.3.5)

Çdo areal dialektor ka një inventar të caktuar fonemash zanore, cili në asnjë rast nuk është i barabartë me numrin maksimal të inventarit të përgjithshëm të të dy dialekteve, ai gjtihmonë është më i vogël. Areali me inventarin minimal ka gjashtë fonema zanore, kurse areali me inventarin maksimal ka nëntëmbëdhjetë fonema zanore, të tjerët kanë një inventar që lëviz nga shtatë deri në shtatëmbëdhjetë njësi fonematike.

Për të vënë në dukje dallimet dialektore sipas inventarit të fonemave zanore po japim këtu me radhë arealet e ndryshme duke nisur nga areali që ka inventarin më të vogël e duke përfunduar me atë që ka inventarin më të madh.

Areali i parë përfshin një zonë të vogël të toskërishtes ku gjenden disa të folme në kufi të Labërisë së mirëfilltë, si e folmja e zonës së Kardhiqit, e folmja e Gjirokastërs, e folmja e Lunxhërisë, e folmja e Libohovës, e folmja e Nepravishtës dhe e folmja e Delvinës (për këtë areal dhe për arealet e tjera sipas inventarit të fonemave zanore shih hartën nr. 6). Këto të folme kanë vetëm një seri fonemash zanore gojore, ashtu si gjuha letrare, por duke qenë se nuk e kanë në sistemin e tyre zanoren *y* të radhës së mbyllur[174], inventari i tyre del me gjashtë njësi fonemash zanore, del me një njësi më pak se ai i gjuhës letrare.

/i e a o u ə/

Po kështu, me gjashtë fonema është inventari edhe në të folmet kalimatre të pjesës veriore të fushës së Lushnjës dhe të krahinës së Sulovës, por aty ekziston /y/-ja dhe mungon /ə/-ja:

/i y e a o u/

Sistemi me një seri prej shtatë zanoresh gojore të shkurtra, sistemi që është karateristik edhe për gjuhën letrare, del në një trevë të madhe të dialektit jugor të gjuhës shqipe:

/i y e a o u ə/

Ky areal, të cilin po e shënojmë me nr. 2. përfshin një numër të madh të folmesh që fillojnë afërsisht nga Shkumbini në Veri dhe

174. M.Totoni, *Vëzhgime rreth së folmes së qytetit të Gjirokastërs në* «SF», 1, 1966, f. 86.

që shkojnë në Jug deri në kufijtë e Kurveleshit e të Gjirokastrës[175], Aty hynë të folmet e Myzeqesë, Mallakastrës, Beratit, Skraparitë Përmetit, Tepelenës, sidomos të Tepelenës toske), të Kolonjës, ts Vakëfeve, të Korçës bashkë me fushën e saj, të Devollit, të Prespës matanë kufirit, të Oparit, të Gorës, Mokrës, Pogradecit, të qytetit t, Vlorës (shtresa e hershme e popullsisë), të fshatrave të saj në Verie në Lindje dhe në Jug (duke përjashtuar Kurveleshin), përfshihet folmja e Zagorisë dhe e folmja kalimtare e Vërçës.

Në shumë të folme të këtij areali gjejmë edhe digftongjet *ua*, *ye*, *ie*, Të folmet që kanë diftongje të këtilla ndodhen në pjesën veriore të këtij areali, ato zënë pjesën më të madhe të toskërishtes veriore, zënë gati të gjithë territorin e këtij nëndialekti, po të veçojmë zonën e Përmetit dhe pjesër'sht edhe atë të Kolonjës e të Vakëfeve. Diftongjet *ua* *ye* dhe *ie* dalin në çdo pozicion në të folmen e Devollit dhe në të folmet e një blloku të vogël malor ndërmjet Osumit e Vjosës: në pjesën jugore të Skraparit, në Dëshnicë dhe në Tepelenën toske. Në të gjitha të folmet e tjera, duke përfshirë edhe të folmen e qytetit të Vlorës e të fshatrave në veri e në verilindje të tij, këto diftongje dalin vetëm me rrokje të brendshme, të hapura ose të mbyllura, nuk dalin me rrokje të hapur fundore: *duar*, *gruaja* dhe *dua*, *dyer*, *fyell* dhe *u θye*; mieł, dieł dhe *bie* ose *bije*.

Duke qenë se këto diftongje në shumë të folme nuk dalin në të gjitha pozicionet dhe në Devoll, në Skrapar, në Dëshnicë e në Tepelenë dalin fakultativisht edhe togjet *ua*, *ye*, *ie*, nuk do t'i interpretojmë si diftogje njëfonemëshe, por si diftongje fonetike, elementet përbërëse të të cilave funksionojnë si dy fonema të veçanta: *u* dhe *a*, *y* dhe *e* dhe *i* dhe *e*.

Areali nr. 3 karakterizohet nga një sistem me dy seri fonemash gojore, një palë janë të shkurtëra dhe një palë të gjata. Të folmet e këtij areali kanë dyfishin e fonemave zanore të arealit nr. 1, gjithsej dymbëdhjetë fonema, nga gjashtë për çdo seri, sepse edhe këtu nuk ekziston fonema *y*:

ĭ ĕ ă ŏ ŭ ə̆
i: e: a: o: u: ə:

175. J.Gjinari, *Të folmet e Myzeqesë*, në «BUSh, SShSh», 4, 1958, Vërejtje mbi të folmet e krahinës së Mallakastrës, në «BUSh, SShSh», 3, 1962. *E folmja e qyeetit të Bertit*, në «BUSh, SShSh», 1, 1957; E folmja e Skraparit, në «BUSh, SShSh», 1, 1957; *Mbi të folmen e Devollit*, në «BUSh, SShSh», 4, 1960, S. Floqi, *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, në «BUSh, SShSh», 3, 1958; J.Thomaj, *E folmja e katundit Seman*, në «BUSH, SSHSH», 13,1961, M. Totoni *E folmja e Zagorisë*, në «BUSh, SShSh» 1, 1962; Q. Haxhihasani, Një vështrim mbi të folmen e krahinës së Sulovës, në «BUSh, SShSh», 3. 1955.

Ky areal shtrihet në pjesën jugore të toskërishtes, përfshin të folmet e Kurveleshit, të Bregdetit, të Sarandës, të Mursisë, të Konispolit dhe të pjesës tjetër të Çamërisë që vazhdon në Greqi deri në gjirin e Prevezës[176].

Në pjesën veriore të këtij areali, pjesërisht në Kurveleshin e Sipërm dhe në anët e Matogjinit (Shushicës), inventari rritet me fonemat *y* dhe *y*:

ɪ ʏ ɛ ɑ ɔ ʊ ə

i: y: e: a: o: u: ə: .

Pa kaluar ende në krahun e djathtë të Shkumbinit nis një trevë tjetër dialektore e shqipes, e dallueshme nga toskërishtja. Ajo fillon me të folmet kalimtare të Darësisë së Peqinit, të Dumresë, të Shpatit, të Polisit e Bërzeshtës dhe vazhdon me të folmet e gegërishtes duke shkuar deri në skajin verior të saj. Arealet e kësaj treve kanë një inventar me një numër më të madh fonemash zanore, sepse aty përveç serive të shkurta e të gjata të zanoreve gojore, ekziston edhe seria e zanoreve hundore. Të folmet e këtyre arealeve dallohen prej toskërishtes dhe gjuhës letrare edhe për shkak se nuk e kanë zanoren *ə* në sistemin e fonemave të theksuara.

Në këtë trevë dallohen katër areale, që nuk kanë diferenca të mëdha në inventaret e tyre të fonemave zanore.

Një areal me nga gjashtë njësi për çdo seri të zanoreve gojore dhe me pesë njësi për zanoret hundore, gjithsej shtatëmbëdhjetë fonema (areali nr. 4) formojnë të folmet kalimtare, që janë gjeografikisht më pranë gegërishtes (ato të Dumresë, të Shpatit, të Darësisë së Peiqnit), të folmet e Shqipërisë së Mesme, d.m.th. ato të anëve të Elbasanit e të Librazhdit, të Tiranës, të Durrësit, të Kavajës e të Peqinit, dhe të folmet e gegërishtes verilindore, si të folmet e rrethit të Tropojës, ato të pjesës veriore të Pukës, e fomja e Hasit,

176. M.Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshitm* në «Dialektologjia shqiptare» I, 1971; *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në «SF», 1, 1964; *Vëzhgome për të folmen e Muhzinës*, në «SF» 2, 1965; Q. Haxhihasani, *Vështrimi i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, «Dialektologjia shqiptare» I, 1971.

e fomja e Krumës dhe gjithë të fomet e Kosovës[177]. Është me interes të vihet në dukje se ky areal përbëhet nga dy zona që nuk kanë vijimësi territoriale, ato ndërpriten nga një areal i gegërishtes qendrore. Sigurisht ndërmjet të folmeve të këtij areali ka edhe diferenca që lidhen me anën fonetike, me timbret e disa zanoreve, p.sh., ndryshe nga të folmet e anës lindore të Shqipërisë së Mesme, në të folmet e tjera *a*-ja është e prapme dhe me variacione labializimi, që arrijnë deri sa e afrojnë me *o*-në në disa të folme verilindore: po ashtu *ë*-ja në gegërishten veriore është e hapur, që shkon deri në *ę*; zanoret e shkurtra në Verilindje janë më të hapura se në Shqipëri të Mesme dhe *a*-ja e gjatë është më e prapme. Me gjithë diferencat fonetike që vunë në dukje, të gjitha të folmet e këtij areali i bashkon numri i njëjtë i njësive fonematike dhe tipi i njëjtë i zanoreve sipas serive:

/i y e a o u/

/i: y: e: a: o: u:/

/ĩ ỹ ẽ ã ũ/

Në një të folme të gegërishtes verilindore, në të folmen e Llapit inventari është me katërmbëdhjetë fonema, për shkak se aty seria e zanoreve hundore është redukuar [178] duke mbetur vetëm fonemat ã dhe ẽ (shih për këtë § 4.3.5).

Me arealin nr. 4 do të bënin një bllok edhe të folmet e gegërishtes

---

177. M. Çeliku, *Vërejte mbi të folmen e Dumresë*, në «BUSh, SShSh», 2, 1963; *Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*, në «SF» 4, 1965; E folmja kaimtare e Shpatit, në «Dialektologjia shqiptare» I, 1971; *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës*, në «SF» 2, 1966; *Të folmet e Kavajës*, në «Dialektologjia shqiptare», II, 1974; Xh.Gosturani, *Struktura gramat(ore e së folmes së qytetit të Elbasanit*, tezë disertacioni për gradën «Kandidat i shkencave filologjike»; I.Ajetim *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovit*, në «GjA» 1, 1961; A.Mulaku, *Govor Albanaca Bajgorske Salje*, Pristina, 1968, H. Agani, *Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të Kujunxhiçit* në «Përparimi» 6, 1977, 2, 1977; L.Mulaku— M.Mardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, në «GjA», 2, 1972m 2, 1973; M.Halimi, *Disa tipare të së folmes së Moravës së Epërme*, në «GjA» 1.2, 1970; *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, në «GjA», 2, 1972; F. Raka, *E folmja e qytëzës së Kaçanikut*, në «Studime gjuhësore» I (Dialektologjia), Prishtinë 10978 J.Gjinari, *V'ërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethi të Tropojës*, në «BUSh, SShSh» 4, 1963; E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit* në «SF» 3, 1964; Xh.Gosturani, *e folmja e Hasit*, në «Dialektologjia shqiptare», III 1975; *E folmja e Çeremit dhe e Valbonës (rrethi i Ttopojës)*, në «Dialektologjia shqiptare» IV, 1982.

178. J. Gjinari, *Zanoret hundore të gegërishtes dhe ë-ja e theksuar e toskërishtes*, në «SF», 3, 1981, f. 50.

veriperëndimore [179] po të mos kishin dy fonema më tepër në serinë gojoreve të gjata. Për këtë arsye këto të folme formojnë një areal të veçantë, arealin nr. 5, që ka një inventar me nëntëmbëdhjetë fonema zanore, nga të cilat gjashtë bëjnë pjesë më serinë e gojoreve të shkurtra, tetë në serinë e të gjatave dhe pesë në serinë e hundoreve;

/ĭ ў ĕ ă ŏ ŭ/
/i: y: ø: e: æ: a: o: u:/
/ĩ ỹ ẽ ã ũ/

Këtu funksionojnë si fonema zanoret æ: dhe ø: në fjalët ku kanë ardhur prej diftongjeve *oe* (*voe* > *vø*: etj.) dhe *ae* (θ*ae* > θæ: etj.).[180] A. Dodi, në artikullin *Rreth sistemit vokalik të shqipes*[181], për shkak të të dhënave jo të mjaftueshme të atëhershme, ka menduar se këto dy fonema janë karakteristike për të gjithë gegërishten veriore, por rëndësi ka se ai i veçoi ato si fonema të serisë së gojoreve të gjata.

Në studime të ndryshme përshkruese, që janë botuar kohë pas kohe nëserinë e të gjatave, në rastet ku æ: vjen nga *ae*, është shënuar një ɛ:[182], kështu është shënuar për Malësinë e Madhe, për Krajën, Shkrelin, Bregun e Bunës e ndonjë tjetër.

Nga të dhënat e «Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe» del se æ: ose ɛ:, që vijnë nga *ae*, ka edhe në verilindje: në rrethin e Tropojës, në pjesën veriore të rrethit të Pukës, në pjesën perëndimore dhe jugore të rrethit të Kukësit, në anët e Gjakovës, Pejës, Rugovës, Istogut, Drenicës dhe në anët e Mitrovicës; po ashtu del se æ: ose ɛ: ka edhe në Shqipërinë e Mesme: në anët e Krujës, Prezës, Tiranës,

---

179. Gj.Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*, në «SF», 2, 1967, f.35-59. 3. 1967, f. 47-66; *E folmja e Hotit*, në «Dialektologjia shqipIare» II, 1974; *E folmja e Kelmendit*, në «Dialektologjia shqiptare» III, 1975; *E folmja e Ranxave të Mbishkodrës*, në «Dialektologjia shqipatreO IV, 1982; *E folmja e qytetit të Lexhës*, tezë disertacioni për gradëb shkencore «Kandidat i shk. filologjike»: J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës* në «Dialektologjia shqiptare» I 1971; B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, në «Dialektoligjia shhqiptare II 1971
180. J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975, f. 64.67.
181. A.Dodi, *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1972, f. 25.
182. Shih më hollësisht Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*, në)SF» 2, 1967, f. 44; *Vëzhgime rreth të folmeve të malësorëve të Bregut të Matës të Ishullit të Shëngjinit*, në «Lissus», Tiranë, 1967, f. 152-170; *Disa veçori të të folmeve shqipe në mal të Zi*, në «SF», 3, 1982, f. 193; J.Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, në «Dialektologjia shqiptare» I, 1971, f. 342, dhe B. Beci *E folmja e Shkrelit*,në «Dialektologjia shqiptare» I. 1971, f. 286.

Peqinit, Klosit të Matit dhe Zerqanit. Tingujt æ: dhe ɛ:janë shumë të afërt në timbër, aq sa dallohen me vështirësi edhe nga një vesh i stërvtur dhe herë-herë në punime dialektologjike janë dhënë njëra për tjetrën, sidomos [ɛ:]-ja për [æ:]-në. Duke u nisur nga kjo, ne kemi menduar që të pranojmë këtu si veçori të arealit të përmendur një fonemë /æ:/, si një zanore e ngritjes së ulët e pëparme, që është në kundërvënie me /e:/-në dhe me /a:/- në. Në të folmet e këtij areali ku ka /ɛ:/ sistemi është gjithashtu katërkëndësh dhe /ɛ:/-ja zë po atë vend në sistem si edhe /æ:/ -ja.

Në dialektin verior dy areale të tjera formojnë të folmet e gegërishtes qendrore, ku përfshihen të folmet e Krujës, të Mirditës, të Peshkopisë, të Lumës, të Dibrës, të Gostivarit e të Tetovës, të Krushovës e të Shkupit, të Malit të Zi të Shkupit dhe të Kumanovës.

Të folmet e këtij grupi janë larguar disi prej të folmeve të tjera të gjuhës shqipe për shkak se aty kanë pësuar ndryshime fonetike zanoret *i*, *u* dhe *y*. Diftongimi i zanoreve *i* në *e͡i*, *ə͡i*, *a͡i* ose *o͡i* dhe diftongimi i *u*-së në *o͡u*, ose *a͡u* kanë sjellë vetëm diferenca fonetike, diferenca që nuk kane prekur sistemin e fonemave të këtyre të folmeve (shih më hollësisht § 4.17.1). Ky është një tipar dallues thjesht fonetik i të folmeve të gegërisntes qëndrore, që nuk i veçon nga pikëpamja fonologjike prej të folmeve të tjera të gegërishtes. Dallimet fonologjike, megjithëse jo të një skkalle të rëndësishme, kanë ardhur më tepër për shkak të ndryshimeve që ka pësuar zanorja y. Reflekset e ndryshme të zanores *y* e ndajnë në dy areale zonën e këtij grupi të folmesh, njëri areal shtrihet në perëndim, kurse tjetri në lindje, ndahen përafërsisht te vija që formon rrjedha e Drinit të Zi.

Areali perëndimor[183], i cili në rend vjen me numrin 6, në të vërtetë nuk ka asnjë dallim me arealin nr. 4 për numrin e njësive të inventarit të fonemave, sepse aty në përgjithësi zanorja *y* vetëm se është kthyer nga një zanore e mbyllur në një zanore të radhës së mesme për nga shkalla e hapjes, ka dhënë ø, pra është raujtur si fonemë:

/ĭ ĕ ø̆ ă ŏ ŭ/
/i: e: ø: a: o: u:/
/ĩ ẽ ø̃ ã ũ/

83. B.Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, në «BUSh, SShSh», 2 1964, 3-3, 1963; *E folmja e Mirditës*, në «Dialektologjia shqiptare» IV, 1982; J. Gjinari. *Vëzhgime mbi të folmet e Krujës dhe të Malësisë së Krujës*, në «SF» e2 e 3 1966; Q.Haxhihasani, *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*, në «SF» 4, 1963, Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e Krahinës së Pukës*, , në «Diaktologjia shqiptare» II, 1974.

Pjesa lindore formon arealin nr. 7, i cili dallohet, sepse ka katërmbëdhjetë fonema, nga një fonemë më pak për çdo seri, meqë aty ka dalë jashtë sistemit fonema /y/, e cila është zëvendësuar nga /i/-ja[184].

/i e a o u/
/i: e: a: o: u:/
/ĩ ẽ ã õ ũ/

Brenda këtij areali ka ndonjë të folme si ajo e Dibrës[185] ku mungon fare seria e fonemave zanore hundore, inventari në këtë të folme është më i vogli në gjithë gegërishten, ka vetëm dhjetë fonema zanore: pesë gojore të shkurtra dhe pesë gojore të gjata. Një gjendje e këtillë, pa serinë e zanoreve hundore, ekziston edhe në të folmen e Ulqinit[186] në veriperëndim, vetëm se ajo e folme, në përputhje me arealin ku bën pjesë, ka në inventarin e vet gjashtë fonema zanore gojore të shkurtra dhe tetë të gjata (shih arealin nr. 5).

---

184. B. Beci, *E folmja e peç — e — Dardhës së Dibrës*, në «SF»m, 4, 1964 dhe 5· 1965; *E folmja e Luzinës së Dibrës*, në «Dialektogjia shqiptare» I, 1974;. *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*, në «SF», 3, 1972, f.90; Sh.Hoxha-*Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-Kalisit të Lumës*, në «Duialektologjia shqiptare», III, f. 142; R.Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së fo) lmes shqipe të rrethit të Tetovës*, në «Studim e gjuhësore» (Dialektologjia I, Prishtinë, 1978.
185. E. Çabej, *Fonetika historike e shqipes* II, Tiranë, 1959, f.59;
186. O. Myderrizi, *Fjalori shqip-turqisht i H.Ali Ulqinakut*, në «BUSh, SShSh». 3. 1961, f. 124.

Këtu poshtë po japim në një hartë arealet dialektore sipas inventarit të fonemave zanore.



Harta nr 5

Shënim: atje ku në serinë e të gjatave gojore ke edhe /æ:/, në arealin përkatës janë shtuar edhe disa vija vertikale të ndërprera.

4.3.2. Dallimet e dialekteve në sistemin fonetik duhet të vështrohen nga disa anë që të dalë më e qartë shkalla e dallimit të tyre në këtë sferë të gjuhës. Ajo që ka më tepër rëndësi në këtë rast është pamja e sistemit të fonemave, organizimi i fonnemave në sistem.

Në paragrafin e parë, duke folur për dallimet në inventarin e fonemave zanore të theksuara, u vu në dukje shkurtazi se disa të folme kanë një seri fonemash zanore, serinë e zanoreve gojore të shkurtra, disa të tjera kanë edhe serinë e zanoreve gojore të gjata, kurse disa, veç këtyre dy serive, kanë edhe serinë e zanoreve hundore. Para se të flasim për secilin nga këto sisteme të marra veçmas, është e nevojshme që në fillim të vihen në dukje në përgjithësi dallimet sipas korrelacioneve në të cilat hyjnë fonemat e të tri serive të marra së bashku.

Nga kjo pikëpamje shihet se në disa të folme të gjuhës shqipe fonemat zanore hyjnë edhe në korrelacion sipas tiparit të sasisë (*të gjata~ të shkurtra*), kurse në disa të tjera, veç korrelacionit sipas tiparit të sasisë, hyjnë edhe në korrelacion sipas tiparit të ngjyrimit, ose më mirë sipas tiparit të rezonatorit (*hundore ~ jo hundore*).

Dallimet sipas këtyre korrelacioneve i ndajnë të folmet e gjuhës shqipe në tri areale, ndryshe nga dallimet sipas inventarit të fonemave, që i ndanin ato në shtatë areale. Njërin areal, arealin nr. 1, e formojnë ato të folme ku mungojnë fare korrelacione të këtilla, sepse ato kanë vetëm një seri zanoresh gojore. Ky areal përfshin të folmet e dialekti jugor të arealeve nr. 1 e nr. 2 sipas dallimeve në inventarin e fonemave. Siç dihet, korrelacionet e sasisë dhe të rezonatorit mungojnë edhe në gjuhën letrare. Areali nr. 2 zë një pozicion skajor në pjesën jugore të toskërishtes, shtrihet në territorin e të folemeve të labërishtes së mirëfilltë dhe të çamërishtes, të cilat kanë si tipar kundërvënien e fonemave zanore sipas korrelacionit të sasisë (*të shkurtra~ të gjata*). Me këtë areal duhen bashkuar edhe të folmet e Dibrës e të Ulqinit, në të cilat, ndryshe nga të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes, zanoret hyjnë në kundërvënie vetëm sipas tiparit të sasisë.

Arealin nr. 3 e formojnë përgjithësisht të folmet e gegërishtes dhe disa të folme kalimtare, d.m.th. të folmet që përfshihen në arearealet nr. 4, 5, 6 dhe 7 të dallimeve sipas inventarit të fonemave zanore. Të folmet e këtij areali kanë si tipar kundërvënien e zanoreve sipas të dy korrelacioneve, edhe sipas korrelacionit të sasisë, edhe sipas atij të rezonatorit. Ky është areal që zë një hapësirë më të madhe në truallin e gjuhës shqipe.

Shtrirjen gjeografike të arealeve dialektore të gjuhës shqipe që

ndahen sipas pranisë ose mungesës së korrelacioneve të sasisë dhe të rezonatorit po e japim në hartën e mëposhtme:



Harta nr 7

Në hartën e mësipërme shihet se sistemi i zanoreve të shkurtra është i përbashkët për të tria arealet dialektore (dhe për gjuhën letrare), sistemi i të gjatave është karakteristik për arealet nr. 2 dhe nr. 3, kurse sistemi i hundoreve del vetëm në arealin nr. 3.

Për të dhënë një pamje sa më plotë të sistemit të fonemave në

dialektet e gjuhës shqipe është e domosdoshme të nxirren tiparet e përbashkëta dhe tiparet dalluese të dialekteve e të folmeve për secilin sistem zanoresh, duke e marrë çdonjërin prej tyre veçmas për të parë se si janë organizuar fonemat përbërëse të tyre.

Për të parë marrëdhëniet e fonemave marrim kryesisht zanoret e rrokjeve të theksuara, prej të patheksuarave do të japim këtu vetëm zanoret gojore të shkurtra, do t'i lemë mënjanë zanoret gojore të gjata dhe zanoret hundore, sepse këto në rrokje të patheksuar, për të mos thënë se nuk shfaqen fare, dalin me një denduri kaq të vogël, sa nuk është për t'u marrë në vështrim.

4.3.3. **Zanoret e theksuara gojore të shkurtra.** — Së pari është për t'u theksuar se këto zanore, ashtu si edhe në gjuhën letrare, formojnë kudo një sistem trekëndësh, pavarësisht nga numri i njësive që ka kjo në të folme të ndryshme, (gjithkund zanoret e kësaj seri ndahen në tri radhë sipas shkallës së hapjes: të hapjes së madhe, të hapjes së mesme dhe të hapjes së vogël ose të hapura, gjysmë të hapura dhe të mbyllura, gjithashtu në të gjitha të folmet ato ndahen në tri klasë sipas lëvizjes horizontale që bën gjuha për artikulimin e tyre: në klasën e përparme, në klasën e mesme dhe në klasën e prapme. Pavarësisht nga numri jo i njëjtë i zanoreve të klasës së mesme, nëpër të forlme të ndryshme (ka vetëm *a*-në një e folmja, ka *a*-në dhe *y*-në ose *ø*-në, apo ka *a*-në, *ə*-në dhe *y*-në), zanorja *a* nuk ka gjithkund një fonemë tjetër që të hyjë në kundërvënie të dyanshme me të sipas tiparit të klasës. Për zanoret e tjera të klasës së mesme (*y*-ja, *ø*-ja, *ə*-ja) atje ku ekzistojnë në sistem (diku vetëm njëra e diku dy prej tyre) nuk është pertinent tipari i klasës, sepse nuk ekziston edhe një klasë tjetër e mesme; për këtë shkak ato bashkohen përgjithësisht me zanoret e përparme *i* dhe *e*, të cilat me zanoret e prapme *u* dhe *o* futen në korrelacion vetëm sipas tiparit të klasës, pra si të përparme e të pra-pme, sepse për këto të fundit nuk është tipar pertinent karakteri buzor, meqë nuk ekziston një klasë e mesme jobuzore më e prapme se klasa që formojnë *y-ja*, *ø*-ja dhe *ə*-ja. Në të folmet ku ekziston *y*-ja, kjo hyn në kundërvënie me zanoren e përparme *i* sipas tiparit të buzorësisë: njëra buzore (*y*), tjetra jobuzore (*i*); atje ku ekziston *ø*-ja, kjo hyn në kundërvënie me *e*-në po sipas tiparit të buzorësisë: njëra buzore (*ø*) e tjetra jobuzore (*e*), atje ku ekziston *ə*-ja, kjo hyn në kundërvënie me *a*-në sipas tiparit të radhës: njëra e hapur (*a*) e tjetra e mbyllur (*ə*).

Në qoftë se në mënyrë të përgjithshme do të jepnim tiparet e përbashkëta të sistemit të fonemeve zanore të shkurtra për dialektet

dhe për gjuhën letrare të marra së bashku, ato do të paraqiteshin me një tabelë të këtillë:



Në sistemin e zanoreve të shkurtra të dialekteve, veç këtyre tipareve të përbashkëta e shumë të rëndësishme nga pikëpamja fonologjike, vërehen edhe dallime të pjesshme për zanore të veçanta, dallime që nuk lidhen me organizimin e fonemave në sistemin trekëndësh dhe as me korrelacionet në të cilat hyjnë ato. Në këtë rast marrim parasysh vetëm praninë ose mungesën e zanoreve *y*, *ø*, *ə* si zanore të klasës së mesme, pa llogaritur vendin që zënë ato në sistemin sipas tiparit dallues (korrelativ) të buzorësisë.

Po të nisemi nga dallimet e pjesshme që kanë të folmet e shqipes në sistemin e zanoreve gojore të shkurtra, ndahen në katër areale, dy nga të cilat kanë një shtrirje gjeografike të madhe, kurse dy të tjerat zënë një hapësirë shumë të vogël.

Arealin nr. 1 e formojnë të folmet e toskërishtes veriore dhe të Zagorisë, ku gjejmë një sistem trekëndësh me shtatë zanore:

ĭ ў ŭ

ə̆

ĕ ŏ

ă

Këtu klasa e të mesmeve përfaqësohet nga zanoret *y* dhe *ə* Zanorja *y*, si zanore e përparme buzore hyn në kundërvënie me zanoren e përparme *i* sipas tipit të buzorësisë: *i* (jobuzore) ~ *y* (buzore).

Të folmet e arealit nr. 2 dallohen nga të folmet e arealit nr. 1, ngaqë në sistemin e tyre nuk bën pjesë zanorja *ə*. Në shumicën e të folmeve të këtij areali klasa e mesme përfaqësohet nga zanorja buzore e shkallës më të vogël të hapjes, nga zanorja e mbyllur buzore *y*, kurse në një numër të vogël të folmesh ajo përfaqësohet nga një zanore tjetër po buzore, por që nga shkalla e hapjes është e radhës së gjysmë të hapurave.



Ky areal shtrihet në të folmet kalimtare, në gjithë Shqipërinë e Mesme, në zonën perëndimore të gegërishtes qendrore (zona e arealit nr. 6 të ndarjes sipas inventarit), vazhdon në veri në gjithë trevën e gegërishtes veriperëndimore dhe në trevën e gegërishtes verilindore.

Në këtë areal dallohen disi të folmet e zonës perëndimore të gegërishtes qendrore, sepse aty klasa e mesme nuk përfaqësohet nga *y*-ja, por nga një zanore, e cila është gjithashtu e përparme buzore, vetëm se për nga shkalla e hapjes është pothuaj e mesme [ø] dhe hyn në kundërvënie me zanoren *e* sipas tiparit të buzorësisë.

Areali nr. 3 shtrihet në skajin jugor të toskërishtes. Klasa e mesme e zanoreve këtu përfaqësohet vetëm nga *ə*-ja.

Në qoftë se kjo zanore do të konsiderohet e përparme, atëhe

Në qoftë se kjo zanore do të konsiderohet e përparme, atëherre nuk ka kundërvënie me zanoren e përparme të ngritjes së mesme *e*, por në qoftë se do të konsiderohet si zanore e prapme e klasës së mesme, meqënëse ajo këtu artikulohet 3, sidomos në Labëri, në Bregdet herë-herë edhe si ʌ, duhet thënë se ajo hyn në kundërvënue me zanoren *o* sipas tiparit dallues të buzorësisë, si dy zanore të prapme, njëra prej të cilave është buzore (*o*-ja) dhe tjetra jobuzore (3-ja):



Një areal më vete përbëjnë të folmet lindore të gegërishtes qendrore, të cilat kanë një sistem trekëndësh me pesë zanore ku klasa e mesme, me përjashtim të *a*-së, e cila qëndron në kufij të sistemit, nuk ka asnjë zanore tjetër:



Siç shihet, sistemi i zanoreve të këtij areali, duke mos pasur fonemën /*y*/, i qëndron më afër sistemit të toskërishtes jugore (areali nr. 3). Veç kësaj të folmet e këtij areali, së bashku me të folmet perëndimore të gegërishtes qendrore, zënë një vend të veçantë në gjuhën shqipe për faktin se aty zanoret e mbyllura *i* dhe *u* shpesh realizohen fonetikisht edhe si diftongje në disa kushte fonetike dhe në raste të caktuara: *i*-ja del me variantet *e̯i̯*, *ə̯i̯*, *a̯i̯*, *o̯i̯* etj. (duke u shfaqur në çdo të folme dy ose tri nga këto diftongje si variante fakultative; *me̯i̯k* «mik», *pə̯i* «pi» etj), kurse *u*-ja del me variantet *a̯u̯*, *o̯u̯* (varianti i parë është më i përhapur): *na̯u̯k* «nuk», *na̯u̯se* «nuse» etj. Ndërsa diftongjet *a̯u̯*, *o̯u̯* të dala nga *u*-ja janë karakteristike vetëm për arealin nr. 4 dhe për të folmen e Krujës, diftongjet *e̯i̯*, *a̯i̯* etj., që lidhen me *i*-në, kanë një shtrirje më të madhe gjeografike, dalin në të gjitha të folmet e gegërishtes qendrore, pra edhe në ato të folme ku ka /*ø*/ për fenomën /*y*/ të tipit të përbashkët.

Përcaktimi që u bënë këtyre diftongjeve si realizime fonetike të fonemave / *i* / dhe / *u* / mund të mos jetë shumë i lumtur, sepse ne jemi mbështetur në analizën e të dhënave që nxirren nga kërkimet dhe studimet e deritanishme, të cilat nuk kanë pasur si objekt analizën e plotë të strukturës fonologjike të këtyre të folmeve. Më parë,[187] më 1969, ne i kemi përcaktuar këto diftongje si fonema të veçanta, krahas fonemave *i* dhe *u*, por po shohim se nga të dhënat e tjera që kanë dalë ndërkohë më shumë gjasë ka që diftongjet *e̯i̯* etj. *a̯u̯* të përcaktohen si realizime fonetike të fonemave / *i* / dhe /*u*/ në kushte të veçanta fonetike dhe si variante fakultative [188] (shih § 4,17.1.).

187. J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare* (dispensë), Tiranë, 1975, f. 65.

188. B.Beci, *E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës*, në «SF» 4, 1964, f.141. Variantet fakultative të kësaj të folmeje i shpjegon me ndikimin e gjuhës le trare.

Zanoret e thjeshta *i* dhe *u* dhe diftongjet gjegjëse të tyre funksionojnë si variante të fonemave /*i*/ dhe /*u*/ edhe në sistemin e zanoreve gojore, edhe në sistemin e zanoreve hundore.



Harta nr. 8

Në qoftë se do t'u mbaheshim skemave që propozon A.Martineja[189] për krahasimin tipologjik të gjuhëve në bazë të dallimeve që kanë në sistemin e zanoreve, duke marrë si tipar numrin e klasave sipas

189. *Langue et fonection*, 1971, f. 117.

zhvendosjes horizontale të gjuhës dhe numrit e radhëve sipëas shkallës së hapjes, del edhe më qartë se dallimi midis të folmeve të gjuhës shqipe për sistemin e zanoreve gojore të shkurtra është shumë i vogël.

Për A. Martinenë sistemi i zanoreve të një gjuhe karakterizohet si sitem me tri klasa po të bëjnë pjesë në të zanorja *y*; ne do të llogaritnim për të folmet e gjuhës shqipe jo vetëm *y*-në, por edhe ø-në, e cila është po ashtu zanore buzore e klasës së mesme.

Sipas skemës së përgjithshme të A. Martinesë del se të folmet e gjuhës shqipe mund të ndahen vetëm në dy areale për dallimet që kanë në sistemin e zanoreve gojore të shkurtra: areali nr. 1, që përfshin pjesën më të madhe të të folmeve të dialektit jugor dhe të dialektit verior, karakterizohet nga sistemi me skemë «3 3», d.m.th. sistem që ka tri klasa zanoresh (*i*∼ *y*∼ *u*) dhe tri radhë të shkallës së hapjes (*i*∼ *e*∼ *a*), areali nr. 2 përfshin një numër shumë të vogël të folmesh, aty hyjnë të folmet e skajit jugor të toskërishtes dhe të folmet e zonës lindore të gegërishtes qendrore, në këtë areal sistemi karakterizohet prej skemës «2 3», d.m.th. përbëhet nga dy klasa (*i*∼ *u*) dhe nga tri radhë të hapjes (*i*∼ *e*∼ *a*).Ndërsa areali nr.1 del si një bllok i tërë, areali nr. 2 përbëhet nga dy zona që janë larg njëra-tjetrës (shih hartën nr. 4). Siç u tha edhe më sipër, në sistemin e zanoreve të toskërishtes jugore bën pjesë edhe zanorja qendrore *ə*. Duke u nisur nga prania ose mungesa e zanoreve të klasës së mesme *y* (ose ø) dhe *ə*, ne dalluam katër areale që lidhen me këtë dallim të pjesshëm në sistemin e zanoreve gojore të shkurtra: areali nr. 1 me *y* dhe *ə*, areali nr. 2 me *y* (ose ø), areali nr. 3 me *ə* dhe areali nr. 4, që nuk ka asnjë nga këto zanore (shih hartën nr. 4).

Si përfundim mund të themi se cilido qoftë kriteri i krahasimit të të folmeve të gjuhës shqipe për sistemin e zanoreve gojore të shkurtra, qoftë ai sipas numrit të zanoreve të klasës së mesme, qëftë ai sipas numrit të klasave dhe të radhëve të hapjes, dallimet midis arealeve janë të vogla.

4.3.4. **Zanoret e theksuara gojore të gjata.** — Nuk ekziston sistemi i zanoreve të gjata në të folmet e toskërishtes veriore dhe në ato të Zagorisë, të Lunxherisë dhe të Gjirokastrës, Libohovës e Delvinës. Të folmet e tjera të gjuhës shqipe, të folmet e dialektit verior dhe ato të toskërishtes jugore (Kurvelesh e Çamëri), ndryshe nga toskërishtja veriore dhe gjuha letrare, kanë kundërvënien e zanoreve të gjata me zanoret e shkurtra. Ky tipar ruhet ende sot edhe në të folmet e arbëreshëve të Italisë, të Greqisë e të Zarës në Dalmaci.



Harta nr. 9

Në përgjithësi zanoret e gjata realizohen fonetikisht si zanore më të mbyllura në krahasim me zanoret e shkurtra, por, përveç kësaj, sidomos në gegërsihten veriore, ato nyjëtohen edhe më të prapme. Kjo diferencë në timbrin e këtyre zanoreve spikat më tepër te zanorja *a*, që është shkallës së hapjes më të madhe, shqiptohet *a*:

Ndërmjet të folmeve që karakterizohen nga kundërvënia e serisë së zanoreve të shkurtra me serinë e zanoreve të gjata dallohen më shumë dhe formojnë një areal të veçantë të folmet e gegërishtes veriperëndimore (megjithëse jo të gjitha), të cilat kanë një numër më të madh fonemash zanore të gjata dhe një sistem me një organizim të ndryshëm nga ai i të folmeve të tjera.

Nga kjo anë të folmet e gegërishtes veriperëndimore janë veçuar relativisht vonë prej të folemve të tjera. Kjo ndodhi atëherë kur në këto të folme lindën dy fonema të reja (fonemat /æ: / dhe / ø: /) nga kontraksioni i dy elementeve përbërëse të dy diftongjete të hershme të shqipes: *ae* (*dhae* «dhe», *ngae* «nge» etj.) dhe *oe* (*voe* «ve-zë», *voesë* «vesë» etj.), të cilat diku mbeten si togje zanoresh *ae* ose si dy zanore të veçuara nga një *v* antihiatizuese (*δae*, *pave* etj., *voe* etj.) diku u monoftonguan duke dhënë përkatësisht *a*: (*δa*:) dhe *o*: (*vo*:), kurse në shumicën e të folmeve të shqipes dhanë *e*: ose ë të dyja diftongjet (*δe*, *ve* etj.) (shih hartën nr. 23).

Lindja e këtyre dy fonemave në të folmet e gegërishtes veriperëndimore bëri që numri i zanoreve të gjata të shkojë nga gjashtë në tetë dhe sistemi të pësojë ndryshime, duke u ndërruar nga një sistem trekëndësh në një sistem katërkëndësh. Kjo lëvizje në sistemin e zanoreve të gegërishtes veriperëndimore u bë për shkaqe të brendshme të vetë gjuhës shqipe, nga kontraksioni që ndodhi në zanoret e diftongjeve *ae* dhe *oe*. Kjo rrugë e lindjes së zanoreve të gjata /æ:/ dhe / ø: / në gegërishten veriperëndimore të çon në një përfundim të kundërt me mendimin e S.Shirikovit [190], i cili i merr ato si dy fonema zanore karakteristike për gjithë gegërishten veriore, nuk i dallon ato si fonema që i ka vetëm seria e zanoreve të gjata, dhe, pa e njohur historinë e lindjes së këtyre, thotë se sistemi katërkëndësh i zanoreve në këto të folme të shqipes qenka si rezultat i veprimit të ushtruar mbi të nga sistemi po katërkëndësh i gjuhëve slalve të jugut.

Duhet të shtojmë këtu edhe një fakt tjetër: mbarë gegërishteja e njeh sistemin katërkëndësh edhe për zanoret hundore, i cili shpjegohet vetëm me zhvillimit e brendshme të gjuhës shqipe [191].

Për të parë vendin që zënë në sistem zanoret / æ: / dhe /ø:/ po japim skemën e zanoreve të gjata të gegërishtes veriorperëndimore ku ekzistojnë këto dy fonema:

i:	y:	u:
e:	ø:	o:
æ:		*a*:

190. S.S.Širokov, *Balkanskije mežjazykovye shozdjenija v vokalizmje ...*
191. J. Gjinari, *Zanoret hundore të gegërishtes dhe ë-ja e theksuar e toskërishtes, në* «SF», 3, 1981, f.56.

Zanorja æ:, që lindi në këto të folme, u gjend në sistem jo vetëm përballë *e*:-së, duke u kundërvënë æ:-ja si zanore e hapur dhe *e*-ja si zanore gjysmë e hapur dhe e ngritjes së mesme për nga shkalla e hapjes (δæ: «ti dhe» ~ δ*e*: «dhe-u»), por u vu përballë edhe me a: — në duke u kundërvënë nga tipari i lokalizimit æ:-ja si zanore e klasës së përparme dhe *a*:-ja si zanore e klasës së përparme (læ: «(ti) le» ~ *l*a: «ka larë»). Kjo e bën sistemin katërkëndësh.

Meqenëse *a*:-ja në klasën e prapme nuk -është buzore, atëherë edhe për dy fonemat e tjera të kësaj serie, për *u*:-në dhe për o:-në, nuk është pertinent tipari i buzorësisë [192]. Duke u nisur prej kësaj, zanoret *u*:, *o*: dhe *a*: hyjnë në korrelacion me zanoret *i*:, e: dhe æ: sipas tiparit të lokalizimit, njëra si klasë e zanoreve të përparme dhe tjetra si klasë e zanoreve të prapme.

Fonemat e klasës së mesme *y*: dhe ø:, meqenëse nuk kanë fonema gjegjëse më të prapme, shkojnë me zanoret e klasës së përparme dhe hyjnë aty në kundërvënie sipas tiparit dallues të buzorësisë duke formuar dy çifte (*i* :~ *y*: dhe *e* :~ ø:) dhe një tufë korrelative:

$$\begin{cases} \text{i} :\sim \text{y}: \\ \text{e} :\sim \text{ø}: \end{cases}$$

Zanoret e gjata të të folmeve të këtij areali hyjnë edhe në korrelacionin e shkallës së hapjes: *i*: — ja e mbyllur me *e* :-në gjysmë të hapur dhe *e*: -ja me æ: -në e hapur, po ashtu *u*:-ja me *o*:-në dhe *o*:-ja me *a*: -në.

Në klasën e mesme këtu bëjnë pjesë dy fonema [193]: *y*:-ja dhe ø:-ja, të dyja janë buzore.

Nga kjo mënyrë e organizimit të zanoreve gojore të gjata në këtë areal (areali nr. 1) mund të themi se sistemi i fonemave të zanoreve të gjata këtu ka këto karakteristika: është një sistem katërkëndësh me korrelacionin e lokalizimit (*zanore të përparme* ~ *zanore të prapme*), me korrelacionin e shkallës së hapjes dhe me zanoret *y*: dhe ø: si përfaqësuese të klasës së mesme. Skema e këtij sistemi është «3 3», d.m.th. përbëhet nga tri klasë të lokalizimit dhe tri radhë të shkallës së hapjes.

Të folmet e tjera të gjuhës shqipe, që karakterizohen nga korrelacioni i sasisë, ku kundërvihen zanoret gojore të gjata dhe të shkurtrat, kanë të gjitha si tipar të përbashkët organizimin e zanoreve

192. Për këtë kriter shih N.S.Troubetzkoy, *Principes de la phonologie*, f.104.
193. Të folmet perëndimore të gegërishtes qendrore kanë ø në vend të *y*-së.

të gjata në një sistem trekëndësh, ashtu si zanoret e shkurtra në-mbarë gjuhën shqipe, me përjashtim të të folmeve ku, siç e kemi thënë ka /æ./ ose /ɛ:/; në këto të folme sistemi është katërkëndësh.

Edhe për sistemin e këtyre të folmeve si tipare dalluese të fonemave janë po ato që ekzistojnë në sistemin e zanoreve të shkurtra, d.m.th. zanoret hyjnë në korrelacionin e lokalizimit (*të përparme ~ të prapme*) dhe në korrelacionin e shkallës së hapjes, fonema *a* në disa të folme del në kufij të sistemit. Zanoret e klasës së mesme diku dalin e diku nuk dalin: të folmet e gegërishtes jugore, të folmet kalimtare, të folmet e gegërishtes verilindore dhe të folmet perëndimore të gegërishtes qendrore kanë zanoren *y*: si përfaqësuese të klasës së mesme, pra në këtë areal (arealin nr. 2) ekziston skema e sistemit «3 3»; të folemet lindore të gegërishtes qendrore dhe të folmet e toskërishtes jugore nuk e kanë fonemën *y*:, ashtu si në sistemin e të shkurtrave, prandaj ato formojnë një areal tjetër (arealin nr. 3) ku skema e sistemit është «2 3», d.m.th. me dy klasë (*të përmarme ~ të prapme*) dhe me tri radhë të shkallës së hapjes. Midis zonës lindore të gegërishtes qendrore dhe zonës së toskërishtes jugore ka një dallim se në sistemin e kësaj të fundit bën pjesë edhe zanorja qendrore *ə*:

geg. lindore.		tosk. jugore	
i:	u:	i:	u:
e:	o:	e:	ə: o:
a:		a:	

Për shtrirjen gjeografike dhe për dallimet që kanë në sistemin e zanoreve të gjata arealet e ndryshme dialektore krahaso hartat nr. 10 nr. 11

4.3.5. **Zanoret hundore.** — Siç është thënë edhe në §4.3.1 të këtij punimi, sistemi i zanoreve hundore është karakteristik vetëm për dialektin verior të gjuhës shqipe.

Duhet thënë se në këtë dialekt janë larguar nga tipi i përbashkët e folmja e Dibrës dhe e folmja e Ulqinit, ku çhundorëzimi i zanoreve nxori nga sistemi fonetik i këtyre të folmeve zanoret hundore dhe bëri që sot aty të ketë vetëm zanore gojore. Ka edhe ndonjë të folme skajore si ajo e pjesëve veriore të Llapit në Kosovë ku hundorësia është ruajtur si tipar vetëm i zanoreve *e* dhe *a*.

Në këtë të folme del një sistem zanoresh hundore krejt i veçantë dhe i dallueshëm nga ai i të folmeve të tjera të gegërishtes. Në qoftë se do ta paraqitnim grafikisht këtë sistem, ai do të kishte këtë skemë:

$$\tilde{\varepsilon} \sim \tilde{a}$$



Harta nr 10



Harta nr 11

Ky është një sistem i përbërë prej dy fonemash zanore të hapura që hyjnë në kundërvënie njëra si zanore e përparme dhe tjetra si zanore e prapme. Këto dy fonema vendosen horizontalisht në sistetem e jo vertikalisht (jo të dallueshme sipas shkallës së hapjes), sepse *ã*-ja nyjëtohet si zanore e prapme dhe është e buzorëzuar.

Të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes kanë sistem të plotë zanoresh të përbërë nga pesë njësi fonematike.

Në përgjithësi duhet thënë se në gegërishte sot *o*-ja del në një numër shumë të vogël fjalësh, te: *zõ:j* «zonjë», *kulõjse* «kullonjëse»

e ndonjë tjetër. Kjo denduri e vogël përdorimi e *o*-së jep arsye të mjaftueshme për të mos e llogaritur atë si njësi të veçantë në sistemin e zanoreve hundore [194]. Vendin e saj në sistem, si zanore e prapme, e ka zënë *a*-ja kudo, sepse në shumicën e të folmeve të gegërishtes ajo nyjëtohet si një zanore më e prapme dhe me një timbër buzor, që, me përjashtim të të folmeve lindore të Shqipërisë së Mesme (Elbasan, Librazhd etj.)[195], në të folmet e tjera del në shkallë të ndryshme, diku më pak e theksuar e diku më e theksuar, aq sa në verilindje *a*-ja jep edhe përshtypjen e *o*-së. Nga kjo pikëpamje të gjitha të folmet e gegërishtes dhe të folmet kalimtare, që kanë zanore hundore, dalin të njësishme, të gjitha kanë një sistem zanoresh hundore katërkëndësh, por, sigurisht, me dallime në inventar dhe me dallime të tjera të pjesshme që lidhen me raportin e numrit të shkallëve dhe të radhëve të zanoreve, si dhe me timbrin e ndryshëm të ndonjë zanoreje.

Po të lëmë mënjanë të folmet lindore të gegërishtes qendrore, të gjitha të folmet e tjera (areali nr. 1) kanë një sistem katërkëndësh me pesë fonema hundore. Në shumicën e këtyre të folmeve klasa e të mesmeve përfaqësohet nga zanorja e ngritjes më të lartë *ỹ*:, kurse në të folmet perëndimore të gegërishtes qendrore (Mat, Krujë, Mirditë, Lurë) ajo përfaqësohet nga zanorja e ngritjej së mesme *ø̃*:

ĩ	*ỹ*	*ũ*
ẽ	*(ø̃)*	*ã*

Për të njëjtat arsye, që janë thënë edhe për zanoret gojore edhe në këtë sistem fonemat hyjnë në korrelacionin e lokalizimit dhe në korrelacionin e shkallës së hapjes, d.m.th. fonemat kundërvihen si të përparme dhe si të prapme (*ĩ, ẽ*~ *ũ, ã*) dhe si të mbyllura e të hapura (*ĩ*~ *ẽ* dhe *ũ*~ *ã*). Skema e sistemit është «3 2».

---

194. Gjinari, *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, në «SF» 4, 1968, f. 140 R. Smajli, *Grafia e Buzukut* . . . , f. 233.

195. Në artikullin tonë *Zanoret hundore të gegërsishtes dhe ë-ja e theksuar e toskërishtes*, në «SF», 3, 1981 i kemi veçuar këto të folme në dialektin verior, i kemi përfshirë ato në një areal më vete duke marrë parasysh se aty *ã*-ja nuk është e prapme dhe e mbyllur dhe se ka shumë raste me *o* (nuk është parësore në këto raste). Në studimin e pranishëm të *sistemit të fonemave zanore* nuk e ndajmë këtë areal nga mbarë gegërishtja, me qënëse numri i rasteve me *o* nuk është aq i konsiderueshëm dhe hapësira që zënë këto të folme është shumë e vogël në tërësinë e dialektit verior të shqipes. Në të vërtetë një gjendje afërsisht si kjo e anës lindore të Shqipërisës ë Mesme ekziston edhe në shumë të folme të gegërishtes veriperëndimore.

Përgjithësisht në të folmet e gegërishtes veriore *ë*-ja është më e hapur [ę] në krahasim me *ë*-në e të folmeve të Shqipërisë së Mesme.

Në këto dy korrelacione hyjnë zanoret hundore në të folmet lindore të gegërishtes qendrore (arealin nr. 2), por ato dallohen prej të folmeve të tjera, sepse mungon fonema /ỹ/ dhe për shkak të kësaj skeme e sistemit të këtyre është «2 2: »

ĩ ũ

ẽ ã

Në hartat e mëposhtme po japim arealet dialektore sipas dallimeve që kanë për sistemin e zanoreve houndore:



Harta nr 12



Harta nr 13

4.3.6. Nga analiza që i është bërë sistemit të zanoreve të dialekteve të shqipes del se të gjitha të folmet kanë të përbashkët korrelacionin e lokalizimit (*të përparme ~ të prapme*) dhe korrelacionin e shkallës së hapjes (*të hapura ~ të mbyllura*), shumica e të folmeve, bashkë me këtë, kanë të përbashkët edhe korrelacionin e kundërvënies së fonemave sipas tiparit të sasisë (*të gjata ~ të shkurtra*), të cilat sipas A. Martinesë mund të paraqiten me skemën L/T, kurse të folemet e gegërishtes dhe disa të folme kalimtare kanë edhe një korrelacion të tretë, kanë edhe korrelacionin e rezonatorit, të hundorësisë, të cilën po e shënojmë me N, gjithashtu sipas A.Martinesë, pra këto të folme kanë skemën L/T/N.

Në qoftë se do të donim të bënim një përmbledhje e t'i jepnim në mënyrë më të sintetizuar dallimet në sistemin e zanoreve që kanë të folmet e gjuhës shqipe, atë më së miri do ta jepnte një hartë ku do të projektoheshin hartat e arealeve të të tri sistemeve të zanoreve të vendosura njëra mbi tjetrën.

Ky projeksion do të nxirrte në hartën përmbledhëse tri areale me këto dallime: areali nr. 1, që përfshin përgjithësisht të folmet e toskërishtes veriore, në të cilat ekziston vetëm një seri fonemash zanore me skemë «3 3», d.m.th. një sistem që ka tri klasa sipas lokalizimit edhe tri radhë sipas shkallës së hapjes, areali nr. 2, që përfshin të folmet e toskërishtes jugore, ku sistemi ka zanore gojore të gjata dhe zanore gojore të shkurtra dhe secila seri ka dy klasa zanoresh (mungon klasa e mesme) dhe tri radhë, ky do të ishte një areal me skemë «2 3» L/T dhe së fundi areali nr. 3, ai i gegërishtes dhe i disa të folmeve kalimtare, brenda të cilit dallohen dy zona, për shkak se në njërin (në shumicën e të folmeve) skema është «3 3» L/T dhe «3 2» N, kurse në tjetrin (në të folmet lindore të gegërishtes qendrore) ckema është «2, 3» L/T dhe «2 2» N. Të dyja zonat e arealit nr. 3 kanë të përbashkët kundërvënien L/T/N, por dallohen nga skema që lidhet me numrin e klasave dhe të radhëve të zonave për serinë e fonemave hundore (N) (shih hartën nr 14).

ZANORET E PATHEKSUARA

4.4.1. Zanoret e gjata dhe zanoret kundore dalin shumë rrallë në rrokje të patheksuara. Në këtë pozitë ato përgjithësisht dalin në fjalë të përbëra ose të prejardhura. Duhet thënë gjithaʃhtu se edhe në raste të këtilla dalin vetëm disa nga zanoret e gjata dhe hundore, pra nuk dalin të gjitha. Duke u nisur nga kjo, mendojmë se është i mjaftueshëm vetëm ky fakt me rëndësi për t'i përjashtuar nga sistemi i të patheksuarave zanoret e gjatë dhe hundoret dhe për të pranuar vetëm një sistem zanoresh të patheksuara të shkurtra.

Fakti që kudo në të folmet e shqipes ekziston vetëm një seri zanoresh të patheksuara ka rëndësi të madhe për shkallën e dallimit të dialekteve. sepse nga kjo anë ato paraqiten më të njësishme se në sistemin e zanoreve të theksuara. Njësia e dialekteve për serinë e zanoreve të patheksuara është më e madhe edhe për arsye se të gjitha të folmet kanë zanore *ə* të patheksuar, kurse në sistemin e të theksuarave *ə* kanë vetëm të folmet e dialektit jugor. Me përjashtim të të folmeve lindore të gegërishtes qendrore dhe të të folmeve të toskërishtes jugore, ku nuk ekziston fonema /*y*/, të gjitha të folmet e tjera



Hartë nr 14

kanë një sistem zanoresh të patheksuara me shtatë fonema: *i, y, e, a, o, u, ə*. Kudo zanoret e patheksuara formojnë një sistem trekëndësh me tri klasa sipas lokalizimit dhe tri radhë sipas shkallës së hapjes. Kudo fonemat hyjnë në korrelacione sipas tiparit të lokalizimit (*të përparme ~ të prapme*) dhe sipas tiparit të shkallës së hapjes (*të hapura ~ të mbyllura*).

		i	y	u	
I					
		e	ə	0	për shumicën e të folmeve [196]
			a		
	i		u		
II					për toskërishten jugore dhe për zonën
	e	e	o		lindore të gegërishtes qendrore.
		a			

Prania e zonores *y* në disa të folme dhe mungesa e saj në të folme të tjera bën që të dallohen dy areale dialektore, njëra me një sistem zanoresh të patheksuara që ka skemën «3 3» dhe tjetra me një sistem që ka skemën «2 3»:

FUNKSIONI I FONEMAVE ZANORE

3.5.1. *Zanoret e theksuara.* — Në sistemin e zanoreve të theksuara kushtet fonetike shkaktojnë në përgjithësi më shumë dallime dialektore që lidhen me variantet fonetike kombinatore ose pozicionale, sesa dallime që lidhen me neutralizimin e kundërvënies së fonemave. Kjo është arsyeja që dallimet në funksionin e fonemave zanore janë shumë të pakta, gati të parëndësishme ndërmjet të folmeve të gjuhës shqipe.

Nga të dhënat e derisotme të studimeve dialektologjike shihet se në sistemin e zonave të theksuara disa kushte të caktuara fonetike shkaktojnë vetëm neutralizimin e kundërvënies së gjatësisë, nuk vërehet ndonjë këmbim tjetër fonemash që të lidhet me neutralizime të tipareve korrelative të tjera të fonemave zanore.

Sigurisht, neutralizimi i kundërvënies së gjatësisë vërehet në ato të folme të shqipes ku ekziston korrelacioni i sasisë së zanoreve (shih § 3.3.4.). Edhe në këtë rast njësia e të folmeve është shumë e madhe, sepse në të gjitha të folmet që karakterizohen nga seria e

196. Ne përfshimë në arealin nr. I edhe të folmet e zonës perëndimore të gegërishtes qendrore ku si zanore buzore e serisë së mesme është ø-ja.



Harta nr 15

zanoreve të gjata ndodh kthimi i të gjatave në zanore të mesme kur kalojnë nga një rrokje e hapur ose e mbyllur fundore në një rrokje të brendshme të hapur, p.sh.: *lo:p — lopa, ba:ł, — bali* «balli», *gu:r — guri, kam la: — lava, ʃpi: — ʃpija* «shtëpia», *ka: — kau* etj., po ashtu edhe të shkurtrat: *plăk — plaku, ʃko — koni* etj. Veçohen në këtë rast vetëm një numër i vogël të folmesh, në të cilat ndodh edhe këmbimi i të gjatave me të shkurtrat kur zanorja e gjatë kalon në një rrokje të mbyllur nga dy bashkëtingëllore, si p.sh. në

disa të folme të gegërishtes veriperëndimore [197], ose në një rrokje të mbyllur nga një bashkëtingëllore e shurdhët (në disa të folme të tjera [198]). Në të vërtetë mund të thuhet se vetëm këto raste të këtyre të folmeve që veçohen përbëjnë dallime dialektore të mirëfillta në funksionin e fonemave zanore të theksuara. Veç këtyre, vërehet gjithashtu se neutralizimi i kundërvënies së zanoreve të gjata me zanoret e shkurtra në një rrokje të hapur brenda fjalës nuk është gjithmonë i pranishëm në të folmet e çamërishtes, në të folmet e Vunoit në të folmet e Krujës. Në çamërishte dhe në të folmen e Vunoit është ruajtur [199] edhe sot e kësaj dite zanorja e gjatë në rastet ku në rrokjen pasuese ka mbetur e pareduktuar zanorja *ə* e patheksuar : *ka:lə* «kalë», *ba:łə «ballë»*, *ʃpi:tə* «shtëpitë», *θo:tə* «thotë», *i ʃto:tə* «i ftohtë» etj. Në të folmen e Krujës [200] ruhet zanorja e gjatë vetëm në raste si këto: mo:rtja «mortja», *de:tin* «detin», *me ʃpi:rtit* «me shpirt», *ka:ve* «kafe», *de:hen* «dehen», *dʒa:mi* «xhami». Siç jemi shprehur edhe një herë tjetër më parë [201], zanoret e mesme mund të merren si variante fonetike të kushtëzuara edhe të zanoreve të gjata, edhe të zanoreve të shkurtra, sepse edhe këto të fundit realizohen gjithmonë të mesme në një rrokje të bredndshme të hapur. Megjithatë, zanoret e gjatësisë së mesme është më e drejtë të konsiderohen si variante fonetike të fonemave zanore të gjata, sepse këto janë realizuar në çdo kohë [202] vetëm si të mesme në kushte të këtilla fonetike.

Në të folmet e zonës së Korçës e të Pogradecit gjendja është pak më e veçantë, sepse aty shqiptohet ende e gjatë zanorja në rrokje të brendshme të hapur në disa raste të ruajtura nga një fazë më e hershme e gjuhës shqipe: *ka:lə*, *θo:tə*, *u:nə*, *gru:rə* etj. Edhe këtu, ashtu si kudo, nuk janë të qëndrueshme zanoret e gjata kur në rrokjen pasuese mbas bashkëtingëllores vjen një zanore tjetër, jo *ə*-ja, p.sh. *ka:li*, *gru:ri* etj. Këto raste ku ruhen zanoret e gjata tregojnë një gjendje kalimtare për të folmet e zonës së Korçës e të Pogradecit, ato jetojnë sot si një mbeturinë e fundit e sistemit të

197. I Gjinari, *e folmja e Bregut të Bunë*, në «Dialektologjia Shqiptare« I, Tiranë, 1971, f. 337.
198. M. Çeliku, *Kuarteti i zanoreve të theksuara në të folmet e shqipes*, në «SF», 4, 1971, f. 65-100.
199. Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në «Dialektologjia shqiptare» II, 1971, M. Totoni, *Vështrim mbi të folmet e Kurveleshit*, në «Dialektologjia shqiptare», I, 1971, f. 42.
200. J, Gjinari, *Vëzhgime mbi të folme të Krujës dhe të Malësisë së Krujës*, në «Studime filologjike», 3, 1966, f. 93.
201. Po ai, *Dialektologjia shqiptare* (dispensë), Tiranë, 1975, F. f. 68, 68.
202. Për gjendjen në kohën e Buzukut shih studimin e R.Ismajlit, *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të Shqipes*, në «GjA», VII, 1971, f. 239. Autori i këtij studimi jep një mendim se në kohën e Buzukut mund mund të neutralizohet gjatësia në kushte të këtilla fonetike, d.m.th. të mesme kanë qenë variante fonetike të të shkurtrave.

dikurshëm fonetik që karakterizohej nga korrelacioni]i gjatësisë. Kjo që thamë duket nga fakti se sot aty zanoret e gjata dalin vetëm në një pozicion fonetik, vetëm kur rrokja pasuese mbaron me zanoren *ə*, shihet gjithashtu edhe nga fakti se zanoret e gjata nuk janë ruajtur në një rrokje fundore të hapur, p.sh.: *ʃpī* «Shtëpi», *drū* «dru» etj. dhe nga fakti se jo rrallë kur nuk shqiptohet zanorja *ə* fundore, zanorja e temës del e shkurtër: θōt «thotë», grur «grurë» etj. Duke u nisur nga këto, mund të themi se sot zanoret e gjata në këto të folme janë vetëm variante fakultative fonetike të zanoreve të shkurtra.

Së fundi duhet thënë se në të gjitha të folmet ku ka fomema zanore të gjata sot neutralizohet kundërvënia e gjatësisë jo vetëm brenda fjalës, por edhe në frazë [203], p.sh.: *taʃ mun t jen īit e da:* (taʃ mund tje:n īi:t e da:) etj.

3.5.2. **Zanoret e patheksuara.**- Njësia e dialekteve të gjuhës shqipe del edhe më e madhe në funksionin e fonemave zanore të patheksuara. Në përgjithësi shihet se konteksti fonetik nuk luan shumë rol në funksionin e fonemave zanore të patheksuara. Edhe ndërrimi i fonemave *i* dhe *ə* në disa kushte të caktuara fonetike është tipar i përbashkët për të folmet e shqipes.

Zanorja *i* ndërrohet me bashkëtingëlloren *j* (del në variantin *i̯*) sa herë që ndodhet para ose pas një zanoreje tjetër: *i preu- īa preu, jepni — jepīa, hapi — punoi* etj.

Në këto kushte neutralizohet kundërvënia *zanore* ~ *bashkëtingëllore* midis *i*-së dhe *j*-së. Ky ndërrim i zanores *i* bën që sistemi i pjesshëm i zanoreve të patheksuara të dalë me një fonemë më pak, të dalë pa zanoren *i*, me gjashtë fonema.

u y

e ə o

a

203: J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, në «BUSh, SShSh», 4, 19623, F. q173-174, *Dialektologjia shqiptare* (dispensë), Tiranë, 1972.

Zanorja *ə* nuk rezalizohet fare kur pasohet nga një rrokje që fillon me bashkëtingëllore sonante të ndjekur nga një zanore tjetër e patheksuar: *vegəl -vegla, lodər — lodra, kokəɾ — kokɾa, i vetəm — i vetmi* etj. Edhe në këtë rast sistemi i pjesshëm i zanoreve të patheksuara del kudo me një fonemë më pak, del pa fonemën *ə*;

i y u

e o

a

Përgjithësisht në të folmet e gegërishtes nuk del sot zanorja *ə* e patheksuar në një rrokje nistore të hapur, p.sh., *gzim* «*gëzim*», *kpu:ts* «këpucë» etj., ajo nuk del edhe në disa të folme perëndimore e veriore të gegërishtes kur ndodhet në një rrokje fundore të mbyllur nga një bashkëtingëllore e zhurmët: *lops* «lopës», *lopt* «lopët» etj. në disa të folme të gegërishtes është ndërruar *u*-ja me *ə*-në në një rrokje fundore të mbyllur nga bashkëtingëllore ɫ ose *r*: *vetəɫ* «vetull», *flutər* «flutur» etj. dhe në disa të folme po të gegërishtes *o*-ja është ndërruar në *a* në një rrokje nistore: *aboɾ* «oborr» etj. (shih hartat 17-21).

Dallime të këtilla dialektore nuk mund të konsiderohen ndërrime ʔi ato të zanoreve *i* dhe *ə* që u përmendën më sipër, sepse vërtet ndodhin në kushte të caktuara fonetike dhe në vend të tyre del një formë tjetër ose fonema reduktohet fare, por, ndryshe nga rastet *i preu — ɟa preu, vegəl — vegla, ə*-ja, *u*-ja dhe *o*-ja të rasteve *gzim, vetəɫ, oboɾ* nuk dalin sot në asnjë formë të fjalës në të folme ku kanë ndodhur këto ndryshime fonetike. Këto ndryshime dalin në dukje kur krahasohet gjendja e këtyre të folmeve me atë të të folmeve të tjera, ku nuk janë bërë ndryshime të këtilla fonetike. Për këtë arsye këto dallime dialektore nuk do të merren si dallime fonologjike, por si dallime *etimologjike të kushtëzuara ose kompensatore, siç* i quan N.S.Trumbetckoj. [204]

VARIANTET FONETIKI TË FONEMAVE ZANORE.

Në krahasim me dallimet dialektore të inventarit të sistemit dhe të funksionit të fenemave, dallimet që lidhen me variantet fonetike janë të dorës së dytë, sepse nuk janë të karakterit fonologjik.

204. N.S. Troubetzkoy, *Principes de phonologie*, Paris, 1949., f.344.

Një palë prej tyre janë të pakushtëzuara fonetikisht dhe shpjegohen me bazën e artikulimit të të folmeve. Dallime të këtilla dialektore janë ato që quhen dallime fonetike absolute. Variantet e tjera fonetike janë të kushtëzuara nga vendi ku ndodhet zanorja në një fjalë, nga lloji i rrokjes ku bën pjesë, nga tingulli që ka pranë etj.

3.6.1. **Absolute.** — Variantet fonetike absolute në të folmet e shqipes përgjithësisht lidhen me shkallën e hapjes të të njëjtave zanore në të folme të ndryshme. Dihet se në përgjithësi zanoret e gjata janë më të mbyllura se zanoret e shkurtra. Kjo shihet kudo në të folmet ku ka kundërvënie të zanoreve të gjata me zanoret e shkurtra, por, veç kësaj, vërehet se në të folmet e gegërishtes veriore e në një-farë mase edhe në ato të gegërishtes qendrore zanoret e shkurtra shqiptohen më të hapura dhe me një tension më të madh se në të folmet e shqipërisë së Mesme dhe të toskërishtes. Gjithashtu, pothuajse në po ato të folme ku zanoret e shkurtra janë më të hapura, zanorja *a* e gjatë shqiptohet më e prapme / *a*: / dhe zanorja *e* hundore shqiptohet e hapur [ɛ̃]. Diferenca të këtilla fonetike vërehen edhe në shkallën e hundorësisë së zanoreve hundore në të folme të ndryshme të gegërishtes, por janë diferenca të nuancave të holla që do të kërkonin studim me mjete të fonetikës eksperimentale për t'u përcaktuar më mirë.

3.6.2. **Të kushtëtzuara.** — Dallimet që lidhen me variantet fonetike të kushtëzuara janë më të shumta në numër në krahasim me dallimet fonetike absolute, por është për t'u theksuar se ato janë kryesisht karakteristike për të folme të gegërishtes, mbasi në gjithë toskërishten kushtet fonetike nuk ndikojnë në atë masë, saqë zanoret të shqiptohen me timbre të dallueshme.

Nga variantet fonetike të kushtëzuara shumica janë variante kombinatore, d.m.th. variante të shkaktuara prej ndikimit që ushtron tingulli fqinj. Me variante të këtilla nga zanoret e theksuara dalin *a*-ja, *e*-ja, *o*-ja dhe *y*-ja, *ø*-ja, *i*-ja dhe *u*-ja.

Zanorja *a* gojore e theksuar në të folmet e Peqinit, të Kavajës, Durrësit, Tiranës dhe Krujës, në një farë mase edhe në të folmet e Matit e të Dibrës, shqiptohet si një *a* më e prapme e më e mbyllur dhe me një nuancë buzorëzimi sa herë që ndodhet pas një bashkëtingëlloreje hundore: *ma°:l* «mal», *ma°:ʒe* «magje», *ma°:r̃im* «marrim», *kna°c* «kënaq» etj. (shih hartën nr.16). Buzorëzimi është i një shkalle relativisht të madhe, aqsa *a*-ja në këto kushte afrohet në timbër me *o*-në: *samor* «samar», *moʒe* «magje», *moj* «maj», *e moðe* «e madhe»,

no:t «natë» [205]. Në disa nga këto të folme jepet përshtypja se bashkëtingëllorja hundore i jep *a*-së edhe një ngjyrim hundor. Nuk është e pamundur që këtë përshtypje ta japë edhe tipari buzor i theksuar që ka *a*-ja në këto kushte fonetike *ma:ts* «mace», *spina°c* «spinaq» «spinaq», *dpa°ja* «dynjaja» etj. në të folmen e Krujës [206], *ma°:ʃ* «mashë» etj. në Reç-e-Dardhë të Dibrës [207] dhe *inot* «inat», *noten* «natën» në Luzni [208] etj.

Po kjo *a* gojore e shkurtër del edhe me variantin e një *a*-je të përparme të mbyllur [æ] zakonisht kur ndodhet pranë bashkëtingëlloreve *j, l,* më rrallë edhe pranë ʃ-së: *mjæft* «mjaft», *nælt* «lart», *zjærm* «zjarr», *tæʃ* «tash», *skæj* «skaj» etj. Kjo dukuri është karakteristike përgjithësisht për të folmet veriore të gegërishtes, sidomos është më e pranishme në anën perëndimore të këtij areali. Në raste më të rralla *a*-ja del me këtë timbër edhe në disa të folme veriore të gegërishtes qendrore (shih hartën nr. 16).

Në të folmen e Shkodrës, të Bregut të Bunës, të Zadrimës, të Mirditës, të Krujës, të Tiranës, të Durrësit dhe në disa fshatra të Matit *e*-ja gojore e shkurtër shqiptohet më e hapur zakonisht kur është në një rrokje të mbyllur ose para nashkëtingëlloreve ɫ,r,δ: *ets, «ec», dzẽp* «xhep», *erδ* «erdhi», *θeu* «theu»; *ðeu* «dheu», *sjeɫ* «sjell» *dzjer* «nxjerr», *zgieɫ* «zgjedh» etj. (shih hartën nr. 17).

Një variant tjetër kombinator i *e*-së gojore të shkurtër është diftongu *ie,* i cili del në rastet kur paraprihet nga një bashkëtingëllore qiellzore ose nga bashkëtingëllorja anësore *l*: *cieθ* «qeth», *cief* «qef», *ciese* «qese», *ʒielˌ* «gjel», *ʒieθe* «gjethe», *lieʃ* «lesh» etj.

---

205. M. Çeliku, *Të folmet e Kavajës, f.* 142.
206. J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmet e Krujës* ..., f. 94.
207. B. Beci, *E folmja e Reç-e-Dardhës,* f. 139.
208. Po ai, *E folmja e Luzinës së Dibrës* f. 226.

Ky variant është karakteristik gjithnjë për gegërishten veriperëndimore dhe për gegërishten qendrore, sidomos për të folmet perëndimore të saj (shih hartën nr. 17).



1. a > a°

2. a > æ

Harta nr 16



Harta nr 17

Në të folmet perëndimore të gegërishtes qendrore (Krujë, Mat, Lurë, Mirditë) fonema *ø*, që i përgjigjet *y*-së së përbashkët të shqipes në këtë zonë, ka si variante fonetike *y*-në ose *Y*-në (*y* më e hapur)[209] kur vjen pas një bashkëtingëlloreje qiellzore ose pas sonates anësore I: *ʒyʃ* «gjysh» *ʒYms* «gjysma», *ʒym* «gjym», *cylym* «qilim», *cYʃ* «*qysh*», *lyp* «lip», *Iyj* «lyej», *klyʃ* «klysh» etj. (shih hartën nr. 18).

209. *y*-ja dhe *Y*-ja janë variante fakultative, herë del njëra dhe herë tjetra në këto kushte fonektike.

Në të folmet e Shkodrës, të Krajës [210] e të Bregut të Bunës fonema *y*, zakonisht e shkurtra, del në variantin ø (zanore e përparme buzore e ngritjes së mesme) kur ndodhet në një rrokje të mbyllur pranë një bashkëtingëlloreje buzore: *løp* «lip», *ʃtøps* «shtypës», *børm* «byrëm», *i zømt* «i zymtë», *pərmøs* «përmbys» etj. (shih hartën nr. 18).

Harta nr 18

Megjithëse kanë një status pak më të veçantë se variantet fonetike kombinatore të radhitura deri tani, këtu po përfshijmë edhe

210. I.Ajeti, vë në ukje se një veçori e këtillë është karakteristike edhe për të folmet e Zarës së Dalmacisë, shih *Iztorijski razvitak gegijskog govora Arbanaca kod Zadra, Sarajevo,* 1961.

diftongjet *e͡i*, *ə͡i*, *a͡i* etj. dhe *a͡u̯*, *o͡u̯* të fonemave përkatëse *i* dhe *u* të gjata e të shkurtra. Këto diftongje, që janë karakteristike për të folmet e gegërishtes qendrore, kanë një status të veçantë, sepse dalin edhe si variante fonetife të kushtëzuara të fonemave *i* dhe *u*, por dalin gjithashtu jo rrallë edhe si variante fakultative (shih § 3.17.1.): *me͡ik* «mik», *δa͡i* «dhi», *ma͡ir* «mirë» *kuʃro͡i* «kushëri» etj. *ro͡uʃ* «rrush», *ma͡usə* «nuse», *ara͡uʃ* «arushë» etj. (shih hartën nr. 19).



Harta nr 19

Në një zonë të kufizuar të gegërishtes veriperëndimore, pikërisht në të folmen e Ulqinit e të Krajës, në të folmen e Bregut të Bunës dhe në të folmen e Shkodrës (te banorët që kanë qenë të besimit my sliman) zanorja *o* gojore e shkurtër shqiptohet si një zanore e prapme jobuzore [ʌ] kur ndodhet në një rrokje të mbyllur përgjithësisht

të fjalëve njërrokëshe dhe në një rrokje të hapur po të fjalëve njërrokëshe: *sʌt* «sot», *bʌl* «boll», *mʌs* «mos», *lʌt* «lot», *kʌs* «kos», *θʌjt* «thonjtë», *ʃkʌn* «shkon», *vlʌjn* «vlojnë», *pʌ* «*po*», *ʃkʌ* «shko» etj.

Pothuaj në shumicën e të folmeve të gegërishtes qendrore dhe në qendër të Kosovës, në Drenicë dhe në krahinëza të tjera përreth saj *o*-ja gojore qoftë e shkurtër, qoftë e gjatë, merr timbrin e një *o*-je qendrore [o̞] (në disa të folme me prirje për t'u shqiptuar edhe si një zanore buzore e përparme dhe e hapur [ø]kur ndodhet pranë bashkëtingëlloreve sonante l, *r*, r̄, j dhe paragjuhoreve ʃ, ʒ, *dʒ*: *groʃ* «groshë», *rob* «rob», roje «roja», *korb* «korb», *vo:rb* «vorbë», *u lo̞ð* «u lodh», *lo̞p* «lopë», *baba jo̞t* «jot», *ʃko̞i* «shkoi», *go̞:ʒd* «gozhdë», *Zo̞:dʒ* «hoxhë» etj. (shih hartën nr. 10).



1. o > ʌ

2. o > o̞

Harta nr 20

Së fundi, ndër variantet fonetike pozicionale po përmendim edhe diftongjet *ua*, *ye* dhe *ie*, të cilat, me përjashtim të Përmetit dhe të Tepelenës, dalin në gjithë zonën je toskërishtes veriore në vend të togjeve përkatëse *ua*, *ye* dhe *ie* kur gjenden brenda fjalës në çfarëdolloj rrokjeje, qoftë ajo e hapur ose e mbyllur, dhe në rrokje fundore të mbyllur: *gruaja* «gruaja», *duar* «duar», *lyente* «lyente», *lyej*, «lyej», *dieli* «dielli», *miel* «miell» etkj. (shih hartën nr. 21).

Nuk mungojnë në këtë zonë edhe shfaqje të rasteve kur këto diftongje dalin si variante fakultative.



Harta nr 21

3.7.1. Në dialektet e shqipes ekzistojnë edhe dallime në përbërjen fonematike të fjalëve, të cilat N.S.Trubetckoj [211] i quan dallime etimologjike. Këto dallime nuk kanë të bëjnë as me inventarin, as me sitemin dhe as me funksionin e fonemave të të folmeve. Këto janë dallime që janë shkaktuar në një fazë të caktuar të zhvillimit të të folmeve duke u këmbyer njëra fonemë me një tjetër pa sjellë pasoja në sistem, por vetëm se diku e ka shtuar dendurinë e përdorimit të një foneme dhe ka pakësuar dendurinë e fonemës tjetër ose ka përjashtuar mundësinë e kombinimit të dy fonemave, p.sh. atje ku në raste të caktuara ka sot *ə* në vend të *a*-së (*mən* < *man. akʃəm* >*akʃam* etj.) është shtuar dukuria e përdorimit të *ə*-së; atje ku grupi *ae* ka dhënë *e* (*nge* < *ngae*, *θe* < *thae* «ti) the» etj.) nuk ekziston sot mundësia e kombinimit të fonemave *a* dhe *e* në disa fjalë ku ka qenë i mundshëm dikur në]mbarë gjuhën shqipe.

Siç e kemi thënë edhe në § 3.5.2. të këtij punimi, disa prej këtyre dallimeve në pamje të parë duken sikur janë dallime që lidhen me funksionin e fonemave, me neutralizimin e kundërvënies së dy]fonemave në një pozicion të caktuar fonetik, p.sh. në disa të folme *o*-ja e patheksuar është këmbyer me *a*-në në një rrokje nistore të hapur (*aboī* < *oboī*, *daktor* < *doktor* etj.). Në këto të folme shihet se në kushte të këtilla fonetike ka vetëm një zgjedhje, shqiptohet vetëm *a* e jo *o* por, megjithatë, duke qenë se kushtet mbeten po ato, se rrokja nistore mbetet gjithmonë e hapur kur ndryshon formë fjala gjatë fleksionit, *a*-ja mbetet dhe nuk ndërrohet përsëri me *o*-në, pra kemi të bëjmë në këto raste me një dukuri të ndryshme nga ajo që vërehet te *kos* > *kʌs* → *kosi* etj.

Dallime të këtilla si *aboī* për *oboī* etj. do t'i quajmë *dallime etimologjike të kushtëzuara* ose *kompensatore*, ndryshe nga ato të tipit *zëmər* / *zemər* / *zəmər* (variante dialektore të *zemër*) etj., në të cilat sot nuk shihet asnjëlloj kushtëzimi.

Pjesa më e madhe e dallimeve në përbërjen fonematike të fjalëve. që kanë të folmet e shqipes u përkasin dallimeve të tipit të kushtëzuar. Në të dy dialektet ka dallime të të dy tipave si në sistemin e zanoreve të theksuara, ashtu edhe në sistemin e zanoreve të patheksuara.

4.7.2. **Dallime të kushtëzuara.** — Nga sistemi i zanoreve si një dallim të këtillë mund të përmendim vetëm kalimin e zanores *i* në *y* te fjalët ku ajo gjendet zakonisht para ose pas një bashkëtingëlloreje buzore: *ɾyp* «rrip», *sypər* «sipër», *kry:p* «kripë», *lyp* «lip», *ʃpyrt* «shpirt», *kolybe* «kolibe», *ly:m* «limë», *cylym* «qilim», *vry:m* «vrimë»,

211. N.S.Troubetzkoy, *Principes de phonologie*, Paris, 1949, F. 344.

fry:k «frikë» etj. Kjo veçori dialektore është karkakteristike sidomos për të folmet perëndimore të Shqipërisë së Mesme (Tiranë, Krujë, Durrës, Kavajë) dhe në masë shumë të vogël edhe për të folmet e Myzeqesë e të Beratit dhe të folmet e Matit (shih hartën nr. 22.).

Rastet e tjera të dallimeve të kushtëzuara janë të sistemit të zanoreve të patheksuara. Në të folmet perëndimore të gegërishtes (Shkodër, Bregu i Bunës, Krajë, Ulqin, Mirditë, Mat, Krujë, Durrës, Tiranë) zanorja *o-* e patheksuar është kthyer në *a* në një rrokje nistore të hapur: *aboĩ* «oborr», *apaŋa* «opinga», *afitser* «oficer» *adʒak* «oxhak»; *katets* «kotec», *damate* «domate», *daktor* «doktor» etj. (shih hartën nr. 22.).

Kryesisht në të folmet e Shqipërisë së Mesme dhe në të folmet



1. i > y

2. 0 > a

Harta nr 22

e Krujës shqiptohet zanorja *ə* për zanoren *u* në një rrokje fundore të mbyllur nga një bashkëtingëllore sonante ł ose *r*: *vetəł* «vetull», *mjegəł* «mjegull», *petəł* «epetull», *uθəł* «uthull», *akəł* «akull», *hekər* «hekur», *flutər* «flutur» etj. (shih hartën nr. 18).

Në këtë zonë, ku vërehet ndërrimi i *u*-së me *ə*-në (në mënyrë sporadike edhe në gegërishten veriperçndimore dhe në anët e Beratit, të Myzeqesë e të Mallakastrës) është si veçori edhe reduktimi i plotë i *u*-së në një rrokje të mesme të një fjale proparoksitone: *vetła* «vetulla», *petła* «petulla», *hekri* «hekuri» etj.

Në të folmet e Tiranës, të Durrësit dhe të Krujës shpesh *u*-ja e patheksuar reduktohet plotësisht edhe në një rrokje nistore të hapur: *mlon* «mbulon?», *mlar* «mullar», *złum* «zullumi», *kłoʃtər* «kulloshtër», *kmona* «kumbana», *fci*: «fuqi», *ksur* «kusur» etj. (shih hartën nr 23)



1. u > x
2. u > ə
3. u > x

Në vatra të shkëputura e të shpërndara që nga skaji verior deri në sjkajin jugor vërehet se *ə*-ja e patheksuar nuk mund të shqiptohet veçse *u* kur ndodhet pranë një bashkëtingëlloreje buzore dhe vende-vende edhe pranë bashkëtingëllores prapagjuhores *k*:

në anët e Shkodrës e të Shkupit [212]: *femun* «femër», *ʒarpun* ose *dʒarpun* «gjarpër», *ðelpun* «dhelpër», *munaʃ* «mëndafsh», *vetum* «vetëm»;

në anët e Elbasanit: *muʃtiel* «mbështjellë», *muzat* «mëzator», *ʒumon* «gjëmon»;

në anët e Beratit: *murzitem* «mërzitem», *muʃcer* «mëshqerrë», *muzat* «mëzat»;

në anët e Gjirokastërës: *muʃcerə* «mëshqerrë», *supatə* «sëpatë», *u murzita* «u mërzita», *munoj* «mënoj», *kuliʃ* «këlysh» etj. (shih hartën nr. 24).

Rregullisht, sidomos në anët e Gjirokastërës, të Bregdetit të Poshtëm dhe të Çamërisë, *ə*-ja e patheksuar shqiptohet vetëm *u* edhe në një rrokje që prihet ose pasohet nga një rrokje tjetër ku ka *u* të theksuar ose të patheksuar: *kuʃuri* «kushëri», *umur* «ymër», *nuku* «nuk(ë)», *cumuʃt* «qumësht», *bukuvale* «bukëvale», *nusuroj* «nusëroj», *ulurij* «ulërij», *sunduk* «sënduk», *ʃtuluŋgə* «shtëllungë», *buruts* «burracë» etj. (shih hartën nr. 24).

Një tipar tjetër i këtillë i kushtëzuar është ai i kalimit të zanores *ə* të patheksuar në *i* përgjithësisht pranë një bashkëtingëlloreje qiellllzore: *pi* «një», *pizet* «njëzet», *pindizaj* «njëdizaj», *gipen* «gënjen», *tə maðip* «të mëdhenj», *ʒilpăn* ose *ʒilpər* «gjilpërë» *ʒimon* «gjëmon», *niʒoj* «dëgjoj», *ci* «që», *cipar* «qëpar» *ciloj* «qëlloj», *cinis* «qëndis» etj. Areali i kësaj dukurie dialektore përfshin gjithë të folmet e gegërishtes, të folmet kalimtare, duke u paraqitur më ji theksuar sidomos në gegërishten veriperëndimore. Për një numër të mirë rastesh nga këto, sidomos për ato ku *ə*-ja gjendet pranë *p*-së dhe *c*-së, bashkohen me këtë areal edhe të folmet perëndimore të toskërishtes, si ato të Beratit, të Myzeqesë, të Mallakastrës dhe të Kurveleshit (shih hartën nr. 24).

Dallime të këtilla të kushtëzuara janë formuar nëpër të folmet e shqipes edhe për shkak të reduktimit të *ə*-së së patheksuar në disa kushte të caktuara në të folme të ndryshme.

Së pari duhet vënë në dukje se një dallim i këtillë është formuar për shkak se *ə*-ja fundore diku është reduktuar plotësisht, nuk shqiptohet sot, e diku shqiptohet ende. Të folmet që e ruajnë ende *ə*-në

212. C.Tagliavini; *Le parlate albanesi di tipo Chego orientale, Roma,* 1942.



1. e> u kombinatore

2. e> u pozicionale

3. e> i

Harta nr 24

në këtë pozicion janë shumë të pakta në numër dhe skajore, e ruajnë atë të folmet e Gjirokastrës, të Çamërisë dhe ato të anëve të Korçës e të Pogradecit, megjithëse edhe këtu nuk mungojnë herë-herë edhe raste të kundërta. Pra të folmet që e kanë reduktuar plotësisht në fund të fjalës formojnë një areal shumë të madh që përfshin të gjitha të folmet e gegërishtes, të folmet kalimtare dhe të folmet e tjera të toskërishtes, përveç atyre të Çamërisë, të Korçës e Pogradecit (shih hartën nr. 25): *ƀu:k* ose *ƀuk* «bukë», *mo:ł* ose *moł* «mollë», *mi:r* ose *mir* «mirë», *ʃko:jm* ose *ʃkojm* «shkojmë», *i la:m* ose *i lar* «i larë» etj.

Duhet të përmendim këtu se në të folmet e Gjirokastrës e të Çamërisë *ə*-ja fundore ruhet sot ende edhe në fjalë proparoksitone, ku prej kohësh është reduktuar në mbarë shqipen: *pulənə* «pulën», *mbesatə* «mbesat» *fundəratə* «fundërat», *liðələ* «lidhje», *dajkolə* «gruaja e dajës» etj.

Zanorja *ə* nuk shqiptohet në një rrokje fundore të mbyllur nga një bashkëtingëllore e zhurmët në një zonë dialektore veriore që përfshin të folmet e gegërishtes veriore dhe të folmet perëndimore të Shqipërisë së Mesme (në këtë rast shkon me këtë edhe e folmja e Krujës): *rɑθt* «rrathët», *lopt* «lopët»; *ba:bs* «babës» *nāns* «nënës *a tri tso:pʃ* «është tri copsh», *dikilʃ* «dykilësh» etj. (shih hartën nr. 25).

Në një rrokje të trendshme, të hapur pas theksit [illegible] zanorja sot nuk shqiptohet përgjithësisht në të folmet e dialektit verior, në të folmet kalimtare dhe shpesh në shumë të folme të toskërishtes, sidomos në të folmet e toskërishtes veriore: *perzit* «njerëzit», *punra* «punëra» *bletvet* «bletëvet», *t'lergta* «të largëta», *ʃpatza* «shpatëza», *t ʒiθve* «të gjithëve» etj. (shih hartën nr. 25). Në të folmet e Çamërisë e të Gjirokastrës ajo është ruajtur në të gjitha rastet, gjithashtu edhe në të folmet e Kurveleshit e të Përmetit përgjithësisht *ə*-ja është ruajtur në këto kushte, por nuk mungojnë aty edhe variante fakultative me reduktim të kësaj zanoreje.

Zanorja *ə* para theksit në një rrokje nistore të hapur nuk shqiptohet rregullisht në të gjitha të folmet e gegërishtes e në të folmet kalimtare: *vla*: «vëlla», *fmija* «fëmia», *kput* «këput», *ʃnet* «shëndet», *pīu*: «përrua», *θīas* «thërras», *rzoj* «rrëzoj» etj. Nga kjo anë të afërta me këto të folme janë edhe ato të toskërishtes veriore, ku gjithashtu shpesh në mënyrë fakultative nuk shqiptohet *ə*-ja në këto kushte fonetike. Në këtë pozitë rregullisht *ə*-ja shqiptohet në të folmet e toskërishtes jugore, por edhe aty nuk mungojnë raste pa *ə*, sidomos në ato fjalë ku rrokja pasuese fillon me një bashkëtingë-

213. Fjala është për rastet kur rrokja pasuese fillon me një bashkëtingëllore të zhurmët, sepse në rastet kur rrokja fillon me bashkëtingëllore të zëshme (*motra, i vogli* etj.) *ə*-ja nuk shqiptohet pothuaj kudo në të folmet e gjuhës shqipe.



1. Hə > x
   në fund të fjalës
2. ə > x
   në fund të fjalës para bashkëtingëlloreve të zhurmëta
3. ə > x
   në mes të fjalës pas theksit

llore sonante, θr̄as «thërras», *ndr̄oj* «ndërroj» etj. (shih hartën nr. 26).

E njëjta gjendje është sot në të folmet e shqipes edhe për *ə*-në para theksit në një rrokje të brendshme të hapur. Nuk shqiptohet rregullisht *ə*-ja e një rrokjeje të këtillë në të gjitha të folmet e gegërishtes dhe në të folmet kalimtare: *puntor* «punëtor», *kuʃri* «kushëri», *plecni* «pleqëri», *bagti* «bagëti», *dimnoj* «dimoroj» etj. Të folmet e Beratit, të Myzeqesë, të Mallakastrës dhe të Skraparit afrohen disi me gegërishten në këtë rast, por në të njëjtën kohë edhe largohen prej tyre, sepse e ruajnë përgjithësisht *ə*-në kur rrokja pasuese fillon me një bashkëtingëllore sonante, si *varfəri*, *nusəri* etj. Të folmet e tjera të toskërishtes, në mënyrë të veçantë ato të toskërishtes jugore, e kanë

ruajtur përgjithësisht mirë zanoren ə në këto kushte fonetike (shih hartën nr. 25).



ə në fillim të fjalës para theksit:

1. reduktohet
2. ka përdorim fakultativ, d.m.th. herë ruhet herë reduktohet

Harta nr 26

3.7.3. **Dallime të pakushtëzuara.** — Janë më të pakta në numër se dallimet etimologjike të kushtëzuara dhe, përveç kësaj, pothuaj të gjitha janë formuar në sistemin e zanoreve tç theksuara.

Të folmet e toskërishtes nuk janë të njësishme për rastet ku dikur mbarë gjuha shqipe ka pasur *e* para një bashkëtingëlloreje hundore, si *zemër, dhen, penj* etj. Në fjalë të këtilla të gjitha të folmet e toskërishtes jugore kanë zanore *ə*: *zəmər* «zemër», *fəmər* «femër», *e prəmte* «e premte», *cən* «qen», *brənda* «brenda» *pəɲ* «penj», *ceɲc* «qengj», *frə* «fre», *pə* «pe» etj.

Në të folmet e zonës së Korçës e të Pogradecit pothuajse të gji-

tha rastet dalin me *e*, ashtu si janë sot në gjuhën letrare.

Të folmet e tjera të toskërishtes veriore paraqiten me një gjendje të përzier, në një numër më të vogël fjalësh kanë rregullisht *e*: *pe, fre, peɲ* «penj», *e premte, e eɲte* «e enjte», *femər* «femër,» *θemər* «thëmbër», kurse në rastet e tjera, po ashtu, rregullisht kanë zanoren *ə*: *brəndа*«brenda», *mənt* «mend», *vənt* «vend», *dəndur* «dëndur», *Iəmza* «lemza», *ndəɲa* «ndenja», *cən* «qen», *δən* «dhen», *cəɲc* «qengj» etj. Duhet vënë në dukje se në këtë areal të folmət e rrethit të Përmetit dallohen, sepse kanë më pak raste me *e*, pothuajs vetëm ato ku sot *e*-ja nuk ndiqet nga një bashkëtingëllore hundore, si *pe, fre* etj., pra të folmet e këtij rrethi në këtë rast afrohen më shumë më të folmet e toskërishtes jugore (shih hartën nr. 27).



1. e > e
2. e
3. e > ə dhe e
4. e > -ie

Harta nr 27

Përgjithësisht, në të folmet verilindore, në një numër të vogël fjalësh. *e*-ja: e thekšuar, zakonisht e gjatë, është diftonguar dhe sot në vend të saj del rregullisht togu i zanoreve *ie*: *kie* «qe» (forma e shumësit të fjalës *ka*), *kie* «ke» (forma e vetës së dytë njëjës të foljes *kam*), *ʃkie* «shqe» (forma e shumësit të fjalës *shka-u* «sllav» etj). (shih hartën nr. 27).

Të folmet e shqipes janë diferencuar edhe për shkak se togjet e dikurshme të zanoreve *ae* dhe *oe* kanë marrë rrugë të ndryshme zhvillimi në të folme të ndryshme. Është me interes të vihet në dukje se në shumicën e të folmeve, në gjithë toskërishten dhe në të folmet e Shqipërisë së Mesme dhe përgjithësisht në ato të gegërishtes qendrore, të dyja grupet kanë dhënë e: nge ose ŋe < ngae, θe «ti) the» < thae, *re* «(ti) re» < rae, *le* «(ti) le» < lae; *ve* ose *vezë* < voe, *vesə* ose *ve:s* «vesë» <*voesə*, *re* «(vë)re» < roe.

Përgjithësisht i gjejmë të ruajtura këto dy togje zanoresh në të folmet e Mirditës, aty-këtu edhe në disa të folme të tjera të gegërishtes qendrore, po ashtu edhe në disa të folme verilindore, si ato të Pukës, të Tropojës, të Kosovës: *ŋae* «nge», *pae* ose *pave* «ti pe», *voe* «ve-zë» etj.

Një rrugë tjetër kanë marrë këto togje zanoresh në të folmet e gegërishtes veriore, përgjithësisht në zonat që ndodhen në veri të Drinit. Sipas reflekseve që kanë këtu grupet e zanoreve *ae* dhe *oe*, dallohen dy areale: areali i gegërishtes veriperëndimore ku grupet kanë dhënë dy fonema të ndryshme karakteristike për këtë zonë (shih § 4.3.1.), gjegjësisht fonemat æ: (< *ae*) dhe *ø* :(< *oe*): θæ: «ti the», *vø*:«ve-zë» etj., areali i gegërishtes verilindore ku grupi *ae* ka dhënë *a*: dhe grupi *oe* ka dhënë *o*: θ*a*: «(ti) the», *vo*: «ve-zë» «ve-zë» etj. (shih hartën nr. 28).

Si të fundit nga dallimet në përbërjen fonematike të fjalëve po renditim atë që lidhet me rastet ku sot në gjuhën letrare ka togje zanoresh *ua* (duar), *ye* (fyell), *ie* (diell).

Këto togje i gjejmë në të gjitha të folmet e toskërishtes, i gjejmë gjithashtu të ruajtura përgjithësisht në shumë të folme të gegërishtes verilindore, por me një dallim, se këtu ka tog *ue* atje ku toskërishtja ka *ua* : *duer*, «duar», *mue* «mua», *lyej*, *u θyè* «u thye», *diel* «diell», *bie* etj. Duhet thënë se ato janë ruajtur përgjithësisht edhe në të folmet e tjera që shtrihen midis Drinit e Matit, por vetëm në një rrokje fundore të hapur. Arealin e tretë e bëjnë të folmet e tjera të gegërishtes, shumica e të folmeve të këtij dialekti bashkë me të edhe shumë të folme kalimtare, ku në vend të grupeve *ua*, *ye* dhe *ie* regullisht ka *u* (*dur* «duar», *gru* «grua»), *y* (fyl «fyell», *u ly* u lye») dhe *i* (dit «diell», *bi* «bie») (dshih hartën nr. 29).



Harta nr 28

1. ae, oe > e
2. ae, oe
3. ae > æ,;, oe > ø:
4. ae > a:, oe > o:



Harta nr. 29

1. ua, ye, ie
2. u, y, i
3. ue, ye, ie
4. ue, ye, ie në rrokje fundore të hapur

B. SISTEMI I BASHKËTINGËLLOREVE

INVENTARI I FONEMAVE BASHKËTINGËLLORE

4.8.1. **Bashkëtingëlloret.** — Të gjitha variantet e gjuhës shqipe, duke përfshirë së bashku me dialektet edhe gjuhën letrare, kanë një inventar të pasur me 38 fonema bashkëtingëllore. Tërë fonemat e këtij inventari të përbashkët po i japim këtu në një tabelë për të vënë në dukje njësitë (fonemat) që bëjnë pjesë në këtë inventar dhe veçoritë e tyre nyjëtimore sipas vendit dhe mënyrës së formimit.

Sigurisht, në këtë inventar të përbashkët të shqipes ka fonema që nuk ekzistojnë në disa të folme, por këtë dallim do ta japim më poshtë kur të flasim për inventarin e sistemeve të shkallëve të ndryshme të të dy dialekteve, sipas arealeve që formohen nga grupe të folmesh me karakteristika të përbashkëta.

Sipas vendit të formimit / Sipas mënyrës së formimit			buzor		paragjuhore				mes-gjuhore		prapa gjuhore	fari-ngale
			I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X
mbyllitore	të zhurmëta	të shurdhëta	P			t	ts	tʃ	tc,	C	k	
		të zëshme	b			d	dz	dʒ	dz,	ɟ	g	
	sonante		m			n				ɲ	ŋ	
Shtegore	të zhurmëta	të shurdhëta			θ		s	ʃ	φ		x	
		të zëshme		v	ð		z	ʒ	z,	ʝ	ɣ	
		të shurdhëta								j		
		të zëshme										h
	Sonate									j		
		anësore				l	l					
		dridhëse					r r̄					

Siç dihet, gjuha letrare ka 29 fonema bashkëtingëllore: /p/, /b/, /t/, /d/, /c/, /x/, /ç/, /xh/, /q/, /gj/, /k/, /g/, /f/, /v/, /th/, /dh/, /s/, /z/, /sh/, /zh/, /h/, /j/, /m/, /n/, /nj/, /ll/, /l/, /r/, /rr/.

Përputhje të plotë me gjuhën letrare nga kjo anë kanë shumica e të folmeve të dialektit jugor të shqipes dhe të folmet kalimtare qëndrore e lindore. Prej toskërishtes veçohen e folmja e Kurveleshit, ajo e Beratit me rrethinat dhe të folmet e Korçës e të Devollit. Të folmet me këtë inventar prej 29 fonemash përbëjnë arealin nr. 1.

Të gjitha të folmet e tjera të dy dialekteve të shqipes nuk dallohen shumë prej gjuhës letrare për nga numri i njësive të inventarit të fonemave bashkëtingëllore, ato diferencohen me një ose dy fonema më shumë a më pak, me përjashtim vetëm të së folmes së Dibrës, që ka tre më pak. Edhe për nga vetë lloji i fonemave që bëjnë pjesë në inventar nuk dallohen shumë të folmet prej gjuhës letrare.

Dallime për llojin e fonemave shihen në disa të folme që u përgjigjen dy fonemave të gjuhës letrare (q-së dhe gj-së) me tinguj të tjerë të dalë nga ndryshimet fonetike që kanë pësuar ato në këto të folme. Një grup i vogël të folmesh që ndodhen në një zonë të kufizuar në verilindje i përgjigjet *nj*-së së gjuhës letrare me grupin $n + \dot{i}$.

Dallime ka edhe në inventarin e grupeve të bashkëtingëlloreve, por për këto do të flasim më poshtë.

Nga të folmet që dallohen prej gjuhës letrare në sistemin e bashkëtingëlloreve më të afërta janë ato të Shqipërisë së Mesme, shumë të folme kalimtare, të folmet e gegërishtes qendrore, shumica e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore (me përjashtim të Dukagjinit) dhe e folmja e Kurveleshit në Jug. Këto të folme kanë një fonemë më tepër se gjuha letrare, kanë ŋ-në, bashkëtingëllore paragjuhësore sonante (shih në hartë arealin me nr. 2)[214],§ pra gjithsej aty ka 30 fonema. Brenda këtij areali të madh veçohet e folmja e Dibrës dhe e rrethinave të saj, e cila ka 28 fonema, sepse aty kanë dalë nga sistemi bashkëtingëlloret *h* dhe r̄ (nr. 3). Disa të folme të Jugut, ato të Beratit me rrethina dhe të folmet e Korçës, të Fushës së Korçës e të Devollit, ku kanë dalë jashtë sistemit bashkëtingëlloret *h* dhe r̄[215], kanë në inventarin e tyre 27 fonema bashkëtingëllore (nr. 4). Fonema r̄ është e panjohur edhe në të folmet e shumicës së banorëve me origjinë më të hershme qytetare të pothuaj gjithë qyteteve të Jugut. Arealin e pestë e përbën një zonë shumë e vogël në Shqipëri të Mesme, në qendër, që përfshin Peqinin, Malësinë e

214. Për arealet e tjera do të shënojmë në kllapa vetëm numrin e tij që ka në hartën e arealeve sipas inventarit të fonemave bashkëtingëllore.

215. J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare* (dispensë), Tiranë, 1975, f.109.

Peqinit dhe fshatrat e kodrave që shkojnë deri afër Ndroqit, pra gjithë zona kodrinore midis Shkumbinit dhe Erzenit [216]. Në këtë areal çifti i ndërdhëmboreve /θ/ ~ /ð/ mungon dhe në vend të tij është formuar çifti i prapagjuhoreve /χ/ ~ /γ/. Inventari i fonemave të këtyre të folmeve përbëhet prej 30 fonemash bashkëtingëllore, sepse këtu bën pjesë edhe fonema ɳ, ashtu si në gjithë të folmet e tjera të gegërishtes.

Arealet e tjera, që dallohen prej gjuhës letrare, zënë një pozicion verilindor në truallin e shqipes, aty përfshihen të folmet e gegërishtes verilindore dhe një pjesë (pjesa lindore) e gegërishtes veriperëndimore, hyn aty edhe e folmja e qytetarëve të Shkodrës që kanë qenë të besimit katolik. Në këtë zonë diferencat janë formuar për shkak të zhvillimeve [217] që kanë pësuar bashkëtingëlloret mbylltore mesgjuhore *c* dhe ɟ, të cilat kanë dhënë mbylltore afrikate paragjuhore *tʃ* dhe *dʒ*, afrikate mesgjuhore *tc*, dhe *dz*, shtegore mesgjuhore ɕ e ʑ dhe paragjuhore fishkëllyese të palatalizuara φ e z, Në shumicën e të folmeve të kësaj zone gjenden dy, tre ose edhe katër nga këto çifte tingujsh, por në një areal të caktuar njëri prej çifteve përbën çiftin e tingujve që funksionojnë si fonema, të tjerat janë variante fakultative. Kufij më të përpiktë të arealeve që lidhen me këtë dukuri dialektore do të japë atlasi i shqipes.

Brenda kësaj zone formohet, së pari, areali nr. 6, i cili përfshin krahinën e dukagjinit, me përjashtim të anës lindore, shkon më në veri, duke hyrë pak në krahinën e Kosovës, përfshihet aty edhe e folmja e banorëve të Shkodrës që kanë qenë të besimit katolik. Këtu në vend të çiftit të mesgjuhoreve mbylltore *c* e ɟ ka dalë çifti i afrikateve mesgjuhore *tc* ~ *dz*. Inventari i të folmeve që përbëjnë këtë areal ka 30 fonema (29 + ɳ).

Arealin nr. 7 e formojnë përgjithësisht të folmet e Kosovës ku edhe mesgjuhoret mbylltore *c* ~ ɟ, edhe afrikatet e përparme të tipit të përbashkët *tʃ* ~ *dʒ* janë shkrirë në një çift të vetëm, [218] në afrikate mesgjuhore *tc* ~ *dz*, pra inventari i përbashkët ka 28 fonema (27 + ɳ).

Arealin nr. 8 e përbëjnë të folmet e rrethit të Tropojës (krahinat Nikal-Mërtur, Krasniqe, Gash, Bytyç), e folmja e fshatrave lindorë të Dukagjinit dhe e folmja e fshatarave veriorë të Mirditës, ku mes-

216. M.Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*, në «SF», 4, 1965, f. 98.

217. Në këtë trevë është edhe ndonjë e folme skajore që i ka ruajtur mesgjuhoret mbylltore *c* e ɟ (shih I.Ajeti, Rreth disa veçorive të të folmeve të Shqiptarëve të Preshevës e të Bujanovcit, në «GjA., 2, 1969, f. 46.

218. I.Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të Shqiptarëve të Preshevës e të Bujanovcit*, f. 47.

jguhoret mbylltore $c \sim ʒ$ kanë dhënë mesgjuhore shtegore $ɥ$ e j[219]. Këtu inventari përbëhet nga 30 fonema (29 + η). Së fundi, në një zonë të kufizuar, që përfshin Lurën dhe Rajën, formohet një areal tjetër, areali nr. 9, që ka gjithashtu 30 fonema, sikurse ato që u përmendën më sipër, por me dallim se në vend të mesgjuhoreve mbyll-



Harta nr 30

219. J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, në «BUSh, SShSh», 4, 1963, E. Lafe, E *folmja e Nikaj-Mërturit*, në «SF», 3, 1964; Xh. Gosturani, *E folmja e Çeremit dhe e Valbonës*, në «Dialektologjia shqiptare» IV, Tiranë, 1982; B.Beci, *E folmja e Mirditës.*

tore *c*~ʒ janë paragjuhoret fishkëllyese palatale φ dhe z ose ś e ź[220].

Ato që u thanë deri këtu mbi dallimet në inventarin e fonemave bashkëtingëllore midis varianteve të shqipes po i japim me anë të një harte (shih hartën nr. 30).

4.8.2. **Grupet e bashkëtingëlloreve.** — Midis varianteve të shqipes shihen dallime edhe në inventarin e grupeve të fonemave bashkëtingëllore. Ka dallime midis të folmeve që vijnë për shkak se është i ndryshëm njëri prej elementeve përbërëse të grupeve gjegjëse të bashkëtingëlloreve. Diferencat vijnë edhe ngase në disa të folme në vend të grupit ka vetëm një fonemë, e cila ose është e njëjtë me njërin nga elementet e grupit, ose është e ndryshme nga të dyja. Dallime të këtilla sjellin diferenca në inventarin e grupeve të fonemave, në dendurinë e përdorimit të njërës e tjetrës fonemë të grupit e të fonemës së re, që ka dalë nga ndryshimet fonetike, sjellin pastaj edhe diferenca në funksionin e fonemave, në raportet e tyre me grupet bashkëtingëllore etj.

Grupe të këtilla, prej të cilave kanë lindur dallime midis varianteve të shqipes, janë: *mb, nd, ng, nʒ, tj, dj, mj,* dhe *pl, bl, fl.*

Në gjuhën letrare ekzistojnë, janë të mundshme për t'u shqiptuar, të gjitha këto grupe. Ato ekzistojnë pothuaj edhe në tërë dialektin jugor, me përjashtim të së folmes së Kurveleshit, [221] ku disa prej tyre, (*mb, nd, ng, nʒ*) nuk dalin. Dallohen në përgjithësi të gjitha të folmet e dialektit verior dhe shumë të folme kalimtare në të cilat nuk dalin grupet *mb, nd, ng,* dhe grupi *nʒ*. Në vend të tyre përgjithësisht ka mbetur një fonemë, njëri nga dy elementet, zakonisht *m*-ja dhe *n*-ja për grupet *mb, nd,* [222] ose kanë dalë fonema të tjera, fonemat ɳ dhe ɲ për grupet *ng* e *nʒ*. Në qendër dhe në anën veriperëndimore të këtij areali ka një numër të folmesh që kanë *g*[223] për grupin *ng,* ose del i plotë ky grup si variant fakultativ, po

---

220. M. Lambertz, *Bericht.*, 140.

221. E.Çabej, *Për historinë e konsonatizmit në gjuhën shqipe,* në «BUSh, SShSh», 3, 1958; M. Tononi, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit,* në «Dialektologjia shqiptare» I, Tiranë, 1971.

222 Në zonën e Malësisë së Madhe grupi *mb* ka hënë edhe *b* ose *p* dhe *nd* ka dhënë edhe *d* ose *t,* shih Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kastratit* në «SF», 2, 1970 f. 42, 43; *E folmja e Hotit,* në «Dialektologjinë shqiptare», II, Tiranë, 1974, f. 366.B.Beci, *E folmja e Shkrelit,* në «Dialektologjinë shqiptare», I, Tiranë, 1971, f.

223. B.Beci, *E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës,* f.146, Gj. Shkurta *E folmja e Kastratit,* f. 49; *E folmja e Hotit,* f. 368.

ashtu këto të folme, sidomos ato të veriperëndimit, kanë ɟ për *nɟ*. Të folmet verilindore të gegërishtes përgjithësisht e ruajnë grupin *nɟ* (atje *ndʒ* ose *ndz*, [224] (shih hartën nr. 31).



1. mb, nd, ng, nɟ > > m, n, ŋ, ɲ
2. nɟ > ndʒ

Harta nr 31

224. C. Tagliavini, *Le parlate albanesi di tipo Chego orjentale, Roma* 1942; H. Agani, *Cila është treva gjuhësore e fjalëorit të* Kujunxhiçıt, në «Studime Gjuhore» I (dialektologji), 1978, f.199; M.Mulaku, *Govor albanaca Bajgorske Salje*, 1968, f. 135; M.Halimi, *Disa veçori të së folmes së Morovës së Epërme*, në «Studime gjuhësore» I (dialektologji), f. 381.

Prej shumicës së të folmeve të të dy dialekteve dallohen të folmet e gegërishtes qendrore (me përjashtim të së folmes së Krujës), të cilat formojnë një areal ku mungojnë grupet *tj*, *dj*, ato nuk realizohen sot në këto të folme; prej ndryshimeve që kanë pësuar grupet *tj*, *dj*, kanë përfunduar përkatësisht në *c* e ʒ. Në të folmet e pjesës lindore të kësaj zone nuk bën pjesë në inventarin e grupeve të fonemave dhe grupi *mj*, i cili ka dhënë ɲ (shih hartën nr. 32).



1. tj, dj > c, ʒ
2. mj > ɲ

Harta nr 32

Po në]zonën lindore të gegërishtes qendrore dhe në Dukagjin formohet një areal tjetër [225] ku mungojnë grupet *pl, bl e fl.* Një vijë që kalon përafërsisht n aty nga Dibra, e ndan këtë areal në dy pjesë, në pjesën perëndimore,]ku në vend të këtyre grupeve ka *pj, bj, fj,* dhe në pjesën lindore, ku në vend të grupeve *pl,* e *bl* janë grupet *pt͡ʃ, bd͡ʒ* ose një fonemë: *t͡ʃ* (<*pl*), *d͡ʒ* (<*bl*)



1. pl, bl, fl > pj, pj, fj

2. pl, bl > pt͡ʃ, bd͡ʒ, t͡ʃ, d͡ʒ

Harta nr 33

225. W. Cimohovski, *Le dialecte de Dushmani,* Poznan, 1951; C. Taglianini, *Le parlate,* f. 60-61; J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare* (dispensë), 1963 f.48; B.Beci, E *folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës,* f.147; po ai, *E folmja e Luznisë Së Dibrës,* f.240. Grupet *pj* e *bj* për *pl* e *bl* janë karakteristike edhe në anët e Shijakut.

SISTEMI I FONEMAVE BASHKËTINGËLLOREVE

3.9.1. Organizimi i fonemave në sistem nxjerr në shesh mëjmirë njësinë e varianteve të gjuhës shqipe në sistemin e fonemave bashkëtingëllore.

Kjo njësi duket, së pari, se kudo janë të njëjtat fonema që bëjnë pjesë në sistem dhe gjithashtu kudo janë të njëjta ato që qëndrojnë në skajet e sistemit.

Së dyti, ç'ka është më e rëndësishme, fonemat, në bazë të kundërvënies për nga mënyrat e formimit, hyjnë kudo në dy korrelacione: në korrelacionin e kundërvënies së tiparit të zëshmërisë (*të zëshme ~ të shurdhëta*) dhe në korrelacionin e kundërvënies së tiparit të frikativitetit (*mbylltore~shtegore*). Sipas këtyre korrelacioneve kudo formohen katër seri fonemash.

Dallime, që nuk luajnë rol të rëndësishëm në sistem, vërehen në numrin e radhëve të fonemave të ndara sipas vendit të formimit të tyre. Kështu, ndërsa në shumicën e varianteve ka gjashtë radhë fonemash, në dy grupe të folmesh ka një radhë më pak; këto janë dallime që lidhen me numrin e inventarit të fonemave në areale të ndryshme.

Dallime, po ashtu të parëndësishme, ekzistojnë edhe për shkak të diferencave të vogla në numrin e çifteve të secilës radhë të sistemit të fonemave, mbasi prej ndryshimeve fonetike që kanë pësuar fonemat gjatë kohëve nëpër të folme, një çift ka lëvizur nga një radhë e është vendosur në një radhë tjetër, gjithmonë duke e ruajtur korrelacionin e zëshmërisë, por duke qëndruar ose duke e ndërruar vendin në seritë e korrelacionit të frikativitetit.

Diferenca gati të papërfillshme për sistemin ekzistojnë edhe në numrin e tufave korrelative trigjymtyrëshe. Kjo diferencë formohet nga të folmet e Beratit, të Korçës e të Devollit në Jug dhe nga e folmja e Dibrës në Veri, në të cilat për shkak të daljes nga sistemi të fonemës dridhëse të gjatë r̄, është zhdukur kundërvënia *r*-r̄ dhe është zhdukur njëkohësisht edhe tufa korrelative treshe .



Edhe në të folmet ku është sot normë e gjallë ndërrimi i fonemave *c* e ʒ me *j*-në (në Kurvelesh e në Bregdet), fonema *j* sonante del nga skajet e sistemit dhe radhitet me shtegoret në sistem, duke formuar një tufë trigjymtyrëshe me bashkëtingëlloret c~ʒ:



3.9.2. Ashtu si në gjuhën lertrare, edhe në çdo të folme mbeten të painkuadruara në sistem, mbeten pra në skajet, këto fonema: faringalja shtegore *h*, sonantet *m*, *n*, ɲ, *j*, ɫ, l dhe dridhëset *r* e r̄.

Ndryshe nga R. Ismajli [226], i cili e inkuadron në sistem fonemën faringale *h*, ne mendojmë se ajo zë vend në skajet, sepse vërtet është shtegore (e zhurmët) e mund të radhitej me shtegoret e tjera të kësaj natyre, që hyjnë në sistem, por *h*-ja nuk ka shoqe të zëshme, është faringale për nga vendi i formimit dhe në përgjithësi nuk këmbehet me ndonjë fonemë tjetër të sistemit. Prandaj, si e këtillë fonema *h* nuk mund të zërë vend në serinë e të shurdhëtave të shtegoreve të tjera në radhën e prapagjuhoreve, ku do të formonte një tufë korrelative treshe me prapagjuhoret mbylltore: k — g — h

Kjo mund të pranohet vetëm për të folmet e skajit verior të gegërishtes, ku ndodh ndërrimi i *h*-së me *f*-në në disa kushte të caktuara fonetike.

Edhe sonantet hundore *m*, *n*, ɲ, e ŋ zënë vend në skaje të sistemit, sepse nuk mund të hyjnë në korrelacion me mbylltoret e zëshme e të shurdhëta [227]. Prej këtyre të fundit ato dallohen nga dy tipare, nga sonoriteti dhe hundorësia, hyjnë pra në lidhje të shumanshme e jo të dyanshme, nuk dallohen vetëm nga prania ose mungesa e një tipari. Karakteri sonant i tyre nuk mund të mos merret si tipar relevant (pertinent), sepse ai i dallon nga mbylltoret e zhurmshme (*b*~*p*, *d*~*t* etj.). Kjo shihet në faktin se para tyre (sonanteve) bashkëtingëlloret e tjera qëndrojnë të pandryshueshme, nuk neutralizojnë kundërvëniet, me përjashtim të çamërishtes, siç u tha më sipër, ku para *m*-së të shurdhëtat kthehen në të zëshme, p.sh. *krismə*>*krizmə* etj.

Për sa i përket çamërishtes, që veçohet në këtë rast, mendojmë se edhe aty sonantet, megjithëse *m*-ja funksionon si të zhurmëtat e zëshme, nuk hyjnë në sistem, nuk formojnë korrelacione me mbylltoret, sepse nga sonantet hundore vetëm *m*-ja funksionon në këtë mënyrë, e cila mbetet kështu e veçuar.

3.9.3. Po të merret në vështrim inventari i përgjithshëm i gjuhës së përbashkët shqipe, pasi të hiqen dhjetë fonemat e përmendura

---

226. R. Ismajli, *Ndërlidhësi kundërvëniesh të sistemit bashkëtingëllor të shqipes*, në Përparimi», 1, 1973, f. 35.

227. R. Ismajli ka një mendim të kundërt, (art. e cit. f. 33) jep, këtë pohim: « ... hundoret hyjnë në një ndërlidhëri të fortë me okluzivet e shure të zëshme, ndërsa dridhëset dhe anësore formojnë një nënsistem më vete, ose më mirë të themi nuk janë të inkuadruara në sistem:

më sipër, që zënë vend në skajet, njëzet e tetë fonemat e tjera hyjnë të gjitha në sistem.

Këto fonema kudo formojnë një sistem me katër seri sipas dy korrelacioneve të kundërvënies për nga mënyra e formimit: sipas korrelacionit të zëshmërisë (*të zëshme ~ të shurdhëta*) dhe sipas korrelacionit të frikativitetit (*shtegove ~ mbylltore*); fonemat formojnë gjithashtu diku gjashtë e diku pesë radhë sipas vendit të nyjëtimit (korrelacioni i lokalizimit).

Siç kanë vërejtur edhe N.S.Trubetckoj për të folmen e Shkodrës[228] dhe R.Ismajli[229] për gjuhën standarte (shqipen letrare — J. Gjinari), në gjuhën shqipe formojnë kundërvënie edhe shtegoret me mbylltoret, sepse ekzistojnë disa fonema shtegore që për nga vendi i nyjëtimit përputhen me disa mbylltore, d.m.th. nyjëtohen në të njëjtin vend. Kështu formohen çifte korrelative edhe sipas pranisë ose mungesës së tiparit frikativ: *ts*~ *s*, *dz*~ *z*, *t*~ θ, *d*~ δ etj.

Vendi i nyjëtimit të fonemave buzore-dhëmbore *f*~ *v* nuk përputhen plotësisht me vendin e fonemave mbylltore-buzore (dybuzore) *p*~ *b*, po ashtu edhe vendi i ndërdhëmboreve θ ~ δ me vendin e dhëmboreve *t*~ *d*. Po të merrej parasysh kjo mospërputhje, ato nuk do të hynin në sistem sipas korrelacionit të frikativitetit, por për të mos i veçuar nga shtegoret e tjera, që hyjnë në këtë korrelacion, nuk po e përfillim këtë mospërputhje të vendit të nyjëtimit dhe për këtë arsye ato do të futen në sitem duke i konsideruar të parat buzore dhe të dytat dhëmbore.

Në qoftë se do donin të paraqitnin në një tabelë sistemin e gjuhës së përbashkët duke u nisur nga inventari i përbashkët i të gjitha varianteve të gjuhës, pamja e tabelës do të ishte kjo:

p	t	ts	tʃ	tc,	c	k
b	d	dz	dʒ	dz,	ɟ	g
f	θ	s	ʃ	φ	ɥ	χ
v	δ	z	ʒ	z,	ʝ	ɣ
m	n				ɲ	ŋ
					j	h
ɫ		ɾ				
		r r̄				

228. N.S.Troubetckoy, *Principes de phonologie*, Paris 1949, f.16.
229. R. Ismajli, *Ndërlidhësi* ..., f. 36.

Po të abstraktonim e të paraqitnim me anë të një skeme sistemin e gjuhës së përbashkët shqipe, jo sistemet e secilit variant që funksionon realisht, skema do të merrte pamjen e një paralelepipedi [230] të shtrirë, në të cilin faqja e sipërme dhe e poshtmja do të përfaqësonin planet e korrelacionit të zëshmërisë, të kundërvënies *të zëshme ~ të shurdhëta*, kurse faqja e parë dhe e prapmja do të përfaqësonin planet e korrelacionit të frikativitetit, të kundërvënies *mbylltore ~ shtegore*. Të këtillë skemë kanë edhe sistemet e varianteve dialektore të shqipes, por me dallime në çiftet e radhëve.



Skema nr 4

3.9.4. Gjatë krahasimit tipologjik të sistemeve të ndryshme të varianteve dialektore të gjuhës shqipe, krahas fonemave të vendosura sipas serive e radhëve, po japim edhe një formulë përmbledhëse. Me shifrat në fillim të formulës jepet numri i serive korrelative sipas mënyrës së formimit, me shkronja të mëdha jepen shkronjat nistore të korrelacioneve të sistemit dhe me shifra në fund të formulës jepet numri i radhëve sipas vendit të nyjëtimit, p.sh. formula 4 VF6 do të thotë: katër seri të korrelacionit të zëshmërisë (V)

230. R.Ismajli, duke llogaritur edhe korrelacionin me hundoret, nxjerr një skemë në formë prizmi me bazë pesëkëndëshi për sistemin e gjuhës letrare (shih *Fonemat morgjinale të sistemit bashkëtingëllor të shqipes*, në «Përparimi», 5, 1973, f. 141).

e të frikativitetit (F) dhe 6 radhë sipas vendit të nyjëtimit. Në fund të formulës në kllapa po shënojmë me shifra edhe numrin e fonemave që hyjnë në sistem, sepse shumëzimi i numrave 4 dhe 6 të formulës nuk e jep drejt numrin [231] e fonemave të sistemit.

Sistemi i gjuhës letrare përbëhet nga katër seri sipas korrelacionit të zëshmërisë e të frikativitetit dhe nga gjashtë radhë fonemash sipas vendit të nyjëtimit; formula e këtij sistemi është 4FV6 (20):

p	t	ts	tʃ	c	k
b	d	dz	dʒ	ɟ	g
f	θ	s	ʃ		
v	ð	z	ʒ		

Me gjuhën letrare përputhen plotësisht të folmet që përfshihen në arealet nr. 1, 2, 3 dhe 4 sipas dallimeve në inventar (shih hartën nr. 30). Përputhja është e plotë, sepse sistemet e tyre, jo vetëm që kanë të njëjtën formulë 4VF6, por edhe numrin e çifteve korrelative sipas radhëve e kanë gjithashtu të njëjtë. Në arealin nr. 1 për fshimë edhe të folmet e Çamërisë, sepse tingulli prapagjuhor i zëshëm shtegor γ që ekziston aty del vetëm në fjalë të huaja greke, pra është një variant stilistikor i fonemës *g*.

Nga gjuha letrare dhe nga të folmet e arealeve nr. 1, nr. 2 nr. 3, nr. 4 nuk dallohen për formulën edhe të folmet e arealeve nr.5, nr. 6, nr. 8, e nr. 9. Edhe këtu formula e sistemit është 4VF6, por numri i çifteve korrelative sipas radhëve del me diferenca, megjithëse me diferenca shumë të vogla. Kështu, sistemi i arealit nr. 5 në radhën e dytë, në atë të dhëmboreve, ka vetëm një çift mbylltoresh $t \sim d$, mungon çifti i shtegoreve θ∼ð, aty është shtuar një çift shtegoresh në radhën e prapagjuhoreve, ku në gjuhën letrare dhe në të folmet e njëjta me të ka vetëm një çift mbylltoresh, janë vetëm bashkëtingëlloret $k \sim g$:

p	t	ts	tʃ	c	k	
b	d	dz	dʒ	ɟ	g	4FV6(20)
f		s	ʃ		χ	
v		z	ʒ		γ	

231 Për mënyrën e krahasimit tipologjik të sistemeve shih A.Martinet, *Langue et fonction*, 1971, f. 117.

Në sistemin e të folmeve të arealit nr. 6 mungon çifti i mbylltoreve mesgjuhore $c \sim ɟ$, por ekziston një çift tjetër po mbylltoresh $\underline{tc,} \sim \underline{dz,}$ që hyn në grupin e mesgjuhoreve:

p	t	$\underline{ts}$	$\underline{tʃ}$	$\underline{tc,}$	k
b	d	$\underline{dz}$	$\underline{dʒ}$	$\underline{dz,}$	g 4VF6(20)
f	θ	s	ʃ		
v	ð	z	ʒ		

Në sistemin e të folmeve të arealit nr. 8 mungon gjithashtu çifti i mbylltoreve mesgjuhore $c \sim ɟ$, por po në atë radhë ekziston një çift shtegoresh mesgjuhore $ɕ \sim ʑ$:

p	t	$\underline{ts}$	$\underline{tʃ}$	k	
b	d	ds	$\underline{dʒ}$	g	v 4VF6(20)
f	θ	s	ʃ	ɕ	
v	ð	z	ʒ	ʑ	

Në sistemin e arealit nr. 9, në seritë e shtegoreve, ekziston një çift i radhës së mesgjuhoreve $φ \sim z$, ose $s' - z'$ (bashkëtingëllore të palatalizuara). Në të vërtetë këto dy bashkëtingëllore janë paragjuhore (palatalo-alveolare) dhe vendin në sistem do ta kishin në]një radhë me fonemat $\underline{tʃ} \sim \underline{dʒ}$, $ʃ \sim ʒ$, por, duke qenë se ato formojnë një çift të izoluar në atë radhë, nuk mund të formojnë seri të një korrelacioni tjetër (sipas tiparit palatal), ato radhiten në seritë e shtegoreve në radhën e mesgjuhoreve, për shkak të karakterit palatal që kanë:

p	t	$\underline{ts}$	$\underline{tʃ}$	k	
b	d	$\underline{dz}$	$\underline{dʒ}$	g	VF6(20)
f	θ	s	ʃ	φ	
v	ð	z	ʒ	z,	

Të folmet e arealit nr. 7 gjithashtu nuk kanë në sistemin e tyre çiftin e mbylltoreve $c \sim ɟ$, por dallohen prej të folmeve të arealeve nr. 6, nr. 8 dhe nr. 9, sepse aty radha e katërt përbëhet nga afrikatet

e prapme *tc,* ~ *dz,* dhe nga fishkëllyeset ʃ ~ ʒ e jo nga afrikatet e përparme *tʃ* ~ *dʒ* dhe fishkëllyeset ʃ ~ ʒ:

p	t	ts	tc,	k	
b	d	dz	dz,	g	4VF5 (18)
f	θ	s	ʃ		
v	ð	z	ʒ		

Gjeografikisht dallimet në sistem midis varianteve territoriale të shqipes mund të paraqiten përmbledhtazi me këtë hartë:



FUNKSIONI I FONEMAVE BASHKËTINGËLLORE

3.10.1. Midis të folmeve të gjuhës shqipe ka edhe dallime në funksionin e fonemave bashkëtingëllore, por ato janë të pakta në numër në krahasim me disa lloje të tjera dallimesh të sistemit fonetik

Ndërrimet e fonemave që në rrjedhën e të folurit shkaktohet nga fqinjësia e tingujve janë të përbashkëta për të gjitha të folmet e shqipes. Të këtilla janë neutralizimi i kundërvënies së zëshmërisë të fonemave bashkëtingëllore të zëshme para të shurdhëtave (broδa→ *briθte*) dhe të shurdhëtave para të zëshmeve (*skam* «s'kam»: *zbən* «s'bën»).

Njësia e mbarë shqipes në neutralizimin e kundërvënies së zëshmërisë të fonemave bashkëtingëllore thyhet pjesërisht prej të folmeve të çamërishtes, në të cilat, mdryshe nga të folmet e tjera dhe nga gjuha letrare, para sonantes hundore *m* të shurdhëtat nuk realizohen si të këtilla, por kthehen në të zëshme: *ʒizmə* «gjysmë *krizmə* «krismë», *kazma* «kasma» etj. [232]

3.10.2 Dallime në funksionin e fonemave ndërmjet varianteve dialektore të shqipes shihet në mënyrat e nkryshme të realizmit të fonemave *c* e *ʒ* pranë disa bashkëtingëlloreve të tjera të caktuara dhe në mënyrat e ndryshme të realizimit të fonemave bashkëtingëllore të zëshme në pozitë fundore absolute.

Në të folmet e toskërishtes jugore (Kurvelesh, Gjirokastër Bregdet, Çamëri) [233] neutralizohet kundërvënia e mesgjuhores bylltore *c* para dhëmboreve *t* e *n* dhe para buzores *m*: *mijtə*<*mictə* «miqtë» *vdijnə* <*vdicnə* «vdiqën», *pojmə* <*pocmə* «poqëm»). Kjo dukuri del edhe në disa të folme të diaiektit verior, si në të folmen e Kërabës [234], në të folmen e Matit [235], në atë të Reç-e-Darhhës së Dibrës dhe në të folmen e Malësisë së Madhe [236], por shihet se në këto të folme ajo është më tepër si një mbeturinë e një sistemi më të hershëm,

---

232. Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në «Dialektologjia shqiptare», I, f. 156.
233. M.Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, në Dialektologjia shqiptare, I, f.48; *Vëzhgime rreth të folmes së qytetit të Gjirokastrës*, në «SF», 1, 1966, f. 89; *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në «SF», 1, 1964, f.139; Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmet e banorëve të Çamërisë*, *në* «Dialektologjia shqiptare», I, f. 149, E.Çabej, *Për historinë* vazhdon shënimi i faqes paraardhëse nr. 258.
në e konsonantizimit në «BUSh, ShSSh», 3, 1958.
234. M. Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës*, në «SF», 2, 1966, f. 129.
235. B.Beci, *Hulumtime gjuhore e në Mat*, në «SF», 2, 1962, 1, f. 254; *E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës*, në «SF», 4, 1964, f. 145,
236. Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*, në «SF», 2, 1967, f. 41.

sepse norma fonetike nuk vepron rregullisht dhe rastet dalin më tepër në mënyrë fakultative.

Ky neutralizim i kundërvënies së *c*-së me *j*-në shfaqet edhe pas alveolareve dhe lveolare-dhëmboreve *ts, dz, s,* ʃ (në këto kushte merr pjesë në neutralizimin edhe e zëshmja ʒ, e cila nuk ka shkak për shurdhim): *tsjepar* < scepar, *sjup* < *scup* «sqep» *ʃjarθ* < *ʃcarθ* «shqarthi,» i *dzjuar* < i *zʒuar* / «*i zgjuar*,» *zjeδ* < *ʒeδ*. «zgjedhë» etj. kjo dukuri është karakteristike për të folmet e Kurveleshit [237], të Bregdetit të Poshtëm [238] dhe pjesërisht (në mënyrë fakultative) edhe për të folmen e Kërrabës në Shqipëri të Mesme.

Në të folmet e gegërishtes veriore nuk është i mundshëm nyjëtimi i faringales shtegore *h* para dhëmbores mbylltore *t*. Në këto kushte atje rregullisht ndodh neutralizimi i kundërvënies së karakterit faringal të kësaj foneme me karakterin dhëmbor-buzor të fonemës *f*: *ftoft* ← *ftoh*, *ŋgroft* ← ngroh etj.

Dukuria tjetër, e rëndësishme për nga shtrirja e saj gjeografike, është ajo e neutralizimit të kundërvënies së zëshmërisë së fonémave bashkëtingëllore në një pozitë fundore absolute të fjalës: *i maθ*: *i maδi*; *elp*: *elbi* etj. Kjo është karakteristike për gjithë të folmet e toskërishtes veriore, për të folmen e Kurveleshit, për të folmet kalimtare, për të folmet]e Shqipërisë së Mesme dhe për të ato të Malësisë së Madhe.

VARIANTET FONETIKE TË BASHKËTINGËLLOREVE.

3.11.1. Dallime thjeshtë fonetike absolute dhe të pakushtëzuara pothuajse mungojnë në të folmet e shqipes. Një rast të një dallimi fonetik e japin të folmet e gegërishtes veri ore që shtrih prej drinit e sipër, në të cilat bashkëtingëlloret shtegore fishkëllyese ʃ ~ ɜ nyjëtohen me fokusin e dytë të prapëm.

Edhe dallime fonetike të kushtëzuara nuk ka midis të folmeve të shqipes, sepse në përgjithësi sot bashkëtingëlloret në këtë gjuhë, në gjuhën letrare dhe në dialektet, ndryshe nga zanoret, nuk pësojnë aq ndryshime prej ndikimit të tingujve fqinjë ose prej pozitës së bashkëtingëllores në fjalë a në frazë. Ato dukuri që shihen në këtë drejtim janë të përbashkëta.

---

237. M.Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, f.48.
238 Po ai, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, f. 139.

3.12.1. Prej ndryshimeve fonetike që kanë pësuar disa bashkëtingëllore ose disa grupe bashkëtingëlloresh në të folme të ndryshme janë]formuar dallimet në përbërjen fonematike të fjalëve të caktuara. Atje ku janë bërë ndryshime është zëvendësuar një bashkëtingëllore me një tjetër ose është reduktuar fare një bashkëtingëllore, kurse atje ku nuk janë bërë ndryshime, është ruajtur ajo bashkëtingëllore që ka qenë e përbashkët dikur për të gjitha të folmet. Edhe këto janë të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Numrin më të madh e përbëjnë dallimet e pakushtëzuara.

3.12.2. **Dallimet e kushtëzuara.** - *Fonema* ɾ. - Të folmet e gegërishtes dhe të folmet kalimtare nuk kanë sot ɾ në mes]ë fjalës ndërmjet dy zanoreve dhe në fund të fjalës: *rãja* «rrënja», *gʃtẽja* «gështenja», *brĩja* «brinjë», *θoj* «thonj», *hũj* «hunj», *tə kcij* «të këqinj» etj.

Fonema j. — a) Në fund të fjalës, në mbaresën e foljeve të mënyrës dëftore koha e tashme veta e parë njëjës kanë fonemën *ɾ* shumica e të folmeve të toskërishtes veriore (veçohen këtu të folmet e Korçës e të Fushës së Korçës dhe ato të Pogradecit e Gorës): *laɾ* [239] «laj», *bəɾ* «bëj», *Iyeɾ* «*Iyej*» *paguaɾ* «paguaj» etj. Po kështu këto të folme kanë ɾ dhe në mbaresën e foljeve të vetës së tretë njëjës të mënyrës lidhore: *tə laɾ* «të lajë», *te piɾ* «të pijë», *tə lyəɾ* «të lyejë» etj.

Kjo dukuri duket si e kushtëzuar fonetikisht, sepse del vetëm në fund të fjalës, por këtu janë të mpleksura edhe dukuri gramatikore, mbasi lidhet me mbaresa foljesh. Kjo del qartë edhe nga fakti se në të folmet e tjera të toskërishtes (Korçë, Pogradec, Labëri, Çamëri) këto mbaresa foljesh dalin me *j*, kurse, në të njëjtën pozitë fundore, mbaresa e emrave në shumës dhe e mbiemrave del me *ɾ*.

Në një grup fjalësh, si *gojë, bijë, fëmijë, shkëndijë, nevojë, vaj* etj., ku shumica e të folmeve të shqipes dhe gjuha letrare kanë fonemën *j*, të folmet e çamërishtes dhe e folmja e Gjirokastrës (edhe ato të arbëreshëve të Italisë e të Greqisë) kanë fonemën l në vend të *j*-së: *golə, bilə, fəmilə, milə ʃkəndilə, nevolə, val* etj.

Këto të folme ruajnë një gjendje të hershme të gjuhës shqipe në këto fjalë, ku l-ja dikur ka qenë e palatalizuar dhe ka pësuar ndryshime duke u kthyer në bashkëtingëllore qiellzore shtegore në mbarë gjuhën shqipe.

Fonema h. a) Duke përjashtuar të folmet e zonës së Kolonjës, të Dangëllisë së Përmetit, pothuajse të gjitha të folmet e tjera]të toskërishtes veriore e kanë fenemën *h* vetëm në fillim të fjalës, nuk

239. Në raste të këtilla sot janë të ngërthyera)edhe dukuri morfologjike.



1. r > j në fund dhe në mes të fjalës
2. r > j në fund të fjalës të mbresat foljore.
3 r është ruajtur në të gjitha rastet.

Harta nr 35

del në mes dhe në fund të fjalës: *hekur, hi, ha* etj., por *krər* «krëhër», *vjeī* ose *vjeī* «vjehër», *ndim* «ndihmë», *laem* «lahem», *ro* «njoh», *ple* «pleh», *le* «leh» etj. Në anët e Mallakastrës e të Vlorës *h*-ja në mes të fjalës del në]mënyrë fakultative. Me të folmet e toskërishtes veriore afrohen në këtë rast edhe të folmet kalimtare të Shpatlt e të Vërçës.

b) Dikur duhet ta kenë pasur të gjitha të folmet e gegërishtes këmbimin e *h*-së me *f*-në para *t*-së, por mbeti si këmbim fonemash (neutralizim kundërvëniesh) vetëm në gegërishten veriore, sepse në gegërishten jugore për analogji *f*-ja u ruajt si fund i temës foljore edhe në forma ku nuk kishte *t* pas saj, si *ftofim, ftofa, ftofja,* dhe

përgjithësisht në çdo folje që]li mbaron tema me *h*, p.sh. *mif* < *mih*, *ʃof* < *ʃoh*. Kjo pastaj,]duke kaluar si tipar dialektor që lidhet me përbërjen fonetike të fjalës, u shtri edhe në disa emra, si *ʒynaf*, *tafmin*, *bafti*, por jo në raste si *ah-u*, *pleh-u* etj.

3.12.3. **Dallime të pakushtëzuara.** *Fonema r.* — Në një grup të caktuar fjalësh dhe ndajshtesash (mbaresa e prapashtesa) të gjitha të folmet e toskërishtes dhe përgjithësisht të folmet kalimtare kanë fonemën *r*, ashtu si edhe gjuha letrare: *vera*, *briri*, *rəra* «rëra», *emər* «emër», *lakər* «lakër», *plecəri* «pleqëri» (*kam*) *hapur*, *vlezər* «vllëllezër» etj. Në raste si këto të folmet e gegërishtes kanë]fonemën *n*: *vẽna*, *brĩni*, *rãna*, *ẽmən*, *lakən plecni*, (*kam*) *hapur*, *vlazən*, *hyna* etj.

Të folmet e gegërishtes, në këto raste, ruajnë gjendjen e mëparshme të përbashkët, kurse të folmet e toskërishtes pasqyrojnë ndryshimin e *n*-së ndërmjet zanoreve në *r*, rotacizmin, që është bërë shumë herët në këtë dialekt (shih § 3.19.1).

Për]nga shtrirja gjeografike rotacizmi ka rëndësi të madhe në degëzimin dialektor të shqipes, sepse e ndan truallin e saj në dy dialekte me disa tipare të tjera dialektore.

Fonema g. — Në shumë të folme të gegërishtes qendrore, sidomos në ato që shtrihen nga ana e majtë e rrjedhës së Drinit të Zi, në shumicën e fjalëve ku të folmet e tjera kanë fonemën prapagjuhore *g* ato kanë fonemën qiellzore mbylltore *ʒ* : *ʒarð* «gardh», *ʒastare* «gastare», *ʒur* «gur», *paʒuj* «paguaj», *vojʒuri* «vajguri», *zaʒar* «zagar», *burʒ* «burg», *viʒ* «vig», *larʒ* «larg», *de*:*ʒ* «degë» etj. Sipas të folmeve, diku më shumë e diku më pak, disa fjalë (jo të njëjtat në të gjitha të folmet) dalin me *g*, p.sh. *gazep*, *jergaºn* «jorgan», *i egər* «i egër», *zogu*, *guʃt* «gusht» etj. Nuk del se ka ndonjë kushtëzim fonetik në këto fjalë e në të tjera si këto. Tashti po vijnë duke u shtuar rastet e përdorimit të fonemës *g* në mënyrë fakultative, d.m.th. ka më shumë që i shqiptojnë herë me *g* e herë me *ʒ*. Pikërisht këto përjashtime dhe këto lëkundje bëjnë që të konsiderohet kjo dukuri si tipar dallues në përbërjen fonematike të fjalëve, po të mos ishin këto, d.m.th. po të mos dilte asnjë rast me *g*, dukuria do të konsiderohej e karakterit fonologjik, që do të lidhej me inventarin e fonemave në këto të folme, sepse do të mungonte fonema *g* në sistemin e tyre të bashkëtingëlloreve.

Fonemat c e ʒ. a) Në të folmet e gegërishtes qendrore (me përjashtim të së folmes së Krujës) bashkëtingëlloret c e *ʒ* kanë pësuar ndryshime dhe kanë dhënë afrikate paragjuhore *tʃ* e *dʒ* në të gjitha ato fjalë ku ato nuk vijnë prej grupeve *kl* e *gl*: *tʃa*:*f* «qafë», *cən* «qen», *tʃe*:*p* «qepë», *tʃit* «qit», *mustatʃe* «mustaqe», *e ketʃe* «e keqe», *nre tʃ*

«ndreq», *knatʃ* «kënaq», *mitʃ* «miq», *konatʃet* «konaqet», *mitʃ* «miq», *d͡ʒak* «gjak», *d͡ʒa:ʃt* «gjashtë», *d͡ʒeθe* «gjethe», *d͡ʒurm* «gjurmë», *lad͡ʒe* «lagje» etj. Megjithatë, fonemat *c* e *ʒ* nuk mungojnë në sistemin e bashkëtingëlloreve të këtyre të folmeve, sepse janë në fjalë ku kanë dalë prej zhvillimeve të mëtejshme të grupeve *kl* e *gl* (*caj* «qaj», *ʒu:h* «gjuhë» etj.), grupeve *tj* e *dj* (*cetri* «tjetri», *ʒa:l* «djalë» etj.) dhe prej zëvendësimit të g-së me *ʒ* (*ʒur* «gur», *zaʒar* «zagar» etj.).

Ndryshimet që kanë pësuar qiellzoret *c* e *ʒ* në të folmet e gegërishtes qendrore kanë bërë që vendin e tyre ta zenë afrikatet paragjuhore që kanë ekzistuar edhe më parë në këto të folme dhe që i ka mbarë gjuha shqipe. Për këtë arsye themi se në këto të folme, në këtë rast, janë formuar vetëm tipare dalluese në përbërjen fonematike të fjalëve ku *c*-ja dhe *ʒ*-ja janë ndryshe nga të folmet verilindore e disa të folmeve veriperëndimore, ku ato nuk dalin në asnjë fjalë dhe janë zëvendësuar me fonema të reja e të veçanta që kanë sjellë ndryshime në inventarin e fonemave bashkëtingëllore në ato të folme. b) Në fjalët ku *c* e *ʒ* vijnë prej ndryshimeve që kanë pësuar grupet e vjetra *kl* e *gl* gjendja sot nuk është e njëjtë nëpër të folmet e gjuhës shqipe.

Në çamërishte dhe në diasporën arbëreshe të Italisë e të Greqisë këto grupe: janë ruajtur deri në ditët tona *klaj* «qaj» *klumə̯ʃt* «qumësht», *kam klə̯ne* «kam qenë», *klisʃə̯* «kishë», *klutʃ* «kyç», *i glatə̯* «i gjatë», *glan* « ngjan», *glə̯mb* «gjemb» *zgleδ* «zgjedh» *gliʃt* «gisht» etj.

Të folmet e tjera të toskërishtes dhe të folmet e Shqipërisë së Mesme e të folmet e gegërishtes qendrore kanë *c* e *ʒ* në këto fjalë: *caj* ose *caṛ*, *kam cə̯n* ose *kam qẽ:n*, *i ʒat* etj.

Të folmet e gegërishtes veriperëndimore kanë grupet *kj* e *gj* në vend të grupeve përkatëse *kl* e *gl*: *kjaj*, *kjumʃt*; *gjuha*, *gjũni*, «gjuri», *i gja:t* «i gjatë » etj. por (*kam*) *kẽ:n* «kam qenë»

Të folmet e gegërishtes verilindore kanë përkatësisht *k* e *g* për *kl e gl*: *kaj* «qaj», *kumʃt*, *jam kã°n* «kam qenë», *i ga:t*, *i gan* «i ngjan» *gũni*, *guha*, *go:b* «gjobë» etj.[240]

Fonema δ. — Në të folmet veriore të gegërishtes, sidomos në anët skajore (Malësi e Madhe dhe anët e Shkupit përreth) në një numër të paktë fjalësh del fonema ł për fonemën δ: *o mał* «i madh», *u:ł* «udhë», *uła ma:r* «udha e mbarë» *Iap*«dhemb» etj. Në ndonjë rast kjo dukuri del edhe në anët e Kërrabës. Kufizimi vetëm në pak

240. Shih më hollësisht J.Gjinari, Për zhvillimin e grupeve *kl* e *gl* në të folmet e gjuhës shqipe, në «GJA», 1, 1971, f. 57-65.



Harta nr. 36

raste i zëvendësimit të δ-së me ł tregon se kjo dukuri sot mund të jetë mbeturinë e një areali, i cili diku ndodhej midis dy arealeve të ndryshme (një areal që e ruante δ-në dhe tjetri që e kishte zëvendësuar me ł-në). [241]

Fonema ł. — Në Gjirokastër, në Libohovë dhe në Delvinë brezi i vjetër shpesh nuk e shqipton këtë bashkëtingëllore e në vend

241. Nuk kemi të bëjmë në këtë rast me një neutralizim të kundërvënies së δ-së dhe ł-së, siç shprehet R.Ismalli (*art. i cituar*), sepse atje nuk shihet sot ndonjë kushtëzim fonetik që të lidhet me ndonjë normë të gjallë fonetike.

të saj shqipton ndërdhëmboren δ: δ*ambə* «llambë», δ*afosem* «llafosem», *avδi* «avlli», *ambreδə* «ombrellë», *doδap* «dollap», *i ʒaδə* «i gjallë» *kəδəf* «këllëf», *kaδi* «kalli», *peδg* «pellg», *deδ* «dell», *kaδi* «kalli», *tʃakaδ* «çakall», *mieδ* «miell» etj. Të jepet përshtypja sikur nuk ekziston fare fonema ł në të folmen e brezit të vjetër në këto vende, por në të vërtetë nuk është kështu, sepse herë-herë fjalë të ndryshme, sipas rastit, shqiptohet edhe me ł.

Brezi i mesëm dhe i riu, me sa duket, për të qenë në shpqiptim më te rregullt se sa duhet, nganjëherë zëvendësojnë δ — në me ʒ-në: ł*əmbi* «dhëmbi», *u głiʃ* «u gdhifsh», *erła* «erdha» etj[242].

242. *Shih M.* Totoni, *Vëzhgime rreth të folmes së qytetit të Gjirokastërës*, në «SF», 1, 1966, f.91-92. Lëkundjet, që vë në dukje autori i punimit, tregojnë për një rast përzierjeje, për një përdorim fakultativ në gjendjen e sotme.

II. NDRYSHIMET NË SISTEMIN E FONEMAVE GJATË HISTORISË SË DIALEKTEVE

VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM

3.13.1. Në këtë kapitull do të jepen ndryshimet që janë bërë gjatë kohëve në sistemin fonetik të dialekteve të gjuhës shqipe. Sigurisht, ndryshimet do të vështrohen brenda sistemit të fonemave për të nxjerrë në dukje lëvizjet që kanë ndodhur në sistemin fonologjik të dialekteve gjatë zhvillimit të tyre.

Vështirësia që lidhet me mungesën e të dhënave të pamjaftueshme për etapa të ndryshme të historisë së dialekteve bëjnë të pamundur që në këtë pjesë të jepet sistemi i fonemave në prerje kohore të ndryshme, duke u ngjitur shkallë-shkallë nga një etapë në tjetrën. Përgjithësisht vështrimi historik i dukurive dialektore do të bëhet duke marrë pikën e nisjes të një kohe të caktuar dhe pikën e mbërritjes të çdo dukurie. Aty ku do të jetë e mundur do të jepen edhe faktorët gjuhësorë, herë-herë edhe faktorët jashtëgjuhësorë që kanë ndikuar në ndryshimet fonetike të dialekteve.

Në këtë vështrim historik të fonetikës së dialekteve nuk mund të merret si pikë për krahasim sistemi fonetik i një kohe të dhënë të njërit dialekt (qoftë edhe i një të folmeje të vetme), sepse nuk ke mi sot të dokumentuar dialektin ose të folmen e asaj kohe të dhënë, nuk mund të merret as njëri dialekt në gjendjen e sotme, mbasi edhe e folmja më arkaike e një gjuhe nuk ka arritur në ditët tona plotësisht pa ndryshime e zhvillime. Gjithashtu si pikënisje nuk mund të merret as edhe një kohë e caktuar e mëparshme për të gjitha dialektet, sepse në çdo kohë të dhënë gjuha e përbashkët është paraqitur me dallime e variante sipas territoreve ku është shtrirë, veç kësaj, nga pikëpamja kronologjike ndryshimet fonetike nuk janë të gjitha të një kohe. Kështu, ndërsa rotacizmi (*vën / verë*) është

një ndryshim fonetik që ka përfunduar si proces gati njëmijë e treqind vjet më parë, kalimi i qiellzoreve mbylltore *c* e *ɟ* në afrikate *tʃ* dhe *dʒ* (*face* > *fatʃe* «faqe» dhe *ɟa:ʃt* > *dʒa:ʃt* «gjashtë») është relativisht i ri, jo më shumë se dyqind-treqindvjeçar.

Prandaj, për të parë ndryshimet fonetike të dialekteve dhe pasojat e tyre në sistemin e fonemave, si pikënisje për krahasim do të merret një njësi (një fonemë) ose një pjesë e sistemit (një korrelacion, një seri fonemah, një çift, një tufë etj.) e asaj kohe kur ajo ka qenë e përbashkët, e njëjtë, për mbarë gjuhën. Kjo dukuri e përbashkët, që do të merret si pikënisje nuk do të jetë e fazave shumë të lashta të historisë së gjuhës shqipe, por e fazave më të vona, e periudhës kur ishte formuar gjuha e sotme shqipe. P.sh. për variantet dialektore *χ*, *γ*, bashkëtingëllore shtegore prapagjuhore që janë karakteristike për të folme të zonës kodrinore midis Peqinit e Ndroqit, si pikënisje për krahasim do të merren ndërdhëmborët *th* [θ] e *dh* [ð], që erdhën deri në ditët tona në gjuhën e përbashkët shqipe (në dialekte e në gjuhë letrare) dhe jo grykoret palatale *k* e *g* ose fyshkëllyejsja *s* të fazës indoevropiane të shqipes prej nga kanë ardhur *th* e *dh* të shqipes së sotme.

3.13.2. Vështrimi i sistemit të fonemave me lëvizjet që ka pësuar në kohë është i domosdoshëm, sepse gjendja e sotme e këtij sistemi dhe vendi që zënë sot në hapësirë dukuritë dialektore shpjegohen me historinë e tyre.

Dallimet e sotme dialektore në sistemin e fonemave janë përfundimi ndryshimeve fonetike e fonologjike të bëra herë pas here në treva të ndryshme ku është shtrirë gjuha shqipe. Lëvizjet që janë bërë gjatë kohëve në sistemin e fonemave nëpër dialekte kanë pasur si shtysë faktorë të ndryshëm gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Diku dukuria fonetike ka marrë fill për shkak të zhvillimeve të brendshme të gjuhës dhe diku nuk është rezultat i një zhvillimi të këtillë të vetvetishëm, por një zëvendësim i tiparit fonetik të një të folmeje me tiparin e një të folmeje tjetër, për shkak të ndikimit të faktorëve politikë, ekonomikë, kulturorë. Faktorët jashtëgjuhësorë janë faktorët kryesorë, që u japin shtysën të dy llojeve të ndryshimeve gjuhësore në dialekte, ndryshimeve të vetvetishme, të brendshme të sistemit, dhe ndryshimeve me zëvendësim. Në një trevë dialektore, për shkak të veçimit të saj në një periudhë të caktuar, merr fill një dukuri e re gjuhësore, që nuk lind në treva të tjera, p.sh. diftongimi i zanores *i* në trevat e gegërishtes qendrore; në një të folme mund të ndodhë që të ndërpritet zhvillimi që ka marrë një dukuri në gjithë truallin e një gjuhe, p.sh. mbetja në fazën *kj*, *gj* e grupeve të vjetër

kl, *gl* të shqipes në gegërishten veriperëndimore, mund të ndodhë që në një trevë të shkojë më tej, të vazhdojë zhvillimi i një dukurie, që dikur ka marrë fill në gjithë truallin e gjuhës, por që është ndërprerë në shumicën e të folmeve të asaj gjuhe, p.sh. kalimi në *ə* i *a*-së së ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore në disa të folme të toskërishtes edhe në fjalë, si *tamam* > *tamem*, *askʃam* > *akʃəm* etj.; mund të ndodhë gjithashtu që në një trevë të mos marrë fill zhvillimi i një dukurie që pushton gjithë trevat e tjera të gjuhës, p.sh. ruajtja e l-së së palatalizuar në çamërishte (*gole* «gojë», *val* «vaj»), e cila në mbarë shqipen kaloi në *j*. Kur faktorët jashtëgjuhosorë shkaktojnë vetëm zëvendësim të tipareve, ky zëvendësim mund të bëhet duke marrë një e folme një tipar të ri të një të folmeje tjetër që ushtron ndikim mbi të, d.m.th. ai të jetë një zëvendësim progresiv, p.sh. zëvendësimi me *c*, *ʒ* — i grupeve *kl*, *gl* në krahinën e Devollit, ku ka gjasë që këto grupe të kenë qenë ruajtur deri vonë, por mund të ndodhë që zëvendësimi të ketë karakter regresiv, të sjellë një dukuri ruajtur në një trevë ku ajo më parë kishte marrë rrugën e zhvillimit ose ishte zhvilluar plotësisht, p.sh. shqiptimi në mënyrë fakultative herë me *ʒ* dhe herë me *g* (*go:j* dhe *ʒo:j* «gojë») në shumë të folme të gegërishtes qendrore ku kalimi i *g*-së në *ʒ* ka gjasë që të ishte kryer në një kohë të caktuar; mund të ndodhë gjithashtu në një trevë dialektore që zëvendësimi të mos bëhet i plotë, por pjesërisht të ruaj gjendjen e vet të hershme dhe pjesërisht të marrë tiparin e ri, zakonisht të një treve fqinje, p.sh. në zonën perëndimore të toskërishtes veriore (Myzeqe, Berat, Skrapar) zanorja *e* që ka qenë e pasuar nga një bashkëtingëllore hundore është ruajtur dhe shqiptohet rregullisht në disa fjalë, por është zëvendësuar me *ə* në disa fjalë të tjera (*e premte*, *femər*, *pe* dhe *cən* «qen», *brənda* «brenda» etj.).

Si rezultat i ndryshimeve fonetike të bëra herë pas here në treva të ndryshme të shqipes erdhën dhe u vendosën në dialektet e saj tipare dalluese në formë shtresash që u përkasin kohëve të ndryshme, duke nisur që nga shekujt e fundit të mijëvjeçarit të parë të erës sonë dhe duke arritur në një kohë më të re, deri para dy-tre shekujve.

Për studimin e ndryshimeve në sistemin e fonemave të dialekteve, duke bërë një analizë të gjerë të rrugëve dhe të shkaqeve të ndryshimeve që ka pasur në tërësi ky sistem dhe çdo element i veçantë i tij, do të duhej një punim më vete i plotë. Kjo do të ishte temë e një studimi të veçantë e të hapur. Ne këtu do të japim shkurt në fillim ndryshimet fonetike, duke përcaktuar llojin, karakterin e çdo ndryshimi dhe pikën e nisjes e të mbërritjes së tij. Pas këtij vështrimi të përgjithshëm do të bëjmë analizën e rrugëve dhe të shkaqeve të ndrysnieve që kanë pësuar disa fonema dhe seri fonemash duke zgjedhur disa nga dukuritë fonetike dialektore të rëndësishme.

Shihet se më i hapur për ndryshime ka qenë sistemi i zanoreve. Aty proceset fonetike kanë sjellë në dialekte dallime më të shumta, disa prej të cilave kanë prekur sistemin e fonemave në një masë më të madhe se në sistemin e bashkëtingëlloreve.

Duke shkuar deri në një fazë të gjuhës shqipe, ku mund të çojnë të dhënat e sotme të dialekteve, shohim se në një kohë, afërsisht në shekujt e fundit të mijëvjeçarit të parë të erës sonë, të folmet kanë pasur një sistem zanoresh më të thjeshtë, ka shumë gjasë që atëhere ato kanë pasur një sistem të përbërë vetëm me fonema zanore gojore me dy seri: me serinë e të shkurtrave dhe me serinë e të gjatave. Sigurisht që edhe atëherë kanë ekzistuar dallime të tjera fonetike në sistemin e zanoreve midis të folmeve, por në përgjithësi ato sot janë të panjohura për ne.

Ndër ndryshimet e para fonetike që shkaktuan një dallim relevant dialektor në gjuhën shqipe qe ai që çoi në lindjen e serisë së zanoreve hundore në grupin verior të të folmeve. Në raste të caktuara, para bashkëtingëlloreve hundore, zanoret gojore, sipas gjasave, janë shqiptuar me ngjyrim hundor si variante fonetike të kushtëzuara. Ky kushtëzim fonetik duket se ka qenë normë kudo në gjuhën shqipe, pra edhe në trevën ku sot shtrihen të folmet e dialektit jugor, sepse, përndryshe nuk mund të shpjegohet kalimi në *ə* i *a*-së së ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore në këto të folme. Me lindjen e serisë së fonemave, zanore hundore në dialektin verior, u krye një proces fonologjizimi, sepse variantet hundore të zanoreve gojore, që dalin në kushte të caktuara fonetike, u bënë zanore hundore të mëvetësishme, u kthyen nga variante fonetike në fonema të reja. Arealit verior të shqipes iu shtua kështu edhe seria e fonemave zanore hundore, që solli ndryshime në inventarin e fonemave zanore dhe në korrelacionet e tyre: zanoret dalloheshin tashti edhe sipas tiparit korrelativ të hundorësisë. Në dialektin jugor, bashkë me humbjen e varianteve fonetike hundore të zanoreve, u krye edhe një proces tjetër fonologjizimi me lindjen fonemës *ə*, që nuk ekzistonte deri atëhere në sistemin e zanoreve të theksuara dhe që pas kësaj zuri një vend të caktuar në sistem.

Humbja e serisë së zanoreve gojore, të gjata në të folmet e toskërishtes veriore u]shoqërua me një proces defonologjizimi, sepse dolën nga sistemi fonemat zanore të gjata, u zhduk korrelacioni i sasisë (të shkurtra~të gjata) dhe bashkë me këtë erdhi si rezultat edhe pakësimi i njësive në inventarin e fonemave zanore, u krijua një inventar minimal me gjashtë e diku me shtatë fonema. Në të folmet ku mbetën zanoret e gjata u ruajt sistemi me korrelacionin e gjatësisë, por, megjithatë, në të folme të ndryshme të këtij areali proceset fonetike që u kryen shkaktuan ndryshime të tjera jo shumë relevante: organizimin e zanoreve të gjata në një sistem katërkëndësh në gegërishten veriperë-

ndimore dhe dallime në përbërjen fonematike të së njëjtës fjalë, përgjithësisht në dialektin verior, ku për shkaqe fonetike dhe gramatikore u kthyen në të gjata zanoret e shkurtra (*ha:*~*hă*~*hă*) dhe variantet e tyre fonetike të mesme (*ha:n*~*hani*~*ha:n* nga *hamə*~*hani*~*hanə*) etj.

Në disa të folme të shqipes ka pësuar ndryshime zanorja *y* duke marrë dy drejtime kryesore: në të folmet e toskërishtes jugore dhe në anën lindore të gegërishtes qendrore ka dalë nga sistemi duke u zëvendësuar me fomenën *i* (në Jug dhe me *u*-në në disa raste), kurse në anët perëndimore të gegërishtes qendrore nuk është zëvendësuar me ndonjë nga fonemat e tjera ekzistuese të sistemit, por ku dalë një fonemë e re në vend të saj, ka dalë një zanore, po e klasës së mesme dhe buzore, por e ngritjes së mesme për nga shkalla e hapjes [ø]. Në këto të folme, në disa fjalë, ka mbetur edhe zanorja *y*, diku si zanore e mbyllur, diku pak më e hapur, por është e kushtëzuar fonetikisht nga tingujt fqinjë, pra është kthyer në variant fonetik i fonemës ø.

Në të dyja arealet ka ndodhur defonologjizimi i fonemës *y*, por me një dallim: në arealin ku u zëvendësua nga *i*-ja (ose edhe u-ja) u krye një proces defonologjizimi në aspektin funksional, doli *y*-ja nga inventari i fonemave dhe u zhduk kundërvënia korrelative e buzorësisë, gjithashtu aty lindën edhe dallime dialektore në përbërjen fonematike të fjalëve që më parë kishin zanoren *y* (*ki* «ky», *di* «dy», *duʃek* «dyshek» etj.); në arealin tjetër, veç defonologjizimit të *y*-së, u krye edhe një proces fonologjizimi me lindjen e fonemës ø, e cilhyn në kundërvënie me *e*-në sipas tiparit të buzorësisë (buzore~jobuzore), jo me *i*-në, me të cilën hynte më parë *y*-ja.

Grupet e dikurshme të zanoreve *ae* dhe *oe*, të cilat ka gjasë të kenë qenë të përbashkëta për mbarë gjuhën shqipe, morën rrugë të ndryshme në treva të ndryshme. Këto grupe zanoresh diku u ruajtën (në disa të folme të gegërishtes), disa (përgjithësisht në gegërishten veriperëndimore) nëpërmjet shkrirjes dhanë æ: (< ae), ø: (< oe) p.sh. θæ: < θae «the», *vø*: < *voe* «vezë», diku u reduktua plotësisht elementi i dytë i grupeve dhe ato përfunduan në *a*: (< ae) dhe *o*: (< oe), p.sh. θ*a*: < thae, *vo*: < voe, kurse në shumicën e të folmeve të shqipes përfunduan në *e* të dyja grupet ose nëpërmjet reduktimit të elementit të parë të çdo grupi, ose, çka ka më shumë gjasë, duke kaluar grupet gjegjësisht nëpër æ dhe ø.

Me përjashtim të arealit ku u ruajtën këto grupe, në të gjitha arealet e tjera ku pësuan ndryshime është kryer kudo defonologjizimi i tyre, sepse dolën nga inventari grupet e zanoreve *oe* dhe *ae* e bashkë me këtë u zhduk edhe kundërvenia e tyre me një fonemë përkatëse, p.sh. *ae*~*e*, *oe*~*o* etj. Ky proces u shoqërua edhe me pasoja të tjera për të folmet. Atje ku këto grupe dhanë æ: dhe ø: (geg. veripërëndimore) u krye edhe një proces fonologjizimi, sepse në sistemin e zano-

reve të gjata gojore lindën dy fonema të reja, të]cilat sollën edhe ndryshime në organizimin e fonemave zanore të gjata, krijuan një sistem katërkëndësh me një tufë të re korrelative katërshe:



Në të folmet ku dhanë *e* të dyja grupet edhe në të folmet ku njëri dha *a*: dhe tjetri *o*: u shkaktuan dallime dialektore në përbërjen fonematike të fjalëve, pra u bënë ndryshime vetëm në dendurinë e përdorimit të fonemave përkatëse: u rrit denduria e përdorimit të *a*:-së dhe *o*:-së në verilindje dhe denduria e përdorimit të *e*-së në toskërishte e në shumë të folme të gegërishtes jugore.

Zhvillimi që kanë pësuar zanoret *i* dhe *u* të theksuara në gegërishten qendrore, duke dhënë diftongje *ei̯*, *əi̯*, *ai̯* etj. dhe *au̯*, *ou̯* nuk ka sjellë ndryshime fonologjike, sepse diftongjet e dala prej tyre funksionojnë përgjithësisht si variante fonetike (ose edhe fakultative) të fonemave *i* dhe *u* që mbetën si të këtilla në sistem në të tria seritë e zanoreve. Aty dhe në disa të folme të tjera fqinje ka raste ku shihet se diftongjet e dala nga *i*.ja pasi kanë pësuar ndryshime të mëtejshme, janë defonologjizuar, kanë humbur funksionin si variante fonetike dhe kanë përfunduar në *e*, *a* etj. p.sh. *kuse* «kusi», *prał* «prill» (ka të folme ku variantet me *e*, *a* etj. përdoren në mënyrë fakultative). Në këtë rast pasojat e ndryshimeve nuk kanë pothuaj asnjë vlerë nga pikëpamja fonologjike, sepse kanë dalë dallime vetëm në përbërjen fonematike të fjalëve, sepse dalin me *e* ose me *a* ato fjalë që gjetkë janë me *i*.

Numri më i madh i dallimeve dialektore në sistemin e zanoreve lidhet me ndryshimet fonetike që nuk kanë prekur sistemin e fonemave në aspektin funksional. Përfundimet e këtyre ndryshimeve janë dy llojesh: një palë kanë dhënë vetëm variante fonetike të fonemave përkatëse, kurse një palë tjetër kanë shkaktuar zëvendësim fonemash ose reduktimin e plotë të një foneme në disa fjalë, sipas kushteve fonetike ku është gjendur.

Në rastet e dallimeve dialektore që lidhen me variante fonetike të fonemave proceset fonetike që janë zhvlluar gjatë kohëve kanë shkaktuar ndryshime vetëm brenda kufijve të po asaj foneme, është bërë vetëm një përshtatje e saj në timbër, d.m.th. kanë dalë variante fonetike të fonemës në disa kushte të caktuara fonetike, pra nuk janë

zhvilluar as procese fonologjike, as procese defonologjizimi. Në shumicën e rasteve përshtatja është bërë nën ndikimin e tingullit fqinj. P.sh. në të folmet perëndimore të Shqipërisë së Mesme *a*-ja gojore shqiptohet me timbër buzor dhe më e prapme pranë bashkëtingëlloreve hundore [*a*°], *ma*°*l* «mal», *dama*°*te* «domate» etj. Këto karakteristika tingullore e afrojnë më shumë *a*-në gojore të këtyre kushteve fonetike me zanoren *a*, e cila është e prapme dhe në shumë të folme edhe me timbër buzor. Kjo është arsyeja që varianti *a*° i zanores *a* gojore është transkriptuar si *ã*° nga hulumtuesit e dialekteve. Në të folmet veriore të gegërishtes, sidomos në ato të gegërishtes veriperëndimore, *a*-ja e ndodhur granë një bashkëtingëlloreje qiellzore shtegore dhe pranë paragjuhoreve *r* e *l* ka kaluar në një *a* me të përparme dhe më të mbyllur, (æ], p.sh. *prœp* «prap», *nælt* «nalt» etj. Po ashtu nën ndikimin e tingujve fqinjë kanë dalë dhe varantet dialektore të zanoreve të tjera: e (*e* e hapur), *i̯e* (diftongoid) të fonemës *e* gojore (*li̯eʃ* «*lesh*»), ø e fonemës *y* (*møt* < mbyt) dhe *o̞* (një *o* qendrore) e fonemës *o* (*gro*:ʃ «groshë»).

Veç ndryshimeve kombinatore që u përmendën, janë bërë edhe ndryshime pozicionale, jo për shkak të tingullit fqinj, por për shkak të pozitës së zanores brenda fjalës. Në disa të folme të gegërishtes veriperëndimore *o*-ja e shkurtër del me variantin ʌ në rrokje të mbyllur ose dhe të hapur në fjalë njërrokëshe (*sʌt* «sot», *jʌ* «jo»); në të folmet perëndimore të gegërishtes *e*-ja shqiptohet e hapur në rrokje të mbyllur nga bashkëtingëlloret ɫ r̄, ð (*si̯eɫ* «sjell», *hi̯eð* «hedh» etj.); togjet *ua, ya* dhe *ie* shqiptohen si diftongje (*ua̯, ye̯, ie̯*) në rrokje të brendshme të fjalës në toskërishten veriore (*duar*, por *dua̯, i θyer* «thyer», por *u θye* «thye», *die̯ɫ* «diell», por *u ndie*).

Përsa i përket moshës së këtyre ndryshimeve fonetike është vështirë të përcaktohet, sepse, duke qenë se ato janë variante fonemash, nuk janë pasqyruar në dokumentet e shkruara të gjuhës shqipe. Te «Formula e pagëzimit» e Pal Engjëllit del *e*-ja për *i*-në (*spertit* «shpirtit»). po në këtë rast mund të kemi të bëjmë me një zëvendësim fonemash (*i*→*e*), ashtu si sot në disa të folme të gegërishtes qendrore, ku duket refleksi i fundit i *i*-së i përftuar nëpërmjet fazës *i* > *ei̯*.

Edhe ndryshimet që çuan në zëvendësimin e një foneme me një tjetër, çka dalloi përbërjen fonematike të një fjale në të folme të ndryshme, kanë pasur si shtysë të parë ndikimin e kushteve fonetike, por në këto raste procesi fonetik shkoi më tej, u kalua në zëvendësimin e një foneme me një tjetër që ekzistonte edhe më parë. Për këtë varg ndryshimesh në disa raste kemi në fillim një proces thjesht fonetik, krijohen variante fonemash me përshtatje kombinatore (*ke* «që» >

> *kje* dhe *oboĩ* > *ʌboĩ* etj., pastaj vjen procesi i fonologjizimit të varianteve fonetike, d.m.th. shndërrimi i variantit të një foneme në një fonemë tjetër (*ke* > *kje* > *kie* dhe *obor* > *ʌbor* > *abor* etj.). Në raste të]tjera mund të jetë bërë kalimi drejtpërdrejt, pa fazën e përshtatjes dhe të fonologjizimit të variantit fonetik të fonemës, p.sh. *krimb* > *krym*, *məzat* > *muzat*, *hekur* > *hekər*, *punətor* > *puntor* etj. U bë ky kapërcim drejtpërdrejt, sepse timbri buzor që do të merrte, p.sh. zanore *i* nën ndikimin e tingullit fqinj buzor, hyn në kufijtë e një foneme tjetër, e cila dallohet prej disa tipareve relevante nga fonema që zëvendëson (*y*-ja dhe *i*-ja dallohen nga tipari i klasës, nga tipari i shkallës së hapjes dhe nga tipari i buzorësisë).

Shumica e ndryshimeve që lidhen me dallimet në përbërjen fonematike të fjalës çuan vetëm në shtimin ose pakësimin e dendurisë së përdorimit të fonemave ose të grupit të fonemave. Kjo shihet te ndryshimet: *i* > *y* (*li:m* «limë» > *ly:m*), *o* > *a* (*dołap* > *dałap*), *e* > > *ə* (*zemər* > *zəmər*), *e* > *ie* (*ʃke* > *ʃkie* «shqe», *ə* > *i* (*pə* > *pi* «një», *ə* > *u* (*məndafʃ* > munafʃ, *u* > *ə* (*flutur* > *flutər*), *e* > *reduktim i plotë* (*bukə* > *bu:k* ose *buk*, *triməni* > *trimni*, *gəzim* > *gzim*). Me kalimin e togjeve *ue* në *u*, *ye* në *y* dhe *ie* në *i*, në të folmet e gegërishtes, veç shtimit të dendurisë së përdorimit të *u*-së, *y*-së dhe *i*-së, ndodhi edhe defonologjizimi i togjeve të zanoreve, ato dolën nga inventari i togjeve dhe u zhduk kundërvënia e tyre me një zanore të vetme ose me togje të tjera. Me reduktimin e zanores së patheksuar ndërmjet dy bashkëtingëlloreve u shtua përdorimi i një grupi të caktuar bashkëtinëlloresh ose u formua një grup fonemash bashkëtingëllore që nuk ekzistonte, i cili tashti hyn në inventarin e grupeve dhe formon kundërvënie të reja. Së fundi, me reduktimin e plotë të zanores në fund të fjalës pas një bashkëtingëlloreje të zëshme, duke vazhduar të shqiptohen të zëshme bashkëtingëlloret në këto raste (*lug* < < lugə, *e verð* < e verðə etj.). u «trondit» norma e neutralizimit të kundërvënies së zëshmërisë në një fundore absolute të fjalës, ky neutralizim mbeti vetëm në rastet ku shurdhimi është i hershëm: *i maθ* < i mað, *elp* < elb etj.

Ndryshimet që kanë sjellë zëvendësim fonemash mund të pasqyrohen në dokuentet e shkruara në qoftë se gjuha e dokumentit i ka qëndruar besnike dialektit. Kjo duket edhe në dokumentet e vjetra të shqipes, sidomos në ato që vijnë fill pas Buzukut, meqë edhe shumë prej këtyre zhvillimeve fonetike të dialekteve janë relativisht të reja.

3.14.2. Në sistemin e bashkëtingëlloreve kanë ndodhur ndryshime fonetike që kanë sjellë në të folmet e shqipes disa dallime, të cilat lidhen me inventarin e fonemave, me funksionin e tyre dhe me raportet e kundërvenies së disa çifteve, për shkak të ndërrimit të vendit të tyre në radhët e sistemit.

Ndryshimet që lidhen me inventarin e fonemave janë rezultat i proceseve fonetike që kanë shkaktuar dallime në kundërvëniet e disa fonemave në të folme të ndryshme.

Kështu, fonema h, duke qenë e veçuar në sistem, pa shoqe të zëshme në serinë e frikativeve, në disa të folme (Berat, Korçë, Dibër) u zhduk, sepse u ndie i tepërt tipari i saj i shurdhët. Kjo solli që *h*.-ja në ato të folme të defonologjizhet, në kuptimin që të humbasë krejt dhe të zhduket atje kundërvënia e shumanshme e veçuar, në të cilën hynte ajo më parë me fonemat e tjera.

Me defonologjizimin që pësoi fonema r̄ (rr) duke dalë nga sistemi i bashkëtingëlloreve në disa të folme (Berat, Korçë, Dibër e përgjithësisht në qytetet e Jugut), u zhduk kundërvënia e dyanshme e saj me fonemën *r* dhe u prish tufa trigjymtyrëshe l, mbeti vetëm kundër-

vënia e fonemës *l* anësore me *r*-në dridhëse. r — r̄

Edhe në disa të folme verilindore (Tropojë, Rrafshi i Dukagjinit), ku fonema ɲ ka dhënë një grup bashkëtingëlloresh *n* + *j* (kjo e fundit si variant fonetik i *j*-së), ka ndodhur defonolizimi i ɲ-së, është zhdukur, ka dalë kjo fonemë nga kundërvënia e shumanshme me fonemat e tjera dhe është rritur në ato të folme denduria e përdorimit të fonemave *n* dhe *j*.

Atje ku në vend të fonemave ndërdhëmbore θ∼δ janë prapagjuhoret χ∼ɣ (zona kodrinore midis Peqinit e Kavajës) kanë ndodhur ndryshime vetëm në tufat e sistemit: është zhdukur tufa katërgjymtyrëshe e dhëmboreve t—d dhe është formuar një tufë tjetër katërgjym-

θ δ

ytrëshe k—g, por në radhën e prapagjuhoreve ku më parë ekzistonte

χ ɣ

vetëm çifti i bashkëtingëlloreve k-g,. Në të folmet ku mesgjuhoret mbylltore *c* dhe ɟ kanë kaluar në mesgjuhore shtegore ɟ dhe ʝ (Tropojë, Rrafshi i Dukagjinit, zona veriore e Mirditës) ka lindur një kundërvënie e re midis këtyre dhe fonemës *j*, e cila për këtë shkak ka hyrë këtu në sistem, është futur në serinë e shtegoreve të zhurmëta dhe ka formuar tufën tringjymtyrëshe ɟ ʝ; në disa të folme të tjera (në Koso-

j

vë, Dukagjin), me lindjen e afrikateve të prame *tc*, e *dz*, në vend të mesgjuhoreve qiellzore *c* e ɟ, ka hyrë në sistem një çift i r̄i̯ po në serinë e mbylltoreve dhe po me kundërvënien e zëshmërisë (kjo ka ndodhur edhe atje ku kanë përfunduar në *tc*, dhe *dz*, edhe afrikatet e përparme t͡ʃ dhe d͡ʒ), ndërsa atje ku kanë dalë shtegoret fishkëllyese të palatali-

zuara ʒ dhe *dz*, në vend të çiftit *c*-ʒ, është formuar në sistem kundër venie e re e shumanshme dhe përpjestimore midis këtyre fishkëllzuesve të paletalizuara dhe fishkëllueseve jo të palatalizuara. ʃ dhe ʒ, që ekzistonin edhe më parë.

Në të folmet ku I-ja e palatalizuar e dikurshme ka dhënë j(*gol'*> >*goj*. «gojë», val> vaj); atje ku ɾ-ja e ndodhur ndërmjet dy zanoreve dhe në fund të fjalës ka dhënë *j* (*briɾa* > *brija*, *laɾ* > *laj*) dhe atje ku n-ja ndërmjet dy zanoreve ka dhënë *r* (*vẽna* > *vera*) nuk kanë ndodhur proçese të karakterit fonologjik, në kuptimin që të kenë lindur fonema të reja, sepse bashkëtingëlloret *j* dhe *r* të ardhura nga bashkë tingëlloret *l*, ɾ dhe *n*, kanë qenë edhe më parë si fonema në këto të folme. Por në këto ndryshime është zhvilluar edhe një proces fonologjizimi po të kemi parasysh se *l'*-ja, ɾ-ja ndërmjet zanoreve e në fund të fjalës dhe *n*-ja ndërmjet zanoreve e kanë humbur funksionin e tyre si variante të kushtëzuara fonetike qoftë atje ku dhanë fonema të tjera (*l'*>*j*, *ɾ*>*j*, *n*>*r*), qoftë edhe atje ku u ruajtën, mbasi edhe në këto të folme ato nuk funksionojnë sot si variante fonetike të fonemave gjegjëse. Ky ndryshim njëkohësisht solli pasoja edhe në dendurinë e përdorimit të disa fonemave: u pakësua denduria e fonemave *l*, *ɾ*, *n* dhe u rrit denduria e fonemave *j* dhe *r* atje ku u bënë ndryshime.

Ndryshimet që kanë pësuar grupet *mb*, *nd*, *ng*, *nʒ*, *tj*, *dj*, *nj*, *pl*, *bl*, *fl* në disa të folme lidhen me një proces defenologjizimi, sepse. duke dalë nga inventari këto grupe fonemash, është zhdukur edhe kundër venia e tyre me fonemat përbërëse, p.sh. *mb*~*m*, *nd*~*n*, *pl*~*p*. etj. Gjatë zhillimit të grupeve *ng* dhe *nʒ*, veç defonologjizimit, u krye edhe një proces fonologjizimi, sepse *n*.-ja, si variant fonetik me timbër grykor para g-së dha një foneme të re, një bashkëtingëllore grykore sonante [ŋ], kurse varianti me timber qiellzor para ʒ-së u kthye në (ɲ), në një fonemë ekzistuese. Me daljen e fonemës ŋ në sistem, në të folmet e gegërishtes dhe në të folmet e labërishtes lindi një kundërvënie e re, një kundërvënie e shumanshme e ŋ-së me fonemat e tjera. Zhvillimet fonetike që pësuan të gjitha grupet sollën në dialekte edhe dallime që lidhen me dendurinë e përdorimit të fonemave. Kështu është rritur denduria e përdorimit të disa fonemave në të folmet ku grupet kanë përfunduar në një fonemë të vetme: *m* (<*mb*), *n*(<*nd*), përgjithësisht në të folmet e gegërishtes (*m*, *n* edhe në labërishte), ɾ (<*mb*), *t*(< nd) në Malësi të Madhe, *g* (< ng) në Malësi të Madhe dhe në disa të folme të gegërishtes qendrore dhe *tʃ* (< pl), *dʒ* (< *bl*), në anën lindore të gegërishtes qendrore; po ashtu është rritur denduria e grupeve *ndʒ* , *pj*, *bj*, *fj* në të folmet ku grupet *nʒ*, *pl*, *bl*, *fl* kanë ndryshuar duke dhënë një grup fonemash: *ndʒ* (< *nʒ*) në gegërishten verilindore dhe *pj* (< pl), *bj* (< bl), *fj* (< fl) në anën lindore të gegërishtes qendrore.

Një rast më i veçantë shihet në zhvillimin e grupeve *kl* e *gl*. Atje ku pësuan ndryshime këto grupe kemi të bëjmë me një defonologjizim në kohën kur u krye ky proces, sepse grupet dolën nga inventari i grupeve të fonemave, ndërsa nga pikëpamja sinkronike nuk kemi të bëjmë me një proces të këtillë fonologjik, sepse sot në këto të folme ekzistojnë grupet *kl* e *gl* në fjalë të huazuara relativisht vonë ose në fjalë të tjera të formuara brenda shqipes pas ndryshimeve që kishin pësuar këto grupe (krahas rasteve *cumə∫t* < *klumə∫ht* ka edhe: *sklep*, *pikla etj.*).

Ndryshimet fonetike në sistemin e bashkëtingëlloreve kanë pasur dhe pasoja fonologjike që lidhen me neutralizimin e kundërvënies së fonemave në disa kushte të caktuara foketike. Kështu është neutralizuar kundërvenia *mbylltore~shtegtore* e fonemave c e ʒ me *j*-në aty ku sot nuk realizohen *c* e ʒ para *t*-së, *n*-së, *m*-së ose pas *t͡∫*-së, *t͡s*-së, *s*-së, *∫*-së. Në të folmet ku është e gjallë një normë e këtillë fonetike është bërë edhe një lëvizje në sistem, aty fonema *j* ka dalë nga skajet dhe ka hyrë në sistem me një kundërvënie të dyanshme mungesore (privative) me *c*-në dhe ʒ-në. Është neutralizuar kundërvënia korrelative e zëshmërisë në një pozitë fundore absolute atje ku nuk realizohen bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës, kurse në të folmet ku nuk realizohet *h*-ja para *t*-së është neutralizuar kundërvënie e shumanshme e fonemeve *h* dhe *f*.

Neutralizimi i kundërvënies midis *h*-së dhe *f*-së para bashkëtingëres *t*, i cili është sot normë vetëm për gegërishten veriore, ka qenë veçori edhe për të folmet e tjera të gegërishtes, por, ndërsa në gegërishten veriore kjo dukuri mbeti si një ndërrim kombinator fonemash, si një dukuri që lidhet me funksionin e fonemave, në të folmet e tjera ndodhën ndryshime të mëtejshme për shkak se në procesin fonetik ndërhynë edhe procese morfologjike (analogjie). Këtu *f*-ja e ardhur nga ndërrimi i *h*-së në temat foljore fjalëformuese të ndjekura nga ndajshtesa (prapashtesa) *-të* (*ftof-të*) u konsiderua si fundore e temës foljore dhe u shtri për analogji në gjithë paradigmën e foljes: *ftof*, *ftofim*, *ftofa*, *fotofja* etj. Prej këtej *f*-ja u shtri edhe në folje të tjera që u mbaronte tema me *h*, por që nuk hynin në forma ose në fjalë me prapashtesën *-të* ku do të kishte mundësi të ndërrohej *h*-ja me *f*-në, p.sh. *mif*<*mih* *∫of*<*∫oh* etj.

Pas ndërhyrjes së faktorëve gramatikorë, kalimi i *h*-së në *f* nuk ishte më i kushtëzuar fonetikisht. Ndryshimet që u bënë pas kësaj nuk ishin të karakterit funksional, nuk lidheshin me neutralizim kundërvëniesh, por me zëvendësimin e një foneme me një fonemë tjetër ekzistuese në disa fjalë të caktuara, pra u formua në këtë rast një dallim dialektor që lidhet me përbërjen fonematike të fjalëve, u

rrit në këto të folme denduria e përdorimit të fonemës *f* dhe u pakësua denduria e përdorimit të *h*-së-

Dukuria e neutralizimit të kundërvënies së zëshmërisë në fund të fjalës po kalon sot një fazë kapërcimi, sepse, ndërsa dikur nuk kishte mënyrë tjetër zgjedhjeje, e zëshmja patjetër kthehej në të shurdhët në një pozitë fundore absolute, sot pasojat e kësaj dukurie dalin rregullisht vetëm në një numër fjalësh të caktuara, vetëm në ato fjalë ku shurdhimi ka vepruar prej kohësh, kurse në fjalë të tjera nuk shfaqet fare. Pra në të folmet ku është karakteritike dukuria e shurdhimit shihet sot se një fonemë funksionon në dy mënyra në të njëjtat kushte fonetike, p.sh. *i maθ* < *i maδ*, *elp*<*elb* dhe *i barδ*<*i byrδə*, *deg*< <*degə* etj.

Dalja e tingujve γ dhe *h'* (*h* e palatalizuar) në çamërishte nuk e ka prekur sistemin e fonemave bashkëtingëllore, mbasi ata janë variante fonemash, γ-ja është varianti stilistikor i *g*-së, sepse del vetëm në fjalë të huazuara nga greqishtja, dhe *h'*-ja është variant fonetik i *h*-së, sepse del vetëm para zanoreve *i* dhe *e*.

Po të krahasohen dallimet fonetike të të folmeve sipas kriterit fonologjik, d.m.th. sipas asaj se sa e kanë prekur sistemin dhe funksionin e fonemave, shihet se pjesa më e madhe e tyre, si në sistemin e zanoreve, ashtu edhe në sistemin e bashkëtingëlloreve, janë nga ato që lidhen me përbërjen fonematike të fjalëve dhe me variantet fonetike të fonemave.

NDRYSHIMET NË SISTEMIN E ZANOREVE

ZANORET HUNDORE TË GEGËRISHTES DHE *ə*-ja E THEKSUAR E TOSKËRISHTES

Zanoret hundore, si tipar i gegërishtes, dhe *ə*-ja e theksuar, si tipar i toskërishtes, do të vështrohen bashkë, sepse *ə*-ja e dialektit jugor është e lidhur historikisht me sistemin e zanoreve hundore të dialektit verior.[243] Kjo lidhje shihet edhe sot nga një krahasim i thjeshtë i dy dialekteve: atje ku gegërishtja ka *ã*, të gjitha të folmet e toskërishtes kanë *ə* (*zã*/*zə*, *bãn*/*bən*, *rãj*/*rəɲə* etj., dhe atje ku gegërishtja ka ẽ,të folmet e toskisërhtes jugore kanë *ə* në të gjitha rastet, të folmet e anës së Korçës i përgjigjen asaj pothuaj vetëm me *e*, ndërsa të fol-

243. G. Meyer, *Albanisèhe Stusien*, III; E. Çabej, *Fonetika historike*, II, Tiranë 1959, f. 59-60.

x x

met e tjera të toskërishtes veriore pjesërisht i përgjigjen me *e* (*pe, fle, emer, e ɛɳte, e premte*) dhe pjesërisht me *ə* (*zəmər, cən, ðen, brenda, vənt* «vend», *mənt* «mend», *ndəɲa* «ndenja» etj.).

3.15.1. Për të shkuar deri te lidhjet që ka pasur *ə*-ja në historinë e zhvillimit të vet me zanoret hundore, është e domosdoshme të shihet së pari gjendja e sotme e zanoreve hundore në dialektin verior.

Me gjithë dallimet jo të rëndësishme që kanë sot të folmet e gegërishtes për intensitetin e hundorësisë dhe për numrin e rasteve me zanore (fonema) hundore, vihet re, se, me përjashtim të dy-tri të folmeve anësore, siç janë e folmja e Dibrës dhe e folmja e Ulqinit, përgjithësisht sistemi fonetik i gegërishtes karakterizohet nga kundërvënia e fonemave zanore gojore me fonemat hundore. Serinë e zanoreve hundore e kanë edhe të folmet kalimtare [244] të Dumresë, të Darësisë së Peqinit, të Shpatit, të Brregdetit të Poshtëm të Kavajës dhe të pjesës veriore të Sulovës. Zanoret hundore në gegërishte dalin sipas rasteve edhe të gjata, edhe të shkurtra, por duke qenë se të shkurtrat kanë një dendruri shumë të vogël përdorimi, do të pranonim në korrelacionin e hundorësisë vetëm zanoret e gjata[245]: i; y: e: a: u:

i: ỹ: ẽ: ã: ũ:

Gegërishtja, si një tërësi të folmesh, nuk paraqitet në vetvete homogjene edhe për nga hundorësia, shihen aty dallime ndërmjet grupeve të të folmeve, por jo të atilla që të shkaktojnë ndarje të theksuara në sistemin e fonemave të këtij dialekti.

Së pari, duhet thënë se në përgjithësi nuk shihen dallime që lidhen me organizmin e fonemave në sistem. Në pjesën më të madhe të bllokut verior të gjuhës shqipe zanoret hundore formojnë nje sis-

---

244. Q. Haxhihasani, *Një vështrim mbi të folmen e krahinës së Sulovës*, në «BUSH SSHSH», 3, 1963, f. 259-261; M. Çeliku, *Vëzhgim mbi të folmen e Dumresë*, në «BUSH, SShSh, 2, 1963, f. 259-261; *Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*, në «SF», 4. 1965, f. 91-129: *E folmja kalimtare e Shpatit* në «Dialektologjia shqiptare» I, Tiranë, 1971, f. 200-202; *Të folmet e Kavajës* në «Dialektologjia shqiptare», II, Tiranë 1974, f. 140-141.

245. A. Dodi, në artikullin *Rreth sistemit vokalik të shqipes*, në «BUSh, SShSh», 3, 1967, f. 139-146 thotë se zanoret hundore në gegërishte janë zakonisht të gjata, por gjatësinë ai e konsideron si tipar tepërues nga pikëpamja fonologjike; J. Gjinari në *Dialektologjia shqiptare* (dispencë), Tiranë, 1975 pranon për gegërishten një sërë fonemash hundore, por duke mos i përcaktuar për nga tipari i gjatësisë; R. Ismajli, *Grafia e Bu-ukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes*, në «GJA», 1977 f. 27 përfshin në korrelacionin e hundorësisë vetëm zanoret e gjata.

tem [246] katërkëndësh: aty mungon zanorja *o* hundore, vendin e saj në sistem e zë *a*-ja, e cila, meqë në përgjithësi është e prapme dhe e buzorëzuar (vende-vende ndihet gati si *o*-ja), radhitet në klasën e prapme së bashku me *ũ*-në (shih tabelën e mëposhtm).



Duhet thënë gjithashtu në përgjithësi se ngjyrimi hundor i zanoreve në të folmet lindore të Shqipërisë së Mesme është më i dobët se në të folmet e tjera të gegërshtes. Ka të ngjarë që me këtë të shpjegohet fakti që në këtë areal juglindor të gegërishtes zanoret hundore mbetën gati po me atë shkallë të hapjes si zanoret gojore[247].

Ndërmjet të folmeve të gegërishtes shihen dallime të tjera që lidhen me numrin jo të njëjtë të rasteve të përfshira nga hundorëzimi. Këto dallime e gjejnë shpjegimin te disa procese gramatikore dhe fonetike që nuk kanë vepruar kudo njësoj.

Dihet se pothuaj në të gjitha të folmet e gegërishtes ka vepruar analogjia, si dukuri gramatikore, p.sh. në emrat: *uli-ni, drũ-ni, sỹ-ni* sipas modelit të emrave: *mulĩ-ni, hũ-ni, drỹ-ni* etj. dhe në pjesoret e disa foljeve, si (me) ʃĩ: «shirë», (*me*) *vaθũ*: «vathuar», sipas modelit të foljeve me *n*, si (*me*) *bă* «bërë», etj.

Krahas këtyre rasteve pothuaj të përbashkëta, kjo dukuri, herë sipas një modeli dhe herë jo sipas një modeli njësimi, ka përfshirë edhe raste të tjera që në të folme të ndryshme nuk janë të njëjta për nga numri dhe kategoria gramatikore së cilës i përkasin. Kështu në të folmet veriore të gegërishtes dalin me zanore hundore edhe disa folje

246. Ky është sistemi më i përgjithshëm i gegërishtes, por në të vërtetë disa grupe-të fo.mesh kanë diferenca në inventar, e për pasojë kanë edhe sisteme të ve, çanta, kështu të folmet lindore të gegërshtes qendrore, ku mungon fonema *y* kanë një sistem me katër fonema hundore *i, e, u, a*, e folmja e zonës verior të Llapit (Kosovë) ka një sistem të reduktuar në dy fonema: *e—a*.

247. Kjo shihet sidomos te timbri i *e*-së, e cila këtu, ndryshe nga të folmet më veriore, nuk del me variante më të hapura, të cilat në të folmet e skajit verior arrijnë deri në *ɛ̃*.

të tjera në formën e pjesores, si (*me*) *cetũ*, (*asht*) *trenũ*, (*me*) *nigiũe* etj. dalin gjithashtu më shumë emra femërorë oksitonë, si *kusĩ*, *tepsĩ*, *gjiũ* ose *gũ* «gjuhë» etj., kurse në të folmet e gegërishtes jugore me zanore hundore për analogji, foljet dalin më shumë në kohën e tashme: *ʃĩj*, *flẽj*, *ʒẽj* etj.

Veç analogjisë, kanë vepruar edhe faktorë fonetikë, që kanë sjellë diferenca në numrin e rasteve me zanore hundore. Faktorë të këtillë kanë bërë që të veprojë për një kohë më të gjatë procesi i hundorëzimit të zanoreve pranë një bashkëtingëlloreje hundore, ose u rigjallërua kjo normë fonetike në një kohë pasi ishte formuar seria e fonemave zanore hundore në mbarë gegërishten. Kështu sot në të folmet e gegërishtes jugore perëndimore zanorja *a* zakonisht realizohet hundore, në një masë të mirë edhe e labializuar kur gjendet para bashkëtingëlloreje hundore: *akʃãm*, *ʃejtãn*, *niʃãn*, *plãn*, *nãm*, etj. Në disa të folme të kësaj zone kjo dukuri konstatohet edhe për zanore të tjera: *nĩm* «ndihmë» dhe *θõj* «thonj», *peĩẽj* «përrenj».

Duke filluar prej Kruje, në të folmet e Shqipërisë së Mesme numri i fjalëve me zanore hundore vjen e bëhet më i madh, sepse aty janë hundorëzuar zanoret edhe në rastet kur kanë qenë pas bashkëtingëllores hundore ɾ, e cila më vonë është kthyer në shtegore *j*: *dyjãja* (dynjaja), *jãł* (ngjall), *jõfta* (njofta «njoha»), *fəĩł*<*fəɾił*<*fənʒił* «thëngjill», ĩ (< *ni* «një», *ĩtet* <*ɾitet*<*ɾitet* «ngjitet» etj.

Duke qenë se seria e fonemave zanore hundore ekziston në të gjitha të folmet e gegërishtes, del se dallimet e përmendura më sipër për të folmet e këtij dialekti janë dallime dialektore jo funksionale, dallime që lidhen vetëm me dendurinë e daljes së zanores hundore: diku dalin në një numër më të madh fjalësh e diku në një numër më të vogël. Siç u pa edhe nga rastet e shqyrtuara më sipër, del se fonemat hundore kanë një denduri më të madhe në të folmet e gegërishtes jugore, sidomos në të folmet e Shqipërisë së Mesme.

3.15.2. Siç dihet, në toskërishte mungon korrelacioni i hundorësisë për zanoret, Është e ditur gjithashtu se fonema *ə* është karakteristike vetëm për dialektin jugor të gjuhës shqipe, ajo mungon, nuk del në asnjë të folme të dialektit verior, Në këtë rast diferenca midis dy dialekteve është fonologjike, prek sistemin e fonemave të tyre.

Edhe të folmet e toskërishtes kanë dallime midis tyre për zanoren *ə*, por jo të rëndësishme për sistemin e fonemave. Së pari, vihet re se në të folmet perëndimore të toskërishtes, d.m.th. në të folmet e anëve të Beratit, të Myzeqesë, të Mallakastrës, të Tepelenës, të Vlorës dhe të Kurveleshit ka *ə* në vend të *a*-së në një numër fjalësh t ë caktuara[248],

248. Kjo dukuri është kufizuar vetëm në raste të këtilla, nuk janë përfshirë fjalë të tipit: *çoban, stan, stopan* etj.

përgjithësisht në fjalë të huazuara prej turqishtes, si *akʃəm* «aksham», *təməm*, *həməm*, «hamam», *piʃmən* «pishman», *Osmən* «Osman», *ałafrənga* «allafranga», *men* «man» etj. Së dyti, vërehet se të folmet e toskërishtes jugore kanë *ə* në të gjitha ato raste ku gjuha letrare ka *e* që ndiqet ose që ka qenë ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore, p.sh. *cən* «qen», *mənt* «mend», *pəndə* «pendë», *pə* «pe», *frə* «fre» etj., në të folmet e toskërishtes veriore, me përjashtim të të folmeve të zonës së Korçës, *ə*-ja në fjalë të tilla nuk është përgjithësuar te të gjitha rastet, disa fjalë dalin rregullisht me *ə* e disa me *e*, p.sh. *zəmər* «zemër», *ðən* «dhen» etj., por *pe*, *fre*, *e eṛte*. Në zonën e Korçës, veç ndonjë rasti, fjalë si këto kanë *e*. Në raste të tilla kemi të bëjmë me dallime që lidhen vetëm me diferenca në dendurinë e përdorimit të fonemës *e*. Fakti që diku në raste të caktuara përdorin *e* e diku *ə* ose *e* nuk është i rëndësishëm për sistemin e fonemave, sepse të dyja këto zanore ekzistojnë si fonema në të gjitha të folmet e toskërishtes.

3.15.3. Nga të gjitha këto del se rëndësi të dorës së parë për sistemin fonologjik të dy dialekteve kanë kundërvëniet /ə/~ /ã/ dhe /ə/~ ~ /ẽ/ (kjo e fundit jo për mbarë toskërishten). Në këtë rast kemi të bëjmë me një dallim që prek sistemin e fonemave të toskërishtes dhe të gegërishtes. Duke qenë se *ə*-ja e toskërishtes vihet përballë ã-së dhe *ẽ*-së të gegërishtes, është e rëndësishme të shihet se ç'lidhje ka ajo nga pikëpamja historike (etimologjike) me këto dy fonema hundore të gegërishtes. Shihet se në këtë pikë të dy dialektet kanë shkuar krah për krah njëri-tjetrit: atje ku gegërishtja e ka kthyer në ã një *a* të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore, toskërishtja ka *ə*, p.sh. *ʒãː*~*ʒə*, *hãːn*~*hənə* etj., atje ku në gegërishte *a*-ja ka mbetur gojore edhe pse ndodhet sot para një bashkëtingëlloreje hundore, edhe në toskërishte ajo është ruajtur si *a*, p.sh. *daːn*~*darə*, *θaːn*~*θanə*; *aːn*~*anə*. Në dialektin verior, ashtu si në dialektin jugor, kanë mbetur gojore edhe zanoret e tjera në raste si këto: *puːn*~*punə*, *ʒuːm*~*ʒumə*, *peːm*~*pemə*.

Duke qenë se *ə*-ja në shumë të folme të toskërishtes lidhet edhe me *ẽ*-në e gegërishtes, atëhere historia e saj në dialektin jugor të shqipes duhet parë gjithmonë e lidhur me tërë serinë e fonemave zanore hundore e jo në mënyrë të veçuar me ã-në ose me ẽ-në, sepse këto dy fonema, si njësi të serisë së hundoreve hyjnë në marrëdhënie të caktuara me njësitë e tjera të kësaj serie dhe me njësitë gjegjëse të sistemit të fonemave zanore gojore.

Prej kësaj del në mënyrë të pashmangshme pyetja: a ka pasur edhe toskërishtja një seri zanoresh hundore? Pra kemi të bëjmë në këtë rast me një diferencim dialektor që doli nga një gjendje e përbashkët e një faze të caktuar të zhvillimit të shqipes apo hundorësia është një tipar i lindur relativisht vonë vetëm në dialektin verior.

Duke e çekur këtë problem E. Çabej[249], ka dhënë mendimin se *ndjalizimi është tipar i jetë një dukuri ruajtjeje, konservimi, dhe një proces i gjithmbarshëm i gjuhës por pas gjuse është risim një inovacion relativisht i ri, i gegërishtes, i kryer mbase aty nga mesjeta e hershme.*

Sigurisht, nuk do të mendohet që shqipja do ta ketë pasur hundorësinë që në kryet të herës, por në një fazë të dhënë të historisë së saj, në mos pastë qenë edhe si tipar fonologjik, të paktën nuk mund të mos ketë ekzistuar për të dy dialektet si tipar thjesht fonetik, në kuptimin që zanoret në kushte të caktuara fonetike për një periudhë janë reali zuar fonetikisht si hundore, kanë qenë pra variante fonetike të fonemave zanore gojore dhe pas kësaj u bë degëzimi duke lindur prej tyre seria e fonemave zanore hundore në gegërishte dhe duke sjellë këto ndryshime në sistemin fonetik të toskërishtes: lindi áty zanorja ã e theksuar dhe bashkëtingëlloret hundore nuk ndikonin më në nyjëtimin e zanoreve pasardhëse, zanoret para një bashkëtingëlloreje hundore nuk shqiptoheshin më si hundore, humbën funksionin e tyre variantet fonetike hundore të zanoreve.

Përsa i përket kohës kur është kryer ky proces i formimit të serisë së zanoreve hundore është e vështirë të gjendet një cak i prerë, por, të ndihmuar nga historia e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera mund të arrijmë të gjejmë në formë të një hipoteze një cak kohor të përafërt.

Periudha kur u krye ky proces i hundorëzimit të zanoreve në pozitë para një bashkëtingëlloreje hundore është relativisht e hershme[250] në historinë e shqipes dhe se deri në formimin e fonemave zanore hundore (të paktën në sistemin e gegërishtes që njohim sot) mund të ketë vazhduar për një kohë të gjatë norma fonetike e hundorëzimit të zanoreve para një bashkëtingëllloreje hundore. Këtë e tregon qartë fakti se zanoret hundore gege (të mirëfilltat) dhe *ə*-ja e toskërishtes janë të pranishme në fjalë të fondit autokton, në huazime të vjetra greke, në huazimet latine, në disa elemente të vjetra skllave[251] dhe nuk kanë arritur të zënë vend në huazimet sllave përgjithësisht, në huazimet italiane, greke mesjetare e të reja, turke e të tjera më vonë. Fakti që, me përjashtim të elementeve të vjetra. huazimet sllave nuk arritën t'i nënshtroheshin përgjithësisht normës së hundorëzimit tregon se në kohën kur shqipja ra në kontakt me sllavishten ishte formuar seria e fonemave zanore hundore në dialektin verior, pra ishte formuar kundërvënia e gojoreve me hundoret në sistemin e zanoreve, dhe në dia-

249. E. Çabej, *Dy çështjr gjuhësore*, në «GJ» VII, 1977, f. 27.
250. J. Gjinari, *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, në «SF», 4, 196
251. N. Jokli, *Linguistisch-kultur-historische Untersuchunger*, 114.

lektin jugon ishin kryer ndryshime në sistemin e zanoreve me lindjen e fonemës *ə* (të theksuar). Koha e kontakteve të para të shqisës më sllavishten mund të merret pra në mënyrë të përafërt si caku i fundit formimit të këtij tipari dallues të dy dialekteve.

Përsa i përket cakut të fillimit të procesit të hundorëzimit mendojmë se nuk çon fort peshë huazimi *craciun* «kërshëndella» i rumanishtes prej një +*kërcun* të lashtë të shqipes, parashkallë e së sotmes *kərcũ-ni* (geg.), *kərcu-ri* (tosk.)[252]. Themi nuk çon fort peshë, sepse forma me *n* e ruajtur në rumanishte mund të jetë e një kohe kur ende s'kishte filluar të vepronte në gjuhën shqipe norma e hundorëzimit të zanoreve në kushte para bashkëtingëlloreve hundore, ose mund të jetë edhe e një kohe kur kjo normë vepronte, ishte e gjallë, vetëm se *n*-ja nuk ishte reduktuar deri në zhdukje në atë formë të fjalës, ishte koha kur zanoret hundore nuk kishin fituar pavarësinë si fonema të veçanta. Karakterin hundor të zanores *u* rumanishtja nuk mund ta tregonte, sepse ajo ia përshtati sistemit të vet huazimin prej shqipes.

Në caktimin e një kronologjie të përafërt të kësaj dukurie ndihmojnë shumë edhe të dhënat e historisë së brendshme të gjuhës shqipe po të merren të lidhura me dukuri të tjera të gjuhës lindja e fonemave zanore hundore dhe lindja e *ə*-së. Kështu, së pari, rotacizmi në rend kronologjik është më i vonë se hundorëzimi dhe kthimi i *ã*-së (edhe *ẽ*-së) në ə në toskërishte. Kjo është e kuptueshme, sepse ngjyrimi hundor i zanoreve nuk mund të kuptohet pa praninë e bashkëtingëllores hundore pas zanores, as ə-ja e toskërishtes s'mund të mendohet pa karakterin hundor të *a*-së (dhe *ə*-së) prej së cilës ka dalë historikisht. Së dyti, që kjo dukuri është e hershme duket edhe nga fakti se zanoret hundore të gegërishtes (edhe ə-ja e toskërishtes) dalin të formuara plotësisht në mbaresat e disa foljeve dhe të disa emrave që në dokumentet e para të shkruara të shqipes, pra, me sa duket, këto ndryshime janë kryer në një kohë më të hershme. Vetëm kështu mund të shpjegohen kundërvënietfonetike, që shihen sot në disa forma të së njëjtës folje ose të të njëjtit emër. Kështu, në gegërishte, ndërsa në formën e pjesores del hundore zanorja, *a* e temës së foljeve: ðã:*n* «dhënë», θã:*n* «thënë», lã:*n* «lënë», rã:*n* «rënë», zã:*n* «zënë» etj. (në toskërishte si zanore e temës së kësaj forme është ə-ja ðə*nə* etj.), në formën e së kryerës së thjeshtë, veta e tretë shumës po ajo zanore e temës del gojore: ða:*n*, θa:*n*, Ia:*n* etj. (dhe në toskërishte: ð*anə*, θ*anə* etj). Po kështu, ndërsa b*ãj*)«bëj» dhe h*ũj* «hunj» kanë zanore hundore, *laj* dhe *thoj* «thonj» kanë zanore gojore.

Fati që zanorja e temës është gojore para mbaresave *-më*, *-në* të së kryerës së thjeshtë (*dhamë*, *dhanë*), para mbaresës *-nj* të dëftores së tashme veta e parë njëjës («laj») dhe para mbaresës *-nj* të shumësit

252. E. Çabej, *Dy çështje gjuhësore*, f. 29.

të emrave (*thonj*) tregon se këto mbaresa janë formuar si të këtilla në një kohë kur nuk hundorëzoheshin më zanoret para bashkëtingëlloreve hundore, sepse, me sa duket, ishte formuar seria e zanoreve hundore në gegërishte dhe ə-ja në toskërishte.

Të folmet e tipit *laj* (< lanj) dhe të emrat e tipit *thoj* (< thonj). që ishin pa *n* në temë, erdhën e u shtrinë analogjikisht mbaresa foljore *-nj* e tipit të foljes $^{+}$*ban* (*ban*+*nio* > *bap* > *baj* «bëj») dhe mbaresa *ɲ* e shumësit të emrave të tipit $^{+}$*hun* (*hun* + *i* > *huɲ* > *hũj* «hunj» Shtrirja analogjike e këtyre mbaresave në një kohë pasi ishin formuar zanoret (fonemat) hundore[253] shpjegon faktin që mbetën gojore zanoret e temave të foljeve *laj* etj. dhe të emrave *thoj* (thonj» etj. Më vështirë është të shpjegohet fakti se përse është gojore zanorja e temës në format e së kryerës së thjeshtë të vetës së parë dhe të vetës së tretë shumës të folmeve të tipit *dhënë*, *thënë*, *klënë* etj., p.sh.: *δamə*, *θamə*, *lamə*, *δanə* *θanə* etj. Thamë është më vështirë të shpjegohet ky fakt, sepse tema e këtyre foljeve ka mbaruar me *n*, por ndoshta diferenca ndërmjet formës së pjesores *δã:n* (ə) me zanore hundore dhe formës të së kryerës së thjeshtë *δa:n* (ə) me zanore gojore lidhjet me mënyrën dhe kohën e formimit të paradigmës të së kryerës së thjeshtë të këtyre foljeve: këto në sistemin e vet kanë formën sigmatike *δaʃə* «dhashë» ndryshe nga *zũna* (*zura*), *bãna* (bëra) etj. Mbase me këto shpjegohet fakti që sot zanoret hundore të mirëfillta dhe ə-ja e toskërishtes dalin vetëm në rrënjët dhe në temat e atyre fjalëve ku zanorja ka qenë ndjekur shumë herët nga një bashkëtingëllore hundore[254].

Ka edhe raste si: *anə*, *θanə* (emër druri), *da:n* geg. e *darə* tosk., *punə*, *ʒumə*, *dem*, *limə*, *cime* etj., të cilat u bien ndesh rasteve: *ã:m* geg. ~ *əmə* tosk., (*kam*) *δã:n* geg. *δənə* tosk., *θã:n* geg. ~ *θənə* tosk., *brĩ:j* geg. e *bri̯e* tosk. etj. Raste si këto, që kërkojnë shpejegim, vërtet e vështirësojnë njohjen e rrugës që kanë ndjekur zanoret hundore, por, nga ana tjetër, edhe ato mund të tregojnë se hundorëzimi është i hershëm. Në fjalë të tilla bashkëtingëlloret hundore mund të mos jenë ndodhur që në krye të herës fill pas zanores së temës, por kanë qenë pas një bashkëtingëlloreje tjetër[255] dhe kanë dalë aty ku janë sot

253. Sh. Demiraj në *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*. (Pjesa 1), Tiranë, 1973 f. 50 mendon se evolucioni i mbaresës së shumësit nga *-i* (e cila ka palatalizuar *-n-* në e temës së emrit J.GJ.) ka ndodhur para kontaktit të shqipes me sllavishten. Shih edhe Pjesa II, Tiranë, 1976, f. 34 ku shpjegohet mbaresa *-nj* e foljeve *mbanj*, *lanj* etj. sipas tipit të foljes $^{+}$ *banj*.

254. J. Gjinari. *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, në «SF», 4, 1966, f. 139.

255. Si shembuj mund të sillen: *gjumë* që krahasohet me gr. *hypnos* dhe lat. *somnus* (E. Çabej, *Fonetika* f. 70), *anë* nga *asna* dhe *punë* nga *spudna* (G. Mayer, EW). Fjalës *thanë* E. Çabej e jep me etimologji të dyshimtë (shih «Studime filologjike», 3, 1966, f. 53; si të vetën jep një *konga*, ndërsa nga Pederseni një «*thangnë*» (KGZ, 157 v.).

pasi kishte përfunduar procesi i formimit të serisë së zanoreve hundore.

Edhe fakti që gegërishtja nuk ka zanore *o* hundore, të mirëfilltë (po lëmë mënjanë një rast relativisht të ri, si *zonjë*<*zotnja*[256] e ndonjëtjetër) është një tregues që flet për moshën jo të re të hundorëzimit. Me sa duket, në kohën kur vepronte procesi i hundorëzimit të zanreve, *o*-ja që gjendej në një rrokje të mbyllur prej një bashkëingëlloreje hundore ose nga *l*, *ł*, *r*, kishte marrë rrugën e diftongimit. Pra *o*-ja (edhe e-ja që dha *ie*, *ye*) në kushte të këtilla fonetike, kur shqiptohej si dykulmore ose si një diftong e diftongoid, zinte një vend të veçantë në sistemin e fonemave zanore, nuk shqiptohej me ngjyrim hundor, prandaj edhe u veçua prej zanoreve të tjera që ndoqën rrugën drejt fonemave hundore, Kështu +*gron*, +*kron*, +*fton* dhanë përkatësisht *grua*, *krua*, *ftua* në toskërishte dhe *grue*, *krue*, *ftue* në gegërishte.

Me veçimin e *o*-së, mbetej i zbrazët vendi i saj në sistemin e zanoreve hundore, që po formohej. Vendin e saj do ta zinte zanorja *a* e klasës së mesme dhe e hapjes më të madhe, e cila në kushte para bashkëtingëlloreve hundore shqiptohej e labializuar dhe për rrjedhim më e mbyllur. Kjo lëvizje bënte që të formohej një sistem katërkëndësh i zanoreve hundore, ku ã-ja, duke qenë hundore, radhitej në klasën e prapme me ũ-në dhe për nga shkalla e hapjes radhitej me ẽ-në, e cila në përgjithësi, për shkak të tiparit hundor, shqiptohej më e hapur se *a*-ja gojore.

ĩ	ỹ	ũ
ẽ		ã

3.15.4. Është e natyrshme të bëhet pyetja: a ka pasur edhe toskërishtja një sistem të këtillë fonemash, apo ky lindi dhe u zhvillua vetëm në dialektin verior të shqipes?

Sot nuk e gjejmë serinë e hundoreve në asnjë të folme të toskërishtes, as edhe në ndonjë të folme arkaike të saj, qoftë të trungut, qoftë të diasporës. Në «Gramatikën» e Ilia Dilo Sheperit[257] jepen disa raste me zanore hundore në kushtet ku ato dalin edhe në gegërishte, por kjo nuk është shumë e sigurt. M. Totoni[258] ka konstatuar në labërishte zanore me ngjyrim hundor pas bashkëtingëlloreve hundore. Megjithatë, këto vështirë se mund të tregojnë ruajtjen e një gjendjeje

256. H. Pedersen, *Die Gutturale im albanischen* në «Zeitschrift für vorgleichenden Sprachforchung», 36, Bd, 1900, f. 324.
257. Ilia Dilo Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, f. 13-141
258. M. Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurleleshit*, në «Dialektologjie shqiptare», I, Tiranë 1971, f. 43.

të hershme. Edhe po të mos ketë qenë dikur e përbashkët për mbarë gjuhën seria e zanoreve hundore, duhet menduar se *ə*-ja (e theksuar) nuk mund të dilte në qoftë se toskërishtja nuk do tá kishte jetuar të paktën fazën kur zanoret hundore realizoheshin si variante të kushtëzuara nga pozita fonetike.

Karakteri hundor i zanoreve në kushte para një bashkëtingëlloreje hundore bëri që në toskërishte zanoret *a* dhe *e* të pësonin një lëvizje, të ndryshonin: ato kaluan nëpër një reduktim duke përfunduar në *ə*, në një zanore të tipit të papërcaktuar, që ekzistonte në sistemin e, zanoreve të patheksuara. Kjo *ə* u bë zanore e përcaktuar dhe u fut në sistemin e të theksuarave duke zënë një vend në klasën e të mesmeve dhe sipas shkallës së hapjes në radhën e të mesmeve, ajo hyri kështu në korrelacione të caktuara me zanoret e tjera:

i	y	u	ɔ
e	ə	o	
	a		

Zanoret e mbyllura *i, y* dhe *u* u çhundorëzuan pa u reduktuar, sepse timbri i tyre nuk kishte pësuar shumë ndryshime dhe nuk kishte pranë në sistem një zanore të reduktuar si *ə*-ja e patheksuar, që ishte për *ã*-në dhe *ẽ*-në. Varianti ã i fonemës *a*, ashtu si në dialektin verior, edhe në dialektin jugor do të ketë qenë një zanore më e prapme e më e mbyllur dhe disi e labializuar, afërsisht si *o*-ja, ose më mirë si ʌ-ja, që është një zanore e prapme jolabiale. Në kushtet e një sistemi të këtillë, në toskërishten jugore, ku edhe *ẽ*-ja u reduktua në *ə* në të gjitha rastet (me sa duket për shkak se atje ajo shqiptohej më e hapur dhe disi më e prapme), ndryshimet që pësuan ã-ja, dhe *ẽ*-ja, bënë të lindin zanoret ʌ (<ã) dhe ɜ (<ẽ), të cilat do të kenë zënë vend në fillim ndoshta si variante, njëra në klasën e të prapmeve e tjetra në klasën e të përparmeve, kurse më vonë erdhën e u afruan dhe doli prej tyre fonema *ə* e klasës së të mesmeve, e cila edhe sot është disi më e prapme në toskërishten jugore dhe diku më qendrore e diku më e përparme në toskërishten veriore:

i		y		u		i	y	u
e(ɜ)			(ʌ)	o	→	e	ə	o
		e					a	

Gjurmët e kësaj rruge shihen edhe sot e kësaj dite në të folmet e labërishtes[259] dhe në ato të arbëreshëve të Greqisë[260], në të cilat

159- Po ai, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në «SF», 1, 1964, f. 136.
260. C.H.Reinhold, *Noctes Pelasgicae*, Athen, 1855.

ə-ja shqiptohet përgjithësisht si zanore më e prapme [ɜ] dhe ʌ-ja[261] del si variant fakultativ në fjalë të atilla ku gegërishtja ka ã: *bʌn* «bën», *ʒʌra* «gjëra», e *jʌma* «e ëma», *mʌŋa* «mënga», *vʌθ* «vëth», *mʌ* «më» etj.

Në toskërishten lindore (zona e Korçës), ku vetëm ã-ja dha *ə*, ka shumë të ngjarë që *ə*-ja të mos ketë qenë shqiptuar e hapur, pra ndryshe nga toskërishtja jugore, që puqet në këtë pikë me gegërishten[262] ku ë-ja është shumë e hapur (*fəmər* «femër» erj.).

Në të folmet e tjera të toskërishtes veriore (në anët e Myzeqesë, Beratit, Mallakastrës, Skraparit, e Përmetit) disa raste dalin rregullisht me *e*, kurse disa me *ə*. Duke qenë se për raste të këtilla në këtë zonë nuk shihet që të ketë për *e*-në ose për *ə*-në ndonjë kushtëzim fonetik ose përdorim fakultativ, mund të mendohet se në këto të folme të kenë ndodhur interferenca gjuhësore nga grupe të ndryshme popullsie të zonave jugore dhe të zonave lindore të toskërishtesh. Nga kjo pikëpamje kjo zonë në këtë rast ka një karakter të përzier.

Ndryshimet që ndodhën në sistemin fonetik, qenë të karakterit fonologjik për gegërishten, kurse për toskërishten qenë fonetike, por pjesërisht edhe fonologjike. Në grupin e të folmeve të gegërishtes, pasi u reduktuan *n*-ja fundore (+*zan*>*zã*), zanoret hundore dolën edhe në pozita ku nuk kushtëzoheshin me fonetikisht, zanoret e hundorëzuara nga variante u kthyen në fonema dhe formuan serinë e hundoreve, kurse në grupin e të folmeve të toskërishtes shumica e zanoreve me nuancë hundore u kthyen përsëri në zanore gojore, pushuan së qeni variante fonemash, d.m.th. ndryshimet që u bënë në përgjithësi ishin thjesht fonetike, ndërsa dy prej zanoreve, ã-ja dhe ẽ-ja çuan në lindjen e *ə*-së, si një fonemë e re, që solli ndryshime në sistemin e fonemave zanore të këtij grupi të folmesh. Në toskërishtë variantet hundore të *a*-së dhe të *e*-së ka të ngjarë që ta kenë marrë rrugën e ndryshimit drejt *ə*-së para se të reduktohej *n*-ja fundore. Pas kësaj mund të ketë ndodhur edhe çhundorëzimi i zanoreve të mbyllura *i*, *y*, *u*, të cilat nuk kishin pësuar ndryshime në timbër. Nuk përjashtohet mundësia që për çhundorëzimin e zanoreve *i*, *y*, *u* të ketë luajtur rol edhe rotacizimi i *n*-së që ndodhej ndërmjet dy zanoreve.

3.15.5. Sot fonema *ə* gjeografikisht shtrihet në truallin e të folmeve që përbëjnë toskërishten[263], por në fazën kur ishte duke lindur,

---

261. Herë-herë shënohet nga mbledhësi si *o* ose si *ë*°.

262. Këto dy grupe të folmesh skajore të gjuhës shqipe puqen edhe për masën shtrirjes së kësaj dukurie në geg. veriore dalin me ẽ: *flẽj* «fle», *ʒẽj* «gjej» *rẽ* «re», *plẽhen* «pleh» *dzẽt* «nxehtë», *ŋrẽ* «ngre», ashtu si në toskërishte jugore ku këto fjalë f dalin me *e*.

163. Këtu përfshihen edhe ato të folme kalimtare që kanë *e*, edhe të folmet e diasporës që kanë dalë prej zonave të toskërishtes.

pas gjithë gjasave, nuk duhet të ketë pasur atë shtrirje gjeografik e që ka sot. Hapësira e sotme e *ə*-së në gjuhën shqipe ka mundësi të jetë mbeturinë rudhjeje e një treve më të madhe dhe jo me vendosje në jug, siç është sot, por me drejtimin jugperëndim-verilindje, d.m.th dilte nga treva e sotme e toskërishtes dhe shkonte drejt Ohrit, Dibrës e Shkupit. Për këtë një tregues i tërthortë është edhe konstatimi i bërë nga muzikologjia[264], sipas së cilës në zonën e Maqedonisë Perëndimore, midis Dibrës dhe Shkupit dhe në atë të Opojës (Kosovë), që sot janë kryesisht pjesë të trevës së gegërishtes, jeton e ashtuquajtura polifoni gege, një mënyrë të kënduari e afërt me polifoninë karakteristike të trevës ku shtrihet sot dialekti i toskërishtes.

Tregues tjetër për shtrirjen më të madhe që ka pasur dikur *ə*-ja është edhe prania e saj në gjuhë të tjera të Ballkanit, siç janë bullgarishtja dhe rumanishtja me dialektet e saj.

A.M.Selishçevi[265] ka vënë në dukje një fakt me rëndësi që lidhet me *ə*-në e gjuhës shqipe. Sipas tij në të folmet sllave të Maqedonisë Perëndimore, në anët e Dibrës, të Ohrit, të Prespës e të Kosturit *ъ*-ja (ǒ e sl.vj.) ka dhënë *o*. Këtë *o* A.M.Selishçeri e mendon të ardhur nga një *ъ* (një zanore e labializuar e tipit të *ə*-së). Në këtë rast ai sheh një lidhje midis gjuhës (fonetikës) së shqipes të këtyre anëve (Dibër etj.) ku ka o për ã dhe gjuhës së elementit sllav, por, siç thotë ai vet, e ka pasur të vështirë *të përcaktonte se nga ç'anë erdhi ndikimi* («për mungesë të të dhënave të dialektologjisë shqiptare»)[266].

Lidhja që sheh në këtë rast A.M.Selishçevi është e mundshme por mendimi se *o*-ja në të folmet sllave të këtë ardhur nga një *ъ* sekondare nëpërmjet labializimit të saj, na duket se nuk është fort i mbështetur. Ka të ngjarë që *o* dhe *ъ* të jenë rezultat i diferencimit të *ъ*-së në dialektet e bullgarishtes e të maqedonishtes nga zhvillimet e ndryshme që mori ajo duke dhënë diku *o* nëpërmjet denazalizimit dhe diku *ъ* nëpërmjet denazalizimit dhe delabializimit njëkohësisht. Është po ajo rrugë që ndoqi edhe *ã*-ja e gjuhës shqipe, e cila në anët e Dibrës e në disa vende të tjera përfundoi në *o*, kurse në toskërishte në *ə*.

Sekondarja *ъ* (tingulli i reduktuar) i bullgarishtes gjen afërsi me *ə*-në e d'alektit jugor të shqipes dhe me î (â-në) e rumanishtes; kurse *o*-ja e anëve perëndimore të Maqedonisë lidhet me *o*-në (<ã) e të folmeve shqipe të këtyre anëve dhe me *o*-në e meglenoraminishtes

264. Lorenc Antoni. *Trajta polifonike të muzikës popullore vokale të gegëve në Jugosllavi*, në «GJA» 2, 1975, f. 117-130; Po ai, *Elementet polifonike në muzikën popullore të Opojës*, në «GJA» 2, 1974, f. 131-134.
265. A.M.Selišč ev. *Slavinskoe naselenije v Albanii*, Sofija, 1931.

çë i përgjigjet ë (ă-së) së dakorumanishtes. Kjo lidhje nuk duhet të jetë e rastit. Nuk do të ishte pa vend që këtu të shpjegohej me ndikimin gjuhës së veçantë të Ballkanit të lashtë që gjeten sllavët kur ejchin në vendet e sotme.

Mendimi i V. Polakut[267] se te ə-ja (< ă) e toskërishtes shihet, qoftë edhe jo drejtpërdrejt, veprimi i ndikimit të grupit bullgaro-maqedon dhe të ă-ja e gegërishtes veprimi i ndikimit të serbishtes (sipas zhvillimit të jereve sllave në këto dy gjuhë) nuk gjen dot mbështetje për disa arsye. Në radhë të parë për shpjegimin e kësaj dukurie çon shumë peshë rruga e zhvillimit të brendshëm të gjuhës shqipe. Së dyti V. Polaku, duke mos njohur mirë historinë e gjuhës shqipe, e merr ə-në e toskërishtes si primare ndaj ă-së së gegërishtes (nuk dallon në këtë rast ë-në e theksuar prej ə-së së patheksuar). Së treti, po të ishte ə-ja e toskërishtes rezultat i ndikimit të gjuhës së grupit bullgaro-maqedon, përse të mos shihej ky ndikim edhe në të folmet shqipe të zonave të Maqedonisë Perëndimore dhe në meglenorumanishte ku ka o, mbasi nuk mund të mendohet që ndikimi i sllavishtes të mos ishte shumë i madh atje se në jug të Shqipërisë. Së katërti, ndarja e bullgarishtes nga gjuhët e tjera sllave në rrugën e zhvillimit të ă-së e të ë-së dhe rënia e saj në këtë rast me gjuhët fqinje të Ballkanit, që kanë ə të çë në të një merdim i kundërt me atë të V. Polakut. Edhe Kr. Sandfeld[268] dhe Al. Rosetti[269] mendojnë për ndikimin e një substrati traco-ilir në formimin e ə-së (shq.), î, â (rum.) dhe ъ (bg.). Së fundi, vlen të theksohet se sipas K. Mirçevit[270] në bullgarishten e-ja e ardhur prej ă-së sapo fillon të duket në dokumentet e shekullit XII të kësaj gjuhe, pra është e një kohe shumë më të vonë se ə-ja e gjuhës shqipe[271].

E. Petroviçi[272] ka mendimin se î dhe â në rumanishte kanë përfaqësuar një zhvillim të pavarur nga ə-ja e shqipes. Puqja në shumë drejtime për këtë dukuri të përbashkët dhe historia e këtyre dy gjuhëve të çojnë te mendimi se rumanishtja dhe shqipja në këtë pikë nuk janë pa lidhje me njëra-tjetrën. Shihet se edhe metodikisht nuk është trajtuar drejt ky problem. Është krahasuar varianti letrar i një gjuhe me

---

266. Po ai, *po aty*. V. Pelak, *Allarci a Slovare (Vznik e vzaimky dunajch varegnih variant albun*
267. *shqyh*) në «Casvpis pro moderni filologii», XXXIX 2-3, f. 68.
268. Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique-Problemes et résultats*, Paris, 1930, f. 125 v.
269. Al. Rosetti, *Istoria limbii romîna*, vëll. II, 1962, f. 62.
270. K. Mirčev, *Istoričeska grammatika na bălgarskija ezik*, Sofija 1958, f. 101.
271. Kur sllavishtja ra në kontakt me shqipen, e ruante zanoren hundore ă, kjo duket në disa fjalë të shqipes, me sa duket të huazuara më herët prej sllavishtes, sepse ă-ja ka dhënë *zanore + një bashkëtingëllore hundore*: ăN: *zhumbina*.
272. E. Petrovici, *Cercetări de linguistică*, 1, 1963, f. 67-72.

variantet dialektore të gjuhës tjetër dhe, për më tepër, në analizën funksionale dialektet dhe gjuha letrare nuk janë marrë si sisteme gjuhësore më vete. Janë lënë pa u vlerësuar disa pika takimi të rëndësishme midis dialekteve të këtyre dy gjuhëve: është lënë mënjanë fakti se aromanishtja dhe istrorumanishtja kanë *ã*, ashtu si toskërishtja *ə*, ndërsa meglorumanishtja ka *o*, ashtu si të folmet shqipe të Dibrës që kanë o (<ã); nuk është vlerësuar fakti që *ã*-ja e rumanishtes është një zanore më e prapme[273] se qendrore, ashtu si ɜ-ja (edhe ʌ-ja) në labërishte dhe në arbërishten e Greqisë. Së fundi, nuk vihet në dukje një bashkëpërkim jo pa rëndësi: â-ja në disa dialekte të rumanishtes është kthyer në *i* kur është ndodhur pranë një bashkëtingëlloreje qiellzore: *ar*, meglr. *glindă* , *intr. glîndă*, prej lat. *glandus, glandem*, ashtu si në dialekte të shqipes: çamërisht *bij* (<bəɾ), *glimb* (<*gləmb*<*glemb*, «gjemb»), në Çamëri, Myzeqe, Ulqin *iʃt* (<əʃtə) dhe *cĩɾʒ* (<*cẽnʒ*) «qengji» etj. në gegërishte.

ZANORET GOJORE TË GJATA DHE TË SHKURTRAT

3.16.1. Midis të folmeve të gjuhës shqipe ka dallime edhe për gjatësinë e zanoreve. Ndryshimet fonetike që janë bërë gjatë kohëve çuan në një gjendje të atillë ku shihet se të folmet e toskërishtes veriore i kanë humbur zanoret e gjata dhe kanë sot vetëm një seri zanoresh gojore, kurse të folmet e gegërishtes dhe të folmet e toskërishtes jugore e ruajtën serinë e të gjatave krahas serisë së të shkurtrave, pra këtu u ruajt korrelacioni i sasisë së zanoreve, kundërvënia e të shkurtrave me të gjatat (shih § 3.3.4.).

Mendimi i V. Polakut[274] se dallimi i dy dialekteve të shqipes për shkak të zanoreve të gjata, që ekzistojnë në gegërishte, është rezultat i presionit sllav (i rrdhimit të serbishtes në Shqipërisë veëiore) nuk mbështetet as nga realiteti i sotëm gjuhësor i dialekteve, as edhe nga historia e tyre. Së pari, siç e ka provuar A. Dodi[275], i mbështetur edhe nga R. Ismajli[276] dhe B. Beci[277], në sistemin e zanoreve të dia

273. Sipas analizave eksperimentale të Dukelskit, siç thotë vetë E. Petrovici në artikullin e përmendur.
274. V. Polak, *Albànci a slované*, f. 88-89.
275. A. Dodi, *Rreth sistemit vokalik të shqipes*, f. 149.
276. R. Ismajli, *A propos de la quantité vocalique de l'albanaise*, f. 367, 368.
277. E. Beci, *Vlera funksionale e gjatësisë së zanoreve të theksuara në shqipen e Veriut*, f. 90-92.

lekteve të gjuhës shqipe nuk ekzistojnë dallime kualitative të intonacionit, d.m.th. që gegërishtja të karakterizohet nga një theks melodik, i cili është i pranishëm në serbishte. Së dyti, duhet thënë se dallimi për gjatësinë e zanoreve nuk është absolut për dy dialektet e shqipes, sepse serinë e zanoreve të gjata, me përjashtim të toskërishtes veriore e kanë edhe të gjitha të folmet e tjera të toskërishtes, qofshin ato të atdheut, qofshin të diasporës. Prej kësaj del se zanoret e gjata kanë ekzistuar më parë në gjithë truallin e shqipes: shtimi i dendurisë së përdorimit të tyre në gegërishte dhe në labërishte këto shekujt e fundit është një dukuri relativisht e re[278].

Po japim disa shembuj me zanore të gjatë nga të dy dialektet:

në gegërishte: *be:*, *vla*: «vëlla», *dy*: (për gjininë femërore) *ʃpi*: «shtëpi», *tʃepu:r*, *kso:ł* «kasolle», *mã:z* «mazë», *fle:t* «fletë», *mi:r* «mirë», *ʃpi:s* «shtëpisë», *ŋæ:* «*nge*», *vø:* «vezë:», *i pa:ʃkol* «i pashkollë», *be:tim* «betim» etj.:

në toskërishten jugore: *δe:* «dhe-u», *e re:*, *vəła:*, *kazma:*, *si*: «sy», *zə*: «zëri», *pə*: «pe-ri», *u*: «unë», *glu*: «gju», *ʃpu*: «shpuri *ba:łə*, *ka:lə*, *i fto:tə* «i ftohtë», *zə:nə* «zërin», *si:te* «sytë», *tə pa:lema* «të palera», *i pa:kripur* «i pakripur» etj.

4.16.2. Ndërmjet të folmeve ku ekzistojnë zanoret e gjata ka edhe dallime, por ato nuk janë relevante për to, nuk janë të atij karakteri që të prekin sistemin fonologjik të të folmeve.

Së pari, dallohen të folmet e çamërishtes dhe ndonjë e folme e Bregdetit, të cilat kanë zanore të gjata edhe në një rrokje mesore të hapur në fjalët që mbarojnë me *ə* të patheksuar dhe ku zanorja e gjatë është etimologjike *ka:lə*, *ba:łə*, *si:tə*, *ʃpi:tə*, *θo:tə*, *i fto:tə*, *zə:nə* «zërin», *δe:nə* etj.

Së dyti, në disa të folme të gegërishtes, sidomos në ato të anës veriperëndimore, këmbehen zanoret e gjata me të shkurtrat kur kalojnë në një rrokje të mbyllur nga dy bashkëtingëllore, p.sh. *ba:b→babs*, *hũ:→hũjt*, ose kur zanorja e gjatë formon një diftong fonetik me gjymëzanoren *i* ose *u*, që vjen pas asaj dhe mbyll rrokjen: *y:ł→ỹj*, *ka:→→kău*, *ʃi:→ʃiu*, etj.

Së treti, në të njëjtën formë gramatikore të një fjale në disa të folme (më tepër në ato të gegërishtes veriperëndimore, por aty-këtu edhe në të folme të tjera të gegërishtes veriore) ka zanore të shkurtra, kurse gjithë të folmet e tjera kanë zanore të gjata, p.sh. *gŭr* (forma e shumësit) për *gu:r*, *rĭm* për *ri:m* «rrjmë», *rnŏjm* për *ro:jm* «rrojmë», *ʃŭm* për *ʃu:m* «shumë».

278. E. Çabej, *Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes*, në «Bul çpër shk. shoq.» 2, 1957, f. 213: M. Totoni, *E folmja I Bregdetit të Poshtëm*, në «SF», 1, 1964, f. 134, 135: *Vëzhgime për të folmet e Kurveleshit*, f. 40-42; J. Gjinari *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, në «SF», 4, 1968, f. 132.

Në rastin e parë dhe në rastin e tretë kemi të bëjmë me dallime dialektore që lidhen me përbërjen fonematike të një fjale. Ato të rastit të parë janë krijuar për]shkak të ruajtjes së zanores *ə* të patheksuar fundore në çamërishte e të rënies së saj në gjithë të folmet e tjera, kurse ato të rastit të tretë janë krijuar duke u realizuar fonetikisht në mënyra të ndryshme kundërvënia e dy formave gramatikore të një fjale.

Në rastin e dytë kemi të bëjmë me një]dallim dialektor që lidhet me dallimet në normat e]gjalla fonetike të të folmeve, p.sh. në gegërishten veriperëndimore neutralizohet tipari i gjatësisë në kushtet fonetike që u përmendën[279].

Të folmet ku ekziton kundërvënia e zanoreve të gjata me të shkurtrat kanë një rregullsi të përbashkët: si zanoret e]gjata, edhe zanoret e shkurtra kthehen në të mesme kur kalojnë në një rrokje mesore të hapur, p.sh. *pla:k→plaka* dhe *plăk→plaku,* (unë) *ha:*, (ti) *hă →* (ju) *hani* etj. Zakonisht në dialektin verior ky këmbim gjatësie realizohet edhe në sandhi brenda frazës në rrjedhën e të folurit kur zanorja e gjatë gjendet në një pozitë të këtillë fonetike, p.sh. *athĕr han bŭk e moła t'arta,* pra: *athĕr* e jo *athe:r, bŭk* e jo *bu:k.*

Pothuaj të përbashkëta, sidomos për të folmet e gegërishtes dhe të folmet e Kurveleshit, janë edhe këmbimet historike, ato që nuk janë të kushtëzuara sot fonetikisht, këmbimet që bëhen ndërmjet të shkurtrave dhe të gjatave për dallimin e kuptimit të formave gramatikore të fjalëve, p.sh. *di:t* (njëjës) ~ *dĭt* (shumës), *ʃŏk* (njëjës) ~ *ʃo:k* (shumës), (unë) *ha:* ~ (ti) *hă,* .

3.16.3. Proceset e ndryshme fonetike (edhe gramatikore) që u kryen gjatë kohëve në dialektet e shqipes sollën disa lloje ndryshimesh për gjatësinë e zanoreve.

Në toskërishten veriore dhe në disa të folme të tjera jugore në kufi me to dolën nga sistemi zanoret e gjata, pra u defonologjizuan, u zhduk korrelacioni i gjatësisë në sistemin e zanoreve gojore dhe përfundimisht mbeti një seri zanorësh.

Në të folmet e]tjera, ku u ruajt seria e të gjatave, gjithashtu ndodhën ndryshime, me përjashtim pothuaj të çamërishtes, por, megjithatë, edhe në ato të folme ndryshimet e bëra nuk janë të rëndësishme nga pikëpamja fonologjike, në kuptimin që nuk e prekën sistemin e zanoreve gojore me kundërvënien e të gjatave dhe të shkurtrave.

Në të folmet e gegërishtes dhe në të folmet e Kurveleshit, me rënien e zanores *ə* fundore, zanoret e temës, që ishin të mesme për nga

279. Për raste të tjera në të folme të tjera janë sjellë shembuj nga M. Çeliku në *Kuantiteti i zanoreve të theksuara në të folmet e shqipes.* «SF», 4, 1971, f. 137-162 dhe M. Totoni, *Vëzhgime mbi të folmet e Kurveleshit,* f. 41-43.

gjatësia, u kthyen përgjithësisht në zanore të gjata [280] (në Kurvelesh disa forma foljore, sidomos në të pakryerën u ruajtën edhe të mesmet kurse në të folmet e tjera u ndoq tjetër rrugë: në çamërishte përgjithësisht u ruajt *ə*-ja, prandaj edhe nuk pati ndryshime, kurse në toskërishten veriore, pasi ra *ə*-ja, zanoret e temës u kthyen në të shkurtra, sepse aty u zhduk seria e të gjatave. Pra ndryshimet çuan në dallime që lidhen me përbërjen fonematike të një fjale.

Edhe në rastet e të folmeve ku bëhet këmbimi i të gjatave me të shkurtrat për shkak të kushteve fonetike, p.sh. në gegërishten veripërëndimore: *ba:b→babs*, *hu:→hŭjt*, *ў:l→yj* etj., ose në të folme të tjera, në qoftë se vërtet nuk realizohen të gjatat kur rrokja fundore mbyllet nga një bashkëtingëllore e shurdhët, gjithashtu kemi të bëjmë vetëm me dallime në dendurinë e përdorimit të zanoreve të gjata e të shkurtra, sepse në këto të folme raste të këtilla u formuan duke iu nënshtruar fjalët një norme fonetike që ekzistonte aty edhe më parë, nuk u krijua ndonjë normë e re.

Si për diakroninë, ashtu edhe për sinkroninë e raportit të fonemave zanore të gjata e të shkurtra del një rregull i përgjithshëm: të dy palët e zanoreve realizohen të mesme për nga gjatësia në një rrokje të brendshme të hapur, (shih shembujt që kemi sjellë më sipër: *pla:k→plaka* dhe *plăk→plaku*). Kjo është një normë fonetike e gjallë e këmbimit të këtyre fonemave në raste të këtilla. Kjo normë ka ekzistuar dikur në gjuhën shqipe, ekziston edhe sot.

Në pamje të parë duket sikur e «prishin» këtë rregull fonetik rastet, si *ka:lə*, *δe:nə*, *de:tinə*: *sy:tə* ose *si:tə*, *ʃpu:nə* etj., që dalin tek autorët e vjetër (Buzuku, Budi) dhe sot në çamërishte, sepse, sipas këtyre rasteve del se zanoret e gjata mund të realizoheshin disa shekuj më parë dhe mund të realizohen sot në çamërishte në rrokje të brendshme të hapur. Por në raste të këtilla shihet se, nga pikëpamja diakronike kemi të bëjmë me zanore të gjata etimologjike[281], kurse nga pikëpamja sinkronike, dihet se aty pas bashkëtingëllores së fundit vjen në të gjitha rastet zanorja e patheksuar *ə*, e cila, me sa duket, për karakterin e saj, nuk luan shumë rol në kthimin e rrokjes së brendshme nga të mbyllur në të hapur. Kjo shihet sot edhe në të folmet e Korçës, të Devollit e të Pogradecit. Përkundrazi, kur në fund të fjalës ka një zanore tjetër, zanorja e temës, qoftë edhe etimologjikisht e gjatë, kthehet në të mesme, p.sh. *ka :→kaų*, *sy:→syni* «syri», *ʃpu:→ʃpuna* «shpura» etj. Në çamërishte mbeti kjo gjendje edhe sot e kësaj dite, kurse në të folmet e tjera zanoret e mesme tashti dalin

280. Fjala është për rastet kur zanorja e temës nuk ka qenë e gjatë etimologjikisht, p.sh. *ʃokə>ʃo:k*, *lamə>la:m* etj.

281. M. Totoni, *Vëzhgime mbi të folmet e Kurveleshit*, f. 42.

vetëm kur rrokja e brendshme e hapur pasohet nga një rrokje fundore e hapur me një zanore çfarëdo, përveç *ə*-së, e cila nuk del sot, sepse kudo ka rënë. Pra për normën e këmbimit të zanoreve të gjata me të shkurtat nuk ndodhi ndonjë ndryshim as edhe në të folmet e gegërishtes e të Kurveleshit.

4.16.4. Përderisa në një rrokje të brendshme të hapur kthehen në zanore të gjatësisë së mesme edhe zanoret e gjata, edhe të shkurtrat, si duhen marrë zanoret e gjatësisë së mesme, si variante fonetike të të gjatave apo si variante të të shkurtrave? Duket sikur këto zanore kanë qenë edhe janë të papërcaktuara, si të dyanshme[282]. Por, duke u mbështetur në dy tregues, del se zanoret e mesme më tepër duhen interpretuar si variante fonetike të fonemave zanore të gjata. Së pari, as dikur, as sot në rrokje të brendshme të hapur nuk janë realizuar edhe nuk realizohen zanoret e shkurtra, në këto kushte fonetike dikur edhe sot janë realizuar dhe realizohen vetëm të mesmet dhe të gjatat, së dyti, në të folmet ku u ruajt kundërvënia e gjatësisë së zanoreve, me reduktimin e plotë të *ə*-së fundore, zanorja e temës, d.m.th. zanorja e theksuar e rrokjes së brendshme të hapur u kthye në zanore të gjatë. Sigurisht në këtë rast mund të kenë vepruar edhe faktorë gramatikorë së bashku me faktorët fonetikë, nevoja e diferencimit të dy fvnemave gramatikore me kuptime të ndryshme, p.sh. duke u diferencuar me zanore të gjatë forma e shumësit *ʃo:k* (<*ʃokə*) prej asaj të njëjësit me zanore të shkurtër *ʃŏk* etj. *hãn* (e tashme v. III nj.) dhe *hã:n* (e kr. thj. v. III shumës) etj. Megjithatë, faktorët gra atikorë, edhe po të kemi vepruar, kanë qenë të dorës së dytë dhe të varur prej faktorëve fonetikë. Në toskërishten veriore kjo mundësi nuk ekzistoi, prandaj edhe u rrafshuan fonetikisht format e ndiyshme gramatikore, duke u realizuar të gjitha me zanore të shkurtër.

Kthimi i zanoreve të këtyre kushteve në të gjata pas rënies së *ə*-së tregon pra se ato për nga funksioni në radhë të parë, por edhe fonetikisht ishin më të afërta me ltë gjatat, prandaj edhe, me zhdukjen e kushteve fonetike (kalimi i tyre në rrokje të mbyllur) u kthyen në të gjata plotësisht edhe nga pikëpamja fonetike.

Duke u mbështetur në këto tregues, mund të themi se edhe më parë, edhe tashti zanoret e mesme kanë qenë dhe janë variante fonetike të fonemeve të gjata. Prej kësaj del se edhe në këtë drejtim nuk është bërë asnjë ndryshim në dialektet e gjuhës shqipe: kthimi i zanoreve të gjata në të mesme në një rrokje të brendshme të hapur ka qenë dhe ka

---

282 J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare* (dispnesë), Tiranë, 1979. f. 67, 68; R. Ismajli, *Grafia e Buzukut...*, f. 239.

mbetur një përshtatje e fonemave zanore të gjata brenda kufijve të vet, kurse kthimi i zanoreve të shkurtra në të mesme në kushte të këtilla ka qenë dhe ka mbetur një këmbim fonemash.

Së fundi duhet shtruar edhe një pyetje: me rënien e zanores *ə*, që ndodhej në fund të fjalës, kthimi i zanoreve të mesme më të gjata është një zgjatim kompensator apo jo?

E. Çabej[283] zgjatjen e zanores së temës në këto raste e ka quajtur kompensatore dhe, me sa kuptohet, e merr këtë si një proces thjesht fonetik (gjatësia e *ə*-së i kalon zanores së temës — J.GJ.).

M. Totoni[284] dhe ne në *Dialektologjinë shqiptare* f. 42. kemi marrë këtë rast si një ruajtje të një gjendjeje më të vjetër duke u nisur nga shembuj që dalin tek autorët e vjetër dhe sot në disa të folme të toskërishtes jugore, ku zanorja shqiptohet e gjatë edhe pse në fund të fjalës është *ə*-ja e patheksuar (*δe:nə*, *ʃpi:tə*, *ka:tə* etj.). Kjo shihet edhe sot në të folmet e Korçës, Devollit, Pogradecit ku zanorja e temës shqiptohet e gjatë (edhe pse si variante fakultative) në të gjitha rastet ku shqiptohet *ə* fundore.

Zgjatja e zanores së temës do të ishte *kompensatore* po të ishte bërë për shkaqe funksionale, por, siç e thamë edhe më sipër, në këtë proces faktorët gramatikorë, edhe po të kenë luajtur ndonjë rol të vogël, kanë qenë të dorës së dytë dhe të varur nga faktorët fonetikë, që janë faktorët kryesorë. Ky ka qenë një proces kryesisht fonetik dhe jo fonologjik. ndërrimi i kushteve fonetike për zanoren e temës me rënien e *ə*-së bëri që ajo të realizohet plotësisht edhe nga pikëpamja fonetike si je gjatë.

ZANORET E THEKSUARA i DHE u

3.17.1. Në kreun e dytë të këtij punimi (shih §2.2.2.) vumë në dukje se në të folmet e gegërishtes qendrore zanoret e theksuara *i* dhe *u* dalin edhe me variantet fonetike *ei̯*, *ei̯*, *ai̯*, *oi̯* për *i* dhe *au̯*, *ou̯* për *u*.

Përcaktimi i këtyre diftongjeve nga ana fonologjike vështirësohet për faktin se, veç rregullsive të përbashkëta për daljen e tyre kudo në

283. E. Çabej, *Kuantiteti i zanoreve...*, f. 206.
284. M. Totoni, *Vëzhgim mbi të folmet e Kurveleshit*, f. 42.

këtë trevë, vërehen edhe shmangie, sepse shihet se një numër jo i vogël fjalësh diku dalin me zanoret *i* dhe *u*, kurse në të folme të tjera dalin me diftongjet gjegjëse të tyre dhe e kundërta. Kjo shmangie vërehet edhe brenda një të folmeje, çka tregon se gjendja dhe funksioni i këtyre diftongjeve ka nisur të ndryshojë, ato kanë filluar të realizohen edhe si variante fakultative. Raste të këtilla që vërehen brenda një të folmeje mund të shpjegohen edhe me ndikimet e vona të gjuhës letrare[285], por pjesërisht ato mund të shpjegohen edhe me interferenca më të hershme midis të folmeve të kësaj zone, të cilat, siç u tha, kanë dallime në realizimin e zanoreve *i* dhe *u* në fjalë të njëjta.

Shumica e rasteve ku shihen dallime midis të folmeve për realizimin e *i*-së dhe *u*-së janë fjalë të huazuara prej sllavishtes e turqishtes dhe fjalë të prejardhura e forma fjalësh, të cilat, me sa duket, janë të një kohe, kur, të paktën në disa të folme, kishte përfunduar procesi i doftongimit të zanoreve *i* dhe *u*. Diku, si në anën e Pollogut[286], ku, sipas gjasave, procesi i diftongimit të *i*-së e të *u* -së mund të ketë vijuar për një kohë më të gjatë se në të folmet e tjera, ky proces përgjithësisht ka përfshirë edhe fjalë e forma të kësaj shtrese të re, sa herë që ato i përmbushin kushtet fonetike të diftongimit: *stanəi̯ts* (< sl. stanica), *granəi̯ts* (< sl. granica) (por: *Idrizits*, *Belulits* etj.), *atʃe̯i̯k* (< tq. *açik*), *dʒamai̯* «xhami» (< tq. xhami), etj. (por: *dertli* etj.); *ʃʃa̯i̯hem* «fshihem», *besnai̯k* «besnik» (< besë-nik), *iðnai̯m* (< hidhën+im) «hidhërim», *θartai̯n* (< thart+im) etj. (por: *Turki:n* (< Gurki+në, *vditʃ* «vdiq» etj.). Në ndonjë zonë, si më anët e Krujës[287], me pak përjashtime, fjalët dhe format e kësaj shtrese nuk janë përfshirë prej diftongimit: *ʃnik* «shinik», *dʒami* «xhami», *poptɫi*, *maɫkim* «maɫkim», *iʃte* «ishte», *u driðte* «dridhej» etj., por ka edhe raste të kundërta, si *vakai̯* (< tq. vaki), *vai̯ʃte* «vishte» (vesh) etj. Në të folme si ajo e Matit[288] e ndonjë tjetër diftongimi i *i*-së ka përfshirë plotësisht fjalët e huazuara, p.sh.: *granai̯ts* «granicë» *dʒame̯i̯* «xhami» *izmetʃe̯i̯* «hyzmetçi», *ʃai̯ʃe* «shishe», *aʃe̯i̯k* «ashik» etj., ka përfshirë, pjesërisht emrat e veprimit me prapashtesa *-im*: *pikrem*<*pikre̯i̯m* «pikërrime», *tsigrem*<*tsigre̯i̯m* «cingërimë» dhe *festim*, *fitim*, *banim*.

285. B. Beci, *E folmja e Reç-c-Dardhës së Dibrës*, f. 141.
286. R. Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, në «Studime gjuhësore I (Dialektologjia),» Prishtinë 1978, f. 327-352.
287. J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folme të Krujës dhe të Malësisë së Krujës*, në «SF» 3, 1964, f. 91-105 (pjesa e parë).
288. B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat* (Fonetika), n ë «SF» 2, 1962.

nuk ka arritur të përfshijë asnjë rast kur zanorja *i* vjen nga ndërrimi fonetik që ka pësuar zanorja *e* gjatë ndryshimit të formave të fjalëve: *mlíðet*: *mleð* «mblidhet», *kíʃim*: *kemi* «kishim» etj. Pothuaj e njëjta gjendje shihet në këtë areal edhe për zanoren *u*, e cila si variant i fonemës /u/ herë del e kushtëzuar fonetikisht, herë shfaqet edhe atje ku do të pritej variahti *au* ose *ou*[289].

Duke u mbështetur në të dhënat që u vunë në dukje më sipër del se dikur rrethanat fonetike që kushtëzonin realizimin e fonemave /i/ dhe /u/ si zanore të thjeshta ose si diftongje mund]të kenë qenë të përcaktuara mirë për çdo variant. Në të gjithë arealin ed të sot diftongjet, sidomos diftongjet gjegjëse të *i*-së, nuk dalin para dhe pas bashkëtingëlloreve *l, c, ʒ, j,* pas bashkëtingëlloreve *z, d, b, g, dʒ, dz, ɾ, r* dhe para bashkëtingëlloreve *k, p, t, ʃ*. Në qoftë se në atë kohë ki kzis tuar vërtet një rregullsi e këtillë, atëherë mund të themi se në atë fazë zanoret *i, u* dhe diftongjet gjegjëse *ei* etj., *au* etj. kanë qenë plotësisht variante kombinatore të fonemave /i/ dhe /u/. Me kalimin e kohës kjo rregullsi filloi të pësonte ndryshime, sigurisht në masë të ndryshme në të folme të ndryshme.

Këto ndryshime të pjesshme çuan në gjendjen e sotme ku shihet se varianti *i* del (rregullisht ose më mbyrë fakultative) edhe në ato rrethana fonetike ku më parë nuk dilte, d.m.th. del sot edhe atje ku, më parë dilte vetëm diftongu *əi, ai* etj. Siç shihet, prej këtyre ndryshimeve fitoi terren varianti *i*, kurse diftongu *ei* (*ai* etj.) nuk arriti pothuaj në asnjë të folme të shtrihej në rastet kur dilte varianti *i*.

Duke qenë se edhe sot diftongu nuk mund të realizohet në disa kushte fonetike të caktuara, mund të themi se ndryshimet e bëra gjatë kohëve nuk e prekën nga ana cilësore raportin e varianteve *i* dhe *ei* (*ai* etj.) të fonemës /i/, pra diftongu edhe sot ka mbetur si një variant fonetik i fonemës /i/.

Në qoftë se për fazën e parë mund të përcaktohej me mëdyshje se cili ishte kryesori nga dy variantet e fonemës /i/, sot kjo mëdyshje nuk ekziston, tashmë është e qartë se diftongu *ei*, (*ei*: *ai* etj.) është variant fonetik i kushtëzuar i fonemës /i/ (po lëmë mënjanë këtu edhe realizimin e tij si variant fakultativ). Për të mbështetur këtu pohim mund të shtohen edhe këto dy faktet: Së pari, në sistemin e zanoreve të patheksuaradel vetëm zanorja *i* dhe , së dyti, diftongu *ei* (*əi, ai* etj.) lidhet gjenetikisht me zanoren *i* e jo e kundërta (këto vlejnë edhe për *u*-në.

289. B. Beci, në artikullin *E foldja e Reç-e-Dardhës së Dibrës* (L), në «SF», 4, 196 f. 142 sjell këtë statistikë për zanoren *u* në këtë të folme: «nga 113 fjalë 19 dalin me *au (ou)*, 19 të tjera dalin herë me *u* e herë me *au*, kurse 75 fjalë e rujajnë *u*-në të padiftonguemë».

Në rastet kur për zanoren *i* dalin zanoret *e* dhe *a*, të cilat janë përfundime të zhvillimeve të mëtejshme të diftongjeve *ei̯*, *ai̯*, kemi të bëjmë me zëvendësimin fonemash. Proceset fonetike kanë çuar në defonologjizimin e varianteve fonetike *ei̯*, *ai̯*, këto diftongje kanë humbur funksionin e tyre si variante fonetike të kushtëzuara dhe midis të folmeve lindën kështu dallime në përbërjen fonematike të fjalëve.

TOGJET E ZANOREVE ua, ye, ie

3.18.1. Ekziston një ndarje e përgjithshme për praninë dhe shtrirjen e këtyre togjeve, të folmet ndahen në dy areale të mëdha që kanë si kufi të përafërt lumin Shkumbini: areali në jug të Shkumbinit përgjithësisht ka *ua, ye, ie*, kurse areali në veri të tij ka *ue, ye, ie* në disa të folme dhe *u, y, i*, në shumicën e të folmeve ka përkatësisht në vend të togjeve *ue, ye, ie*.

Në secilin areal ka diferenca ndërmjet të folmeve[290]. Kështu të folmet e toskërishtes jugore, d.m.th. të folmet e Çamërisë, të Delvinës, të Gjirokastrës, të Bregdetit, të Kurveleshit, të Zagorisë e të Lunxhërisë, bashkë me këto edhe të folmet e rrethit të Përmetit kanë togje zanoresh *ua, ye*[291], *ie* në të gjitha kushtet fonetike: *buaḷi, duar ftua, fyeḷi, dyer, u θye, mi̯eḷi, di̯eḷ, ʃtie*. Të folmet e kësaj zone për këtë dukuri përputhen plotësisht me gjuhën letrare.

Në bllokun e toskërishtes dallohen disa të folme, që formojnë dy ishuj; të folmet e Devollit, të folmet e pjesës jugore të Skraparit (ato që shtrihen në të majtë të Osumit), të folmet e Dëshnicës në rrethin e Përmetit dhe të folmet e Tepelenës në të djathtë të Vjosës, ato që vijnë si vazhdim i të folmeve të Dëshnicës. Këto të folme kanë diftongje në të gjitha kushtet fonetike, kanë edhe në rrokje fundore të hapur, veçse ato nuk janë gjithmonë të qëndrueshme: *ʃuaḷi, muaj, ftua, fyeḷi, fyeł, u θye, djeḷi, mi̯eł, bi̯e*.

Të gjitha të folmet e tjera të toskërishtes veriore, të folmet e Kolonjës, të Vithkuqit, të Korçës e të Fushës së Korçës, të Oparit, të Gorës, të Pogradecit, të Mokrës, të Skraparit (pjesa në të djathtë të Osumit), të Beratit, të Mallakastrës, të Myzeqesë, ajo e Vlorës (qyteti) në rrokje fundore të hapur: *dua, u θye, bie* dhe diftongje në rrokje të brendshme të mbyllura ose të hapura: *du̯ãr, ʃu̯aḷi, fyeł, fyeḷi, di̯eł, mi̯eḷi*.

290. Të dhënat për të folmet e ndryshme janë nxjerrë nga skicat, monografitë dhe studimet e tjera dialektologjike që kam cituar gjatë këtij punimi.
291. Sigurisht, atje ku nuk ekziston fonema *y*, në vend të togut *ye* ka *ie*.

Këtu kemi një gjendje të përzier, togjet janë dyfonematikë, ashtu si në toskërishten jugore, por në kushte të caktuara këto togje dalin fonetikisht si diftongje (shih § 3.6.2).

Në bllokun e gegërishtes ruajnë një gjendje më të hershme ato të folme të skajit verior që gjenden në zona të brendshme e të larta malore, si në Malësinë e Madhe, në Krajë, në Shkrel, në Dukagjin, në Rugovë, në Peshter, në Nikaj-Mërtur, Gash, Krasniqe, Bytyç e në Has dhe në një masë të mirë edhe në malësitë që mbyllin nga ana veriore Rrafshin e Kosovës, si në anët e Bajgorës, në malësinë e Llapit, të Gollakut, të Medvegjes etj. Më arkaiket ndër këto të folme malore janë ato të Peshterit, të Rugovës, të Kelmendit, Hotit, Grudës, Rrjollit dhe Shkrelit, gjesërisht edhe të Krajës, në të cilat del më shpesh togu *ua* (herë-herë edhe togu *uo* ose togu *ue*) në rrokje fundore të hapur: *kam ʃkua, ka lʃua*, kurse togjet *uo* edhe *ue* dalin në rrokjet e brendshme të hapura ose të mbyllura: *ruojm* «ruajmë», *e vaṙueme* (e plagosur), *knues* «këndues» (gjel), *luejʃin* «luanin» etj. Në Peshter, në shumë raste togu ua del edhe në rrokje të brendshme. Në raste të rralla në këto të folme ka edhe *u* në vend të këtij togu zanoresh. Në to folmet e Dukagjinit, të Nikaj-Mërturit, Gashit, Krasniqes, Bytyçit, Hasit e Krumës dhe në malësitë e Rrafshit të Kosovës ka zakonisht tog *ue* në të gjitha kushtet fonetike. E njëjta gjendje është edhe për togjet *ye* dhe *ie*, ruhen përgjithësisht në këto të folme malore në të gjitha kushtet fonetike: *krye, lyejm* «lyejmë», *dieł, bərziej* «përziej» etj. Në këtë zonë nuk mungojnë edhe rastet, sidomos në rrokje të brendshme të fjalës, ku në vend të togjeve dalin përkatësisht zanoret *u, y, i*.

Në trevën e të folmeve të gegërishtes që shtrihen midis Drinit dhe Matit, në disa të folme të Kosovës, sidomos në ato që gjenden në skaje dhe pranë malësive, dhe në një farë mase edhe në të folmet të zonave malore të trevës lindore të gegërishtes, që shtrihet prej Dibre e Gostivari deri në Shkup e në Kumanovë dalin shpesh të ruajtura togjet *ue, ye, ie* në rrokje fundore të hapur: *due, me knue* «kënduar», *krye, bie* etj., kurse në rrokje të brendshme, në vend të togjeve, dalin rregullisht *u, y, i* : *du:l* «doli», *pagu:j* «paguaj», *dy:r*, *θyjʃin* «thyenin», *mi:l* «miell», *dił*i «dielli» etj.

Një bllok të madh në gegërishte formojnë të folmet që shtrihen ndërmjet Matit dhe Shkunbinit, në të cilat, pa përjashtim, në të gjitha rastet ka zanore *u, y, i* në vend të togjeve *ue, ye, ie*: *m ka bəʃtu* «më ka shpëtuar», *du:l* «doli», *rujti* «ruajti», *kam θy*: «kam thyer», *θyj* «thyej», *θyva*<*θyeva* «theva», *me zi* «zier», *i pərzim* «i përzier», *e pərzime* «e përzier» etj. Kjo izofonë e redktimit të togjeve *ue, ye, ie* në *u, y, i* shkon e shtrihet edhe në zonat e ulëta të gegërishtes veriore, ajo përfshin në këto anë: Shkodrën me rrethinat, Bregun e Bunës, Zadrimën dhe në verilindje pothuaj gjithë qytetet e Kosovës dhe të folmet fushore, si në Rrafshin e Dukagjinit, edhe në Rrafshin e Kosovës.

Në brezin e të folmeve kalimtare ka të folme, si ato të Vërçës e të Rajcës, në një farë masë edhe ajo e Polisit, që kanë togje *ua, ye, ie* në të gjitha kushtet fonetike, kurse të folmet e tjera , ato të Shpatit, të Sulovës, të Dumresë, të Darsisë së Peqinit, të Çermave të Lushnjes dhe të Bregdetit të Poshtëm të Kavajës kanë rregullisht togje *ua, ye, ie* në rrokje fundore të hapur: *grua, u θye, bie* dhe zanore *u* për *ue*, *y* për *ye* në rrokje të brendshme: *kam punu:r* «kam punuar», *ka ləru:r* «ke lëruar», *du:r* «duar», *ʃuli* «shualli», *θy:m* «thyem», *fy:li* «fyelli» etj. Veçohet këtu togu *ie*, i cili edhe në këto kushte fonetike shpesh del i plotë, nuk reduktohet në *i*.

Të folmet e diasporës ruajnë në përgjithësi gjendjen e dialektit të asaj kohe kur janë shkëputur prej trungut të atdheut. Kështu në të folmet e arbëreshëve të Italisë[292] dhe në të folmet e arbëreshëve të Greqisë[293] gjejmë togje zanorësh, ashtu si në të folmet e toskërishtes jugore. Shpesh këtu për *ua* del edhe togu i vjetër *uo*, i cili tek arbëreshët e Italisë shqiptohet edhe si diftong ngjitës në rrokje të brendshme, si variant fonetik, edhe fakultativ: *duort* «duart», *muorm* «morëm», *buoł* «buall», *ngalkuom* «ngarkuar» (Greqi) dhe *duomi* «duam», *kiʃ paguor* «kishte paguar», *kloft bekuor* «qoftë bekuar» (Itali). Në të folmet e arbëreshëve të Italisë ndahet prej shoqeve e folja e Montecilfones, ku togjet dalin të reduktuara në një zanore, ashtu si sot në gegërishte.

E folmja e arbëreshëve të Zarës[294] në Dalmaci, e dalë nga anët e Malësisë së Krajës në gjysmën e parë të shek. XVIII, i ruan togjet të pareduktuara, ka *ua* (krahas tij edhe *uo* në rrokje brenda fjalës), *ye*, dhe *ie*: *mua, grua, me kəndua* «kënduar», *me arnua* «arnuar», *puntuor* «punëtor», *pluor* «pluar», *i juoj* «i juaj», *ndyesa* «ndjesë», *bie, mieł, dieł* etj.

Te shqiptarët e Ukrainës[295], e folmja e të cilëve edhe pse ka tipare thelbësore të toskërishtes, togjet janë reduktuar dhe kanë përfunduar *ua*-ja në *u* (*muj* «muaj» *ʃəmtur* «shëmtuar»), *ye*-je në *y* (*kry* «krye», *dyr* «dyer», *pys* «pyes») dhe *ie*-ja në *i* (*mił* «miell», *bi* «bie»).

---

292. M. Lambertz, *Albanische Mundarten in Italien*, në «Indogerm, Jahrbuch»
293. O.H.Reinhold, *Noctes Felasgicae*, Athen, 1655; G. Weigand, *Das albanische in Attika*, në «Balkanarchiv», 2 (1926); A.F.Furiki, *I am Attik elincalvaniki dialektos*, në «Athina», 44 (1932), 45 (1933); C. Haebler, *Grammatik dor albanischen Mundart von Salamis*, Wiesbadens, 1965.
294. C. Tagliavini, *L'albanese di Dalmazia*, Firenze, 1935; G. Weigand, *Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zare im Dalmatien*, në ««IBIRS XVII-XVIII», 1911, f. 177-239; I. Ajeti, *Istorjski razvitak gogijskog govora arbanasa kod Zadra*. Sarajevo, 1961.
295. S. Islami, *Material gjuhësor nga kolonitë shqiptare të Ukrainës* në «Bul për shk. shoq.», 2. 1955, f. 163-180.

Në Mandricë të Bullgarisë[296] ka *ua*: *grua, dualn* «dolën», *korkuan* «kërkuan», *ye*: *kərtsyeka* «kërcyeka», *u ksye* «u kthye» dhe, sipas një shembulli të vetëm që japin autorët e studimit të kësaj të folmeje, ka *je* për *ie*: *djelin*. Krahas *ua*-së ka edhe *uo*, por ky variant nuk del në rrokje fundore të hapur: *punuoke, duor* etj.

4.14.2. Në këtë pamje të larmishme që japin sot të folmet e shqipes për këto togje zanoresh shihen gjurmët e zhvillimit të tyre nga një fazë e caktuar. Sigurisht, këto gjurmë nuk të çojnë deri në pikënisjen e tyre nga një zanore e vetme[297], as edhe në fazën e kalimit të *o*-së deri në *uo*[298], sepse gjurmët e këtyre fazave të hershme nuk janë pasqyruar në dokumentet e shkruara dhe në dialektet e sotme.

Në analizën që do të bëjmë këtu për rrugën e zhvillimit të togjeve *ua, ye*, dhe *ie* do të nisemi nga ajo fazë kur *ua* ishte ende në gjendjen e *uo*-së. Megjithatë, e ndiejmë të nevojshme të bëjmë pak fjalë edhe për ndryshimet që ndodhën kur filluan të diftongohen *o*-ja, prej së cilës më vonë doli *uo*-ja, që është e dokumentuar, dhe *e*-ja që dha *ye* dhe *ie*. Për këtë fazë po ndjekim vetëm rrugën që bëri zanorja *o* për të shkuar deri në *uo*, sepse, me sa duket, edhe *e*-ja pati po ato shkaqe dhe bëri po atë rrugë për të arritur tek *ye* dhe *ie*.

Siç dihet[299], zanorja *o* e theksuar u diftongua në kushte të caktuara fonetike, ajo u diftongua vetëm në ato raste ku ndodhej në një rrokje të mbyllur nga një bashkëtingëllore sonante. Në këto kushte *o*-ja realizohej si një variant fonetik me timbrin e një *o*-je më të mbyllur, kishte pra një status fonetik të veçantë: *+ftọn (ftua)* etj. Që të kalonte o̱-ja (*o* e mbyllur) në togun e zanoreve *uo* duhet të jetë realizuar fonetikisht si një diftoid u̯o (një tingull jo i thjeshtë me një *u* të rrëgjuar në fillim dhe me *o*-në). Deri në këtë fazë, me ndryshimet fonetike të *o*-së në këto kushte, nuk u bë ndonjë lëvizje me karakter fonologjik në sistemin e zanoreve, sepse diftongoidi u̯o funksionon te si një variant fonetik i *o*-së, pra lëvizjet ishin bërë vetëm brenda kufijve të fonemës *o*. Kjo gjendje shkoi pa ndryshime fnetike dhe fonologjike derisa nuk ishte reduktuar bashkëtingëllorja *n* në fund të fjalë, pra derisa ende shqiptohej **ftọn*.

Pasi u reduktua *n*-ja fundore në fjalë të këtilla si **fton* (ftua), **peron* (përrua) **mon* (muaj) etj., diftongoidi u̯o mbetej i pamotivuar fonetikisht, sepse tashti në raste si këto nuk dilte në rrokje të byllur

296. M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Madricës*, në «SF», 2, 1965, f. 103-116.
297. G. Meyer, *Albanesischen Grammatik*, Leipzig 1888, f. 4,5.
298. N. Jokl, *Zur Geschichte des Alb-Diphtonge -ua, -ue*, në «Indogerm Forschungen», 49 (1931), f. 274-300 dhe 50 (1932). f. 33-50.
299. Po ai, *po aty*, Shih edhe Sh. Demiraj, *Rreth ditongimit të o-së në gjuhën shqipe*, në «SF», 3, 1981, f. 15-16.

nga një bashkëtingëllore sonante, kurse në rastet e tjera ku nuk pësuan ndrysime sonantet ai ishte i motivuar (**duor* «duar», *buoł* «buell», *duol* «doli» etj.). Me këto ndryshime fonetike ndryshoi edhe statusi i diftongoidit *u̯o*, i cili deri në këtë fazë funksiononte si variant i fonemës *o*. Pas kësaj ai doli nga kufijtë e *o*-së, sepse në rastet ku ra *n*-ja ishte i pakushtëzuar fonetikisht, u bë i pavarur. Me këtë u radhit edhe diftongoidi *u̯o* i rasteve të tjera ku qëndruan sonantet (*duor*, *buoł* etj.). Tashti ai funksiononte si një grup zanoresh i përbërë nga *u*.ja dhe *o*-ja, të cilat më shumë ka të ngjarë që në rrokje fundore të hapur të jenë shqiptuar si tog zanoresh *uo*, (*ftuo*, *muo* etj.), kurse në kushte të tjera si diftong *u̯o* (*du̯or*, *bu̯oł* etj.). Diftongu *u̯o* funksiononte si variant fonetik i kushtëzuar i togut *uo*.

Në qoftë se proceset janë zhvilluar në këtë mënyrë, mund të themi se, me daljen e togut *uo* prej *o*-së, ndodhën këto ndryshime në sistemin e zanoreve: diftongoidi *u̯o* u fonologjizua, humbi funksionin e tij si variant fonetik i fonemës *o*, togu *uo* i përbërë nga fonemat *u* dhe *o*, që dolën prej *u̯o*-së, solli ndryshime në dendurinë e përdorimit të këtij grupi zanoresh po të jetë se një grup si ky kishte ekzistuar edhe më parë në inventarin e grupeve të fonemave zanore, lindi një diftong *u̯o* me funksionet e variantit fonetik të grupit *uo* dhe, së fundi, në mënyrën e funksionimit të fonemave u krijua një rast i këmbimit të fonemës *o* me grupin *uo* në një rrokje të mbyllur nga një bashkëtingëllore sonante; në këto kushte fonetike neutralizohej kundërvënia e një zanoreje (e *o*-së) me një grup zanoresh (me *uo*-në): *dor* → *duor*, *dole* — *duol* «doli» etj. Ndryshime të këtilla ndodhën edhe për fonemën *e* që dha *ye* dhe *ie* në raste të caktuara.

Siç ka vërtetuar N.Jokli[300], edhe grupet *vo-*/*va-* (*voj* gegërisht, *vaj* toskërisht) pikënisjen e tyre e kanë nga një *o*, duke kaluar nëpër *uo*. Grupi *uo*/*ua* me këtë prejardhje gjendet vetëm në fillim të fjalës, fjalanis me këtë grup (*voj*, *voī*, *i vorfən*, *voδe* etj.),. Në raste të këtilla, për shkak të kushtev e fonetike të veçanta, meqenëse ndodhej në fillim të fjalës, diftongu *uo* u zhvillua më tej duke dhënë një grup tingëllor të përbërë nga një bashkëtingëllore (nga *v*-ja) dhe nga një zanore (nga *o*-ja, në toskërisht nga *a*-ja). Në këtë rast gjysmëzanorja *u̯* e diftongut *u̯o* kaloi në bashkëtingëllore buzore v për shkak se ishte në një pozitë të fortë, ishte në fillim të fjalës. Ndryshimet sollën fonologjizimin e *u̯*-së, sepse humbi finksionin e saj si variant fonetik i fonemës *u*, veç kësaj, tashti nuk realizohej më në fillim të fjalës diftongu *u̯o*.

Deri në këtë fazë ndryshimet nga *o* në *uo* u bënë gjithkund njësoj në mbarë truallin e gjuhës shqipe.

300. N. Jokl, *Zur Geschichte...f.*

3.18.3. Që aty nga fundi i fazës, kur u bënë ndryshimet nga *o* deri në *uo*, mund të kenë filluar proceset fonetike që çuan në diferencat që shohim sot nëpër të folmet e shqipes për togjet *ue*, *ye* dhe *ie*. Dallimi më i hershëm duhet të jetë ai që u krijua me daljen e togut ose të ditongut *ua* në të folmet e toskërishtes. Hershmëria e kësaj dukurie dialektore shihet në faktin se ky ndryshim përfshin edhe grupin *va* (*vatər* etj.), i cili nuk mund të mendohet veçse i formuar nga diftongu *u̯o*, siç e ka menduar N.Jokli (vep. cit.).

Pas kësaj ndodhën ndryshime të tjera njëra pas tjetrës në të folmet e shqipes, që çuan diku në kalimin e togut *u̯o* në *ue* dhe më tej në *u*, në disa të folme, diku në zbërthimin e diftongut *u̯a* në tog zanoresh *ua* në të gjitha kushtet fonetike e diku vetëm në rrokje të hapur fundore. Në disa të folme u ruajt togu *uo*.

Të gjitha këto ndryshime nuk ishin relevante për sistemin e zanoreve në dialektet e shqipes, nuk ishin të karakterit fonologjik, të atilla që të preknin vetë sistemin e fonemave zanore. Kalimi i *uo*-së në *ua*, në *ue* dhe në *u* (*ye*>*y*, *ie*>*i*) solli vetëm dallime në dendurinë e përdorimit të grupit të fonemave *uo*, *ua*, *ue* dhe të fonemave *u*, *y*, *i*, Atje ku diftongjet kaluan në togje zanoresh në të gjitha kushtet fonetike ndodhi edhe një fonologjizim i diftongjeve, që ishin variante fonetike të grupeve *ua*, *ye* dhe *ie*.

Përse është kjo gjendje sot? Siç do të shpjegojmë më tutje, zhvillimet e ndryshme që kanë pësuar këto diftongje nëpër të folmet e shqipes kanë qenë të lidhura me gjatësinë që kanë ruajtur ose që kanë fituar ato, me pozitën në fjalë dhe me karakterin e rrokjes ku kanë bërë pjesë.

Për mungesë të dhënash, që të jenë të dokumentuara në shkrimet e vjetra, ose që të gjenden në gjuhën e sotme të gjallë, është vështirë të provohet në se kanë kaluar këto diftongje gjatë zhvillimit të tyre nëpër shkallën e diftongjeve të vërteta ose të ekuilibruara, siç quhen diftongjet me komponentë barabar të theksuar. Prandaj hëpërhë po e lëmë mënjanë mendimin që kemi shprehur në një vend tjetër më parë[301] dhe po shpjegojmë vetëm kushtet e ndryshme fonetike që në disa të folme shkaktuan zbërthimin e diftongjeve në togje zantresh, në disa monoftongimin e tyre dhe në disa të tjera ruajtjen si diftongje.

Shqiptimin si togje zanoresh të diftongjeve i pari e ka konstatuar O. Dozoni[302] në zonën e Përmetit, por, duke mos e njohur atëhere prejardhjen e tyre nga zbërthimi i një zanoreje, arrin në përfundimin se shqipja nuk duhet të ketë pasur diftongje të mirëfillta dhe *ua*-në e quan si një bashkim dy zanoresh që formojnë dy rrokje.

301. J. Gjinari, *art. cit.* f. 372-374.
302. O. Dozon, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise,* Paris, 1879.

Më vonë H. Pederseni[303], duke bërë një përgjithësim, thotë se diftongjet shqiptohen togje zanoresh në shqipen jugore (mund të ketë bërë përgjithësim duke u mbështetur vetëm në toskërishten jugore), nuk jep shpjegim për këtë dukuri në shqipe, por vetëm sjell fakte edhe nga gjuhë të tjera ku konstatohet po e njëjta gjë.

K.Cipo në «*Gramatikën shqipe*» (1949), f. 12, pasi jep mendimin se sot në shqipe (me sa duket në shqipen e përbashkët letrare) te fjalët *diell, ruaj,* nuk ka doftong, sepse shqiptohen të theksuara zanoret *i* dhe *u,* thotë më poshtë: «*nuk formon diftong edhe kombinimi i dy zanoreve* kur vjen pas një bashkëtingëlloreje *r* e *l.* p.sh. *triumf, orialis, kriesë, klient, triak, krijoj, tryezë* etj.». A. Dodi[304], duke e zhvilluar këtë mendim, jep një shpjegim , sipas të cilit: «. .*sonantet, qoftë kur janë përpara diftongut, veçanërisht r, l, tentojnë të tërheqin theksin drejt vehtes, duke arritur nganjëherë edhe në ekuilibrin e elementeve*» . . . dhe jep shembuj: *tryezë, tryel, klient, luan, luadh,* me tog zanoresh dhe *duar, duan* me diftong. Faktet me tog zanoresh, si *tryezë, tryel, klient* etj. janë reale dhe i gjejmë në gjuhën letrare e në të folmet popullore, por mendojmë se shkaku nuk duhet të jetë ai që është dhënë, sepse si do të shpjegoheshin atëhere faktet e shumta me diftong: *ruaɲ* ose *ruaj, kruaɲ, luaɲ, lyeɲ, përmjer, rjep,* (<riɛp) etj.? Shkaqet duhet të jenë të tjera dhe të ndryshme. Për disa shkaku është fonetik, togjet e zanoreve në ato raste nuk vijnë nga zbërthimi i një zanoreje, por janë kombinacione si rezultat i ndryshimeve fonetike që ka pësuar fjala (*tryel* krahaso *turjel, luadh* krahaso *livadh, livad*), për disa duhet marrë parasysh shqiptimi në gjuhën nga janë marrë hua (*klient, triumf,* etj.) dhe për disa të tjera duhet parë morfologjia je tyre (*krijesë* < kri+esë, *kri(j)oj* < kri+o-j, *luan* ose *lua* vjen sipas E. Çabej[305] nga një *luo* — *loni* me prapashtesë zmadhimi -ã (< *-an*) si tek *patã -patani.*

A.Dodi[306] në përgjithësi shkakun e zbërthimit të diftongjeve në togje zanoresh e gjen te shpërngulja e theksit në një rrokje më përpara dhe në ballë të këtij procesi mendon se ka qenë gegërishtja, siç thotë ai, «*këtë dukuri e vemë re edhe në fjalë të tjera të tipit ai*». Por zbërthimi i diftongjeve në togje zanoresh nuk ka ndodhur vetëm në gegërishte, ai është kryer dhe në shumë të folme të toskërishtes, prandaj vendosja e theksit në elementin e parë nuk duhet të ketë qenë si shkak, por si rezultat i procesit të zbërthimit të diftongjeve për shkak

303. Sipas një shënimi të E. Çabejt në artikullin e cituar *Diftongje e grupe zanoresh të shqipes,* f. 77.
304. A. Dodi, *art. cit.,* f. 198. 189.
305. E. Çabej. *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe,* në «SF» 2, 1964, f. 32.
305. A. Dodi, *art. cit.,* f. 196, 202.

të gjatësisë së tyre dhe shpërngulja e theksit u bë në përputhje me veçoritë e përgjithshme të mbarë shqipes, sipas së cilës fjalët që kanë më shumë se dy rrokje duhet të jenë paraoksitone.

Ne mendojmë se diftongjet u zbërthyen në ato të folme ku nuk u shkurtuan për nga gjatësia, atje ku, siç ka mundësi më tepër, vazhduan të shqiptoheshin të gjata. Themi kështu, sepse procesi i zbërthimit të diftongjeve ka ndodhur kryesisht në gegërishte dhe në toskërishten jugore, ku janë ruajtur mirë deri sot zanoret e gjata, qoftë primaret, qoftë edhe ato sekondaret të formuara për shkak të pozitës në]fjalë ose për shkak të ndryshimeve fonetike që kanë pësuar fjalët.

Në ato të folme ku diftongjet janë monoftonguar (në disa të folme vetëm në trup të fjalës, kurse në disa të tjera në të gjitha pozitat) ka mbetur elementi i parë, i cili, për shkak se bart peshën e theksimit, ka reduktuar dalngadalë elementin e dytë, që ka qenë i lirë nga theksimi, gjersa e ka tretur krejt. Ky proces mund të ndodhte në një diftong zbritës ose në një **tog** zanoresh. Gj. Pekmezi[307], kur flet për diftongun, *ie*, duke përgjithësuar për tërë dialektin gegë, thotë: «*në gegërishte haset shpesh diftongu i gjatë ie* (e shënon *ie*), *vetëm se ai, veçanërisht në rrokje të mbyllur, monoftongohet*. . .?»; më poshtë thotë se *i, y, u*, të përftuara nga monoftongimi, shqiptohen me një ton zbritës e më të gjata se *i, y, u*, primare. Megjithëse Gj. Pekmezi në Gramatikën e vet nuk bën dallime midis diftongjeve dhe togjeve të zanoreve; nga ato që përmendëm më sipër, duket se monoftongimi, sipas tij, ka ndodhur në një diftong zbritës. Na duket se kanë më tepër të drejtë E. Çabej[308] dhe A. Dodi[309], të cilët mendojnë se procesi i monoftogimit ka ndodhur në togje zanoresh. Po ne do të shtoshim që, meqenëse ky proces ka ndodhur në një tog zanoresh, atëhere është më e drejtë të thuhet se në këtë rast kemi të bëjmë me një kontraksion zanoresh.

Gj. Pekmezi[310] monoftongimin e shpjegon me ndikimin e elementit muzikor, që, sipas tij, shfaqet me forcë në shqiptimin e rrokjeve të gjata, sidomos kur ato janë të mbyllura. Këtu ka një konstatim me vlerë, që monoftongimi ndodhi në rrokje të gjata të mbyllura, por shkaku i këtij procesi nuk mund]të shpjegohet me ndikimin e elementit muzikor, sepse ai nuk ekziston në gegërishte dhe në gjuhën shqipe në përgjithësi.

Të dhënat e sotme dialektore tregojnë se në një zonë të madhe të gegërishtes, në atë që ndodhet midis Drinit e Matit, dhe në të folmet kalimtare, diftongjet dalin rregullisht të monoftonuara vetëm në trup

307. F. Pekmezi, *vep. cit.*, f. 7.
308. E. Çabej, *Diftongje e grupe zanoresh të shqipes*», f. 71.
309. A. Dodi, *art. cit.* f. 202, 203.
10. Gj. Pekmezi, *vep. cit.*, f. 7. 16.

të fjalës (në rrokje të mbyllura ose të hapura). Ky fakt të çon te mendimi se monoftongimi për herë të parë është kryer në trup të fjalës. Kushtet fonetike që e kanë shkaktuar atë nuk kanë qenë vetëm gjatësia e diftongjeve, sepse ky kusht ka ekzistuar edhe për të folmet shkajore të gegërishtes e të toskërishtes, ku diftongjet për shkak të gjatësisë janë zbërthyer e kanë mbetur togje zanoresh. Ne mendojmë se me këtë rast, së bashku me gjatësinë, në rrokjet që ndodhen në trup të fjalës ka ndikuar edhe intensiteti relativisht më i madh që ka theksi dinamik i fjalës në përgjithësi në gegërishte e sidomos në gegërishten jugore, ku konstatohet monoftongimi në të gjitha pozitat dhe ku gjithashtu kanë ndodhur edhe reduktime të tjera e të shumta, të cilat herë-herë kanë çuar deri në zhdukje tingujsh ose rrokjesh.

Diftongjet që vazhdojnë të jetojnë akoma vetëm në toskërishten veriore shqiptohen sot të shkurtra dhe ngjitëse: *u̯a̯ł-i, ye̯ł-i, ie̯ł-i* (në disa të folme, siç kemi thënë, ka diftongje edhe në rrokje fundore të hapur: *θu̯a, u θye, bie̯*).

Gj. Pekmezi[311] ka konstatuar në toskërishten lindore kthimin e diftongut *ie̯* *në* *je* dhe thotë se kjo ndodhi, meqënëse toskërishtja shkoi në rrugën e shkurtimit të diftongut. Po të jetë fjala këtu vetëm për diftongun *ie* të fjalëve *mbjell, vjel*, etj. të ardhur nga një e, kjo, siç e kemi thënë, ka ndodhur në të gjitha të folmet e shqipes. kurse në toskërishten veriore shkurtimi ka përfshirë edhe tri diftongjet që po shqyrtojmë. Në toskërishten veriore, siç dihet, nuk janë ruajtur zanoret e gjata dhe për pasojë as diftongjet e gjata, kështu ,duke filluar për herë të parë në rrokje të mbyllura, diftongjet u shqiptuan të shkurtra dhe u ruajtën ashtu si diftongu i vjetër *je*<*ie* i fjalëve: *vjel, pjek, Pjetër, vjet, vjen* etj. Pasi ndodhi në rrokje të mbyllura, ky proces përfshiu edhe diftongjet në rrokje të hapura në trup të fjalës., gjë që duhet të jetë bërë për analogji ose për shkak se edhe më parë diftongjet nuk shqiptoheshin të gjata në këtë pozitë, kurse në rrokje fundore të hapura në shumicën e të folmeve, përkundrazi, ato u zbërthyen, sepse në një pozitë të këtillë nuk mund të shkurtoheshin.

Gjithashtu duhet thënë se në ato të folme të toskërishtes veriore, ku në rrokje fundore të hapur rregullisht ka togje zanoresh, tek emrat që mbarojnë në të pashquarën me *o* të patheksuar, kur shquhen, dalin me diftong *u̯a*: *Spiru̯a, Malu̯a, Mapu̯a, karua* etj. Shpjegimin e formimit të diftongut *u̯a* në rastet si këto na e jep morfologjia e këtyre emrave : këtu diftongu ka lindur nga bashkimi i *o*-së së shkurtër e të patheksuar të temës me mbaresën shquese *a* (kras. formimin e trajtës së shquar të këtyre emrave në të folme të tjera: *Spiro-Spiroja*

311 *Vep. cit.* f. 16.

ose *Spirja* etj.). Duke u bashkuar *o*-ja dhe *a*-ja të patheksuara (*Taqo-+a*), kanë formuar një diftong jo të gjatë **oa* (**Taqoa*), i cili u kthye pastaj në *ua* dhe u bashkërendua me diftongun *ua* që ekzistonte në fjalë të tjera, ku ka ardhur nga zbërthimi i *o*-së.

Për kronologjinë e zhvillimeve të ndryshme që kanë pësuar diftongjet nëpër të folmet e shqipes, përveç monoftongimit, i cili sipas E. Çabejt[312] dokumentohet për herë të parë më 1710. është vështirë të thuhet ndonjë fjalë, sepse dokumentet e shkruara në të dy dialektet nuk kanë shënuar me anë të grafisë gjatësinë e diftongut, hapjen e tyre në togje zanoresh dhe kalimin në diftongje të shkurtra ngjitëse.

Shihet se diftongjet *ua/ue*, *ye*, *ie*, duke ecur të gjithë krahas njëritjetrit brenda një të folmeje, gjatë zhvillimit të tyre kanë marrë rrugë të ndryshme në treva dialektore të ndryshme të shqipes. Pa lënë mënjanë edhe faktorin social, që ka ndihmuar deri në një farë mase në përhapjen gjeografike të rezultateve të proceseve që kanë ndodhur, duket qartë se zhvillimi i diftongjeve ka qenë i kushtëzuar nga gjatësia e tyre, nga intensiteti i theksit dhe nga pozita që kanë pasur në fjalë, d.m.th. nga karakteri dhe vendi i rrokjeve ku janë ndodhur, pra ka qenë një ndryshim fonetik pozicional që është bërë sipas rregullave të caktuara në mënyrë jo të njëjtë në treva dialektore të ndryshme. Këto kushte të ndryshme fonetike që u krijuan nëpër të folmet e shqipes shkaktuan për diftongjet dallimet që vërehen sot: zbërthimin e tyre e mbetjen si togje zanorësh në disa të folme, monoftongimin ose shkrirjen e dy zanoreve në një të vetme në disa të folme të tjera dhe formimin e diftongjeve të shkurtra ngjitëse në të folme të tjera.

Diftongimi nuk vepron sot. Që kjo dukuri nuk është sot e gjallë, e tregojnë në mënyrë bindëse këto fakte: shtrirja e diftongjeve me anë të analogjisë edhe në ato pozita ku kushtet fonetike nuk e përligjin: *mbuəlәm*, *mbuəlәt*, *lyeva* etj. dhe mbetja e temës me *o* e emrave të tipit *lakruar* si në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar: *lakror-i*, *qershor-i*, *krahror-i*, etj. (bile ka filluar të duket kjo edhe në emrat e tipit *trual*, *shuall*, p.sh. *troll-i*, *sholl-i*) Njësimi me *o* te *lakror-i* etj. po bëhet, sepse nuk vepron diftongimi tek emrat e shumtë që formohen sot me prapashtesën *-or*. (*blegtor*, *epror*, *rreshtor*, etj.) si dhe tek fjalët e huazuara që mbarojnë me *-or*, *-oll*, *-on* (*motor*, *tornitor*, *futboll*, *ballkon*, etj.).

Sot vërehet si prirje e përgjithshme shtrirja e togjeve të zanoreve në dialektin jugor dhe shtrirja e monoftongimit në dialektin verior. Mbi të folmet sot ushtron një ndikim të madh edhe gjuha e përbashkët shqipe, sidomos gjuha letrare, me anë të shkollës, të radios e të

312. E. Çabej, *Diftongje e grupe zanoresh të shqipes*, *f.* 77.

shtypit, që kanë marrë një përhapje të gjerë e masive në vendin tonë. Nën ndikimin e gjuhës letrare po fillojnë të përhapen kudo togjet e zanoreve. Këto tregojnë se për ndryshimet që pësojnë diftongjet sot luan një rol të madh faktori shoqëror.

NDRYSHIMET NË SISTEMIN E BASHKËTINGËLLOREVE

R O T A C I Z M I

3.19.1. Rotacioni, d.m.th. kthimi i bashkëtingëllores ndërzanore *-n-* në *-r-*, hundorësia e zanoreve dhe kthimi i *ã*-së në *ə* janë tri nga tiparet më të lashta që dallojnë dialektet. Të tria këto dukuri duhen parë së bashku, sepse kanë lidhje varësie dhe kronologjie.

Duke i parë të lidhura me njëra-tjetrën këto dukuri, shihet qartë se rotacioni në rend kronologjik është më i vonë se hundorësia dhe kjo e fundit është më e hershme edhe se kthimi i ã-së në *ə*. Kjo shpjegohet me faktin se karakteri hundor i zanoreve nuk mund të kuptohet pa praninë e bashkëtingëllores hundore dhe dukuria ã > *ə* s'mund të mendohet pa karakterin hundor të zanores *a*. Rotacizmi në vetvete nuk ka lidhje varësie me hundorësinë[313] në kuptimin që ai të jetë shfaqur vetëm atje ku ka pasur zanore hundore, sepse shihen edhe në raste si *ëmən-i/emər-i* etj., prapashtesa e shumësit të llojeve *-ëna/-ëra* e dalë nga bashkimi i mbaresës *a* me *-ën/-ër* (fundi i temave të fjalëve të]tipit: *ëmën/emër*[314], pjesorja *lidhur* etj); gjithashtu ndërmjet rotacizmit dhe hundorësisë nuk ka lidhje varësie as edhe në kuptimin që zhdukja e zanoreve hundore në të gjitha rastet është shkaktuar prej rotacizmit[315], sepse këtë nuk e provojnë raste të këtilla, si *kãngə* > *kəngə*, *kãmbə* > *kəmb(ə)*, *bãj* (< *baṛ*) > *bəj* etj. ku kalimi i ã-së në *ə* (gojore) është bërë edhe pa qenë i]pranishëm rotacizmi.

Për rotacizmin, së pari, duhet thënë se është një veçori absolute e toskërishtes, rastet: *kunor* dhe *vler* të gegërishtes që sjell E. Çabej[316],

---

313. E. Çabej, në *Fonetika historike e shqipes* (dispensë), Botimi II, Tiranë, 1960: f. 102, 115 mendon se këto dy dukuri kanë lidhje varësie.
314. M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, f. 8.
315. E. Çabej, çhundorëzimin e zanoreve në toskërishte e lidh me rotacizmin, (*Fonetika historike e shqipes*, f. 102); R. Ismajli, duke miratuar mendimin tonë (*për historinë e dialekteve....*, f. 137), thotë se nuk sheh lidhje kauzale në këtë rast (*Edhe diçka rreth rotacizmit në gjuhën shqipe*, në «Dituria», Prishtinë, 2-3, 1971/1972, f. 7.).
316. Po ai, *po aty*, f. 113.

siç thotë ai vetë, janë raste disimilimi, pra nuk kanë të bëjnë me dukurinë e rotacizmit.

Rotacizmin H. Pederseni[317] e shpjegon me shqiptimin e labërguar të *n*-së në gjuhën shqipe. Për mënyrën e shqiptimit të *n*-së në shqipe H. Pederseni ka të drejtë, sepse këtë e tregon edhe reduktimi i plotë i saj në fund të fjalës: *zã* (<*zan), *mułĩ* (< mullin), *ftua* (< fton), e tregon edhe rënia e mbaresës *-n* te kallëzorja e vjetër e pashquar, por mendoj se rotacizimi i *n*-së duhet vështruar në një plan më të gjerë, duhet lidhur me vetinë që kaĵpasur shqipja për reduktimin e bashkëtingëlloreve të zëshme ndërmjet zanoreve ose në fund të fjalës, p.sh. *be* (< beda), *pył* (< lat. padulem), *mjeʃtər* (< lat. magister), etj. Sot bashkëtingëllore të këtilla nuk reduktohen në këto pozita, por megjithatë, ato shqiptohen të dobëta (kjo zbulohet më mirë nga analizat eksperimentale në laborator).

Ka shumë mundësi që tingulli i përftuar nga rotacizimi i *n*-së të ketë kaluar nëpër disa faza gjersa arriti në *-r-*. Në fillim ai do të ketë qenë një variant i fonemës *n*, kurse pastaj, dalngadalë, erdhi e u puq me fonemën *r*.

Është krejt në kundërshtim me historinë e shqipes mendimi i V. Polakut se fenomeni i rotacizmit ndodhi «pas ardhjes së elementit shqiptar në Shqipërinë e Jugut» dhe se «është pasojë e substitucionit të lindur nga imitimi i «n» kakuminale shqipe prej sllavëve[318]. Ky mendim është në kundërshtim me historinë e shqipes, sepse tashmë është bërë e njohur dhe është vërtetuar bindshëm se rotacizmi në gjuhën shqipe ka filluar para ardhjes së sllavëve dhe se ai po pushonte së vepruari në kohën që erdhën sllavët në Shqipëri. Përveç kësaj, në qoftë se rotacizmi do të ishte pasojë e substitucionit të lidhur me imitimin e «n» kakuminale shqipe prej sllavëve, përse kjo ndodhi vetëm në ĵpjesën jugore të Shqipërisë e nuk ndodhi edhe në pjesën veriore ku gjithashtu sipas vetë V. Polakut ka vepruar ndikimi sllav (serb)? Më në fund po përmendim edhe faktin se, nga analizat e bëra në laborator të fonetikës eksperimentale është provuar[319] se *n*-ja e shqipes nuk është kakuminale.

Mendimi i Majer-Lybkes[320], i pranuar edhe nga të tjerë, se veprimi i rotacizmit bie para ardhjes së sllavëve ka një rëndësi të madhe edhe për vërtetimin e ekzistencës së shqiptarëve në këto vende ku janë sot para se të vinin sllavët, gjithashtu edhe shpjegimin e

317. H. Peder?en, *Albanesische Texte mit Glosar*, f. 8.
318. V. Polak, *Albanci a slovane*, f. 65.
319. A. Domi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Botim I, Tiranë 1, 1963, f. 24.
320. Meyer-Lybke, *Humanische Romanisch, Albanesisch*, në «Mitteilungen des Rumänischen Institute an der Universitet Wien», I, Heidelberg, 1914, f. 4L.

rrethanave e të shkaqeve gjuhësore të zhvillimit të rotacizmit dhe të ndalimit të tij.

Përsa u përket rrethanave dhe shkaqeve gjuhësore që ndaluan fenomenin e rotacizmit shpjegimet mund t'i japë fonetika historike e shqipes. Dihet se *-n-*ja intervokalike e parotacizuar, që kanë sot disa fjalë është shpjeguar me faktin se ajo vjen nga një *nn* ose nga një *n* që ka qenë në grup me bashkëtingëllore të tjera[321]. Për një kohë të gjatë ɲ-ja (*n* e ardhur nga *nn* origjinale dhe nga *n* + *bashkët.*) ka qenë e dallueshme fonetikisht dhe fonologjikisht nga *n*-ja, ajo ka qenë një *n* postdentale disi e zhurmët, ashtu si shqiptohet sot në shkodranishte ɲ-ja e ardhur nga *nd* (*ma kãña* «ma kënda»). Faza ɲ është arritur afër sisht atëherë kur vepronte e ishte duke mbaruar rotacizmi. Në periudhën e marrëdhënieve të shqipes me latinishten ɲ-ja nuk ishte kthyer në *n*, sepse përndryshe, do të ishte rotacizuar si *-n-*ja latine. Dalngadalë, kur ɲ-ja ndërronte natyrën e saj, kur vinte duke iu afruar në timbër *n*-së, gjersa u puq me të, ashtu si sot në Shqipëri të Mesme *n*-ja e ardhur nga *nd*-ja (*ma kãna*) varianti i *-n*-së që kishte filluar të rotacizohej vinte duke iu afruar fonetikisht fonemës *r*, gjersa u bë si ajo, d.m.th. kaloi nga varianti i *n*-së në fonemën *r*, ndodhi një fonologjizim i variantit fonetik, sepse tashti u gjendën në kushte fonetike të njëjta (ndërmjet zanoreve) edhe *n*-ja që po rotacizohej, edhe *n*-ja e ardhur nga ɲ-ja; siç e arsyeton më tej R. Ismajli, kjo dukuri fonetikisht e mundshme dhe fonologjikisht e domosdoshme, ishte ekonomike në plan të përgjithshëm gjuhësor[322]. Pas kësaj, *n*-ja dhe *r*-ja e rasteve ku kishte ardhur nga rotacizmi ishin dy fonema të ndryshme. Kjo periudhë përkon me kohën e hyrjes së sllavizmave, te të cilat për këtë shkak, me përjashtim të disa fjalëve të hershme, nuk u rotacizua *-n-*ja intervokalike. Po kështu ndodhi edhe në fjalë të ardhura nga gjuhët romane, greke të reja, turke etj.

BASHKËTINGËLLORET QIELLZORE C DHE ɟ

3.20.1. Të dhënat e derisotme të kërkimeve e të studimeve dialektologjike tregojnë se areali ku ruhen ende qiellzoret *c*, ɟ është shumë i madh, ai përfshin gjithë toskërishten, të folmet kalimtare, gegërishten jugore, të folmen e Krujës dhe një numër pak a shumë të madh të folmesh të gegërishtes veriperëndimore, si atë të Zadrimës, të Bregut

321. G. Meyer, *Albanesische SStudien*, III; E. Çabej, *Grupet* nd *e ng në gjuhën shqipe*», Bulet. për shk. shoq.», 4. 1953, f. 30.
322. R. Ismajli, *Edhe diçka rreth rotacizmit*. . . . , f. 7.

të Bunës, të folmen e banorëve të Shkodrës që kanë pasur besimin mysliman, të folmen e Shkrelit, të Thethit, të Malësisë së Madhe, të Ulqinit, të malësisë së Krajës dhe të rretheve të Tuzit. Vatra të vogla e të veçanta, ku mbahen ende qiellzoret mbyllotore *c* e *ɟ* ekzistojnë edhe në verilindje, ai në anët e Preshevës e Bujanovcit[323], në anët e Rugovës[324], të Peshterit[325] e në ndonjë zonë tjetër.

Treva, ku këto bashkëtingëllore kanë pësuar zhvillime të mëtejshme kap një pjesë të madhe të gegërishtes, e cila fillon prej Dukagjinit në perëndim, vazhdon në lindje në rrethet e Tropojës e të Kukësit, zbret poshtë më në jug: në Pukë, në Mirditë, në Mat e në Dibër, shkon në anën vrilindore, duke u hapur në një territor të madh që përfshin gati të gjitha të folmet shqipe të Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore.

Izofonat që pasqyrojnë zhvillimet e ndryshme të bashkëtingëlloreve c, ɟ përgjithësisht kanë këto shtrirje gjeografike: në qendër (rrethi i Tropojës, një pjesë e Dukagjinit dhe ana veriore e Mirditës) ekzistojnë si variante kryesore mesgjuhoret shtegore /ç/ (< c) e /ɟ/ (< ɟ), të cilat nyjëtohen duke nisur si *c* e ɟ, por që shqiptohen me hapjen e shtegut. Në këto të folme është zhdukur çifti i mbylltoreve *c*~ɟ, është shtuar një çift (ç~j) në radhën e shtegtoreve dhe është formuar një tufë korrelative me tri gjymtyrët: ç — j. Përgjithësisht

j

në Kosovë, në Dukagjin, në Shkodër (te banorët që kanë qenë të besimit katolik), në pjesën jugore e lindore të Mirditës dhe në anën perëndimore të Matit ka kryesisht afrikate mesgjuhore *tc*,~*dz*, (të këtilla bashkëtingëllore i gjejmë si variante edhe në të folmet shqipe të Maqedonisë, prej Gostivari e deri në Shkup); me daljen e këtyre fonemave në vend të qiellzoreve *c*~ɟ , nuk ka ndryshuar inventari, por është krijuar një tufë korrelative katërshe e afrikateve. Në lindje, pjesërisht në Kosovë, në Kukës, në Maqedoni, në Dibër dhe në pjesën më të madhe të Matit qiellzoret primare janë përputhur me afrikatet paragjuhore të tipit të përbashkët *tʃ* e *dʒ*, por, megjithatë, aty ka mbylltore iellzore *c*~ɟ të ardhura nga grupet *kl, gl* ose, në disa të folme. edhe nga grupet *tj, dj*. Në një numër shumë të vogël të folmesh, si në anët

323. I. Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bajanovcit*, në «GJA», 2, 1969, f. 37-61.
324. M. Begolli, *Të folurit e Hugovës me disa veçori të veta*, në «Përparimi», 5, 1958; f. 310-316.
325. L. Mulaku, M. Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Pesnhterit*, në «GJA», 2, 1972, f. 100.

Lurës[326], të Rajës e të Shoshit[327], qiellzoret *c*~ɟ janë zhvilluar duke përfunduar në shtegtore paragjuhore fishkëllyese të palatalizuara *c*,~z, (<*c*~ɟ), herë-herë ato nyjëtohen edhe si shtegtore njëvatërshe të palatalizuara *ś*, *ź*. Në sistemin bashkëtingëllor të këtyre të folmeve është formuar një opozicion i ri midis shtegtoreve /c,/, /z,/ dhe /ʃ/, /ʒ/ të tipit të përbashkët ose shtegtoreve të palatalizuara /ś/, /ź/ dhe /s/, /z/. Bashkëtingëllore të këtilla që u përgjigjen qiellzoreve *c*, ɟ dalin atykëtu si variante edhe në disa të folme të Maqedonisë Perëndimore. Në zonat ku ka c, e z, ose *ś* e *ź* dhe në ato pjesë të Matit e të Mirditës ku ka *tc*, e *dz*, nuk mungojnë si variante fakultative edhe afrikatet paragjuhësore *tʃ* e *dʒ*.

Areali i reflekseve të bashkëtingëlloreve *c*, ɟ që u zhvilluan në gegërishte nuk përputhet plotësisht me arealin ku grupet *kl* e *gl* kanë dhënë *kl̨*, *gl̨* e *k*, *g*. Kështu grupet *kl̨*, *gl̨* gjenden edhe në shumë të folme të gegërishtes veriperëndimore ku qiellzoret *c*, ɟ nuk kanë pësuar lëvizje. Reflekset *k*, *g* i gjejmë në verilindje në disa të folme të veçuara ku janë ruajtur bashkëtingëlloret *c*, ɟ. Përkundrazi, në shumë të folme të gegërishtes qendrore, ku *c*, ɟ kanë dhënë *tc*, e *dz*, ose *tʃ* e *dʒ* grupet *kl* e *gl* kanë dhënë *c*, ɟ.

3.20.2. V. Polaku[328], duke parë një ngjashmëri fonetike midis disa të folmeve të gegërishtes, ku qiellzoret *c*, ɟ shqiptohen si afrikate mesgjuhore *tc*, e *dz*, dhe serbokroatishtes, në të cilën ekzistojnë bashkëtingëllore afrikate të këtij tipi (ћ e ђ), ka nxjerrë përfundimin se edhe në këtë rast, shihet ndikimi i serbishtes në dialektin verior të shqipes. Së pari, siç e thamë edhe më sipër, kjo veçori nuk është karakteristike për gjithë dialektin gegë, por vetëm për disa të folme të tij. Së dyti, parimisht nuk është e drejtë që të nxirret një konkluzion i tillë duke u mbështetur vetëm në një ngjashmëri fonetike që mund të kenë dy gjuhë. Vështrimi i gjërave duhet bërë në një mënyrë më të gjerë dhe më të thelluar, duhet parë se ç'përfaqësojnë *tc*, e *dz*, në bashkësinë e varianteve të tjera gege të qiellzoreve *c* e ɟ, duhet parë dhe historia e përftimit të tyre në kuadrin e qiellzoreve të gjuhës shqipe, nuk po përmendim këtu edhe faktin që duhet pasur gjithashtu parasysh historia e formimit të afrikateve ћ e ђ në serbokroatishten.

Të gjitha këto variante dialektore të gegërishtes veriore, që për-

---

326. Q. Haxhihasani, *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*, në «BUSH, SShSh» 4. 1963, f. 123 dhe materiale të Kartotekës së dialektologjisë të mbledhura nga M. Çeliku.
327. M. Laubertz, *Bericht uber meine linguistischen Studien in AZlbanien von Mittel Mai fis Endi August* 1916, në «Auzeiger d.k. Akad. Viss. in Fien, Rh Hist. klasse», XX, 1916, f. 122-146.
328. V. Polak, *Albanci a slovani*, f. 88.

faqësojnë shkallë të ndryshme të zhvillimit të mëtejshëm të sërës së tretë[329] të qiellzoreve *c* e *ʒ* të shqipes, të përftuara nga palatalizimi i grykoreve *k* e *g* që ndiqeshin prej zanoreve të përparme *i* dhe *e* dhe gjysmëzanores *j*, nuk mund të shkëputen nga rruga që kanë ndjekur gjatë zhvillimit të tyre sëra e parë e qiellzoreve, e ardhur prej guturaleve palatale ie: $\widehat{k}$ e $\widehat{g}$, të cilat dhanë përkatësisht θ e δ dhe sëra e dytë e qiellzoreve të ardhura prej labiovelareve ie. $k^{w}g^{w}$, të ndjekura nga *i* ose *e*, që dhanë *s* e *z*[330].

GRUPET E BASHKËTINGËLLOREVE kl DHE gl

3.21.1. Reflekset e ndryshme të grupeve të vjetra *kl* e *gl*, që shihen sot nëpër të folmet e shqipes, tregojnë qartë se këto grupe nuk e nisën rrugën e zhvillimit në të njëjtën kohë kudo dhe gjithashtu tregojnë se zhvillimi i tyre diku u ndal në mes të rrugës e diku shkoi në fund, duke marrë drejtime të ndryshme. Po të mbështetemi në faktis se reflekset më të përhapura nga pikëpamja gjeografike janë mesgjuhoret mbylltore *c*, *ʒ*, të ngritura edhe në normë të gjuhës së sotme letrare, atëhere mund të mendojmë se reultatet e ndryshimeve që pësuan këto grupe nuk mund të ndahen nga sëra e tretë e qiellzoreve të shqipes, d.m.th. nga *c* e *ʒ* primare që lindën në shqipe nga palatalizimit të prapagjhoreve *k* e *g*. Por, në qoftë se do të marrim parasysh faktin se, të paktën në një numër të folmesh, zhvillimi i këtyre grupeve nuk zuri fill në të njëjtën kohë me qiellzoret mbylltore *c*, *ʒ* që nuk vijnë prej grupeve *kl*, *gl*, duhet pranuar se në planin dialektor ato duhen lidhur me sërën e tretë të qiellzoreve.

Kufijtë e shtrirjes së reflekseve të grupeve *kl* e *gl* në vija të përpërgjithshme janë dhënë edhe më parë prej studiuesve të ndryshëm të historisë së shqipes e të dialekteve të saj, por, megjithatë, ne mendojmë se është e nevojshme të jepet përsëri një pamje për këto reflekse e për kufijtë e përhapjes së tyre, sepse të dhënat e kërkimeve të shumta dialektore të bëra në terren brenda dhe jashtë Shqipërisë në këto 30 vjetët e fundit përcaktojnë më mirë kufijtë e shtrirjes së refekseve të këtyre

329. H. Pedersen, *Die Gutturale in Albanesischen*, në «Zeitsehrift fur Vergçeichende Sprachforschung», 36, 1900.
330. Më hollësisht këtë e kemi trajtuar në artikullin *Mbi vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe*, në «SF», 3, 1969, f. 71-79.

grupeve dhe, ç'ka është e rëndësishme, japin me hollësi rastet e veçant, ku shihen zhvillime të ndryshme të grupeve *kl, gl* brenda një të folmeje dhe gjithashtu japin një pamje të mirë të disa dukurive të tjera dialektore që janë të lidhura me këto grupe e që ndihmojnë shumë për shpjegimin e rrugës së zhvillimit të tyre.

Grupet *kl, gl* ruhen sot ende në skajin jugor të toskërishtes (në të folmet e Çamërisë), ruhen gjithashtu edhe nëpër të folme të kolonive, si në të folmet e arbëreshëve të Greqisë, në shumë të folme të arbëreshëve të Italisë dhe tek shqiptarët e Ukrainës. Këto grupe kanë qëndruar deri sot të pandryshuara te brezi i vjetër i malësisë së krahinës së Devollit vetëm në katër fjalë: grupi *kl* te *kliʃə* «kishë», *klytʃ* «kyç» e *klinda* «qindat e fustanit» dhe grupi *gl* në *zgleð* «zgjedh».

Reflekset *kļ* (< kl) dhe *gļ* (< gl), si bashkime të një prapagjuhoreje mbylltore me një gjysmëzanore, shtrihen sot në gegërishten veriperëndimore e pikërisht në Dukagjin, në Malësi të Madhe, në Shkodër e në rrethinat e saj, në Breg të Bunës, në malësinë e Krajës, në Zadrimë dhe në Peshter (afër Novipazarit në veri të Kosovës) e në Rugovë. Këtë fazë zhvillimi të grupeve *kl, gl* e gjejmë edhe në të folmen e shqiptarëve të Dalmacisë (pranë Zarës).

Areali ku grupet *kl* e *gl* kanë përfunduar vetëm në elementet e para *k, g*, shtrihet në verilindje, ai fillon nga perëndimi në krahinën e Nikaj-Mërturit, vazhdon pastaj në Krasniqe, në Gadh e Bytyç të Tropojës, zbret në pjesën veriore e qendrore të rrethit të Pukës, shkon nga lindja në rrethin e Kukësit dhe hidhet më në lindje duke mbuluar gjithë krahinën e Kosovës. Aty-këtu në mënyrë sporadike reflekset *k, g* dalin edhe në disa të folme shqipe të Maqedonisë Perëndimore, që janë fqinje me gegërishten verilindore, si e folmja e Dibrës e ndonjë tjetër.

Zhvillimi i grupeve *kl, gl* nëpërmjet palatalizimit deri në mesgjuhore mbylltore *c, ɟ* është kryer në një trevë dialektore të madhe, që përfshin shumë të folme të dy dialekteve, Kjo trevë përfshin pothuaj gjithë toskërishten, mbetet jashtë vetëm çamërishtja, përfshin brezin e të folmeve kalimtare dhe të folmet jugore e qendrore të gegërishtes (zonat e Elbasanit, të Durrësit, të Tiranës, të Krujës, të Mirditës, të Matit, të Dubrës dhe ato të Maqedonisë Perëndimore). Zhvillim i plotë deri në *c, ɟ* është kryer edhe në disa të folme të arbëreshëve të Italisë.

Në qoftë se në të folmet ku ruhen *kl, gl* dhe në të folmet ku ato kanë dhënë *k, g* vërehet një rregullsi e plotë për të gjitha rastet, në dy arealet e tjera, atje ku ato kanë përfunduar në *kļ, gļ* dhe në *c, ɟ*, në raste të caktuara shihen edhe shmangie, që shpjegohen fonetikisht, sepse edhe ato janë kryer sipas një rregullsie. Kështu pothuaj në të gjitha të folmet e gegërishtes veriperëndimore dalin me *k*: *ʃkyj* <shkly-

ej, *ki*:ʃ<kliʃə, *kyt͡ʃ*<klyt͡ʃ, *Kiri*<Kliri, pjesorja e foljes «jam» : *me kẽn, jam kẽn*, dhe me *g*: *gi͡ʃt*<gli͡ʃt, *gẽm*<glemb dhe ato forma të foljes «zgjedh» ku zanorja *e* e temës këmbehet me zanoren *i*: *zgiδ, zgiδni, zgiδʃe* <*zgleδ* etj. Në trevën ku *kl* e *gl* kanë dhënë *c* e ɟ kudo del me *k* fjala *kyç*; për raste të tjera të folmet e këtij areali ndahen në këtë mënyrë: ndërmjet të folmeve të toskërishtes dallohen vetëm ato të Korçës e të Bregdetit që kanë *k* e *g* në fjalët: *kiʃə, kinda* e *gi͡ʃt*, kurse në gegërishten jugore e qendrore kudo dalin me *k* fjalët *ki*:ʃ «kishë», *kin* «kind» dhe në shumicën e tyre: *ʃky*:*j* ose *ʃkiej* «shqyej» (në anët e Tiranës edhe *ʃkly*:*j* ose *ʃkəlyj*) dhe me *g*: *gi͡ʃt* e *zgiδ* (format ku *e-ja* këmbehet me *i*-në).

Në disa të folme të toskërishtes vërehet edhe një fenomen tjetër: në anët e Beratit, të Myzeqesë, të Gjirokastrës e të Bregdetit të Poshtëm zhvillimi *kl*>*c* ka përfshirë edhe fjalën *ci͡ʃ* «kishë», në Myzeqe edhe fjalët: *cyt͡ʃ* «kyç» dhe *cet͡ʃkəz* (pjesë parmende) nga *kleçk*+*ēz*.

Shmangiet nga rregulli i përgjithshëm në këto të folme, siç shihet, kapin pjesën më të madhe të truallit të shqipes. Ato shpjegohen me faktin se *kl* e *gl* janë ndodhur në kushte të caktuara fonetikë, përgjithësisht në raste ku grupet *kị, gị*, të dala prej grupeve *kl* e *gl*, kanë qenë pasuar të shumtën e herës prej zanores së përparme *i* të theksuar: *klishë*>*kị̈ishë*>*kishë, glisht*>*gị̈isht*>*gisht* etj. Në këto kushte gjysmëzanorja *ị̈* e grupeve *kị, gị* është shkrirë me zanoren *i* pasuese, fenomen ky që është i njohur për shqipen e përbashkët (krahaso këmbimet fonetike të sotme *ji*→*i*: *vaji*>*vai, jini*>*ini* etj.). Tek fjala *kyç* nga sl. *ključ i*-ja është shkrirë me *u*-në dhe të dyja kanë dhënë *y*, ndërsa tek rastet e veçanta të anës veriperëndimore *kẽn* nga *klenë*, *gẽm* nga *glemb* ka të ngjarë që të ketë ndodhur një monoftongim i diftongut ngjitës *i̯e* në *e* (krahaso në këto anë *δe*:*t* për *dhjetë*).

3.21.2. Gjuhëtarët që janë ndalur në studimet e tyre për trajtimin e historisë së zhvillimit të grupeve *kl, gl* në gjuhën shqipe kanë qenë të një mendjeje për rrugën që kanë ndjekur këto grupe nga gjendja e tyre e vjetër deri në *kị, gị* në disa të folme edhe në *c*, ɟ në të folme të tjera, po ata janë ndarë pastaj kur kanë dhënë mendime për kalimin nga *kl, gl*, në *k, g*. Kjo e gjen shpjegimin e vet në faktin se, ndërsa për reflekset *kị, gị* e *c*, ɟ shkaqet fonetike dhe fazat e zhvillimit janë më të dukshme e për pasojë më të pranueshme, për reflekset *k*, **g**, çështja është më e ndërlikuar dhe mungojnë të dhëna të tilla që të merren si argumente të drejtpërdrejta për të nxjerrë përfundime të pakundërshtueshme. Në këtë rast studiuesit janë ndarë në dy lagje: njëra palë sheh një kapërcim të pandërmjetshëm nga *kl, gl* në *k*, **g**, kurse pala tjetër pranon një fazë kalimtare *kị, gị*.

I pari që ka hedhur mendimin për kalimin nga *kl, gl*, në *k*, **g**, duke u reduktuar *l*-ja para se të jotizohej, ka qenë, siç dihet, K. talia-

vini[331]. Mendimin e këtij albanologu e ka miratuar më vonë E. Çabej[332], megjithëse me një rezervë të vogël.

Hipotezën tjetër e ka shprehur së pari Cimohovski[333]. Kjo hipotezë ka tërhequr pas vetes shumë nga studiuesit që e kanë trajtuar këtë problem. Njëri pas tjetrit janë shprehur për këtë mendim I. Ajeti[334], A. Desnickaja[335], L. Mulaku[336] dhe H. Agani[337]. Mund të thuhet se tek I. Ajeti[338] tërthorazi nxirret edhe mendimi i tretë sipas të cilit *kl, gl* kanë kaluar në *k, g* pas një depalatalizimi të mesgjuhoreve *c, ʒ*, por, me sa duket, ky është një konkluzion i hequr në kalim nga disa të dhëna të pjesshme, që i kanë dalë në një rast të vetëm në të folmen e Preshevës e Bujanovicit, përndryshe ai kryesisht qëndron në anën e V. Cimohovskit.

Mendimi i parë mbetet një hipotezë që kërkon shumë argumente për të mbështetur reduktimin e pandërmjetshëm të *l*-së në grupet *kl, gl*. Mendimi i dytë diçka mbahet duke qendruar mbi një argument të tërthortë, meqenëse grupet *kj, gj*, si një fazë e ndërmjetshme, jetojnë edhe sot e kësaj dite në gegërishten veriperëndimore, një trevë kjo që bën pjesë në gegërishten veriore, ku hyn edhe grupi i të folmeve verilindore.

Megjithatë, sot për sot ky argument mbetet vetëm i tërthortë gjersa faza *kj, gj* nuk vërtetohet dot për vetë të folmet verilindore as në gjendjen e sotme, as në etapa të mëparshme të historisë së tyre, që nga koha kur fillojnë të pësojnë lëvizje grupet *kl, gl*. Shembujt: *kie-t* ose *kje-t* dhe *zgieð* ose *zg-jeð* të sjella prej L. Mulakut (vep. e cit., f. 117, 118) si relikte të fazës *kj, gj* në anët e Kosovës nuk mund të merren si të këtilla. Ato janë një koincidim i mëvonshëm i shkaktuar në rastet e dhëna prej një zhvillimi relativisht të ri, që ka pësuar zanorja *e* e theksuar, e cila është diftonguar dhe ka dhënë sipas pozitës herë diftong zbritës me *i* të gjatë dhe herë diftong ngjitës me *i* të shkurtutër, që ka kaluar në gjysmëzanore *i* ose në bashkëgëllore *j*, ashtui si te *kie* «që» (shumësi i emrit *ka*-u), te *kie* «ke» (e tashmja e vetës së dytë e foljes «kam») etj.

---

331. C. Tagliavini, *Le parlate albanesi di tipo Chego orientale*, f. 56.
332. E. Çabej, *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, në BUSh SShSh» 1, 1958, f. 52.
333. W. Cimohowski, *Le dialecte de Dushmani*, 1951, f. 22.
334. I. Ajeti, *Pamje historike*, f. 34 dhe *O jezik Divana*, f.39
335. A. Desnickaja, *Albanskij jazyk i ego dialekty*, 1968, f. 145.
336. L. Mulaku, *Govor albanca Bajkorske Salje*, Prishtina, 1968, f. 261.
337. H. Agani, *Cila është treva gjuhësore e fjalorit të Kujunxhiçit* II, në «GJA» 1, 1968, f. 174.
338. I. Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, në «GJA», 2. 1969, f. 51.

As edhe prova se te P. Bogdani gjenden disa raste ke *kj, gj* krahas atyre vetëm me prapagjuhore *k, g* nuk e ndryshon dot karakterin e tërthortë të këtij argumenti. Për këtë shkrimtar të vjetër me origjinë nga anët verilindore mbetet që mbetet dyshimi se është përpjekur të normalizojë gjuhën e veprës së vet duke u drejtuar nga e folmja e dheut të Shkodrës.

Edhe sikur ky argument të ishte i drejtpërdrejtë për gegërishten verilindore, prapëseprapë mendimi i kalimit të grupeve *kl, gl* në *k, g* nëpërmjet grupeve *kj, gj* mbetet gjithashtu një hipotezë që kërkon prova të tjera për të vërtetuar se gjysmëzanorja *j* u reduktua pa palatalizuar elementet e para të grupeve *kj, gj* ose duke i palatalizuar ato e duke i kthyer në qiellëzore *c, ɟ*, të cilat pastaj u depalatalizuan e dhanë *k, g*.

V. Cimohovski, I. Ajeti dhe L. Mulaku janë mjaftuar vetëm me pohimin që përmendëm. A. Desnickaja, e cila është thelluar diçka më tepër për këtë problem në veprën e cituar (f. 141, 145, 146), duke treguar edhe shkaqet, ka shprehur mendimin se grupet *kj, gj* nuk janë palatalizuar, por metgjithatë prej saj nuk është bërë asnjë përpjekje për t'u argumentuar reduktimi i gjysmëzanores *j*. Mendojmë se kjo nuk gjen shpjegim as me faktorët fiziologjikë[339], me mosaktivizimin e pjesës së mesme të gjuhës në shqiptimin e mesgjuhorëve në gegërishten verilindore. Meqenëse jemi këtu, është e nevojshme të thuhet se faktorë të këtillë lidhen me bazën e nyjëtimit të një gjuhe a të një dialekti dhe, duke ditur se baza e nyjëtimit ndryshon kohë më kohë me zhvillimin që pësojnë sistemi fonologjik e fonetik i gjuhës a dialektit, nuk mund të merren për shkak ata faktorë që vetë janë pasojë.

A. Desnickaja, duke i rrokur së bashku reflekset e grupeve *kl* e *gl* si në gegërishten verilindore, ashtu edhe në gegërishten veriperëndimore, mendon se këto grupe nuk dhanë mesgjuhore *c, ɟ* në këtë trevë të gegërishtes, sepse, sipas saj, mesgjuhoret mbylltore primare kanë qenë pushtuar shumë herët nga prirja për t'u shkrirë me afrikatet (mesgjuhore) (vep. e cit., f. 145). Po aty ajo vazhdon të shpjegohet më gjerë duke thënë «në qoftë se në gegërishten jugore, si edhe në toskërishten veriore (sic) grupet *kj, gj* në kohë e vet u tërhoqën drejt radhës së mesgjuhoreve mbylltore dhe në fund të fundit hynë në to duke humbur cilësinë e tyre të grupeve të një prapagjuhoreje mbylltore me një zanore jorrokjeformuese, që kishte treguar në të veprim pala-

339. Ky mendim është shprehur me rezervë prej H. Aganit në *vep. e cit.* f. 182. Pohimi se në këto anë të gegërishtes nuk aktivizohet pjesa e mesit të gjuhës për nyjëtimin e mesgjuhoreve duhet rishikuar se në sistemin e bashkëtingëlloreve të gegërishtes verilindore ekziston qiellzorja shtegtore *j* dhe në disa raste të pakta edhe okluzivja *n*.

talizues, në gegërishten veriore kategoria e mesgjuhoreve *c* e *ʒ* në këtë kohë ishte zhdukur. Këto, mbasi ishin zëvendësuar nga katagoria e afrikateve mesgjuhore, nuk mundën të tërhiqnin pas vetes grupet *kj*, *gj* dhe t'i gëlltitnin ato. Kategoria e prapagjuhoreve mbylltore ruajti qëndrueshmërinë e vet» (po aty, f. 145).

Vështrimi së bashku i rrugës së zhvillimit të grupeve *kj* (*kl*) e *gj* (*gl*) dhe i mesgjuhoreve *c* e *ʒ* bën që të shihen dukuritë dialektore brenda sistemit fonologjik të të folmeve. Kjo do të ishte një përpjekje e frytshme për shpjegimin e kësaj dukurie dialektore sikur në rastin konkret këtë hipotezë ta mbështetin faktet reale të gjendjes së sotme të këtyre të folmeve të gegërishtes dhe kronologjia e zhvillimeve të grupeve *kl*, *gl* dhe mesgjuhoreve *c*, *ʒ*, që jep fonetika historikie e shqipes për këto treva.

Gjendja e sotme e këtyre të folmeve dhe e disa të tjerave, që janë fqinje me to, tregon se areali i reflekseve *kj*, *gj* e *k*, *g* i grupeve *kl*, *gl* nuk përputhet me arealin e reflekseve të mesgjuhoreve primare *c* e *ʒ*. Sigurisht, mund të mendohet se në ndonjë nga këto të folme të ketë në njërin ose rjetrin rast ndikim prej të folmeve fqinje, por asnjëherë nuk mund të themi se mospërputhja e këtyre izofonave në gjithë këtë trevë do shpjeguar në këtë mënyrë. Grupet *kj*, *gj*, të ardhura nga *kl*, *gl* shtrihen sot në të gjitha të folmet e gegërishtes veriperëndimore, kurse nga ana tjetër shihet se qiellzore *c*, *ʒ* ruhen të pandryshuara në një numër të madh të folmesh të këtij grupi të gegërishtes. Ato ruhen p.sh. në Zadrimë, në Bregun e Bunës, në Shkrel, në Theth, në Malësinë e Madhe, në Ulqin, në anët e Krajës, në të folmen e Preshevës, të Bujancovit e të Peshterit në Serbinë Jugore dhe në gegërishten qendrore në rastet ku vijnë prej grupeve *kl*, *gl*.

Pra del e qartë se shkaku i zhvillimit të grupeve *kl*, *gl* deri në fazën *kj*, *gj* në veriperëndim ose zhvillimi i tyre në *k*, *g* në verilindje nuk duhet kërkuar te fakti që në këtë anë të shqipes mesgjuhore *c*, *ʒ* kanë përfunduar në afrikate, qoftë kjo herët ose vonë.

Përsa i përket kronologjisë, kalimin e grupeve *kl*, *e gl* në *kj* e *gj* e shohim]që tek autorët e vjetër, që vijnë pas Gj. Buzukut, (tek P. Bogdani gjejmë edhe *k*, *g*), kurse lëvizja e mesgjuhoreve mbylltore *c*, *ʒ* drejt afrikateve nuk del gjëkundi tek ata shkrimtarë. I. Ajeti[340] për gjakovarishten e mendon të kryer këtë zhvillim aty nga fundi i shekullit të kaluar. Caktimi prej E. Çabejt[341] i çerekut të parë të shekullit XVIII si një kronolcgji relative për kalimin e qiellzoreve *c*, *ʒ* në afrikate *t͡ʃ*, *d͡ʒ* në gegërishten veriperëndimore, është mbështetur vetëm në faktin se këto reflekse shihen tek arbëreshët e Zarës (Dalmaci, të

340. I. Ajeti, *Pamje historike*, f. 28.
341. E. Çabej, *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, f. 33



Hartə 32 (ADGJSH) 1. ruhen c, ʒ primare

shpërngulur nga anët e Briskut e të Shestanit rreth viteve 1726-1735. Por ky mendim ndoshta do rishikuar përderisa mesgjuhoret *c, ʒ* ruhen edhe sot e kësaj dite në vetë këto anë të Krajës. Një gjendje e këtillë, që del nga historia e fonetikës së shqipes, tregon se në gegërishten veriore faza *kj* e *gj* e grupeve *kl* e *gl* është arritur më përpara se të fillonte lëvizja e mesgjuhoreve mbylltore drejt afrikateve e jo e kundërta.

Rrugët e ndryshme që morën grupet *kl* e *gl* gjatë zhvillimit nëpër të folmet e shqipes vërtet duhen shpjeguar duke u rrokur fenomenet dialektore të lidhura me njëri-tjetrin brenda sistemit fonologjik, pra në rastin konkret duke i parë grupet *kl, gl* të lidhura me mesgjuhoret

c e ʒ, ato duhen lidhur me lindjen dhe formimin e qiellzoreve mbylltore *c* e ʒ e jo me kalimin e tyre në afrikate.

Kështu në ato të folme ku grupet *kl* e *gl* dhanë *c* e ʒ, ka shumë të ngjarë që stadi *kj* e *gj* të jetë arritur në një kohë kur mesgjuhoret e sotme *c* e ʒ nuk ishin formuar ende si fonema të veçanta, por kur funksiononin si variante fonetike të prapagjuhoreve përkatëse *k* e *g* në kushte fonetike para *i*-së, *e*-së, *j*-së, të cilat u jepnin këtyre bashkëtingëlloreve timbër palatal. Grupet *kj* e *gj* hynë në një rrugë zhvillimi së bashku me paraardhësët e këtyre qellzoreve për të kaluar ashtu siç ndodhi më vonë, në mesgjuhore mbylltore *c*, ʒ si fonema të veçanta. Në rrugën e kalimit nga *kl*, *gl* në *c*, ʒ u bënë këto ndryshime: kur u shndërruan në *kj*, *gj*, nuk ndodhi ndonjë ndryshim fonologjik, në kuptimin që të lindte ose të zhdukej ndonjë fonemë përbërëse e grupeve, ndodhën vetëm ndryshime në inventarin e grupeve bashkëtingëllore, dolën nga ky inventar grupet *kl*, e *gl* dhe u zhduk opozicioni i tyre me *l*-në ose me *k*-në dhe *g*-në, palatalizimi i *k*-së dhe *g*-së nën ndikimin e *i*-së solli vetëm ndryshime të karakterit fonetik, në kushte para *i*-së këto bashkëtingëllore shqiptoheshin me timbër palatal, kur kaluan në *c*, ʒ, ashtu si edhe në fjalët e tjera ku *k* e *g* të palatalizuara dhanë mesgjuhore qiellzore, u bënë ndryshime të karakterit fonologjik, lindën në sistem dy fenoma të reja (*c* e ʒ), të cilat u kundërviheshin tashti prapagjuhoreve *k* e *g* me tiparin e tyre mesgjuhore. Ndryshe nga këto të folme, në gegërishten veriore është shumë e mundur që stadi *kj*, *gj* të jetë arritur në një periudhë kur variantet kombinatore të palatalizuara të prapagjuhoreve *k* e *g* kishin dhënë tashmë fonemat e veçanta mesgjuhore mbylltore *c*, ʒ, kështu që nuk mund të formoheshin më variante të palatalizuara të *k*-së e *g*-së nga grupet *kj gj*, ashtu sikurse nuk formohen sot nga grupet *k-j*, *g-j*, *l-j*, *n-j*, *t-j*, *d-j* etj.

Me kalimin e grupeve *kl*, *gl* në *kj*, *gj* në gegërishte veriperëndimore nuk ndodhën ndryshime fonologjike në sistemin fonetik të kësaj zone, por vetëm ndryshime në inventarin e grupeve të bashkëtingëlloreve.

Duke qenë se në verilindje përfundimet e zhvillimit të grupeve *kl* e *gl* kanë qenë të ndryshme nga ato të zonës veriperëndimore, mund të mendohet se në këto dy treva të gegërishtes veriore qiellzore *c* – ʒ kanë qenë në faza zhvillimi disi të ndryshme në kohën kur do të përsonin zhvillimin e mëtejshëm grupet *kj*, *gj*. Në qoftë se në veriperëndim qiellzoret *c*, ʒ mund të ishin formuar plotësisht, kur grupet *kl*, *gl* kaluan në *kj*, *gj*, ka të ngjarë që në verilindje procesi i formimit të tyre të mos kishte shkuar ende deri në fund, ato mund të kenë qenë në kohën që sapo formoheshin si fonema të veçanta. Në verilindje gjysmëzanorja *j* e grupeve *kj*, *gj* u dha prapagjuhorve një timbër palatal disi të lehtë duke u reduktuar vetë plotësisht.

Me rënien e gjysmëzanores *ị*, timbri disi palatal i këtyre prapagjuhoreve të ardhura nga grupet *kị*, *gị* mbeti i pamotivuar fonetikisht dhe humbi dalngadalë, sepse pas lindjes së fonemave të reja qiellzore *c*, *ɟ* nuk vepronte ligji i palatalizimit të këtyre bashkëtingëlloreve nën ndikimin e zanoreve të përparme *i*, *e* ose gjysmëzanoreve *ị*. Zhvillimet që pësuan grupet *kl* e *gl* në verilindje sollën ndryshime në inventarin e grupeve të bashkëtingëlloreve dhe në opozicionet e tyre me disa grupe a me disa bashkëtingëllore. Me këto ndryshime u rrit denduria e përdorimit të bashkëtingëlloreve *k* e *g*.

Me të drejtë janë parë të lidhura me këtë fenomen disa raste që në shqipen e përbashkët janë me *q* dhe që në të folmet verilindore dalin me *l*, si *kep* «qep», *ker* «qerre», *lkẽ* «liqen», *keʃ* ose *kieʃ* «qesh» *kie* «qe» (shumësi i emrit *ka-u*), *kindz*, «qengj», *kime* «qime» e ndonjë tjetër. Në shumë nga këto raste zanorja *e* nuk është primare, ajo është përftuar prej ndërrimit të *a*-së në *e*[342]. Edhe diftongimi i *e*-së në *ie* te disa nga këto fjalë këtu duhet të jetë i vonë. Rrajtja e grykoreve në këto raste të gegërishtes verilindore do të ishte e shpjegueshme në qoftë se, si ndërrimi *a/e*, edhe diftongimi *e* > *ie*, kanë ndodhur atëherë kur nuk vepronte procesi i palatalizimit të bashkëtingëlloreve prapagjuhore. Por ky mbetet gjithnjë një problem i vështirë dhe i hapur që kërkon të studiohet për të dhënë prova më bindëse.

Është pak e vështirë të mendohet se në këto raste *k*-ja njëherë u palatalizua në *q* e pastaj me anë të një regresioni u kthye përsëri në prapagjuhore. Themi është e vështirë, sepse një proces i këtillë nuk del gjatë historisë së shqipes. Është e vërtetë se në ndonjë të folme të izoluar, siç është ajo e Kërrabës[343] në një e dy raste shihet një regresion nga *q*- në k, p.sh. *kit kryet* «qit kryet», *ati ki e vrau i mur grũn* «atij qi (që) e vrau i mori gruan», por mendojmë se në këtë të folme kanë qenë faktorë psikologjikë ata që e kanë shkaktuar këtë fenomen për t'iu shmangur keqkuptimeve të papëlqyeshme, pra në këto raste kemi bëjmë me faktorë jashtëgjuhësorë që çuan në zëvendësimin e njerës fonemë me tjetrën. Po ashtu edhe rastet e sjella për të folmen e Kaçanikut prej F. Rakës[344]: ʃeker «sheqer», *kerpitʃ* «qerpiç» e fjalë të

342. Për *qep* nga lat. *capio* shih H. Pederse, KZ XXXVI, 330; N. Jokl, *Ling. Kul., Unter.*, 308. Për krahasimin e *qesh* me *ie. kakhio* shih H.Barić, *Albano-rumunt. Stud.*, I, 1919, 42; C. Tagliavini, *L'albanese di Dalmazia*, Për *kerr* «qerre» nga lat. *carra* shih W. Meyer-Lübke, 1043. Për *lke* «liqen» nga gr. vj. λεκάνιον shih Thumbi, *IF* 26, 15 dhe E. Çabej, *Shumësi i singul.*, Tiranë, 1967, f. 133. Për *kingj* «qengj» nëpërmjet një *ken-k* shih E. Çabej, *Studime rreth etim.* BUSh SShSh» 2, 1965, f. 38.

343. M. Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës, në* «SF», 2, 1966,

344. F. Rakaj, *Vëzhgime mbi të folmen e Kaçanikut*, në «Përpafrimi», 12, 1970, f. 666.

tjera me origjinë turke dhe *ketər* «tjetër», *gep* «djep» etj. nga grupet *tj*, *dj* (ka edhe *gjal* për *djal*, *gjaθ* për *djathë*, por *gem* për *djem* duhen parë të lidhura sidomos me mjedisin e huaj që ka pranë ajo e folme.

Fakti që në gegërishten verilindore shquhen duke marrë *i* e jo *u* emrat mashkullore]që mbarojnë me *k*, *g*, *h* (*miki*, *zogi*, *krahi*) nuk mund të lidhet me palatalizimin e grupev *kl*, *gl* në ato anë[345]. Në këtë rast mund të kemi të bëjmë me një dukuri gramatikore, me përgjithësimin e mbaresës shquese *i* te të folmet e kësaj treve të shqipes në një kohë të dhënë, herët ose relativisht vonë.

Reflekset *k*, *g* të grupeve të vjetër *kl*, *gl* në gegërishten verilindore dhe refkekset *kj*, *gj* në gegërishten veriperëndimore, ashtu si veçoritë e tjera dalluese të të folmeve të shqipes, lindën dhe u formuan gjatë historisë së zhvillimit të gjuhës sonë në kushte shoqërore dhe ekonomike të periudhës parakombëtare që shkaktonin kryesisht largimin e dialekteve. Në ato kushte ndryshimet në dialekte bëheshin përgjithësisht për shkak të zhvillimit të brendshëm të gjuhës, si zhvillime të vetvetishme. Pas konsolodimit të gjuhës së njëhsuar letrare shqipe, që është forma më e lartë e zhvillimit të gjuhës sonë, dialektet priren në zhvillimin e tyre drejt arfrimit e bashkimit. Dalngadalë, ashtu si gjithë veçoritë e tjera të kësaj treve të gegërishtes, edhe reflekset *k*, *g* dhe *kj*, *gj* të grupeve *kl*, *gl* do t'i nënshtrohen ndikimit të gjuhës letrare, vetëm se tashti jo nëpërmjet zhvillimeve të brendshme të gjuhës, por për shkak të]faktorëve të jashtëm, duke u zëvendësuar drejtpërdrejt *kj* e *gj* e *k*, *g* me *c*, *ʒ* të gjuhës së përbashkët.

NEUTRALIZIME KUNDËRVËNIESH TË BASHKËTINGËLLOREVE

3.22.1. Në gjuhën e sotme shqipe grupet me]bashkëtingëlloren *n* si element të dytë nuk janë kudo të gjitha të qëndrueshme dhe numri i fjalëve ku dalin është i kufizuar, sepse, me përjashtim të disa fjalëve të huaja, kryesisht të gjuhës letrare, grupe të këtilla formohen në kufij të morfemave të disa formave gramatikore dhe të fjalëve të prejardhura a të përbëra.

Këto grupe bashkëtingëlloresh dalin sot kudo në formën e vetës së dytë shumës të kohës së tashtme e të kohës së pakryer të foljeve të mënyrës dëftore e lidhore dhe në formën e vetës së dytë shumës të urdhërores, p.sh.: *hapni*, *ikni*, *lidhni*; *dilnim*, *zbritnim*; *prisni*, *merrni* etj. Në gjuhën letrare dhe në dialektin verior ato dalin edhe në disa fjalë jo të parme, si *atnor*, *barna*, *brezni*, *burrneshë*, *drithnik*,

345. Shih A. Desnitskaja, *Albanskij jazyk i ego dialekty*, 1968, f. 146.

fisnor etj. Në gjuhën letrare këto grupe dalin në një numër shumë të vogël fjalësh të parme të huazuara nga gjuhë ëtë tjera, si *alternativë, agnostivizëm, etnografi, kornizë, magnetofon, sputnik, vernik* etj. Raste të këtilla shumë të rralla eksistojnë edhe në dialekte, p.sh. *esnaf, bərnut* e ndonjë tjetër. Denduri më të madhe për disa grupe kanë shumica e të folmeve të toskërishtes: të folmet e skajit lindor (të Korçës, Kolonjës, Pogradecit), ato të skajit jugor (të Labërisë, të Çamërisë. me përjashtim të së folmes së Gjirokastrës) dhe të folmet e zonave qendrore malore (të Skraparit, Përmetit, Zagorisë). Në këto të folme, me pak dallime ndërmjet tyre, veç formave të përbashkëta të dëftores, të lidhores e të urdhërores, ekzistojnë si të vetme ose si variante edhe forma të vjetra të kallzores së shquar të emrave mashkullorë njëjës që u mbaron tema me bashkëtingëllore (*miknə* «mikun», *detnə* ose *denə* «detin» etj.) dhe forma të së kryerës së thjeshtë të foljeve me bashkëtingëllore (*hipnə* «hipën», *mbaθnə* «mbathën» etj.).

Forma të këtilla të vjetra të së kryerës së thjeshtë ruhen ende edhe në të folmen e shkodrës, p.sh.: *iknę* «ikën», *dulmę* «dolëm» etj.).

Siç do të shpjegohet edhe më poshtë, në këto të folme disa grupe të këtilla, sidomos nga ato të formave të vjetra të kallzores e të së kryerës së thjeshtë, janë të paqëndrueshme, njëri prej elementeve reduktohet plotësisht, p.sh. *malnə* > *malə*, *mbetnə* > *mbenə* etj.

Historia e shqipes tregon se në faza më të hershme të zhvillimit të saj grupe të këtilla bashkëtingëlloresh kanë]qenë të kufizuara në numër dhe kanë pësuar ndryshime duke u reduktuar njëri nga elementet e tyre, ashtu si vërehet sot në të folmet skajore të toskërishtes. Kjo duket qartë sot në rastet si *barrë* që krahasohet me gr. *pherné, prrall* që vjen nga gr. *pournari*[346], *furrë* nga lat. *furnus*[347], *punë* > **spudno*[348] dhe në format e pjesores të foljeve *dhënë, lënë* etj. dhe *marrë, tjerrë, vjelë dalë, mbjellë*, që kanë kaluar edhe në të tashmen: *marr, vjel, mbjell* etj. [349] Në këto folje bashkëtingëllorja fundore e temës formonte grup me *n*-në e mbaresës.

Ka të ngjarë që edhe te *zonjë* e ardhur nga **zotnia*[350] të ketë ndodhur këmbimi i grupit *tn* > *n*. Ky proces i këmbimeve, sidomos në

346. E. Çabej, «BUSh, SShSh», 1960, f. 46, dhe *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* 1959, f. 77; Për raste të tjera, si p.sh. *e dielë* nga forma e kallzores shih. H. Pedersen KZ, 33, 543; *dal* nga *dalno* shih E. Çabej, «BUSh, SShSh», 1961, 1, f. 79; *rrej*: gr. *arneomai* shih H. Pederson, KZ, 33, 542 shënimi 2; *djerrë* shih G. Neyer, *Alb. St.*, III, 73 etj.
347. Miklosich, *Alb. For.*, II, Wien 1871, f. 86.
348. E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, 1959, f. 76. Për pjesoret *nxjerrë* etj. shih G. Meyer, *Alb. Gramm.*, 115,
349. 3; M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes, Tiranë* 1961, f. 65; I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqupe Morfologjia historike*, Prishtinë, 1969, f. 93;
350. Sh. Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa II), f. 185.

grupet *tn, ln, ln, rn* ka qenë një tipar që e ka shoqëruar gjuhën shqpie edhe në faza më të vona të zhvillimit të saj. Kjo hihet te fjala *gjithmonë*, fjalë e mbarë gjuhës e dalë nga *gjithëmotnë* nëpërmjet përngjitjes (*gjithë* + *motnë* «motin»), shihet te rastet: *tene zone*<*tënë zotnë*, *muore* <*muornë* «morën», *duole*<*duolnë* «dolën», *angre*<*angërnë* «hëngrën» të Buzukut, te *i paafanë*>*i pafatnë* (vepra e De Radës «*Skënderbeu i pafanë*» dhe te raste sporadike të formave të vjetra të kallzores e të së kryerës së thjeshtë, që kanë mbetur si forma variante ose të ngurosura në disa shprehje në të folmet gege të Malësisë së Madhe (*katər djelm i pen* «mbetën»), *t zon* «të zotin», *daltʃ metʃ e martʃ mal* «malin» etj.)[351], të Luznisë e Reç-e-Dardhës të Dibrës (t *ven* «të vetën», *von* «vajtën» etj.)[352], dhe të së folmes së Kërrabës, ku rastet janë më të shumta se në të folme të tjera të gegërishtes (*kimen* «kimetin», *mon* «motin» *duhan* «duhanin», *tʃun* «çunin», *s'pan* «s'patën» etj.)[353].

Relikte të këtilla dhe forma të vjetra të kallëzores e të së kryerës së thjeshtë të ruajtura në shumë të folme të toskërishtes tregojnë se në një periudhë gjatë mesjetës, të paktën deri para tre shekujsh në mbarë shqipen ka qenë më e madhe denduria e grupeve *bashkt.* + *n* për shkak të ndryshimeve fonetike e morfologjike që kishin pësuar disa forma gramatikore (kallëzorja e emrave mashkullorë dhe e kryera e thjeshtë). Kjo del qartë nga gjuha e autorëve të vjetër dhe nga të folmet e diasporës, sidomos ato të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë, ku janë të shpeshta rastet me]formën e kallëzores së emrave mashkullorë njëjës të shquar me mbaresën *-nə* edhe kur tema mbaron me bashkëtingëlloren (*qytetnə, mortnə, liʒne* etj.) dhe forma të së kryerës së thjeshtë me mbaresat *-mə, -tə, -nə* për tri vetat e shumësit të foljeve me bashkëtingëllore (*deʃnə, duolnə* «dolën», *folnə, grabitnə, mbloðnə, pohnə* etj.). Tek autorët e vjetër grupet e bashkëtingëlloreve në forma të këtilla gramatikore dalin përgjithësisht të qëndrueshme, të reduktuara ato shihen vetëm në raste të rrala, si *zone* < *zotnë* dhe *duole* < *duolnë muore* < *muornë, angre* < *angrenë* «hëngrën» e ndonjë tjetër. Siç shihet, edhe në këtë kohë këmbime fonetike vërehen kryesisht te grupet *ln* > *l*, *rn* > *r*(*r*), rrallë edhe *tn* > *n*.

Reduktimi vetëm i disa grupeve solli një larmi formash të kallzores e të së kryerës së thjeshtë dhe preku sistemin e këtyre formave gramatikore, prandaj, me sa duket, nëpërmjet ndryshimeve fonetike e morfologjike, që u kryen njëherazi në këto forma, dolën forma të reja

---

351. H. Pedersen, *Die Guturale*, f. 279.
352. B. Beci. *E folmja e Reç.-e-Dardhës së Dibrës*, «SF», 1964, 4, 4. 147 dhe *E folmja e Luznisë së Dibrës*, në «Dialektologjia shqiptare» II, f. 240, 241.
353. M. Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës*, «SF», 1966, 2, f. 132. Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*, «SF», 1967, 2, f. 44, 45.

pa zanoren *ə* fundore të mbaresave dhe]me një zanore anaptikse midis temës e mbaresës për analogji me forma të tjera: *liʒin, mikun, malin; ʒetən, folən, erðən, morən* etj.[354]. Ndryshime të këtilla do të jenë bërë duke pasur si shembëlltyra fjalë paroksitone, si *popuł, ðəndəɾ, hekur, djalə* etj. dhe fjalë në të cilat tema mbaronte me dy a më shumë bashkëtingëllore, ku bashkë me *n*-në e mbaresës, grupet do të dilnin me tre e më shumë bashkëtingëllore, si *giʃt, bulk, vend, tund* etj. Kjo shihet edhe sot e kësaj dite në të folmen e Devollit, ku, krahas formës së vjetër të kallëzores (*litarə* < *litarnə, brezə* < *brezn* etj.), ekzistojnë si të rregullta ta edhe forma të reja për fjalë ku ka kushte të këtilla fonetike (*djalən, populin, biʃtin* etj.).

Me sa duket, këto ndryshime që pësuan format e kallëzores dhe të së kryerës së thjeshtë zunë fill në dialektin verior të shqipes, u përhapën dalëngadalë dhe kështu format e reja u bënë të vetmet forma për gjithë gegërishten dhe për të folmet veriperëndimore të toskërishtes (edhe për gjuhën letrare). Edhe në të folmet e skajit jugor e lindor të toskërishtes dhe në ato të zonave malore në qendër lindën forma të këtilla të reja e të përbashkëta, po, megjithatë, këtu vazhdojnë të përdoren edhe format e vjetra, në shumë nga këto të folme si variante, duke mbizotëruar diku njëra formë e diku tjetra, kurse në disa të folme, si në ato të anës lindore (Korçë, Kolonjë) duke qendruar si forma e vetme e kryera e thjeshtë me mbaresat *-mə, -tə, -nə* për foljet me bashkëtingëllore[355].

Nga kjo pamje që përvijuam deri këtu shihet se në shqipen e sotme veçohet, nga njëra anë, gjuha letrare, dialekti verior, të folmet e toskërishtes veriperëndimore dhe ajo e Gjirokastrës, ku këto grupe bashkëtingëlloresh dalin me një denduri më të vogël dhe janë të qëndrueshme dhe nga ana tjetër, të folmet skajore e qendrore të toskërishtes, ku grupe të këtilla dalin me denduri më të madhe dhe disa prej tyre pësojnë ndryshime fonetike. Në të folmet e toskërishtes, ku ruhet një gjendje më e hershme, këmbimet fontetike vërehen jo vetëm në grupet *tn, ln, łn, rn*, por edhe në grupe të tjera bashkëtingëlloresh. Veç kësaj vihet re se në të folmet qendrore e lindore këmbime të këtilla fonetike ndodhin kryesisht në format e kallëzores e te së kryerës së thjeshtë, në të folmet e labërishtes dhe të çamërihshtes (edhe në pjesën jugore të Mallakastrës) kjo dukuri ka përfshirë në një farë mase edhe grupet që dalin në format

354. Me këto ndryshime për kallëzoren dhe për të kryerën e thjeshtë u formuan dy nënsisteme: një formë me mbaresën *-në* (*dhenë, barinë* për kallëzoren e emrave që u mbaron tema me zanore të theksuar, dhe një formë tjetër me mbaresën *-in* ose *-un* për kallëzoren e emrave që u mbaron tema me bashkëtingëllore (*malin, mikun*); për të kryerën e thjeshtë të foljeve me zanore një formë me mbaresat *-më, -të, -në* (*lamë, latë, lanë*), kurse për ato me bashkëtingëllore një formë tjetër me mbaresat *-ëm, -ët, -ën* (*folëm, folët, folën*).

355. Në të folmet e skajit jugor dhe në ato të qendrës format e së kryerës së thjeshtë me mbaresat *-më, -të, -në* dalin si variante për foljet me bashkëtingëllore.

e dëftores e të lidhores së tashme dhe të urdhërores: *kuloni* «kullotni», *dili* «dilni», *ta funi* «ta futni», *mo i kpuni* «mos i këputni» etj[356]

Siç shihet, në disa grupe bashkëtingëlloresh elementet e tyre përbërëse janë të qëndrueshme, kurse në disa të tjera zakonisht njëri element zhduket fare në shqiptim, dhe në raste më të pakta grupi këmbehet me një fonemë tjetër.

3.22.2. Qëndrueshmëria dhe ndryshimet e elementeve të këtyre grupeve janë të lidhura me faktorë të ndryshëm fonetikë, fenomatikë dhe gramatikorë. Faktori gramatikor, analogjia që ka synim të rrafshojë format për ruajtjen e sistemit, në një farë mase ka luajtur një rol për ndryshimet fonetike në këto grupe, sepse ato formohen në kufi të mor emave. Faktori fonetik luan një rol shumë të madh, sepse tingujt fqinjë ndikojnë njëri mbi tjetrin në rrjedhën e fë folurit për nga mënyra e nyjëtimit dhe për nga vendi dhe organi aktiv i nyjëtimit të tyre. Faktori fonologjik është faktori kryesor, faktori organizues e rregullues në këto ndryshime që pësojnë tingujt ose në ruajtjen e tyre. Kjo duket edhe në rastin e këtyre grupeve, në të cilat veprimi i tingujve mbi njëri-tjetrin nuk çon thjesht në modifikim të njërit tingull, duke dhënë një variant fonetik të tij. por ose ruhet, ose këmbehet me një fonemë tjetër, ose zhduket njëri prej elementeve përbërëse të grupit. Të gjitha këto procese fonetike kryhen sipas një rregullsie, në përshtatje me sistemin fonologjik të shqipes. Bashkëtingëllorja *n*, që është e pranishme në të gjitha këto grupe, është fomemë margjinale në sistemin e fonemave bashkëtingëllore të shqipes, është hundore dhe sonante. Me përjashtim të çamërishtes, bashkëtingëllorja *n*, ashtu si gjithë sonantet e tjera, nuk hyn në korrelacionin e zëshmërisë (shih § 3.8.1). Kjo bën që të mos kthehen në të zëshme bashkëtingëlloret e shurdhëta kur ndodhen pranë *n*-së dhe sonanteve të tjera as në mbarë gjuhën shqipe, p.sh.: *kasnets, dasmə, misri* etj., as në të folmet skajore e qenrore të toskërishtes, p.sh. *iknə, ndɔcnə, bresnə* < *breznə* etj.

Natyra e bashkëtingëllores që merr pjesë në grup me *n*-në bën që grupet ose të jenë të qëndrueshme për nga numri i elementeve përbërëse, ose të pësojnë ndryshime duke u reduktuar plotësisht njëri prej elementeve.

Kur elementi i parë është një bashkëtingëllore prapagjuhore (*k g, h*), mesgjuhore (*c, ɟ*) ose buzore (*p, b, m, f, v*), përgjithësisht grup,

i

356. Shih M. Totoni, *Vëzhgime rreth të fommeve të Kurrveleshit*, në «Dialektologjia shqiptare». I, f. 55; *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, në SF, 1964, 1. f. 143-Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*; në «Dialektologjia shqiptare»., I, f. 156; J.. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e, krahinës së Mallakastrës*, «BUSh, SShSh», 1962, 3, f. 159.

qëndron fare i pandryshueshëm, vetëm në]labërish]e, në çamërishte dhe në pjesën jugore të Mallakastrës mund të ndodhë që bashkëtingëllorja e parë e grupit të këmbehet me një bashkëtingëllore tjetër të afërt me *n*-në për nga mënyra e nyjëtimit, d,m,th, sonante, por duke ruajtur tiparet e tjera që lidhen me vendin dhe organin aktiv të nyjëtimit të tyre, kështu *p*-ja ndërrohet eme *m* (ʃkopn (ə) > ʃkomn (ə) «shkopin», *hipn*(ə) > *himn* (ə) «hipën», *k*-ja në ŋ në labërishte, ku ekziston kjo fonemë, dhe në grupin *ng* [ng] në të folmet e tjera (*fikn* (ə) > *fiŋn* (ə) ose *fiŋgn* (ə) «fikun», *u plakn* (ə) > *u plaŋn*(ə) ose *u plaŋgn* (e) «u plakën»[357]. Në raste të këtilla nuk reduktohet plotësisht bashkëtongëllorja e parë. sepse ajo është e ndryshushme prej *n*-së edhe nga mënyra e nyjëtimit, njëra është josonante, tjetra sonante, dhe bëhet i mundshëm nyjëtimi i të dy elementeve, sepse për të dyja bashkëtingëlloret pengesa formohet në vende të ndryshme dhe si organe aktive janë pjesë të ndryshme të gjuhës. Në raste të këtilla neutralizohet vetëm kundërvënia e tipareve sonante ~ josonante (*iknə* → *iŋnə*).

Në grupet ku si element i parë është një bashkëtingëllore paragjuhore (*tn, ln, łn, rn, δn, zn* etj.) njëri nga elementet e grupit përgjithësisht i nënshtrohet procesit të reduktimit të plotë, sepse ndonjë prej këtyre bashkëtingëlloreve është e njëjtë me *n*-në përnga vendi dhe organi aktiv i nyjëtimit, p.sh. *tn*, kurse të tjerat janë të njëjta vetëm për nga organi aktiv i nyjëtimit, p.sh. *ln, ʒn, rn* etj. Kështu *tn*, ndryshe nga të gjitha grupet e tjera, jep *n*, sepse të dyja bashkëtingëlloret janë mbylltore, formohen në pjesën e prapme të dhëmbëve dhe me majën e gjuhës Duke qenë kështu, nyjëtimi i *n*-së fillon pa u realizuar faza e tretë e hapjes së pengesës për nyjëtimin e *t*-së. Që në këtë rast ndikon *n*-ja mbi *t*-në e jo e kundërta, luan rol edhe fakti se nyjëtimi i *n*-së bëhet duke kaluar një pjesë e ajrit nëpër zgavrën e hundës me ngritjen e njerithit. Duke qenë se kundërvënia e dy bashkëtingëlloreve është njëgjymtyrëshe (josonante ~ sonante), neutralizohet ky tipar dallues, prandaj grupi thjeshtohet, mbetet vetëm *n*-ja.

Në grupet *ln, zn, rn, δn, zn* etj. bashkëtingëllorja e parë e grupit është shtegore, ndryshe nga *n*-ja që është mbylltore. Kur maja e gjuhë do të ndërrojë vend që të formojë pengesën për nyjëtimin e *n*-së mbylltore, bashkëtingëllorja e parë është realizuar, sepse nyjëtohet me shteg të hapur. Kjo bën që pengesa për *n*-në të]jetë e dobët ose të mos realizohet fare. prandaj si rrjedhim nyjëtohet zakonisht elementi i parë i grupit: *ln* > l, *łn* > ł, *rn* > r̃, *δn* > δ *zn* > *z* etj.

Reduktimi i grupeve *ln, łn, rn,* është kryer regullisht kudo në këto

357. M. Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurrveleshit,* në «Dialektologjia shqiptare», I, f. 55; *E folmja e Bregdetit të Poshtëm,* f. 143; Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë,* në «Dialektologjia shqiptare», I, f. 136.

të folme të toskërishes, ashtu si dikur në mbarë shqipen. Me sa duket kjo ndodh, sepse të dy elementet e grupit janë sonante. Në këtë tip grupe bashkëtingëlloresh me kundërvënie po njëgjymtyrëshe (anësore~joanësore) neutralizohet ky tipar dallues në dëm të joanësores. Në të folmet skajore të Jugut, sidomos në labërishte, ky proces është sot një normë fonetike e gjallë, sepse shihet se vepron edhe në forma të dëftores së tashme etj. (*dili* «dilni», *meri* «merrni»). Në këto të folmet ekzistojnë si variante edhe forma të rindërtuara, në të cilat nuk del i reduktuar grupi (*malnə* «malin», *dualnə* «dolën» etj.).

Grupet e tjera me bashkëtingëllore paragjuhore josonante (*δn, zn* etj.) dalin shpesh të reduktuara (*mbloδnə* > *mbloδə* etj.), por jo rregullisht. Ka të ngjarë që këmbimi i fonemave në këto grupe të mos jetë rezultat i një norme fonetike, por të jetë kryer për analogji me grupet *ln, rn* etj., që kanë si element të parë një bashkëtingëllore sonante. Analogjia, si faktor gramatikor, ka vepruar për ruajtjen e sistemit, për rrafshimin e formave të kallëzores e të së kryerës se thjeshtë me tema që mbarojnë me bashkëtingëllore. E kundërta ka ndodhur në të folmen e Shkodrës, ku janë ruajtur edhe grupeti *ln, rn.* p.sh. *dulnę* «dulën» *murnę* «morën» etj. Këtu analogjia do të jetë zhvilluar relativisht vonë, sepse raste të këtilla nuk dalin as tek autorët e vjetër, as edhe sot nëpër të folmet e tjera, qoftë edhe si relikte.

Në qoftë se do t'i paraqitim në formën e një tabele të gjitha këto procese, del kjo pamje:

Elementi që këmbehet	pn, gn, kn,	tn	ln, ɫn,	δn, z n, sn
Elementi i parë i grupit	— ose përshtatet	+	—	—
Elementi i dytë i grupit	—	—	+	+ ose —

Tabela nr 4

Duke parë rrugën e zhvillimit që kanë ndjekur këto grupe bashkëtingëlloresh në gjuhën shqipe, del se ato janë formuar herë pas here kur në faza të ndryshme kanë lindur forma gramatikore e fjalë që kanë dhënë mundësi për takimin në grup të një bashkëtingëlloreja çfarëdo me hundoren sonante *n.* Njësia e mbarë shqipes në etapa të ndryshme të zhvillimit të saj shihet edhe në faktin se disa prej grupeve të këtilla kudo e kurdoherë kanë pësuar ndryshime duke u thjeshtuar në një bashkëtingëllore të vetme (*ln* > *l, rn* > *r, tn* > n etj.) edhe në faktin tjetër se, sidomos për shkaqe fonetike, por në një farë mase edhe për shkaqe gramatikore, kudo kohë më kohë kanë ndodhur shpërbërje të këture grupeve. Një dasi brenda njësisë së mbarë gjuhës duket sot në disa të folme skajore të toskërishtes, ku, siç u pa, ruhen ende disa

forma të vjetra gramatikore me këto grupe dhe me këmbimet fonetike që pësojnë elementet e tyre përbërëse, por ed ie këtu kjo gjendje ka kohë që ka filluar të ndryshojë duke ndjekur tipin e përbashkët të shqipes me rindërtime formash gramatikore të reja, ku nuk dalin këto grupe.

Ndryshimet në mbarë gjuhën shqipe, duke përfshirë edhe të folmet skajore të toskërishtes, janë bërë sipas një rregulle fonetike të caktuar lidhur me tipin e rrokjes ku kanë bërë pjesë të dy bashkëtingëlloret e këtyre grupeve. Këto bashkëtingëllore kanë formuar një rrokje me një zanore të patheksuar që vinte pas tyre, pra një rrokje të tipit *ccv*. Ky është një tip i mundshëm për shqiptim; këtë e tregon edhe formimi i tyre herë pas here në gjuhën shqipe dhe gjendja e sotme në mbarë gjuhën, p.sh.: *dilni, merrni, vritni*, etj. Sipas këtij tipi të rrokjes së hapur janë bërë edhe këmbimet fonetike të elementeve të grupeve, nga *ccv* në *cv*, p.sh. *furrë* nga *furnë* (lat. *furnus*), *vjelë* nga *vjelnë* etj. Me këtë rrugë janë formuar fjalë e forma që kanë hyrë në sistem ose që kanë formuar një nënsistem për mbarë shqipen, si fjalët *furrë*, *prrallë* (përnallë) etj. dhe format foljore *vjelë*, *marrë* etj., ose forma të përkohshme e dialektore, përsëri sipas një sistemi, si p.sh. format e sotme variante të dialektit jugor (*malə* nga *malnə*, *denə* nga *detnə*, *,mbloðə* nga *mbloðnə*, *ndezə* nga *ndeznə* etj.).

Rruga tjetër e zhvillimit ka qenë shpërbërja e grupit duke hyrë një zanore në mes elementeve të tij, me sa duket me tepër për shkak të reduktimit të zanores fundore të rrokjes, pra ndodhi një kalim nga tipi *ccv* në *vcc* (tip i paqendrueshëm), pastaj në *cvc*, si tip i rregullt rrokjesor i shqipes ku rrokja mbyllet nga një bashkëtingëllore sonante[358]. Këtë tip ndoqën kudo në gjuhën shqipe, këtë pojndjekin sot edhe në të folmet e përmendura të toskërishtes, grupe të këtilla bashkëtingëlloresh në format e kallëzores (*malnə* > *maln* > *malin*) dhe në format e së kryerës së thjeshtë (*iknə* > *ikn* > *ikən*).

PËRMBYLLJE

3.23.1. Duke i krahasuar të folmet e shqipes, shihet se në përgjithësi më shumë ndryshime fonetike kanë pasur të folmet e dialektit verior. Toskërishtja paraqitet me e njësishme në sistemin fonetik. Kjo mund të shpjegohet, së pari, me faktin se të folmet e saj kanë qenë më konservatore, në një fazë më të vonë, për periudha të gjata e kanë ruajtur

358. Edhe në të folmen e gegërishtes veriore, që dallohen për rediuktimin e plotë të *ə*-së së patheksuar në të gjitha kushtet e tjera fonetike, e ruajnë atë në një rrokje të mbyllur nga një sonante: *pərplas, ämbəlsina, ðelpən, i vogəl, vetəm* etj.

në përgjithësi sistemin e tyre të fonemave; mund të shpjegohet, së dyti, edhe më faktin se ato lëvizje që kanë ndodhur në sistemin e saj fonetik ose kanë përfshirë që në fillim të gjitha të folmeti a një pjese të madhe të tyre, ose në një kohë kanë ardhur e janë shtrirë dhe është formuar njësia me kohë në këtë dialekt.

Njësia në dialektin jugor shihet dhe në sistemin e fonemave zanore, edhe në sistemin e fonemave bashkëtingëllore, sidomos në sistemin e bashkëtingëlloreve ajo është edhe më e madhe. Në të folmet e këtij dialekti dallimi më i rëndësishëm që lidhet me inventarin dhe sistemin e fonemave vjen nga prania e dy serive zanoresh (të shkurtra e të gjata) në toskërishten jugore, në kundërvënie me toskërishten veriore, e cila ka vetëm një seri zanoresh gojore; pas këtij dallimi duhet përmendur edhe mungesa e fonemës *y* gjithashtu në shumë të folme të toskërishtes jugore. Ajo që e thekson më]shumë karakterin e njësishëm të të folmeve të toskërishtes është se në këto të folme variantet fonetike mungojnë në sistemin e bashkëtingëlloreve, ashtu si në mbarë gjuhën shqipe, dhe janë gati të papërfillshme si numër (një, dy) në sistemin e zanoreve. Kjo tregon se në këtë dialekt nuk ka qenë si tipar përshtatja (modifikimi) e zanoreve për shkak të kushteve fonetike. Së fundi, duhet përmendur se edhe dallimet që lidhen me përbërjen fonematike të së njëjtës fjalë (dallime etimoligjike në sistemin fonetik) janë shumë të pakta në numër si në sistemin e zanoreve, ashtu edhe në sistemin e bashkëtingëlloreve.

Ndryshe nga dialekti jugor, dialekti verior paraqitet më pak i njësishëm në sistemin fonetik. Megjithatë duhet thënë se edhe në këtë dialekt mbizotëron karakteri i njësishëm i sistemit, sidomos për ato anë të]tij që janë më relevante, për anët që lidhen me funksionin e fonemave, me seritë e tyre dhe me organizimin në sistem. Me përjashtim të dy-tri të folmeve skajore, ku është tretur gjatë kohëve seria e zanoreve hundore, të gjitha të folmet e tjera karakterizohen nga të tri seritë e zanoreve, nga dy seri të zanoreve gojore (të shkurtra e të gjata) dhe nga seria e hundoreve. Ekzistojnë dallime të këtilla që lidhen me anë të ndryshme të sistemit fonologjik të të folmeve: në një grup të folmesh zanoret e gjata gojore formojnë një sistem katërkëndësh, kurse në shumicën e të folmeve ato formojnë sistem trekëndësh; në disa të folme ka dalë zanorja *y* n gasistemi e në disa të tjera është zëvendësuar me *ø* -në,që formon një çift kundërvënieje me *e*-në, diku një çift fonemash bashkëtingëllore është zhdukur dhe është prishur tufa katërshe që formohej nga ai dhe një çift tjetër korrelativ; diku një çift bashkëtingëlloresh ka ndryshuar vëndin e radhës në sistemin dhe ka hyrë në kundërvënie me një çift tjetër bashkëtingëlloresh etj. Dallimet e tjera janë të shumta ndërmjet të folmeve të gegërishtes, por nuk janë relevante nga ana funksionale. Ato shihen më shumë në variantet fonetike të fonemave, d.m.th. në përshtatjen e fonemave në kushte të caktuara fonetike,

shihen dhe në variantet dialektore që lidhen me përbërjen fonetmatike të së njëjtës fjalë në të folmen të ndryshme.

Edhe nëpërmjet ndryshueshmërisë duket tej e ndanë njësia e dialekteve të shqipes në sistemin e fonemave. Kjo njësi në thelb është ruajtur dhe ka arritur deri në ditët tona, çka nxjerr në dukje qëndrueshmërinë e bashkësisë gjuhësore dhe etniko-politike të shqiptarëve.

KREU IV

DALLIMET MORFOLOGJIKE TË SHQIPES SIPAS NJË KLASIFIKIMI STRUKTUROR

KRITERET E KLASIFIKIMIT

4.1.1. Kërkimet në terren dhe studimet e ndryshme për dialektet e gjuhës shqipe të bëra deri tashti kanë nxjerrë pothuaj gjithë inventarin e dallimeve të të folmeve në sistemin morfologjik. Sigurisht, do të duhen kërkime dhe studime të tjera për të nxjerrë edhe dallimet më të imëta të kësaj sfere në kategori e klasa fjalësh të caktuara dhe ndonjë tipar dallues të paevidentuar ende në ndonjë trevë të veçantë e të ngushtë dialektore ku nuk janë bërë kërkime, por kjo nuk na pengon të themi se, në përgjithësi, sot njihet mirë ndryshueshmëria dialektore e shqipes në sferën e morfologjisë. Kërkimet dhe studimet që vijojnë do të plotësojnë më tej njohjen e dallimeve morfologjike dialektore të shqipes dhe do të saktësojnë më shumë kufijtë e shtrirjes së tyre në hapësirë dhe në shtresa të ndryshme shoqërore. Për këtë do të ndihmojë sidomos «Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe», që është duke u hartuar. Studimet e mëtejshme kanë për detyrë gjithashtu të

bëjnë vlerësimin dhe shkallëzimin e veçorive dalluese morfologjike sipas vendit që zënë dhe sipas funksionit që kryejnë në sistemin gjuhësor të dialektit, sepse në studimet e derisotme ato janë dhënë pothuaj si dallime me vlerë të barabarta, duke u parë vërtet si elemente të sistemit, por përgjithësisht veçmas nga njëri-tjetri dhe jo me vlerën dhe shkallëzimin e tyre brenda sistemit morfologjik. Një analizë e këtillë ka qenë e përligjur gjatë fazës së hetimit të përgjithshëm të dialekteve, kur si detyrë kryesore ishte në radhë të parë evidentimi i dallimeve të të folmeve të shqipes. Një analizë e këtillë nuk jep një përfytyrim të saktë dhe objektiv për dallimet morfologjike të dialekteve, në fund të fundit ajo jep vetëm sasinë dhe llojin e dallimeve sipas klasave leksiko-gramatikore e sipas kategorive gramatikore, por këto nuk janë të mjaftueshme për të njohur thelbin e dukurisë.

Për të nxjerrë në shesh objektivisht shkallën e dallimit të dialekteve në sistemin morfologjik është e domosdoshme një analizë strukturore[359]. Metoda strukturore përdor materiale të rrafsheve të ndryshme të gjuhës dhe ka parasysh funksionin e elementeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre[360]. Kjo metodë e përdorur në studimin e dialekteve nxjerr në pah jo vetëm dallimet, por edhe tiparet e përbashkëta të tyre, në aspektet më thelbësore, siç janë ato të strukturës dhe të funksionit në gjuhë. P.sh. po të analizohen dallimet fonetike te dialekteve në kuadrin e sistemit, inventari i tipareve jep mundësi për një grupim në zona më të gjera[361], sepse nuk]ka gjithmonë përputhje ndërmjet dallimeve që janë thjesht fonetike (timbre, variante të tingujve) dhe dallimeve fonologjike (zakonisht një zonë me ndryshueshmëri nga ana fonetike paraqitet e njësishme nga ana fonologjike).

Në studimin e dialekteve mund të përdoret plotësisht metoda strukturore edhe për sferën e morfologjisë, ashtu si është përdorur ajo me sukses në sferën e fonetikës. Sigurisht, ndërsa për dallimet fonetike merret si bazë kriteri fonologjik, për dallimet morfologjike do të merret kriteri morfologjik, duke u mbështetur në radhë të parë në vlerën që kanë këto dallime brenda sistemit morfologjik për t'i shkallëzuar ato ashtu si bëhet edhe për dallimet fonetike. Kur krahasohen të folmet, shihen dallimet në kundërvëniet e kategorive morfolo-

359. Një analizë të këtillë, sipas parimeve të N.S. Trubetckojt («Phonologie und Sprachgeographie» në TICP, 1931) ne kemi bërë së pari në studimin e dallimeve fonetike të dialekteve të gjuhës shqipe (shih *Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të dialekteve të gjuhës shqipe i krahasuar me sistemin e gjuhës letrare* në «SF», 1977, 4, f. «-35; *Sistemi fonologjik i zanoreve të dialekteve të gjuhës shqipe*, në «SF», 1983, 2, f. 50-91).

360. L. Heilmann, *Per una dialectologia strutturale, në* Communications et rapports du Premier Congres International de Dialectologie generale», part I. Louvain 1964, f. 94-97.

361. A. Avram, *Despre dialectologie strukturală*, në «LR» XI, 1962, 6, f. 625.

gjike, të mënyrës së ndërtimit të formave gramatikore dhe të mjeteve të shprehjes së tyre. P.sh., në disa të folme të gjuhës shqipe ekziston një kundërvënie e kategorisë së gjinisë për numërorët *dy* e *tre*, në disa të tjera vetëm për numërin *tre*, kurse në shumë të folme nuk ekziston një kundërvënie e këtillë; në disa të folme për një numër përemrash pronorë (në funksion mbiemri) janë sinkretizuar format rasore, ka mbetur vetëm forma e rasës kallëzore, është zhdukur diferencimi formal morfologjik dhe kundërvëniet rasore shprehen me mjete sintaksore, kuptimet e rasave dalin nga emrat me të cilët përdoren përemrat pronorë (*djali tim, i, e djalit tim, djalit tim, djalin tim, djalit tim*).

Për të nxjerrë në dukje shkallëzimin e dallimeve dialektore morfologjike nga pikëpamja e strukturës (e sistemit) po japim këta shembuj prej varianteve dialektore të formës së foljeve veprore të mënyrës dëftore koha e pakryer: në disa të folme te gegërishtes dne në disa të folme të toskërishtes përdoret forma e vetës së dytë edhe për vetën e parë njëjës (*lajshe, laje*, geg, *lanje* tosk,), pra në këto të folme për dy veta të njëjësit është zhdukur kundërvënia (formale) e vetave; në gegërishte për të pakryerën është përgjithësuar forma sigmatike (*hapʃa, lajsha* etj. me variante të ndryshme), kurse toskërishtja ka një formë josigmatike (*happa, laṛa* etj. me variante të ndryshme), pra ka një kundërvënie në strukturat e formave: *sigmatike* ~ *josigmatike*; brenda një dialekti, ose edhe brenda një grupi të folmesh, ka forma të së pakryerës me mbaresa të ndryshme në të folme të ndryshme, p.sh., për vetën e parë njëjës në gegërishte diku ka *lajʃa*, diku *lajʃna* etj., në toskërishte diku *laṛa* diku *laṛam* diku *laj*, diku *lajə*, pra në këtë rast midis të folmeve ka kundërvënie në ndajshtesat e formave foljore. Së fundi shihet se ndërmjet të folmeve ka dallime thjesht fonetike në format gramatikore, diku njëri element i mbaresës del me *ṛ* e diku me *j* (*laṛa* dhe *laja, laṛe* dhe *laje, laṛə* dhe *lajə*). Nga ky shembull që sollëm besojmë se shihet qartë që dallimet për të njëjtat folje dhe për të njëjtën kategori gramatikore nuk janë të barasvlershme nga pikëpamja e sistemit, e strukturës.

Po t'i vështronim në mënyrë atomastike këto dallime të formave të së pakryerës, në hapësirën e gjuhës shqipe do të na dilnin vetëm ndërprerje të vazhdimësisë, kurse, duke i shkallëzuar ato sipas një kriteri strukturor, dalin zona të mëdha të njësishme të gjuhës, p.sh. format e së pakryerës, me përjashtim vetëm të një numri të vogël të folmesh, në të gjithë truallin e shqipes dalin me kundërvënie të plotë të kategorisë së vetës, kurse sipas tipit *sigmatik* ~ *josigmatik* shihen vazhdimësi në dy zona të mëdha: një në zonën e gegërishtes e tjetra në zonën e toskërishtes. Ndryshueshmëria (me copëzime jo të pakta në numër) shihet jo në dallimet që lidhen me strukturën e formës, por vetëm në variantet ndajshtesore të formave, të cilat janë gjithashtu strukturore, por të një rrafshi më të ulët, shihen gjithashtu edhe në variantet fonetike,

të cilat nuk kanë vlerë për strukturën e formës gramatikore. Këtë analizë objektive të metodës strukturore po e ilustrojmë me disa harta të vëna njëra pranë tjetrës:

Me analizon strukturore, sipas disa kritereve, dallimet morfologjike të dialekteve të gjuhës klasifikohen në grupe të ndryshme dhe disa grupe ndahen në nëngrupe.



p aradigmë e plotë.

paradigmë me një ormë më pak

Harta nr 38



Harta nr 39

DALLIME NË INVENTARIN E STRUKTURAVE

5.2.1. Një grup, grupin e parë të dalîimeve morfologjike e përbëjnë dallimet e inventarit, ku hyjnë dallimet që lidhen me numrin e kategorive e të formave gramatikore. Këto janë kryesisht kundërvënie mungesore (privative), diku ekzistojnë disa kategori ose forma e diku mungojnë ato. Sipas asaj nëse dallimet e kanë prekur plotësisht apo pjesërisht kategoritë gramatikore, dallimet e këtij grupi ndahen në dy nëngrupe: 1) në dallime të inventarit, *të plota*. p.sh. në disa të folme ekzistojnë si kategori e kryera e mbipërbërë (*kam pas ʃkue, kiʃe pas ʃkue*) me të gjitha format e saj vetore, kurse në disa të folme të tjera ajo mungon plotësisht dhe 2) në dallime të inventarit, *të pjesshme* p.sh.



Harta nr 40

në disa të folme ekzistojnë të gjitha format vetore të paradigmës të së pakryerës, kurse në disa të tjera ekzistojnë paradigma si kudo, por mungon vetëm një formë vetore (shih hartën nr 38).

1. **Në kategori gramatikore** (të plota). Dallimet e nëngrupit të parë i kemi quajtur *të plota* vetëm në lidhje me dallimet e nëngrupit të dytë (të pjesshmet), sepse në të vërtetë në dialektet e gjuhës shqipe nuk ka dallime inventari të plota absolute, që të përfshijnë një kategori gramatikore të një klase leksikogramatikore ose të një kategorie të një



Harta nr 41

grupi të tërë fjalësh (kategori të gjinisë, të numrit, të vetës, të kohës etj).

Gjithësej në të folmet e gjuhës shqipe njihen pesë raste dallimesh inventari të plota: në gegërishten veriore dhe në toskërishten veriore numërori 3 ka një formë *tre* për gjininë mashkullore dhe një formë tjetër *tri* për gjininë femërore; në gegërishten veriore edhe numërori 2 ka dy forma: *dy* për mashkulloren dhe *dy*; për femëroren (dallohet *y*-ja nga gjatësia); ndryshe nga toskërishtja, gegërishtja ka mbiermra prejfoljorë me prapashtesën *-shəm* që tregon mundësi ose aftësi (*i kapʃəm, i bindʃəm, i laʃəm, i punueʃəm, i piʃəm* etj); të folmet e gegërishtes veriore dallohen nga të folmet e tjera të shqipes, se kanë përemra dëftorë të formuar nga pjesëzat *ce* e *pi* dhe format *ai* (ajo), *ky* (kjo), që i përcaktojnë dhe e veçojnë më dukshëm sendin a frymorin

(*ceky, cai, ɲiky, ɲai* etj.); gegërishtja ka përemra pronorë vetvetorë (i vet, e vet etj.), ndryshe nga toskërishtja, e cila edhe kuptimet e këtyre përemrave i mbulon me përemrat pronorë *i tij, e tij* etj.; të gjitha të folmet e gegërishtes, me një përdorim të vogël dhe të folmet e labërishtes, kanë forma të mbipërbëra të së shkuarës për të treguar se veprimi është kryer shumë kohë më parë, më parë se ajo që tregon forma e së kryerës (*kam pas ʃkue, kiʃa pas ʃkue* etj.). (shih hartën nr. 42).



1. i punueʃəm etj.
2. çai̯, ɲai̯ etj.

|···|- kam pas ʃku(e) etj

- kam pas shkuar

Harta nr 42

Këto tipare kanë të bëjnë me mjete e forma të veçanta që kryejnë funksione gramatikore të caktuara, prandaj dhe gjuha letrarre pa marrë parasysh se nga cili dialekt vijnë, ka marrë dhe i ka bërë të sistemit të vet ato që janë më të domosdoshme e me një shtrirje të madhe gjeografike, siç janë format e numërorit *tre* për dallimet e gjinisë, formimi i mbiemrave me *-shëm* nga tema foljore, përemrat pronorë vetvetorë dhe format e mbipërbëra foljore për kohën e shkuar. Ajo ka lënë jasht format e numërit *dy* si forma tepruese për dallimin e gjinisë në numërorët (prirja është që ky dallim të zhduket edhe për numërorin *tre*), ka lënë edhe format e përemrave dëftorë (*ceky, ƒiky* etj., funksionet e të cilave gjuha letrare, ashtu si edhe shumica e të folmeve të dy dialekteve i mbulon me mjete sintaksore, duke i shoqëruar përemrat dëftorë përkatës me pjesëzën *ja* (*ja ky* etj.).

2. **Në forma të një paradigme** (të pjesshme). Edhe dallimet e nëngrupit të dytë. dallimet e pjesshme, janë të pakta në numër, pothuaj aq sa edhe të plotat. Në të folmet e toskërishtes veriore dhe në të folmet e gegërishtes jugore, përafërsisht në zonën midis Vjosës dhe Matit, ekziston një formë rasore më tepër se në të folmet e tjera, aty është një formë e veçantë, forma e rasës vendore me mbaresën *t* e shoqëruar gjithmonë me parafjalët *nə, nən, nəpər, mbi, me* (*nə malt, nə gropət* etj.); në disa të folme, përgjithësisht të toskërishtes, nuk ka forma të veçanta të përemrave vetorë *ne, ju* për rasën emërore, në vend të saj është shtrirë forma e dhanores (*neve, juve*), kështu aty ka një formë më pak në paradigmën e rasës së këtyre përemrave; po ashtu përemrat (mbiemrat) pronorë *im, ime, yt, jote* në disa të folme të toskërishtes (përgjithësisht veriore) dhe në disa të folme të Shqipërisë së Mesme, si edhe përemrat *e mi, e mia, e tu, e tua* në anët e Korçës kanë vetëm formën e rasave të zhdrejta për gjithë paradigmën, përkatësisht: *tim, time, tənt/tat, tənde/tate*, (*djali tim* etj. *djali tənt/tat* etj.) dhe në anët e Korçës *tim, time, tənd, tənde* (*djemtə tim, djemte tənt* etj.); të folmet e gegërishtes veriore kanë një formë të veçantë me mbaresën *-i* për vetën e parë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore (e lidhore) të foljeve që u mbaron tema me bashkëtingëllore, ms përjashtim të atyre që e bëjnë të kryerën e thjesthë me apofoni (*kapi ~ kap ~ kap* etj.) në shumë të folme të gegërishtes verilindore dhe në disa të folme të Shqipeƒisë së Mesme veta e parë njëjës e kohës së tashme e foljeve të tipit *ha, pi* etj. diferencohet nga format e dy vetave të tjera duke nxjerre të gjatë zanoren e temës (*ha:~ha~ha* etj.); në disa te folme të Përmetit e të Kolonjës dhe në disa folme të Shqipërisë së Mesme nuk ka një formë të veçantë për vetën e parë njëjës të së pakryerës, në vend të saj është shtrirë forma e vetës së dytë (*laƒe* anët e Përmetit, Kolonjës, dhe *laje* në anët e Elbasanit) (shih hartën nr. 38).

Në shumicën e këtyre rasteve që u përmendën paradigmat dalin

të gjymtuara, dalin me në formë rasore ose vetore më pak në të folmet ku shfaqen si veçori dialektore. Gjuha letrare ka marrë si tipar ruajtjen plotë të paradigmës në këto raste, kurse formën e rasës vendore dhe formën me mbaresë të vetës së parë njëjës të foljeve me bashkëtingëllore në kohën e tashme ajo i ka përjashtuar nga paradigmat përkatëse si forma tepruese dialektore.

DALLIME NË VARIANTET E STRUKTURAVE GRAMATIKORE

4.3.1. Grupin e dytë të dallimeve dialektore morfologjike e përbëjnë *dallimet e varianteve të formave gramatikore.* Dallime të këtilla nuk kanë të bëjnë me kandërvënie mungesore të kategorive gramatikore në dialekte, por me kundërvënie të formave si mënyra e mjete shprehjesh të kategorive gramatiokore. Në të gjitha të foîmet ekzistojnë kategoritë gramatikore, por ndërmjet tyre ka dallime në strukturën e formave të ndryshme. Sipas asaj nëse dallimi, nga pikëpamja e gjendjes së sotme, ka prekur gjithë strukturën e formës gramatikore apo vetëm morfemat përbërëse të veçanta të saj, ato ndahen në: 1) variante *strukturore të formave*, p.sh. *laheʃa* dhe *u lajshe* dhe 2) variante *morfemash*, p.sh. *u loδa* dhe *u loδəʃ* Po të krahasohen për nga shkalla lla e rëndësisë dhe e nivelit në lidhje me strukturën, ato të nëngrupit të parë, janë të një niveli më të lartë.

Dallimet e nëngrupit të dytë shihen përgjithësisht në morfemat ndajshtesore, sidomos në mbaresat, por aty bëjnë pjesë edhe një numër dallimesh që lidhen me ndërrimet fonetike (jokombinatore) që ndodhin në morfemat -temë ose në morfemat-ndajshtesë gjatë eptimit të fjalëve. Këto dallime që lidhen me alomorfet, formojnë një nëngrup tjetër: 3) nëngrupin e dallimeve morfonologjike.

Dallimet e varianteve të formave gramatikore përbëjnë numrin më të madh të dallimeve dialektore morfologjike në gjuhën shqipe, ato janë gati dyfishi i dallimeve të çdo grupi tjetër. Nga të dy nëngrupet numër më të madh dallimesh ka nëngrupi i dytë, ai i varianteve të morfemave, nga të cilat shumicën e përbëjnë variantet e morfemave-mbaresa.

1. Variante strukturash. — Dallime të nëngrupit të parë, d.m.th. dallime të varianteve të strukturave të formave në dialektet e gjuhës shqipe janë: përemrat pronorë në shumicën e të folmeve dalin pa nyjë të përparme (me përjashtim të vetës së tretë njëjës e shumës), kurse në disa të folme, përgjithësisht në gegërishten veriore, ato dalin me nyjë të përparme (*i emi, e emja, i yti, e jotja, i yni, e jona* etj.); në gegërishten verilindore, sidomos në të folmet e Malsisë së Gjakovës dhe në të fol-

met e Rrafshit të Dukagjinit, si e barasvlershme me format *po shkoj, jam duke shkuar*, për të tashmen dhe të shkuarën e dëftores, ekziston një formë variante e përbërë nga folja ndihmëse *jam*, që zgjedhohet në kohë e në veta, nga pjesëza *ka* (*h*) dhe nga folja që bart kuptimin kryesor, e cila zgjedhohet vetëm në të tashmen (*jam ka ʃkoj, je ka ʃkon, iʃ ka ʃkon* etj.); gegërishtja përgjithësisht karakterizohet nga një formë sigmatike e së pakryerës të foljeve veprore (*kapʃa, lajʃa* etj.), kurse toskërishtja ka vetëm formën josigmatike (*kapa, laa* etj.); po ashtu gegërishtja përgjithësisht e formon trajtën e së pakryerës të foljeve pësore nga forma e veprores me pjesëzën përemërore *u* (*u driðʃa, u lajʃa* etj.), ndërsa toskërishtja kudo ka trajtë të veçantë të pësores së pakryer me mbaresë të ndryshme nga format e veprores (*driðeʃa, laheʃa* etj.); të folmet e arbëreshëve të Italisë, përkundrejt formave të së ardhmes të mbarë shqipes *do tə ʃkoj, kam pər tə ʃkuar*, kanë një formë të veçantë të përbërë nga folja ndihmëse *kam* dhe forma e lidhores (*kam tə ʃkoj* etj.); në gegërishten verilindore foljet jokalimtare në format e përbëra të së kryerës dhe të së kryerë së plotë dalin me foljet ndihmëse *jam* (*jam ʃkue* etj.) e jo me foljen *kam*; për paskajoren gegërishtja ka formën e përbërë nga pjesëza parafjalore *me* dhe pjesorja e foljes (*me punue* etj.), kurse toskërishtja ka vetëm formën e përbërë nga pjesëza parafoljore *për*, nga pjesëza *të* dhe nga pjesorja e foljes (*pər tə ʃkuar* etj.), e cila mbulon më pak funksione se forma *me punue* në gegërishte. (shih hartat nr. 43, 44).

Nga variantet e këtij nëngrupi gjuha letrare në sistemin e vet ka format që janë të përbashkëta, ato që kanë përhapje më të madhe, *po ʃkoj, jam duke ʃkuar, kam ʃkuar, imi* etj. dhe ato forma të toskërishtes që formojnë kandërvënie absolute me gegërisheten, si *laja, laheʃa, pər tə ʃkuar*.

2. **Variante ndajshtesash.** — Dallimet e nëngrupit të dytë, ato të varianteve të morfemave, janë më të shumta në numër se ato të nëngrupit të parë. Variantet e mbaresave dhe alomorfet e një forme gramatikore përgjithësisht janë dy, por ka edhe forma që kanë tri e më shumë variante dialektore. Këto të fundit, kuptohet se e ndajnë truallin e shqipes në disa zona për veçorinë dialektore përkatëse, kurse ato që paraqiten me dy variante e ndajnë territorin në dy zona. Është e rëndësishme të thuhet që, me përjashtim të dy rasteve, të gjitha të tjerat nuk formojnë izoglosa për ndarjen e dy dialekteve të shqipes, por njëri variant përgjithësisht ka një shtrirje gjeografike të madhe në të dy dialektet, paraqitet si varianti më i përbashkët dhe normë për gjuhën letrare, kurse tjetri ka një shtrirje gjeografike relativisht të kufizuar, është risi ose ruajtja e një gjendjeje më të hershme të gjuhës së përbashkët dhe zona ku shtrihet formon një bllok të vetëm ose rrallë del edhe e ndërprerë.

Variantet e morfemave-mbaresa shfaqen pothuaj vetëm në sistemin foljor, me përjashtim të dy-tri rasteve që i përkasin sistemit emëror: në gegërishten verilindore edhe emrat mashkullorë që mbarojnë me *k, g, h* mbarrin mbaresën *-i* në trajtën e shquar (*miki, zogi, krahi*);[362] në gegërishten veriperëndimore forma e pashquar ku-



Harta nr 43

362. Ka edhe të folme të tjera të gegërishtes ku emrat me *h* e formojnë trajtën e shquar me mbaresën *-i* (*krahi, ahi* etj.), por, meqenëse aty ekzistojnë edhe emrat me *-u* (*miku, zogu*), varianti dialektor hyn në grupin e dallimeve të dëndurisë së përdorimit (shih më poshtë) e në grupin e varianteve të formave.

1. i ɛ̈mi, e ɛ̈mja
2. jam ʃkue
3, jam ka ʃkoj

Harta nr 44

ptimisht e rasës rrjedhore e emrave femërorë del me mbaresën *-et* e jo me *e* si në mbarë gjuhën shqipe (*pər doret, miʃ lopet* etj.);[363] mbiemrat prejfoljorë të paranyjëzuar në gegërishte dallohen në gjini

363. Ky rast hyn në këtë grup dallimesh në qoftë se në ato të folme nuk ekziston edhe një formë tjetër (forma me *-e*) për rrjedhoren e pashquar.

jo vetëm nga nyja e përparme, por edhe nga mbaresa (*i la:m ~ e lame*)[364]; në disa të folme perëndimore të Shqipërisë së Mesme folja *them* në kohën e tashme veta e parë njëjës del me mbaresën *-mi* (*θemi* ose *θomi*) dhe veta e parë shumës me mbaresën *-na* (*θona*)[365]; në anët e Dibrës del me mbaresat *-ish* ose *-jsh* (sipas tipit të foljes) veta e dytë njëjës e foljeve dëftore koha e tashme (*mariʃ* «merr», *lajʃ* «lan»); fojet e formës pësore të mënyrës dëftore koha e tashme dalin: veta e parë njëjës në shumicën e të folmeve me mbaresën *-(h)em* (*vritem, lahem*), në gegërishten veriore me mbaresën *-mi* (*vritmi, la:mi*), kurse në anën perëndimore të Shqipërisë së Mesme me mbaresën *-(h) (e) na* (*vritna, lahna*), veta e dytë njëjës gjithkund ka mbaresën *-(h)e* dhe vetëm në anët lindore të gegërishtes e të toskërishtes ka mbaresën *-(h)esh* (*vriteʃ, laheʃ*), veta e parë shumës në shumicën e të folmeve është me mbaresën *-(h) emi* (*vritemi, lahemi*), në gegërishten verilindore me mbaresën *-(h) em* (*vritem, lahem*), kursnë e anën perëndimore të Shqipërisë së Mesme me mbaresën *-mi* (*vritmi, la:mi*) dhe veta e dytë shumës kudo del me mbaresën *-(h)eni* (*vriteni, laheni*), kurse në skajin jugor dhe në anët lindore skajore të toskërishtes kanë mbaresën *-(h) i* (*vritI, lahi*)[366]; në disa të folme skajore jugore të gegërishtes dhe në disa të folme skajore veriore të toskërishtes, ndryshe nga të folmet e tjera, është karakteristike forma sigmatike e së kryerës së thjeshtë veta e parë njëjës (*u goditəʃ* ose *u goditʃ* etj.); në anët e Korçës edhe foljet që u mbaronë me zanore të theksuar marrin mbaresën *-vi* (< *-i*) në vetën e tretë njëjës së së kryerës së thjeshtë; përgjithësisht në toskërishte veta e dytë shumës e urdhërores formohet me mbaresën *-(h) uni*, që ka edhe gjuha letrare (*uluni, lahuni*), në anët e Kurveleshit, Korçës, Elbasanit, Tiranës, Matit, Mirditës, Dibrës, Tetovës formohet me mbaresën *-(h)i* (*uli, lahi*), në gegërishten verilindore me *-(h)nu* (*ulnu, lahnu*), në gegërishten veriperëndimore me *-(h) ɲiu* (*ulɲiu, lahɲiu*), në anët e Durrësit, Krajës e Kavajës me *-(h)ni* (*ulni, lahni*); në skajin verior të gegërishtes dhe në skajin jugor të toskërishtes del pa mbaresën *-te* forma e së pakryerës e vetës së tretë njëjës e foljeve *jam, kam* (*iʃ, kiʃ*); një larmi të madhe formash me variante mbaresash nëpër të folme të ndryshme të të dy dialekteve kanë foljet në kohën e pakryer, nga të cilat po sjellim për ilustrim vetëm mbaresat variante të vetës së parë njëjës: *-ja, -ɾa, -ɾam, (-jam), -ɾe, -ɾə, -j, -ij* në toskërishte dhe *(-j)ʃa, -(j)ʃna*; *-je* në gegërishte; me përjashtim të rasteve fakultative,

364. Ky është njëri rast nga ky nëngrup dallimesh që formon izoglosë për ndarjen e shqipes në dialekte.
365. Forma me mbaresën *-na* për vetën e parë del edhe në disa të folme të veçuara në gegërishten veriore.
366. Nuk mungon një formë e këtillë edhe në disa të folme të veçuara të gegërishtes.

në gegërishte përgjithësisht format e pjesores dalin pa mbaresë (*veʃ, godit, la, pi* etj.), kurse në toskërishte dalin me mbaresë (*veʃur, larə, vjelə* etj.)[367] Mund të përmendeshin këtu edhe dallime me variante morfemash-prapashtesa, të cilat gjithashtu karakterizojnë të folmee. grupe të folmesh nga ana gramatikore-leksikore (fjalëformim) (shih hartat nr. 45, 46, 47 dhe nr. 39, 40).



1. i l*a*:m/e lame
   ve:ʃ «veshur», la: «larë»
2. θemi/θomi «them»
   θona «themi»
3. miki, zogi, krahi
4. miʃ lopet

Harta nr 45

367. Ky është rasti i dytë që formon izoglosë për ndarjen e toskërishtes nga gegërishtja.

3. **Dallime morfonologjike.** Nga dallimet e këmbimeve të morfemave (të alomorfeve) në dialektet e shqipes mund të përmendim këto: në shumicën e të folmeve nuk e ndërrojnë temën në të dy trajtat em-

1. vritmi «vritem»
2. vritna «vritem»
   vritmi «vritem»
3. vritem «vritemi»
4. vritesh veta II nj.

Harta nr 46

at që mbarojnë në *-or, -uall, -yell*, si *punətor-i, buał-i, kertseł-i*, kurse në disa të folme këta emra dalin me tog zanoresh në trajtën e pashquar (*puntuar / puntur, buał / buł, kertsyeł / kertsył*) dhe me zanoren e temës të padiftonguar në trajtën e shquar (*puntori, boli, kertseł i*); emrat e tipit *ftua, thua* në shumicën e të folmeve të toskërishtes e të gegëri-



Harta nr 47

shtes e formojnë trajtën e shquar duke nxjerrë **o** në vend të togut *ua* (*ue*) para mbaresës *-i* (*ftoi*), në gegërishten veriore tema e emrit del e zgjeruar me n-në (*ftoni*), kurse në Myzeqe togu qëndron si në trajtën e pashquar dhe tema zgjerohet me *n*-në e rotacizuar (*ftuari*); në pjesën jugore dhe juglindore të toskërishtes dhe në anët e Dumresë, të Sulovës, të Krujës, Matit, Mirditës, Pukës, M. së Madhe, Rekës së Dibrës e Kërrabës emrat mashkullorë të numrit shumës me temë në bashkëtingëllore dalin shpesh me mbaresën *-e* në format e dhanores, gjinores e rrjedhores (*plece, cəne* δẽne etj.), ndryshe nga shumica e të folmeve që kanë mbaresën e zgjeruar *-ve* edhe në këtë kategori emrash; forma e kallzores së shquar e emrave mashkullorë numri njëjës me temë në

zanore marrin mbaresën *-n*(ë) përgjithësisht në të folmet e të dy dialekteve (*δenə, kanə*), kurse në të folmet e gegërishtes veriore, sidomos në gegërishten verilindore, dhe në disa të folme qendrore të toskërishtes veriore marrin mbaresën *-un* (*δeun, kaun* etj.), kurse për emrat e tipit *hu, kushëri,* përgjithësisht gegërishtja ka formën *hūnin, kuʃrīnin,* kurse toskërishtja formën *hunə, kuʃərinə*; diku bëhen ndërrime metofonie ose apofonie në morfemat-temë të foljeve e diku jo (*morən / muərə*) etj. (shih hartat nr. 48,49).



1. ftoni «ftoi»
2. ftuari «ftoi»

plece «pleqve»

Harta nr 48

Nga variantet e nëngrupit të dytë dhe nëngurupit të tretë gjuha letrare përgjithësisht ka si normë ato që janë me një shtrirje më të madhe gjeografike, të cilat në shumicën e rasteve nuk janë risi morfologjike, por një gjendje më e hershme e përbashkët. Në dy rastet që ndajnë dy dialektet ajo ka si normë variantin e dialektit jugor (*i larə — e larə* dhe *veʃur, larə, vjelə, δənə*), kurse në rastet të veçanta e të pakta ka marrë për normë një varaiant me shtrirje të kufizuar, siç është rasti i së pakryerës (*laja* etj.) që gjendet në zonën e Dëshnicës dhe të Tepelenës toske, ka marrë gjithashtu për normë variantin e kufizuar gjeografikisht *ish, kish*, por si normë dytësore për funksione stilistike



1. δeun,

2. δenə, kuʃərinə

Harta nr 49

Dallime në dendurinë e përdorimit të varianteve strukturore.

5.4.1. Grupin e tretë të dallimeve morfologjike e bëjnë ato *të shpërndarjes së varianteve gramatikore të dialekteve* (të distribucionit) brenda një të folmeje. Dallime të këtilla nuk prekin inventarin e strukturave (as të kategorive, as të formave të veçanta gramatikore). sepse, p.sh., në një të folme ekzistojnë kundërvëniet në kategorinë e gjinisë së emrave *mashkullorë* ~ *femërorë* ~ *asnjanës*. por nga klasa e emrave asnjanës grupi i emrave që tregojnë lëndë ka kaluar në klasën e emrave mashkullorë (*dyłət* → *dyłi*. *miʃtə* → *miʃi* etj.), kanë mbetur asnjanës (ruhet kategoria e kësaj gjinie) emrat prejfoljorë ose prejmbiemërorë (*tə ftohtət*, *të verðət* etj.), ose disa emra që dikur kanë qenë femërorë, sot në shumë të folme janë mashkullorë (*ndera* → *nderi*, *ʃəndetja* → *ʃəndeti* etj.). Gjithashtu dallimet e këtij grupi nuk janë as si dallimet e grupit të dytë (dallimet e varianteve të formave gramatikore), sepse, p.sh., në]gegërishte një grup emrash mashkullorë e bëjnë shumësin me *-a* (*doktora*, *ʃofera*, *ofitsera*, *dollape* etj.), kurse në toskërishte e bëjnë me mbaresën *-ə* (*doktorə* etj.), mirëpo në këtë rast nuk ka një kundërvënie mungesore midis dy dialekteve, mbasi në toskërishte ekziston edhe shumësi me *-a* (*lisa*, *plepa*, *burā* etj.), po ashtu edhe në gegërishte ekziston shumësi me *-ə* (sot nuk shqiptohet *ə*-ja në fund të fjalës, p.sh. *malsor* (*ə*), *katundar* (*ə*) etj.).

Pra, në raste si këto dallimet midis të folmeve janë vetëm në dendurinë e përdorimit të njërit e të tjetrit variant dialektor, variantet janë në një të folme, por njëri ka marrë një shtrirje më të madhe në një kategori fjalësh në dëm të një varianti tjetër, është shtuar numri i njësive dhe i klasave leksikore ose edhe gramatikore në grupin e një kategorie gramatikore (gjinie etj.) ose në grupin e një klase fjalësh që kanë si karakteristikë një ndajshtesë të caktaar (mbaresë shumësi, mbaresë shquarësie, foljeje etj) dhe është pakësuar numri i tyre në kategori e klasa të tjera ku kanë bërë pjesë më parë. Siç shihet këto janë dallime morfologjiike të dendurisë së përdorimit të varianteve në të folme të ndryshme, ose, më mirë të themi, janë thjeshtë dallime *sasiore*.

Nga kjo pikëpamje dallimet e këtilla morfologjike ngjajnë me dallimet dialektore *të përbërjes fonematike të fjalëve*, të cilat nuk kanë lidhje me dallimet në inventarin e fonemave, as me dallie të organizimit të fonemave në sistem, as me dallimet në funksionin e tyre. por me dendurinë e përdorimit të fonemave, ekzitojnë dy fonema në një të folme, ekzistojnë ato edhe në të folmet të tjera, siç është rashti i fonemës *r* në toskërishte, e cila ka një përdorim më të madh në këtë dialekt në krahasim me gegërishten për shkak të rotacizimit që ka vepruar atje dikur në një numër fjalësh.

Si dallime morfologjike të këtij grupi në dialektet e shqipes, mund të radhitim këtu dallimet në gjininë e emrave: emrat e lëndëve, si *dyllë, djathë, brumë, mjaltë, ujë, grurë* etj. diku janë asnjanës e diku mashkullorë; emrat, si *nder, qytet, lot, kryq, shëndet* etj. diku janë mashkullorë e diku janë femërorë (në geg. veriperëndimore), emrat si *djep, tul, llokum* diku janë mashkullorë e diku femërorë (*djepe, tule, łokume*); disa emra diku janë femërorë, si *furə, spetse* e diku mashkullorë (*fur, spets*); disa emra mashkullorë: diku janë më shumë me mbaresë *-a* në formën shumësit (*doktora* etj.) e diku më shumë me *-ə* (*doktorə* etj.), disa janë diku më shumë me *-a* (*nipa* etj.) e diku më shumë me *-ər / -ən* (*nipər / nipən* etj.) etj.; foljet e tipit *ha, rri, fle* në diasa të folme të gegërishtes jugore (ana perëndimore) zgjedhohen në të tashmen e dëftores duke, marrë në të gjitha vetat e të dy numrave mbaresat e foljeve të tipit *punoj laj* etj. (*haj*~*hăn*~*hăn*~ *ha:jm*~ *hani*~ *ha:jn*); në gegërishten veriore, sidomos në anën l!ndore, dhe në disa të folme të Shqipësisë së Mesme disa folje, si *marr, dal, gjej, mbes, zë, vë* etj. dalin pa mbaresë vetore në formën e vetës së tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë (*dul, mur, ʒet, mbet, zu, vu* etj.), kurse foljet e tjera dalin me mbaresë; zgjedhimi i disa foljeve në të kryerën e thjeshtë në disa të folme bëhet sipas një tipi të një klase tjetër foljesh, p.sh. *lajta, ʃajta, ndajte* etj. sipas tipit *mbajta*, diku *ʃtyva* e diku *ʃtyna / ʃtyra* sipas *lava* dhe *bëra* etj.; në labërishte formimi i pjesores së foljeve *vjelë, dalë, marrë, dhënë* etj. bëhet sipas klasës së foljeve që kanë mbaresën *-ur* (vjelur, dalur, ðənur etj.); klasës së emrave mashkullorë që shquhen me mbaresën *-i* u bashkohen edhe emrat që mbarojnë me bashkëtingëlloren *h* (*krahi, ahi, plehi* etj.) në geg. veriperëndimore dhe në disa të folme veriore të gegërishtes qendrore etj.

Këto lloj dallimesh të shpërndarjes kanë një kushtëzim semantik ose gramatikor, dalin rregullisht në klasa të caktuara fjalësh në një të folme, prandaj nuk duhen barazuar me raste kur në një të folme ekzistojnë dy forma gramatikore, të cilat pa kurrëfarë kushtëzimi kanë denduri të barasvlershme, p.sh. e ardhmja me *do* (*do të laj*) dhe forma tjetër e së ardhshmes *kàm pën të larë*, nuk duhen barazuar as me rastet kur dy forma gramatikore kanë denduri të ndryshme përdorimi në dy dialekte të ndryshme për shkak të funksioneve jo të njëjta sintaksore që kanë secila prej tyre, p.sh. lidhorja ka më pak funksione në dialektin verior në krahasim me paskajoren, kurse në dialektin jugor raporti është i kundërt (dallime të këtilla janë të rrafshit të sintaksës).

–Gjuha letrare në përgjithësi ka si normë variantin më të përbashkët nga tiparet dalluese të këtij grupi, ka atë variant që ka shtrirje më të madhe gjeografike, me përjashtim të formës së shumësit me *-ë* të disa emrave mashkullorë (*doktorë* etj.), të cilën e ka marrë nga dialektil jugor. Në gjuhën e folur sa vjen e po bëhet kudo më i përdorshëm shumësi

me *-a* (*doktora*) dhe, duke marrë këtë shtrirje të madhe gjeografike e në shtresa shoqërore, ky tip po ushtron një trysni të madhe edhe në gjuhën letrare.

Shumë nga këto ripare dalluese dialektore, duke qenë se nuk kanë të bëjnë me inventarin e strukturave dhe me variantet strukturore të formave gramatikore, pra, duke qenë se nuk janë dallime të mirëfillta të sistemit, kalojnë herë-herë më lehtë në gjuhën letrare si përdorime dialektore që thyejnë normën letrare, ndryshe nga tiparet dalluese dialektore që lidhen me inventarin dhe me variantet e strukturave.

DALLIME FONETIKE TË VARIANTEVE STRUKTURORE

4.5.1. Së fundi, grupin e katërt të dallimeve morfologjike dialektore e përbëjnë *dallimet fonetike të formave gramatikore.* Variantet dialektore në këtë grup dallimesh janë të rrafshit tingullor (fonetik), por që janë të lidhura me strukturën gramatikore e jo me strukturën fonetike, në kuptimin që nuk lidhen me sistemin fonologjik e që nuk janë të kushtëzuara fonetikisht në një dialekt.

Të këtilla janë variantet dialektore të disa përemrave vetorë e dëftorë *unə* dhe *u* ose ŭ, *ai* dhe *ay*, *ajo* dhe *ao*, *ky*, *kjo* dhe *cy*, *co*; format e bashkuara të shkurtra të përemrave *ma* dhe *m'e* (*δa*), *ta* dhe *t'e* (*δa*) (në çamërisht); forma e vetës së parë njëjës e foljeve dëftore në kohën e tashme të tipit *laj*, *punoj*, që në shumicën e të folmeve të dy dialekteve është me mbaresën *-j*, kurse në Myzeqe, Berat, Mallakastër, Skrapar, Opar, Përmet, Kolonjë del me mbaresën *-ɾ* (*laɾ*, *punoɾ*); forma e vetës së parë shumës e së kryerës së thjeshtë e foljeve me bashkëtingëllore në toskërishten lindore (Korçë) del me mbaresën *-mə* (*veʃmə*) dhe në geg. veriperëndimore me mbaresën *-mę* (*dulmę*,) ndryshe nga shumica e të folmeve që këtë formë e kanë me mbaresën *-əm* (*veʃəm*, *doləm*; forma e së ardhmes diku del e plotë (*do tə laj*), diku e reduktuar fonetikisht (*do laj*, *o laj* në anët e Gjirokastrës, ose *to laj* në anët e Korçës); pjesëza e përcjellores diku është *duke*, diku *tuke*, diku *tue*, diku *tuj* e diku *tu*; variantet e shumësit të disa emrave mashkullorë: me mbaresën *-ɾ* (*θoɾ*) dhe -j (*θoj*), me mbaresën -iɾ (*kuʃəriɾ*) dhe -ij (*kusʃərij*), me mbaresën -eɾ (*lumeɾ*) dhe -ej (*lumej*). (Shih hartën nr. 50).

Gjuha letrare ka si normë variantin më të përbashkët në shumicën e rasteve, me përjashtim të mbaresave të shumësit, për të cilat ka marrë variantin e dialektit jugor.

Dallimet e grupit të fundit (dallimet fonetike), por në një masë të madhe edhe ato të grupit të tretë (dallimet sasiore), nuk janë dallime



1. laɾ «laj»
3. veʃmə/veʃmę «veshëm»
3. θoj «thonj»
lumej «menj»

Harta nr 50

strukturore të mirëfillta, d.m.th. nuk janë dallime morfologjike si ato të inventarit dhe të varianteve të strukturave, të cilat kanë prekur strukturën e kategorive dhe të formave gramatikore në dialekte të ndryshme. Prej kësaj duhen nxjerrë përfundime se këto dallime nuk janë të një shkalle me ato të grupeve të para për sistemin morfologjik të dialekteve.

Duke u nisur nga numri i tipareve dalluese dialektore morfologjike që sollëm këtu, shihet se ato përafërsisnt dalin me një përqindje të këtillë sipas grupeve e nëngrupeve të tyre.



Këto janë shifra të përafërta të nxjerra nga llogaritja e tipareve dalluese morfologjike më të njohura për zonë të mëdha dialektore nuk janë përfshirë këtu disa dallime të zonave shumë të ngushta dialektore.

E rëndësishme është se nga kjo përllogaritje del që dallimet më të rëndësishme morfologjike, ato që lidhen me inventarin e strukturave dhe me variantet e strukturave të formave, janë të një numri të vogël në krahasim me llojet e tjera të dallimeve (përbëjnë 28,5% të të gjitha dallimeve), dallimet jo të mirëfillta gramatikore, ato të shpërndarjes dhe fonetiket, kanë një numër të madh (përbëjnë 41,5% të të gjitha dallimeve).

KREU V

MARRËDHËNET E SOTME TË DIALEKTEVE ME GJUHËN LETRARE

PËRBËRJA E GJUHËS LETRARE NË RAPORT ME DIALEKTET

5.1.1. Gjuha letrare, si një gjuhë mbikrahinore, ngrihet mbi dialektet për të formuar një sistem të vetin me normë të njësuar për mbarë kombin. Pasi lind e formohet gjuha letrare kombëtare, dialektet futen në marrëdhënie me këtë variant të ri të gjuhës së përbashkët. Këto marrëdhënie janë të dyanshme dhe dialektike, me masë dhe drejtim veprimi të ndryshëm në periudha të ndryshme. Në periudhën kur është duke u formuar gjuha letrare kahu kryesor i drejtimit të veprimit shkon nga dialektet në gjuhën letrare, sepse kjo në këtë kohë mbruhet duke e marrë lëndën nga dialektet. Pas formimit të gjuhës letrare veprimi kalon me forcë të madhe nga gjuha letrare mbi dialektet për afrimin e tyre, megjithëse edhe në këtë kohë dialektet mbeten përsëri si një burim për pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare.

Në fillim do të ndalemi në marrëdhëniet e periudhës së formimit të gjuhës letrare për të vënë në dukje shkurt se si e ka «zgjedhur» ajo lëndën që e ka marrë nga dialektet, d.m.th. për të parë se ç'ka ngritur

në rrafshin e normës së vet nga variantet dialektore dhe ç'ka lënë mënjanë prej tyre dhe përse.

Që në fillim mund të themi se shkalla pak a shumë e madhe e afërsisë që ka gjuha letrare shqipe me dialektet shpjegohet në radhë të parë me shkallën e vogël të dallimit që kanë të folmet e gjuhëi sonë me njëra-tjetrën.

Për formimin e sistemit të vet gjuha letrare merr nga dialektet së pari ato tipare që janë krejt të përbashkëta. Tipare të këtilla në të folmet e shqipes ka shumë në të gjitha sferat e gjuhës. Por veç këtyre, dialektet kanë edhe tipare që paraqiten në formë variantesh territoriale në të folme të ndryshme. Duke qenë se gjuha letrare ka një sistem gjuhësor të vetëm, të përbashkët për gjithë kombin, jo një sistem me variante të ndryshme, siç e kanë dialektet, kuptohet vetvetiu se në formimin e sistemit të saj nuk do të hyjnë të gjitha variantet e dialekteve, në normën e saj do të arrijnë të ngrihen vetëm disa prej varianteve dialektore. Pa lënë fare mënjanë edhe fakltorët gjuhësorë, «zgjedhjen» e këtyre varianteve për ti ngritur në normën e një gjuhe të përbashkët e përcaktojnë faktorë jashtëgjuhësorë (politiko-shoqërorë), të cilët janë të ndryshëm për gjuhë letrare të ndryshme.

5.1.2. Tiparet e sistemit të zanoreve të gjuhës letrare përputhen përgjithësisht me tiparet më të përbashkëta të sistemit të zanoreve të dialektit jugor. Mirëpo në pjesën më të madhe këto tipare janë po ashtu të përbashkëta edhe për të gjitha të folmet e shqipes, sepse ekzistojnë në çdo të folme krahas tipareve të tjera që mund të ketë një e folme. P.sh. sistemi i zanoreve të gjuhës letrare, që është një sistem i thjeshtë, i përbërë vetën nga një seri zanoresh gojore, nuk është tipar vetëm i të folmeve të toskërishtes verore, por e gjejmë atë edhe në toskërishten jugore krahas me serinë e zanoreve gojore të gjata, e gjejmë edhe në të gjitha të folmet e gegërishtes bashkë me serinë e zanoreve gojore të gjata dhe me serinë e zanoreve hundore. Pavarësisht nga fakti se në dialektin verior mungon në inventarin e fonemave zanorja (*ə*) e theksuar dhe në disa të folme të toskërishtes jugore e në disa të folme të gegërishtes qendrore mungon fonema *y*, e rëndësishme është se kudo në të folmet e shqipes zanoret gojore të shkurtra, që ka edhe gjuha letrare, formojnë një sistem trekëndësh dhe hyjnë në të njëjtat korrelacione: në korrelacionin e lokalizimit (*të përparme* ~ *të prapme* dhe në korrelacionin e shkallës së hapjes (*të mbyllura* ~ *të hapura*):

i (y) u

e (ə) o

a

Nga kjo pikëpamje ky tipar merr një vlerë shumë të madhe për bazën e përbashkët që ekziston në sistemin fonetik të dialekteve dhe të gjuhës letrare shqipe.

Në krahasim me inventarin e shumicës së të folmeve të të dy dialekteve inventari i fonemave zanore të gjuhës letrare është më i vogël ose më mirë të]themi gati më i vogli. Ai përbëhet nga shtatë fonema zanore gojore: /i/, /y/, /e/, /a/, /o/, /u/, /ë/. Gjuha letrare ka lënë mënjanë në këtë rast serinë e zanoreve gojore të gjata të gegërishtes e të toskërishtes jugore, ka lënë po ashtu edhe serinë e zanoreve hundore të gegërishtes.

Sistemi fonetik i gjuhës letrare, edhe pse përbëhet vetëm, nga një seri zanoresh gojore, i plotëson funksionet e veta të gjuhës. Funksionin kuptimdallues të zanoreve të gjata ajo e mbulon në të shumtën e rasteve me mjete të tjera fonetike ose gramatikore. Kështu mbajtja e zanores *ë* të patheksuar në fund të fjalës zhduk homofoninë ndërmjet emrave të gjinisë femërore e atyre të gjinisë mashkullore (*plakë* ~ *plak*), mbaresa *ë* e shumësit të disa emrave mashkullorë diferencon formën e shumësit nga forma e njëjësit (*shok* ~ *shokë*) etj. Sigurisht, gjuha letrare ka edhe raste ku nuk mund të zhdukë homofoninë, p.sh. forma e foljes *ha* për tri vetat e numrit njëjës të kohës së tashme (në geg. I *ha*:~ *II*, III *hă*), por raste të këtilla nuk janë të rralla edhe në të folmet që karakterizohen nga kundërvënia e zanoreve të gjata me të shkurtrat.

Mundësia e mbulimit të funksionit të zanoreve të gjata dhe hundore nga seria e zanoreve të gjuhës letrare shpjegohet edhe me faktin se të tria seritë e zanoreve kanë edhe lidhje gjenetike (etimologjike) me njëra-tjetrën. Në shumë raste kjo bën që të jetë e kuptueshme për të gjithë përbërja fonematike e fjalëve të gjuhës letrare, krahaso p.sh. *zë, hi, lëmë, punëtor*, etj. të gjuhës letrare me *zã, hĩ, lãm, puntor* etj. të dialekteve.

Përsa i përket funksionit të fonemave zanore, d.m.th. mënyrës se si funksionojnë ato në ligjërim, a ndodhin apo jo neutralizime kundërvëniesh të tipareve të tyre në situata të caktuara fonetike, mund të themi se gjuha letrare përputhet në këtë rast me dialektet po të jetë se në raportin gjuhë letrare-dialekt marrim vetëm sistemin e zanoereve gojore të shkurtra. Siç është shpjeguar edhe në këtë punim, edhe për dialektet njësia është shumë e madhe në funksionin e fonemave zanore. Nga rastet e neutralizimeve gjuha letrare ka ngritur në normë drejtshqiptimore këmbimin e *i*-së së patheksuar me *j* kur ajo ndodhet pranë një zanoreje tjetër, p.sh. *ja* δa (< ia δa) «*ia dha*» etj., dhe në normë drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore ka mbajtur reduktimin e plotë të zanores *ë* të patheksuar kur kalon nga një rrokje e mbyllur prej një bashkëtingëlloreje sonante në një rrokje të hapur, p.sh. *lodër* → *lodra*, *i vetëm* → *i vetmi* etj.

Sigurisht, gjuha letrare ka lënë mënjanë ato neutralizime që lidhen me sisteme zanoresh, të cilat nuk janë karakteristike për të; p.sh. ka lënë neutralizimin e korrelacionit të gjatësisë, që është karakteristike vetëm për dialektin verior dhe për toskërishten jugore.

Prej varianteve fonetike dialektore gjuha letrare nuk ka ngritur asnjë në nivelin e sistemit të vet, sepse në përgjithësi ato dalin si tipare të kufizuara nga pikëpamja gjeografike dhe, për më tepër, janë të shpërndara në zona të ndryshme. Në këtë rast kemi të bëjmë përgjithësisht edhe me inovacione që kanë ndodhur në zona dialektore të veçanta dhe gjuha letrare, me përjashtime të pakta, nuk u ka hapur vend inovacioneve në sistemin e zanoreve.

Për variantet që lidhen me dallimet në përbërjen fonematike të fjalëve gjuha letrare ka mbajtur qëndrime të ndryshme, por në numrin më të madh të rasteve ka pranuar në sistemin e vet ato që pasqyrojnë një gjendje më të hershme të përbashkët, pavarësisht nga shtrirja gjeografike që kanë sot. Kështu ka vepruar ajo për zanoren e theksuar *e* që ka qenë e ndjekur dikur nga një bashkëtingëllore hundore (*dhen, brenda, pe, fre* etj.). Ky është tipar vetëm i të folmeve të anëve të Korçës e të Pogradecit, por, megjithatë, nuk duhet lënë pa u llogaritur këtu edhe fakti që gjithë dialekti verior ka *ë* (*dën*, «dhen», *mrëna* «brenda» etj.).

Kështu ka vepruar gjuha letrare në drejtshkrim edhe për ruajtjen e zanores *ë* të patheksuar në fund të fjalës (*bukë, lajmë* etj.), në mes të fjalës pas theksit (*bletëve, të largëta* etj.) dhe në mes të fjalës para theksit (*punëtor, bagëti* etj.); për shtrirjen gjeografike të tyre të kufizuar në dialekte shih hartat nr. 25, nr. 26.

Në raste si *nge*, (ti) *re, vesë, ve-zë* etj. ka pranuar variantin me *e* për shkak se ai gjendet në dialektin jugor dhe në gegërishten jugore, ka lënë mënjanë variantet dialektore shumë të kufizuara me *ae, oe*, që pasqyrojnë gjendjen primare dhe variantet e tjera gjegjëse æ:, ø: dhe *a:, o:* si inovacione po ashtu të kufizuara nga pikëpamja territoriale (shih hartën nr. 28).

Për togjet e zanoreve *ua, ye, ie* është mbështetur edhe në faktin se janë tipare të toskërishtes, por në të njëjtën kohë edhe në faktin se ato ekzistojnë në shumë të folme të gegërishtes veriore, duke përjashtuar togun *ua*, në vend të të cilit atje ka *ue*. Ka mënjanuar në këtë rast variantet gjegjëse si inovacione: *u* (*dur* «duar»), *y* (*dyr* «dyer») dhe *i* (*dil* «diell»).

Kuptohet vetvetiu se gjuha letrare s'kishte si të ngrinte në normë variante të kufizuara gjeografikisht të këtilla, si *y* për *i* (*krym* «krimb» *a* për *o* (*abor* «obor»), *u* për *ə* (*muzat* «mëzat»), *ə* për *u* (*hekər* «hekur») reduktimin e *ə*-së së patheksuar në rrokje nistore (*gzim* «gëzim»)etj.

Variantet fonetike kombinatore ose pozicionale të fonemave za-

nore kanë mbetur në nivelin dialektor, asnjë prej tyre nuk ka arritur të ngrihet në nivelin e normës letrare. Është e kuptueshme se variantet fonetike të fonemave nuk do të zinin vend në normën drejtshkrimore, sepse ato lidhen me variacione të timbrit të fonemave në kushte të caktuara fonetike, por ato u përjashtuan edhe nga norma drejtështkrimore pavarësisht nga zona dialektore ku shtrihen, p.sh. nuk u ngritën në normën e shqiptimit as diftongjet fonetike *ua, ye, ie* si variante të togjeve *ua, ye, ie* në rrokje të brendshme të hapura ose të mbyllura, që janë karakteristike për shumë të folme të dialektit jugor.

Shkalla e madhe e njësisë që kanë të folmet e gjuhës shqipe në sistemin e fonemave bashkëtingëllore shpjegon mirë edhe vendin që zë gjuha letrare sot në tërësinë e gjuhës shqipe. Ajo, si varianti me normën e përbashkët kombëtare, ka në bazën e vet një sistem bashkëtingëlloresh me elementet më të përbashkëta të shqipes së sotme dhe të një etape më të hershme të zhvillimit të saj.

Kjo duket në radhë të parë në faktin se gjuha letrare ka marrë sistemin e përbashkët bashkëtingëllor të të gjitha të folmeve, i cili përbëhet nga katër seri me korrelacionet e zëshmërisë dhe të frikativitetit. Edhe nga radhët, nga çiftet dhe tufat e sistemit ajo ka mbajtur ato që kanë qenë dikur të përbashkëta për mbarë gjuhën shqipe dhe që sot kanë një shtrirje më të madhe gjeografike:

p	t	c	ç	q	k
b	d	x	xh	gj	g
f	th	s	sh		
v	dh	z	zh		

Në sistemin e gjuhës letrare nuk kanë zënë vend radha e afrikatëve të prapme dhe çiftet e tufat katërgjymtyrëshe që janë formuar në disa të folme prej ndryshimeve fonetike që kanë pësuar atje tingujt. Kuptohet se, bashkë me këto, ajo ka lënë jashtë inventarit të saj fonemat që bëjnë pjesë në këto çifte. Në inventarin e fonemave të gjuhës letrare janë mbajtur fonemat skajore të sistemit, si *h*-ja dhe *rr*-ja, ba shkë me to edhe kundërvënia e shumanshme e veçuar e *h*-së me fonema të tjera dhe kunëdërvënia e dyanshme *r* ~ *rr* [r̄] dhe tufa trigjymtyrëshe

l
/ \
r —— rr

, janë mbajtur gjithashtu edhe grupet e fonemave që kanë qenë të përbashkëta dikur (*mb, nd, ng, ngj, tj, dj, pl, bl, fl*), duke ruajtur kë-

shtu edhe raportet fonologjike të tyre me elementet përbërëse (*mb* ~ *m* etj.).

Edhe për mënyrën e funksionimit të fonemave bashkëtingëllore në disa kushte të caktuara fonetike gjuha letrare ka tipare më të përbashkëta, ajo ka përjashtuar nga sistemi i vet tiparet e kufizuara nga ana gjeografike, si neutralizimin e kundërvënies së të zëshme me të shurdhëtat në fund të fjalës, këmbimin e *h*-së me *f*-në para *t*-së, këmbimin e *q*[c]-së *gj*[ɟ]-së me *j*-në pranë *t*-së, *n*-së, *m*-së etj.

Ndaj dallimeve dialektore në përbërjen fonematike të fjalëve ajo ka mbajtur qëndrime të ndryshme, në disa raste ka ngritur në normë atë që përfaqëson zhvillimin më të ri, p.sh. rastet me *j* ku ajo vjen nga *l*-ja (*vaj* etj.), rastet me *q* [c] e *gj*[ɟ] ku ato vijnë nga grupet *kl* e *gl* (*gjuha* etj.), në ndonjë rast ka ngritur në normë atë që ka qenë dikur e përbashkët, p.sh. rastet me *nj* [ɲ] ndërmjet dy zanoreve dhe në fund të emrave e mbiemrave (*rrënjë, ullinj, të këqinj*), në ndonjë rast tjetër tipari i saj shpjegohet me faktin se është një tipar qenësor në dialektin jugor, p.sh. rastet me rotacizëm (*vera, emri* etj.) etj. Dallime të këtilla dialktore, që nuk lidhen me anën funksionale të fonemave, por vetëm me dendurinë e përdorimit të tyre, kanë bërë dhe bëjnë të mundur preniuë në gjuhën letrare edhe të fjalëve me përbërje fonematike të ndryshme nga ajo që është pranuar si normë e saj, p.sh. *hapësinor* e jo *hapësiror, zanore* e jo *zërore, njoftim* e jo *njohtim* etj. Këto edhe të tjera si këto janë elemente që nuk e prekin sistemin fonetik të gjuhës letrare në anët e tij thelbësore.

Shihet se në sistemin e bashkëtingëlloreve gjuha letrare ka karakter konservativ, mbasi në përgjithësi ka bërë të vetat tiparet që kanë qenë dikur më të përbashkëta në gjuhën shqipe.

5.1.3. Në përbërjen e gjuhës letrare ka një numër të mirë tiparesh gramatikore (kategori, forma, ndajshtesa) të përbashkëta me dialektet. Të këtilla janë kategoria e shquarsisë me kundërvënien e trajtave të së shquarës dhe të së pashquarës në sistemin emëror (*mal* ~ *mali* etj.); sistemi i nyjeve të përparme (*i malit, i kuq* etj.), kundërvënia e mbiemrave të nyjshëm me mbiemrat e panyjshëm (*i drunjtë* ~ *drusor* etj.), shumica e formave të mënyrave dhe të kohëve të ndryshme në sistemin foljor (pavarësisht nga dallimet që mund të kenë format nëpër të folme të ndryshme në përbërjen e tyre fonetike dhe në ndajshtesat) etj. Në të njëjtën kohë, në sferën morfologjike të gjuhës letrare ka edhe një numër të madh tiparesh që vijnë nga disa të folme dhe që dallohen nga tiparet e të folmeve të tjera.

Prej dallimeve të këtilla dialektore ajo nuk ka ngritur në rrafshin e normës letrare kundërvënien *dy* ~ *dy*: të numërorit 2 (e para për mashkulloren, e dyta për femëroren), meqë janë forma tepruese për dallimin e gjinisë dhe meqë dallimi bëhet me anë të gjatësisë së zanoreve

të temës (*y* ~ *y:*), tipar ky që nuk e ka gjuha letrare në sistemin e vet fonetik. Po ashtu gjuha letrare ka lënë mënjanë, nuk i ka bërë të normës së vet, përemrat-dëftorë *qeky*, *njiky* etj., sepse janë të kufizuar gjeografikisht, janë veçori vetëm të të folmeve të gegërishtes veriore, dhe, përveç kësaj, funksionet e këtyre përemrave ajo i mbulon me mjete sintaksore, duke i shoqëruar përemrat dëftorë të mbarë shqipes me pjesëzën *ja* (*ja ky* etj.).

Dallimet e inventarit të formave të një paradigme lidhen me mugesën ose tepricën e formave gramatikore të një paradigme të caktuar. Gjuha letrare ka si tipar të vetin paradigmën e plotë e më të përbashkët në]gjendjen e]sotme, ajo ka përjashtuar edhe paradigmat dialektore me mungesë formash edhe ato me tepricë formash, p.sh. nuk ka marrë as paradigmën me një formë të përemrit pronor *im* (*djali tim*, *djalit tim*, *djalin tim* etj.), as paradigmën e emrit me formën e rasës vendore si një formë e tepërt për shumicën e të folmeve, ajo ka formën *mal* për emërore e kallëzore dhe *mali* për gjinore, dhanore e rrjedhore:

emërore *mal*
gjinore i(e) *mali*
dhanore *mali*
kallëzore *mal*
rrjedhore *mali*

Ndaj veçorive dialektore që lidhen me variante të strukturave (të strukturës së një forme gramatikore) gjuha letrare ka mbajtur dy qëndrime, sipas rastit: kur variantet e strukturave formojnë kundërvënie absolute midis dy dialekteve, d.m.th. kur njëri prej tyre është tipar i toskërishtes dhe tjetri i gegërishtes, gjuha letrare ka mbajtur atë variant që është tipar i dialektit jugor, p.sh. paskajorja *për të shkuar* ndaj asaj *me shkuem*, e pakryera e foljeve veprore *laja* e jo *lajʃa*, e pakryera e pësores *laheʃa* e jo *u lajʃa*. Kur variantet e strukturave kanë një shtrirje gjeografike më të madhe ose më të vogël se një dialekt, gjuha letrare ka marrë si normë atë që ka shtrirje më të madhe, p.sh. *yti*, jo *i yti*, *kam shkuar*, jo *jam ʃkue*, *do tə shkoj* dhe *kam pər tə shkuar*, *po shkoj* dhe *jam duke shkuar*, jo *jam ka ʃkoj* etj

Siç e thamë më sipër, ndryshe nga variantet e këtij nëngrupi që prekin gjithë strukturën e formës gramatikore, disa variante të tjera prekin vetëm njërën morfemë, të shumtën e rasteve mbaresën e prapashtesën. Këto përbëjnë shumicën e tipareve dalluese dialektore. Janë të rëndësishme, por jo në atë masë sa ato që prekin strukturën e formave gramatikore. Duke qenë të këtilla, gjuha letrare ka zgjedhur për]normë ato tipare që kanë përhapje më të madhe gjeografike, edhe sikur të mos kenë shtrirje të gjerë nëdialektin jugor. Të këtilla janë: forma me

mbaresën *-u* e emrave me *k, g, h* në trajtën e shquar (*miku, zogu, krahu*), forma pa mbaresë vetore e foljes *them* për vetën e parë njëjës (dialektore: *θemi, θomi*), *themi* për vetën e parë shumës e jo *θona*, për formatë pësores *vritem*, e jo *vritmi* a *vritna*, *vriteʃ* e jo *vrite*, *vriteni* e jo *vriti*, *vrituni* e jo *vriti*, *vritniu* e *vritnu* et. ruajtja e morfemës-temë në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar tek emrat e tipit *punëtor-punëtori*, *buall∼bualli*, trajta e shquar me *i* e jo me *ni* për emrat e tipit *ftua∼ftoi* etj., përjashtimi nga norma e formave të kallëzores së shquar me mbaresën-*në* për emrat mashkullorë që u mbaron tema me bashkëtingëllore (*detnə* etj.) dhe me mbaresën *-un* për emra të tipit *sy- syrin, kushëri kushëririn* etj. Nuk po i sjellim këtu të gjitha rastet e normës letrare që kanë lidhje me tipare dalluese morfologjike të këtij grupi. Në një rast, në variantet dialektore të pjesores (*me mbaresë∼ pa mbaresë*), me qënë se izomorfa kalon në kufirin e dy dialekteve, gjuha letrare ka marrë për normë variantin me mbaresë, që është tipar i dialektit jugor (*hapur, larë*, dhe *vjelë, dhënë*).

Dallimet morfologjike që lidhen vetëm me dendurinë e përdorimit të ndajshtesave në grupe të caktuara fjalësh, siç e kemi thënë më përpara (§4.4.1.), nuk e prekin strukturën gramatikore të të folmeve as në inventar as në forma e ndajshtesa, sepse, p.sh. disa të folme në Jug kanë një]formë me mbaresën *-jta* etj. Këto të folme kanë më shumë raste me këtë mbaresë, veç foljes *mbajta*, që e kanë të gjitha të folmet. Në raste të këtilla gjuha letrare ka pranuar si normë atë variant që ka përhapje më të madhe gjeografike, p.sh. *lava, shava* etj., e jo *lajta* etj., *djep, tul, llokum* etj. e jo *djepe, tule, łokume* etj., *furrë* etj., jo *fuī, nipa* etj., jo *nipər* etj., *ha∼ ha∼ ha* etj., jo *haj∼han∼han* etj. *vjelë, dhënë* etj., jo *vjelur, δənur* etj. Megjithëse sot forma e shumësit me *-a* për disa emra mashkullorë i kalon kufijtë e gegërishtes, gjuha letrare ka ngritur në normë formën me *ë* (*doktorë, oficierë, komunistë* etj.), që më parë kanë qenë tipar i toskërishtes.

Duke qenë se dallime dialektore të këtilla nuk janë të mirëfillta strukturore, por lidhen vetëm me shpërndarjen e varianteve dialektore në grupe e klasa të caktuara fjalësh, kalojnë herë-herë deri edhe në normën e shkruar të gjuhës letrare, kur nuk vihen re nga redaktorët Edhe më pak se këto e kanë prekur strukturën dallimet dialektore që lidhen me variantet fonetike të ndryshme gramatikore. Me përjashtim të mbaresave të shumësit të emrave mashkullorë *-nj* (*thonj*), *-inj* (*kushërinj*), *-enj* (*lumenj*), që janë tipare për të gjitha të folmet e toskërishtes (gegërishtja i ka me *-j, -ij, -ej*), nga variantet fonetike të rasteve të tjera janë ngritur në rrafshin e normës letrare ato që kanë shtrirje më të madhe gjeografike, ashtu si në rastin e dallimeve të dendurisë së përdorimit të formave e ndajshtesave gramatikore, kështu p.sh. *unë* e jo *u, ai* e jo *ay, kjo* e jo *co, ma dha* e jo *m e ɔa, laj, punoj* e jo *lap*

punoɲ, veshëm e jo *veʃməʃ, do të laj* e jo *do laj, to laj* etj., *duke* e jo *dyke, tuke, tue* etj.

Prej secilit grup të dallimeve dialektore morfologjike kanë mbetur si dialektizma ato tipare dialektore që nuk kanë mundësi të ngrihen në rrafshin e normës letrare, ashtu si kanë mbetur si të këtilla edhe shumë tipare dialektore fonetike, sintaksore dhe leksikore.

Këto dialektizma, sipas llojit të tyre, i nënshtrohen një]procesi të caktuar në marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare, një pjesë e tyre treten në dialekte, duke u zëvendësuar dalëngadalë prej tipareve të përbashkëta letrare, një pjesë tjetër hyn në gjuhën letrare, bëhet pjesë përbërëse e saj për ta pasuruar, për ta pastruar dhe për ta zhvilluar më tej atë, sepse dialektet gjithmonë mbeten një burim i rëndësishëm për gjuhën letrare.

TIPARE DALLUESE DIALEKTORE QË TËRHIQEN NGA DIALEKTET NËN VEPRIMIN E GJUHËS LETRARE.

5.2.1. Procesi i tërheqjes së dialekteve nën ndikimin e gjuhës letrare është i pashmangshëm. Ky proces bëhet kryesisht me rrugën e zëvendësimit të veçorive dialektore me tiparet e përbashkëta të gjuhës letrare. Sigurisht, tërheqja e veçoricve dalluese dialektore kërkon një kohë të gjatë dhe bëhet në masë e shkallë të ndryshme në shtresa shoqërore të ndryshme. Veç kësaj edhe tiparet dialektore nuk]kanë të njëjtën masë qëndrueshmërie ndaj veprimit të gjuhës letrare, kjo është e lidhur me llojin e tyre sipas sferave të gjuhës dhe sipas natyrës specifike të veçorive të një sfere.

Ne po përpiqemi të bëjmë këtu një shkallëzim të shtresave të çdo sfere të gjuhës sipas masës së qëndrueshmërisë së tyre ndaj gjuhës letrare. Këtë po e bëjmë për një orientim të përgjithshëm duke]dhënë disa shembuj nga të folme të ndryshme.

Në sferën e fonetikës tronditjen e parë e pësojnë ato veçori dialektore që lidhen me inventarin e sistemin e fonemave dhe me përbërjen fonematike të së njëjtës fjalë. Dallime të këtilla vërehen në]të folme ku mungojnë disa fonema të gjuhës letrare, si në të folmet e gjithë dialektit verior, ku mungon *ë*-ja e theksuar (*bëj* : *bãj* etj.), grupet *mb, nd, ng* (*mbaj* : *maj, ndal*: *nal, ngul* : *ŋul* etj.), në të folme veriore të gegërishtes ku mungoinë fonemat *c* e *ɟ* e në vend të tyre ka *tʃ* e *dʒ* osejanë zëvendësuar nga afrikatet mesgjuhore *t̠c*, dhe *d̠z*, (*qafë*: *tʃa:f* ose *t̠c,a:f, gjak*: *dʒak* ose *d̠z,ak*), në të folme ku mungon fonema *y* (*tym*: *tim*) etj. Dallime]të këtilla ka edhe në të folmet ku përbërja fonetike e një fjale është e ndryshme nga ajo e gjuhës letrare, p.sh. atje ku në vend të *q*-së ka *kl, kj* ose *k* (*qiməsht*: *kliməʃt, kjumʃt, kumʃt*), *n*

në vend të *r*-së (*vera* : *vena*), *ei̯*, *ai̯* për *i* (mik: *mei̯k* ose *mai̯k*) etj. Ndër këto veçori dialektore më me vështirësi tërhiqen ato që lidhen me timbrin ose ngjyrimin (nuancën) e fonemës, p.sh. fonemat zano. hundore në gegërishte etj.

Më vonë dhe më me vështirësi se këto që përmendëm tronditen ato fonema të të folmeve që ekzistojnë edhe në gjuhën letrare, por që nëpër të folmet kanë edhe variante të ndryshme të kushtëzuara prej pozitës fonetike në fjalë ose prej faktorëve të tjerë fonetikë, p.sh. æ-ja (*mjæft* «mjaft» etj.), që është karakteristike sidomos për të folmet e gegërishtes veriperëndimore, ʌ-ja (*kʌs* «kos», *katʌlik* «katolik», *ʌfitser* «oficier» etj.,), që është karakteristike për disa të foîme të anëve të Shkodrës, të Krujës e ndonjë tjetre etj. Këto veçori dialektore janë më të vështira për t'u mënjanuar në shqiptim, kurse në shkrim janë më të lehta, ndoshta mund të thuhet se për shkrimin e tyre sipas gjuhës letrare shumë herë ato nuk përbëjnë problem.

Afërsisht të një natyre me këto të grupit të dytë janë edhe rastet ku veçoritë dialektore janë shkaktuar prej veprimit të fenomeneve fonetike, si asimilimi, disimilimi, zhdukja e tingujve etj. Këto janë të vështira për t'u mënjanuar edhe në shkrím.

Prej sferës së morfologjisë veçoritë dialektore që mund të largoheshin më shpejt e më lehtë do të ishin format gramatikore që dalin ti variante dialektore plotësisht në gjithë paradigmat e tyre, si të këtilla janë shumë forma të sistemit foljor, si p.sh. e pakryera *lajʃa* etj e shumicës së të folmeve të gegërishtes, *laɾam*, *laɾim* të Beratit e të Myzeqesë etj. për *laja* etj. të gjuhës letrare; forma foljore perifrastike *am ka punoj etj.* e të folmeve të gegërishtes verilindore për *po punoj* ose *am duke punuar* të gjuhës së përbashkët shqipe etj.

Pas këtyre mund të radhiteshin format analogjike, si p.sh. në sistemin foljor: *punovi* për *punoi* e të folmeve të anës së Korçës, *ka lojtur* për *ka luajtur* e të folmeve të po as. j zone, *ka vjelur*, *ka mɜɾ̄ur*, *ka dalur* etj. të labërishtes për *ka vjelë*, *ka marrë*, *ka dalë* etj. *lyeva* për *leva*, *muarən* për *morën* të shumë të folmeve të toskërishtes; në sistemin emëror: *miki*, *zogi*, *krahi* për *miku*, *zogu*, *krahu* të gegërishtes verilindore, *syu*, *vlau* për *syri*, *vëllai* të disa të folmeve të gegërishtes jugore, *δeri*, *ftuari* për *dheu*, *ftoi* të disa të folmeve të toskërishtes veriore, si në Myzeqe e në ndonjë tjetër; te përemrat, p.sh. format: *tem*, *teme* (*djalin tem*, *tʃupən teme*, *djemte tem*, *tʃupat teme*) për *tim*, *time*, *e mi*,*e mia* të të folmeve të Korçës, etj. Me këto mund të radhiten format që dalin si variante dialektore të veçuara brenda një paradigme, si p.sh. I*a(h)əʃ* për *lahej* e të folmeve të Skraparit, Beratit, Myzeqesë, Mallakastrës e ndonjë tjetër.

Në radhën e tretë do të renditeshin format që kanë një larmi në-

për të folme e herë-herë edhe në gjuhën letrare, si p.sh. format e shumësit të emrave mashkullorë etj.

Pas këtyre do të vinin rastet kur një formë përdoret me kuptimin e një forme tjetër, si p.sh. iʃa për *qeshë* e anasjelltas, *ju* (*θa*) për *u* (*tha*) *jau* (*δa*) për *ua* (*dha*), *mə* (*drekə*) për *në* (*drekë*) etj.

Në fund prej sferës së morfologjisë do të radhiteshin variantet dialektore të disa pasthirmave, si: *bre, mre, re, amoj* etj. dhe disa përemrave të pakufishëm e ndajfolje, të cilat lidhen edhe me sferën e leksikut.

Në sferën e sintaksës mund të mënjanohen më shpejt e më lehtë ato veçori që kanë të bëjnë me funksionin sintaktik të formave gramatikore, p.sh. përdorimi i formës së rasës vendore në të folmet që shtrihen midis Matit dhe Vjosës në vend të formës së kallzores së pashquar të gjuhës letrare (*ra nə gropət, hipi ne ʃelgut, ʃkon nəpər lumət* etj.), përdorimi i rrjedhores së shquar njëjës për rrjedhoren e pashquar njëjës në gegërishten veriperëndimore (*lãɳ kʃtẽjet, miʃ vitʃit* etj.), përdorimi i formave të kallëzores së përemrave vetorë për formën e rasës emërore në shumë të folme të toskërishtes) (*si*) *ty, (nga) mua* etj.), përdorimi i kallëzores në vend të rrjedhores me parafjalët *përtej, matan* etj. në shumë të folme të zonave malore të Jugut (*pərtej garδin, matan lumin* etj.), përdorimi i nyjës së përparme *e* me funksion predikativ në gegërishte dhe në të folmet e anës së Korçës (*e ka gojən e əmbəl* për *e ka gojën të ëmbël* etj.), përdorimi i paskajores në të folmet e gegërishtes etj. Më në fund duhen renditur ndërtimet e periudhave me fjali të varura bashkë me lidhëzat e me mjetet e tjera gramatikore dhe rendi i fjalëve në fjali

Në sferën e leksikut më shpejtje më me lehtësi mund të zëvendësohet ajo shtresë e leksikut dialektor që përbëhet nga fjalë të cilat janë karakteristike për të folmen dhe që nuk gjenden në gjuhën letrare të përbashkët as si sinonime të fjalëve gjegjëse, p.sh. në të folmen e Korçës *alisivə* «finjë», *bəras* «eci», *imonik* «shalqi», *ʒene* «përsëri», *ʒyrmə* «shpuita e këmbës», *ndetem* «lyhem, ʒyhem», *peronə* «gozhdë», *ʃcerə* «çengj», *vərtit* ««rrotulloj», në të folmen e Shkodrës: *bjeī* «humb» *kətərʃet* «dyzet», *ndje* «mëngjes», *ɾchi* «numëroj», *tret* «humb» etj. Më me vështirësi dhe më vonë mënjanohet përdorimi me kuptime të tjera i atyre fjalëve që janë të përbashkëta me gjuhën letrare dhe që kjo e fundit i përdor vetëm me kuptimin e tyre kryesor, p.sh. në të folmen e Beratit: *face* dhe *sy* për *fytyrë* në rastet si *lɑr facet*, lar *syt*, *ʃpejt* edhe për «*herët*» (*u ngrit ʃpejt sot nə merʒes*.) *fare* edhe për «*përgjithmonë*»(*ma δa kalemin pər fare, te traʃegoeni fare*! etj.). Në një radhë me këto mund të vihen edhe fjalët e prejardhura të formuara me prapashtesa që u japin atyre ngarkesa emocionale ose nuance të tjera kuptimore, p.sh. në të folmen e Korçës : *δemkə* «dhembje e vogël», *djalkə* «djalë», *syʃkə, dotʃkə, vetʃke*, «*vezë*», në të folmen e Beratit : *ɬafazank*

«llafazane», *łapazark* «grykëse, «që ha shumë», *ənəz* «hënë», *vetəz* «vetë» etj. Pas këtyre duhen radhitur përdorimet stilistikore dialektore të fjalëve, si p.sh. në të folmen e Beratit : *cəŋge fare!* «qenke pa mend, krejt budalla», *e nget me ʃkum* «driddhet nga frika», *nəne səmur* ose *nene* «njeri i fjetur», « i urtë jashtë masës», *api dzəlet!* «hapi sytë» etj.

5.2.2. Procesi i shtrirjes së gjuhës letrare në të gjitha territoret dhe në shtresat shoqërore të një vendi është i gjatë, sepse forca e transmetimit të gjuhës dialektore nga një brez në tjetrin është e madhe. Në shpejtimin e]ritmeve të këtij procesi ndikojnë në një masë të madhe faktorët shoqërorë. Veprimi i ndikimit të gjuhës letrare mbi dialektet nuk është i njëjtë në shtresa të ndryshme shoqërore të popullsisë së një vendi: ndryshe vepron ajo në brezin e ri e ndryshe në brezin e vjetër, ndryshe në njerëzit e arsimuar e ndryshe në ata pa arsim, ndryshe në ata që lëvizin e ndryshe në ata që nuk dalin prej krahinës, ndryshe në fshat ndryshe në qytet. Por, mbi të gjitha, për masën dhe ritmin e ndikimit të gjuhës letrare mbi dialektet ndikojnë faktorët jashtëgjuhësorë, kushtet ekonomiko-shoqërore, sistemi shoqëror i një vendi, sepse të gjitha ato që thamë më sipër për shtresat dhe kategoritë e ndryshme shoqërore të popullsisë varen në radhë të parë prej sistemit ekonomiko-shoqëror. Kështu në kombin kapitalist, për shkak të ligjeve të atij sistemi, nuk mund të zhvillohen barabar të gjitha zonat, në përgjithësi fshati mbetet shumë prapa qytetit, zonat larg qendrave ekonomike mbeten akoma më prapa etj. Në kushte të këtilla nuk ka si të veprojë kudo dhe me ritme të shpejta gjuha letrare mbi dialektet. Ndryshe nga kapitalizmi, në socializëm bëhet një zhvillim proporcional ekonomik i të gjitha rajoneve të vendit dhe ritmet e këtij zhvillimi janë të shpejta, ngrihet mirëqenia ekonomike e kulturore]e popullit si në qytet, ashtu edhe në fshat, merr një përhapje shumë të madhe arsimi dhe kultura e masat punonjëse bëjnë një jetë shoqërore e politike të gjallë dhe aktive. Ne vetë jemi dëshmimtarë të një procesi të këtillë që po ndodh në Shqipërinë tonë socialiste, ku edhe brenda një çerek shekulli dialektet kanë pësuar ndryshime të dukshme, sidomos në brezin e ri dhe në shtresa të tjera të shoqërisë që bëjnë një jetë shoqërore e politike të gjallë duke përfshirë edhe fshatin ku është duke u bërë gjithmonë e më tepër ngushtimi i dallimit të tij me qytetin.

Në kushtet e tanishme, kur është formuar dhe është ngulitur mirë gjuha letrare e njësuar si gjuhë zyrtare dhe me «prestigj» në të gjithë jetën e kombit, ajo shtrihet kudo dhe shton përherë e më tepër dendurinë duke u zotëruar dhe duke u përdorur nga më shumë individë dhe grupe shoqërore të bashkësisë kombëtare. Një vend tjetër zënë tani dialektet në gjuhën e përbashkët të kombit. Në fazën e sotme dialektet ende kanë shtrirjen që kanë pasur nga pikëpamja territoriale e përdoren në jetën e përditshme brenda zonave ku shtrihen, por tani

nuk janë si dikur me kufij të mbyllur për shkak të kontakteve midis banorëve të krahinave të ndryshme dhe për shkak të ndikimit që ushtron mbi to gjuha letrare. Denduria e përdorimit të dialekteve vjen duke u pakësuar, tërhiqen ato nga individë dhe grupe dhoqërore që zotërojnë gjuhën letrare, përdoren vetëm në familje e në rrethana të tjera të caktuara nga disa që e zotërojnë gjuhën letrare, por që njëkohësisht përdorin në rrethana të këtilla edhe dialektin. Duhet thënë gjithashtu se dialekti edhe te grupet ku ruhet mirë nuk është i mbyllur, sepse hyjnë aty elemente a pjesë të sistemit të gjuhës letrare, e cila përditë ushtron ndikimin e vet me anë të shtypit, të librit, të radios e televizionit nëpërmjet veprimtarisë së gjallë politike etj.

Rruga e përgjithshme që ndjekin dialektet pas formimit dhe ngulitjes së gjuhës letrare të njësuar është ajo e tërheqjes pothuaj në një kohë në të gjithë truallin e shqipes. Ky proces zhvillohet kryesisht duke u zëvendësuar dialekti me gjuhën letrare, ai po kryhet e do të kryhet dalëngadalë në shtresa të ndryshme të shoqërisë, në radhë të parë në brezat më të rinj për shkak të faktorëve jashtëgjuhësorë. Sigurisht ky proces nuk është i thjeshtë dhe nuk përfundon në një kohë të shkurtër. Nga dialekti tërhiqen ato elemente që janë tipare dalluese të tij, d.m.th. ato elemente që nuk përputhen me normën e gjuhës letrare. Të këtilla elemente, ku më shumë e ku më pak, kanë të folmet e të dy dialekteve të gjuhës shqipe. Në këtë mënyrë dialektet ndjekin rrugën e konvergimit të tyre me gjuhën letrare. Kjo është rruga e vetme nëpër të cilën kalojnë dialektet, sepse me formimin dhe ngulitjen e gjuhës së njësuar letrare, funksioni i tyre vjen duke u kufizuar nga pikëpamja gjeografike e shoqërore, ato tani i nënshtrohen gjuhës letrare, e cila për funksionet dhe normën e saj të njësuar qëndron në një shkallë më të lartë se dialektet.

TIPARET DALLUESE DIALEKTORE QË HYJNË NË GJUHËN LETRARE PËR PASURIMIN, PASTRIMIN DHE ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË SAJ

5.3.1. Megjithëse prirja e dialekteve është që të tërhiqen, kjo nuk do të thotë se lidhjet dhe marrëdhëniet e tyre me gjuhën letrare janë të njëanshme, d.m.th. të atilla që veprimi shkon vetëm nga gjuha letrare mbi dialektet. Në të vërtetë marrëdhëniet janë të dyanshme, sepse edhe dialektet veprojnë mbi gjuhën letrare duke i dhënë asaj ato elemente për të cilat ajo ka nevojë të pasurohet e të përsoset më tej. Nga kjo anë dialektet edhe sot janë burim shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës letrare. Ky proces është objektiv,

sepse gjuha letrare e njësuar nuk është diçka statike, sistemi i saj në tërësi nuk është i mbyllur dhe i palëvizshëm, përkundrazi, ajo si kategori historike në dukurinë e gjuhës, lind brenda gjuhës së përbashkët kombëtare, formohet, pasurohet dhe është gjithmonë në zhvillim.

Procesi i pasurimit dhe i zhvillimit të mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe në fazën e tanishme kryhet pjesërisht në mënyrë të vetvetishme, për shkak të zhvillimit të brendshëm të vetë gjuhës, i cili është një proces i vazhdueshëm, pjesërisht kryhet edhe në mënyrë të ndërgjegjshme, duke vepruar shoqëria në përputhje me domosdoshmërinë e pasurimit dhe të zhvillimit të vetë gjuhës. Ky proces, që sot ka një peshë më të madhe se procesi i zhvillimit të brendshëm, kryhet me «ndërhyrje» nga jashtë, duke vepruar me veprimtarinë e tyre shkrimtarët, gjuhëtarët, specialistët e lartë e të mesëm të të gjitha fushave dhe masat e gjera punonjëse në përgjithësi.

5.3.2. Gjuha letrare funksionon në formën e shkruar dhe në formën e folur. Midis këtyre dy varianteve ka edhe dallime. Këto dallime vijnë, së pari, nga se gjuha e shkruar ka një sistem më të ndërlikuar, ajo ka më shumë nënsisteme e mjete gjuhësore të stileve të ndryshme që funksionojnë në sferën shkencore-teknike, në sferën shtetëroreadministrative, letrare-artistike, politike-shoqërore etj., kurse gjuha e folur ka një sistem më të thjeshtë për shkak të numrit të kufizuar të stileve të saj. Së dyti, dallimi midis tyre vjen edhe ngase në kodifikimin e normës së gjjuhës së shkruar, me parimin fonetik, që është parimi themelor i gjuhës sonë letrare, ndërthuren edhe parimi gramatikor, i cili kërkon të ruhet në shkrim njësia e përbërjes tingullore të fjalëve e të morfemave, dhe parimi historik me parimin tradicional, që e largojnë normën e gjuhës së shkruar nga norma e shqiptimit të sotëm.

Nga të dy format e gjuhës letrare më e zbuluar dhe më e ndjeshme ndaj trysnisë së përditshme të dialekteve është forma e folur, sidomos ligjërimi bisedor. Ndryshe nga sferat e fonetikës dhe të morfologjisë, që kanë inventar dhe sistem të përcaktuar e të fiksuar, sferat e leksikut dhe të sintaksës mbeten gjithmonë më të hapura ndaj veprimit të dialekteve edhe në formën e shkruar, sepse këto dy sfera kanë më shumë shtresëzime stilistikore, që kanë nevojë për variante funksionale, kanë ndërtime dhe fjalë sinonime, që duhen pasuruar kohë pas kohe, dhe janë, pothuaj, të vetmet sfera të gjuhës të ngarkuara me ndërtime e fjalë të huaja, të cilat duhen pastruar e zëvendësuar me elemente vendëse. Këto dy sfera pranojnë vetëm ndryshime për pasurimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre dhe jo çdo lloj ndryshimi, sepse edhe aty norma letrare është e fiksuar. Kështu gjuha letrare nuk do të pranonte të hynin nga dialektet pa funksione të veçanta fjalë të këtilla, si *katërdhet, nadje, esh, tëlyn, rënkoj* «ngushëlloj», *çimi* «kanë ujë». *kokosh* etj. Ajo ka pranuar variante dialektore me funksio-

ne stilistike ose si sinonime: *goçë, vashë* krahas *vajzë, lirishtë* krahas *rogë, epem* krahas *përkulem* etj. Ajo ka marrë gjithashtu nga dialektet për të zëvendësuar fjalë të huaja, fjalë të këtilla si *brezare* për *taracë, emnak* për *adcsh, eptim* për *fleksion, trysni* për *presion* etj. Dialektet janë një burim shumë i rëndësishëm sidomos për zhvillimin e terminologjisë tekniko-hkencore. Gjuha letrare pasurohet shumë në sferën e leksikut, sidcmos me fjalë dialektore që]janë karakteristike për një a disa të folme të veçanta e që nuk gjenden e nuk kanë variante gjegjëse në të folme të tjera, si. p.sh. *araqe* (Përmet) «mënyra e të lidhurit lirshëm të një nyjeje peri a litari», *balltavec* (Myzeqe) «njeri i rëndë dhe i plogësht», *balls* (Mat)» 1. pjesa e përparme e një sendi; 2. kockat e kraharorit të pulës», *beronjë* (Shpat) «grua belhollë, e gjatë, e hijshme dhe e zhdërvjellët», *bitme-bitmja* (Shpat) «rasat duhani ose dcmateje», *bozës* (Divjakë) «grumbull rëre që mblidhet në bregdet nga erërat», brazimë (Opar) «shtresë e hollë bore», *kallzi-a* (Labëri) «të kallzuarit, spiunim», *kiti* (i borës) (Shkrel) «bora e ngrirë në pemë», *pramë* (i, e) (Shkrel) «i infektuar», *prajs-i* (Shkrel) «gur ku ulen për t'u çlodhur», *she-u* (Veri) «përrua me burim të vogël», *rigë* (Kosovë) «vesë e hollë shiu», *tezak-u* (Kosovë) «djali i tezes», *takie* (Myzeqe) «kapuç prej pëlhure të bardhë,» *ullashtër* (Berat, Mallakastër) «ulli i egër», *xhubletë* (M. e Madhe) «veshje karakteristike për gra në atë krahinë», e shumë të tjera. Fjalë të këtilla lidhen me veçantinë e terrenit të krahinës, me bimësinë, me kulturën, me prodhimin e me veçanti të tjera të saj, prandaj nuk janë fjalë dialektore të mirëfillta e kështu kcnsiderohen pasuri e përbashkët e gjithë gjuhës dhe merren të gjitha nga gjuha letrare për të mbuluar funksionet e dryshme në sferën e leksikut.

Sferat e fcnetikës e të morfolcgjisë, për arsyet që përmendëm, i ndiejnë shumë pak dhe shumë ngadalë ndryshimet që vijnë nga veprimi i dialekteve. Përgjithësisht, dukuritë dialektore që janë ose që arrijnë të bëhen më të përbashkëta pas një kohe, në fillim gjejnë përdorim të gjerë në variantin e folur të gjuhës letrare dhe pastaj murd të zënë]vend edhe në formën e shkruar, duke pësuar kështu norma ndryshime të mëtejshme në mënyrë të pjesshme ose duke u ndërruar krejt.]

Në sferën e fonetikës rrugën e kanë të hapur pothuaj vetëm ato tipare dialektore që nuk e prekin sistemin dhe inventarin e fonemave, sidcmos në radhë të parë ato që lidhen me dendurinë e përdorimit të një foneme në të folme të ndryshme. Me këtë shpjegohet trysnia që ushtrojnë sot dialektet edhe mbi formën e shkruar për të mos u përdorur zanorja *ë* e patheksuar në rastet ku gjendet në fund të temës jalëformuese, p.sh. *puntor*, për *punëtor*, *antar* për *anëtar* etj. dhe në fund të disa emrave mashkullorë, që dikur kanë qenë asnjanës, ku sot *ë*-ja nuk përligjet nga pikëpamje gramatikore, p.sh. *brumë*, *djathë*,

mjaltë, dyllë, grurë, gjumë, lumë, kalë. Trysnia e një dukurie të këtillë arriti të zërë vend në normën shkrimore te varianti përfundimtar i «Rregullv²e të drejtshkrimit» të botuar pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në fjalët, si *arsye, kopsht* etj. ku *ë*-ja ishte brenda temës dhe në fjalët: *amtar, vetvete, gjithkund*; *kurrsesi* etj. ku *ë*-ja ishte në fund të temës fjalëformuese.

Trysnia e dialekteve për arsye të ndryshme ndihet sot në një farë mase në sferën e morfologjisë, sigurisht më tepër në formën e folur të gjuhës letrare. Në radhë të parë vepruese janë format gramatikore me shtrirje të madhe dialektore që nuk e prekin ndërtimin dhe inventarin e kategorive e të formave gramatikore të dialekteve e të gjuhës letrare. Të këtilla janë disa tipare dalluese dialektore morfologjike që lidhen me anën fonetike të formave gramatikore, si *do laj,* formë e thjeshtuar fonetikisht (pa pjesëzën të) për *do të laj*; *ullij, përrej* etj. forma të shumësit me mbaresën *-j* për *ullinj, përrenj* me mbaresën *-nj* që janë sot të normës letrare etj. dhe disa variante që lidhen me dallimet e dialekteve në dendurinë e përdorimit të ndajshtesave, si shumësi më *-a* i disa emrave (*doktora* për *doktorë, traktorista* për *traktorist, mësuesa,* për *mësues* etj.), format: *djepe, tule, llokume, basme* për *djep, tul, llokum, basmë,* format foljore *ngrejmë, pijmë* (sipas tipit *lajmë*) për *ngremë, pimë* ose *shkruajtur, shkruajta* (sipas tipit *mbajtur*) për *shkruar, shkrova* etj. Rastet si këto të grupit të dytë arrijnë të hyjnë si shmangie deri edhe në formën e shkruar pa bërë ndonjë përshtypje të madhe te përdoruesit e gjuhës letrare, sepse në një klasë gramatikore fjalësh të gjuhës letrare ekzistojnë të dyja variantet. Trysnia e dialekteve në raste shumë të pakëta shihet edhe në tipare që lidhen me inventarin e strukturave dhe të formave morfologjike, d.m.th. edhe në raste kur dallimet e dialekteve janë të karakterit strukturor, pra shumë të rëndësishme. Kjo ndodh kur gjuhës letrare i mungojnë forma gramatikore që kryejnë funksione kuptimore të caktuara, si forma foljore e mbipërbërë e së shkuarës (*kam pasë shkruar, kisha pasë shkruar),* të cilën e mori nga dialekti verior dhe nga disa të folme skajore të toskërishtes (labërishtja). Këto forma sot kanë zënë vend në sistemin foljor të gjuhës letrare dhe janë kodifikuar në «Gramatikën» e Akademisë (1976) për kuptime që nuk i mbulojnë dot format më të thjeshta të së kryerës (*kam shkruar* etj.). Trysni të madhe ushtrojnë dialektet edhe në ndonjë strukturë ose formë gramatikore të gjuhës letrare që sot është rudhur shumë në hapësirën e të dy dialekteve të shqipes, siç janë p.sh. formë e përemrave pronorë *sime, sate, sonë, suaj* përballë formave dialektore gjegjëse: *time, tënde, tonë, tuaj.* Format letrare të këtyre përemrave sot përdoren më shumë në formën e shkruar të gjuhës letrare dhe janë duke u ndierë më tepër si forma arkaike. Pak a shumë si e këtillë ndihet sot edhe struktura e tipit *imë bijë, im vëlla* etj. përballë strukturës *bija ime, vëllai im* etj., e cila përgjithësisht është pothuaj e vetmja

strukturë e përdorur nga brezi ri, kurse struktura me mbiemrin pronor para emrit (*ime bijë*) është kufizuar në brezin e moshuar, sidomos te gratë. Në variantin e folur të gjuhës letrare sot janë duke u përdorur më shumë ato forma që kanë shtrirje më të madhe në dialekte. Ndoshta në të ardhmen trysnia e dialekteve do të bëjë që ato të gjejnë pasqyrim si të kodifikuara edhe në formën e shkruar të gjuhës letrare.

Nuk po sjellim këtu shembuj për raste të tjera që ekzistojnë në gjuhën tonë dhe për raste që mund të lindin më vonë. Siç u tha, shumica e këtyre ndryshimeve janë të lidhura me zhvillimin e brendshëm të të gjuhës. Një zhvillim i këtillë që kryhet në mënyrë të vetvetishme është i ngadalshëm dhe vetëm kohë më kohë sjell ndryshime të pakta e jo shumë të ndieshme në tërësinë e sistemit të gjuhës. Kjo shpjegohet me faktin se ndryshimet që lidhen me procese të këtilla ndodhin më së shumti në sferën e fonetikës e të morfolofgjisë ku sistemi i gjuhës letrare është më i përcaktuar dhe më i kristalizuar. Në këto dy sfera inventari i sistemit është përcaktuar dhe është kodifikuar pothuaj tërësisht. Aty kanë zënë vend më mirë jo vetëm elementet e përbashkëta të gjuhës shqipe, por edhe ato elemente të normës që janë sot në të njëjtën kohë edhe tipare dalluese të dialekteve, qofshin ato të dialektit jugor, qofshin të dialektit verior. Veç kësaj, sferat e fonetikës dhe të morfologjisë janë më asnjanëse nga pikëpamja e funksionimit, me përjashtime të pakta, ato nuk kanë aq shtresëzime stilistikore si kanë sfera e leksikut dhe sfera e sintaksës. Mungesa e shtresëzimit stilistikor bën që sferat e fonetikës dhe të morfologjisë të mos e ndiejnë sa leksiku e sintaksa nevojën e pasurimit të tyre. Gjithashtu këto dy sfera janë pothuaj të pangarkuara me ndikime e huazime nga gjuhët e tjera, prandaj nuk kërkohen edhe ndryshime për pastrimin e tyre.

Në fazën e tanishme të zhvillimit të gjuhës sonë letrare sferat leksikut e të sintaksës janë më tepër në lëvizje dhe pësojnë më shumë dryshime sesa sistemi fonetik dhe sistemi morfologjik. Për arsy të ndryshme kjo është më e theksuar sidomos për sistemin leksikor. Veç zhvillimit të brendshëm e të vetvetishën, në këto dy sfera, siç e kemi thënë, kryhen në përgjithësi ndryshime, dhe për pasurimin e kristalizimin e mëtejshëm të shtresave stilistikore të tyre. Një pjesë e ndryshimeve, sidomos në leksik, janë të lidhura edhe me domosdoshmërinë e pastrimit të inventarit të këtyre dy sferave nga elementet e huaja, të cilat zëvendësohen herë pas here me elemente vendëse. Për vetë vatyrën e tyre, ndryshime të këtilla zënë vend dhe nguliten më shpejt në normën e gjuhës letrare.

Për kristalizimin e mëtejshëm të sistemit leksikor dhe sistemit sintaksor gjuha letrare u drejtohet më shpesh dialekteve. Në këto dy sfera sot ndihet më shumë veprimi i dialekteve mbi gjuhën tonë letrare. Duke qenë se gjuha jonë letrare tashmë është formuar dhe është

ngulitur, në vështrimin e parë do të dukej sikur këtu ka një kontra-
ktë. Në të vërtetë nuk ka kontradiktë, sepse, së pari, në tërësinë e gj-
hës letrare të formuar sistemi dhe norma leksikore janë më të hap-
për arsyet që përmendëm dhe, së dyti, sidomos në sferën e leksik
janë shumë më të pakta dallimet e mirëfillta dialektore, fjalët që do
hynin nga dialektet nuk do t'i binin ndesh normës letrare në këtë sf
të gjuhës. Përtgjithësisht për këto shkaqe fjalë të këtilla janë pasur
gjithë gjuhës shqipe. Për ilustrim po japim vetëm disa nga këto fjal
*batak, bornajë, breshkan, brezore, brimoj, brof, emnak, golle, gj-
gjethnajë, krahisht, kreshkë, kopanis, kullë, tejtu* etj[368].

Në gjuhën letrare nuk hyjnë vetëm fjalë të këtilla, ajo ka qenë dhe
të jetë gjithmonë e hapur edhe për fjalët e mirëfillta dialektore sa
që do të jenë të nevojshme për pasurimin e përgjithshëm dhe për zh-
llimin e pasurimin e shtresave dhe varianteve të ndryshme të saj. Kë
shtu kanë hyrë e do të hyjnë fjalë për pasurimin e zhvillimin e sino-
meve të pjesshme e të plota, për zhvillimin e antonimeve e të zhvillim
semantik në përgjithësi, sigurisht me kritere të caktuara, p.sh. m
funksione sinonime kanë hyrë: *gocë, cucë,* krahas *vajzë. gopësi,* krah
grykësi, kaleshar krahas kalesh dhe *leshtor, belban* krahas *i be*
ka marrë ajo: *lirishtë* dhe *rogë, prashit* dhe *capoj, kukuvajkë* dhe *kuk-
mjaçkë, kresë* dhe *jastëk, përkulem* dhe *epem, gjel* dhe *këndes* e sh
të]tjera. Disa prej këtyre fjalëve që hyjnë prej dialekteve me kë
mund të marrin përparësi ndaj sinonimeve të tyre, sidomos kur kë
të fundit janë me burim të huaj, p.sh. *lirishtë* ndaj *rogë, capoj* ndaj
prashit etj. Shumë i rëndësishëm është burimi dialektor edhe për p
surimin e stileve të gjuhës letrare, sidomos për pasurimin e stilit le
traro-artistik, të stilit politioko-shoqëror, për ligjërimin bisedor etj
Nuk po ndalemi të flasim gjatë këtu për rolin shumë të madh që lu-
ajnë dialektet në pasurimin, pastrimin dhe zhvillimin në përgjithësi
të terminologjisë së fushave të ndryshme. Te dialektet e kanë burimin
shumë terma që janë formuar deri tashti, prej të cilëve po përmendim
kalimthi vetën disa: *bregore, bujtinë, butak, epim, i epshëm, grimcë,
trysni, vetullore* etj.

Dialektet gjithnjë do të jenë një burim i pashtershëm për gjuhën
letrare, e cila do të marrë atje fjalë për t'u dhënë kuptimet e një term
dhe do të marrë formante e shëmbëlltyra formimi fjalësh për të krijua
ar terma të]rinj.

Gjithë lënda që merr gjuha letrare nga dialektet i nënshtrohet
normës së saj, sidomos normës fonetike e gramatikore. Kjo lëndë
hyn dalëngadalë pa i rënë ndesh sistemit të gjuhës letrare, zë vend dhe
bëhet pjesë përbërëse e këtij sistemi. Ky proces ka një rëndësi të madhe

---

3 68. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe,* Tiranë 1980.

në zhvillimin e dialekteve të gjuhës sonë të përbashkët, sepse me këtë rrugë gjuha letrare, duke rritur nga pikëpamja sasiore shtresën e përbashkët të saj, pëson dhe ndryshime cilësore, afrohet më shumë me dialektet. Kjo rrugë së bashku me procesin e ndikimit të gjuhës letrare mbi dialektet të çon shkallë-shkallë në konvergimin e dialekteve me gjuhën letrare.

Gjuha është një dukuri që nuk rri në vend, ajo gjithmonë pasurohet e zhvillohet. Gjatë këtij procesi, sipas fazave të zhvillimit të gjuhës sonë të përbashkët, gjuha letrare dhe dialektet, deri sa të jetojnë, do të jenë në lidhje dhe në marrëshënie dialektike të caktuara.

*

* *

Gjuha letrare shqipe e njësuar është inventarizuar dhe kodifikuar sidomos në vepra të tilla normative që e përshkruajnë atë në gjendjen e sotme, si *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe* (1976) dhe *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980). Por inventarizimi dhe kodifikimi i gjuhës letrare nuk janë bë rë njëherë e përgjithmonë. Ata bëhen herë pas here për tri arsye: së pari vetë gjuha është në lëvizje e në zhvillim, pasurohet, lëmohet, pëson ndryshime; së dyti, inventarizimi dhe kodifikimi vijnë gjithmonë duke u plotësuar me njohjen gjithnjë e më të thellë e më të plotë të përbërjes së gjuhës letrare në të gjitha variantet e funksionimit të saj dhe, së fundi, megjithëse në një masë të vogël, ndryshime bëhen kur ndreqen herë pas here zgjidhjet subjektive të bëra sidomos gjatë inventarizimit dhe kodifikimit të parë të gjuhës letrare të njësuar.

Për t'i njohur më mirë dhe për t'i pasqyruar objektivisht këto ndryshime duhen bërë në mënyrë të vijueshme studime të theksuara për sistemin fonetik, gramatikor e leksikor të gjuhë letrare dhe të dialekteve. Kjo është një detyrë aktuale dhe perspektive e disiplinave të ndryshme të gjuhësisë sonë. Dialektologjia jonë në veçanti, tashti pasi ka përfunduar hetimin e përgjithshëm të dialekteve, ka për detyrë t'i vijojë më tej kërkimet e studimet mbi të folmet e shqipes, duke e thelluar gjithmonë e më tepër, si për të njohur në mënyrë më të plotë visarin gjuhësor të dialekteve dhe veçoritë e tyre, ashtu edhe për të ndjekur nga afër ndryshimet që pësojnë sot dialektet nën ndikimin e gjuhës letrare.

Pjesërisht këtë detyrë dialektologjia shqiptare do ta plotësojë me veprën e saj themelore, me «Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe», i cili është duke përfunduar së hartuari. «Atlasi» do të japë gjendjen e tanishme të dialekteve të parë nga ana strukturore e funksionale.

Veç tij, me lëndën e mbledhur deri tashti dhe me kërkimet e mëtej-

shme në fushën e leksikut të dialekteve, do të njihet pasuria e fjalëve dialektore dhe do të botohet ajo kohë pas kohe në mënyra të ndryshme duke filluar nga artikuj me fjalë dialektore e fjalës të të folmeve të reçanta, ashtu si është bërë deri tani, e duke vijuar me fjalorë krahinorë e dialektorë të një treve të ngushtë ose të trevave më të gjera të dialekteve të shqipes.

Tashti që po përvijohet më mirë lëvizja e dialekteve me ndryshimet që pësojnë në shtresa e grupe të ndryshme shoqërore dhe në hapësirë nën ndikimin e gjuhës letrare, është e domosdoshme të vazhdojnë duke u shtuar e duke u përqendruar kërkimet e studimet e dialekteve me përshkrimin sa më të plotë të sistemit fonetik e të sistemit gramatikor të disa të folmeve përfaqësuese të qendrave fshatare e qytetare. Këto kërkime e studime dialektologjike duhet të synojnë tashti të bëhen me një medodikë e me kërkesa të përcaktuara për të parë gjendjen dhe prirjen e ndryshimeve të dialektit si dhe kufirin deri ku mbahet dialekti e ku fillon gjuha letrare në grupe të moshave dhe të shtresave shoqërore të ndryshme.

Studime të këtilla do të ndihmojnë për të njohur rrugën që ndjekin sot dialektet drejt afrimit me gjuhën letrare, çka ka rëndësi jo vetëm për historinë e gjuhës shqipe, por edhe për përcaktimin e rrugëve që ndjek sot shoqëria jonë për ngulitjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës sonë letare të njësuar

RÉSUMÉ

RECHERCHES ET ETUDES SUR LES DIALECTES DE L'ALBANAIS (§1.1.1-§1.1.3)

Comme l'ensemble de la linguistique albanaise, mais de façon particulière, la dialectologie en tant que branche fut créée et formée durant l'époque du Parti du Travail, dans les années d'après la Libération. A partir du début des années 50 la dialectologie albanaise fut portée graduellement au niveau d'une science comptant des réalisations nombreuses et importantes dans le recueil d'un riche matériel dialectal concernant les parlers de la langue albanaise, notamment ceux existant sur le territoire de la RPS d'Albanie, dans la connaissance des traits distinctifs et communs des parlers par de nombreuses études descriptives de ceux-ci, dans la connaissance plus complète, exacte et approfondie de la ramification dialectale de l'albanais, autrement dit, des dialectes et des groupes de parlers en tant que systèmes dialectaux de divers degrés avec leurs rapports, leurs dépendances et leur extension géographique, dans la connaissance de l'histoire du développement de certains phénomènes dialectaux et de la structure des dialectes en général, ainsi que des rapports actuels des dialectes avec l'albanais littéraire unifié.

Grâce à des recherches systématiques et programmées effectuées durant cette étape, la dialectologie albanaise réussit à créer dès le début une base matérielle importante, comptant un fichier et une phonothèque dialectale à la portée des divers chercheurs. Les études sur les parlers et les dialectes de l'albanais, telles que des essais dialectologiques, des monographies, des articles, etc., au cours de cette période non seulement s'accrurent en nombre de manière incomparable avec l'étape antérieure, mais aussi furent d'un niveau qualitatif beaucoup plus élevé. Les essais et les monographies dialectologiques qui virent le jour, décrivaient les parlers de l'albanais en présentant non seulement des phénomènes dialectaux partiels et détachés de diverses sphères de la langue selon des observations occasionnelles,

mais aussi les particularités des parlers pour toutes les sphères de la langue et selon des observations programmées par des enquêtes plus ou moins uniques sur les lieux. Des essais décrivant les différences, qui ne présentaient que les traits distinctifs des parlers, on en vint aux monographies d'ensemble, qui décrivent intégralement le parler dans son système phonétique ou phonétique et morphologique. Des études de synthèse, fondées et traitées théoriquement, furent effectuées sur des phénomènes dialectaux particuliers, sur les groupes de parlers, ainsi que sur tout l'ensemble des parlers de l'albanais. L'étude des parlers par l'intermédiare de la description monographique, en présentant les particularités du parler d'un site ou d'une région, a été déjà faite et actuellement on procède à leur étude par la méthode de la géographie linguistique et le travail se poursuit à l'élaboration de «L'Atlas dialectologique de la langue albanaise». Le niveau des études dialectologiques s'est élevé de plus en plus même au point de vue de la méthode. Ces dix dernières années on est passé à l'étude de parlers particuliers et des dialectes en général par la méthode de la linguistique structurelle et fonctionnelle, en considérant les phénomènes dialectaux entièrement en système, surtout dans le domaine de la phonétique, sous l'aspect phonologique, et en classifiant les traits dialectaux des diverses sphères selon la fonction qu'ils remplissent à l'intérieur du système de la langue.

Les recherches et études sur les dialectes de la langue albanaise, qui furent entamées après la Libération, ne partirent pas de zéro. En commençant par l'oeuvre de J.G. v. Hahn «Albanesische Studien» II, paru en 1854, jusqu'à la veille de la libération furent publiés de temps à autre des grammaires de la langue albanaise, des dictionnaires et des textes folkloriques émaillés de données sur les divers dialectes et parlers, de notes et de relations concernant des remarques sur les dialectes. Rarement furent effectuées aussi des recherches et études dialectologiques proprement dites, mais sur un nombre très limité de parlers et, d'autant plus, sur des parlers marginaux et de la diaspora albanaise, telles que celles de Gj. Pekmezi, M. Lambertz, G. Weigand, C. Tagliavini, A. Phurikis et V. Cimochowski. A cette période, vers le début des années 40, l'idée fut avancée et le projet dressé en vue d'élaborer un atlas de la langue albanaise, mais il n'en fut réalisé par E. Çabej, que le questionnaire en 1943, avec environ 1600 questions surtout lexicales. Cette entreprise s'arrêta aux débuts du travail, les enquêtes sur le terrain ne se firent même pas.

Dans leur majorité, les données sur les dialectes de l'albanais jusqu'à la veille de la libération proviennent des publications de chercheurs étrangers. Les peu d'études de ces savants et de ceux albanais sur les dialectes de l'albanais durant cette étape furent faites de manière séparée, souvent dictées par l'occasion et plutôt dans le but de tirer des données servant la linguistique historique et comparée. Les données des grammaires publiées pendant la seconde moitié du siècle dernier, et au début de ce siècle reflétaient l'état de certains parlers, plutôt méridionaux, à cette époque, alors que les données de recherches et les études dialectologiques authentiques étaient partielles, par beaucoup de phénomènes elles étaient incomparables et sur un petit nombre de parlers choisis par ci par là à des points marginaux

et dans la diaspora. Vu l'état défectueux des connaissances sur les parlers de l'albanais, après la libération, le besoin se fit sentir de procéder à des recherches dans tous les parlers de la langue albanaise pour connaître intégralement et partout les traits distinctifs des parlers avec les limites de leur extension et la ramification dialectale de l'albanais. Cela devenait désormais possible grâce à la création des conditions requises par le Parti du Travail d'Albanie et le nouvel Etat socialiste, en vue de faire développer les sciences.

LA RAMIFICATION DIALECTALE DE LA LANGUE ALBANAISE ET SON HISTOIRE (§ 2.1.1.—§2.4.5.)

Comme dans toute langue, en albanais aussi les distinctions dialectales ont existé depuis les temps anciens, mais elles ont subi de temps des changements qui n'ont pas rejoint nos jours, ayant fusionné durant les âges sans laisser de traces. Les traits distinctifs les plus anciens séparent les deux dialectes de l'albanais. Ils ont une pleine extension sur l'aire de chacun des dialectes. Plusieurs traits anciens sont actuellement le domaine d'un groupe de parlers d'une extension territoriale circonscrite, mais ces sont en très petit nombre. Les traits distinctifs les plus récents, surgis dans ces deux ou trois, ou même durant ces quatre derniers siècles, ont une extension géographique différente. Quelques-uns de ces traits ont même connu de l'extension pour devenir les traits d'un dialecte, s'ajoutant ainsi aux traits distinctifs plus anciens, sans toutefois connaître une extension totale dans le domaine même de leur dialecte; d'autres ont connu de l'extension pour devenir aussi les traits de quelques parlers d'un autre dialecte (p.ex. l'opposition des voyelles longues à celles brèves en guègue et en tosque méridional, comme conservation et évolution après la perte des voyelles longues dans le tosque méridional, etc.). Quelques-uns de ces traits, relativement récents, distinguent actuellement les sous-dialectes à l'intérieur de chacun des dialeces, d'autres ont isolé des groupes de parlers.

Les changements dialectaux intervenus en albanais ont abouti à la distinction de plusieurs parlers q'u on peut grouper, sur la base des traits distinctifs et des traits communs, en unités de différents niveaux. Les deux grands systèmes de la langue dialectale albanaise ont comme ligne approximative de démarcation le cours du Shkumbin. Le dialecte du Nord, ou guègue, s'étend à droite de ce fleuve et le dialecte du Sud, ou tosque, à sa gauche. A l'intérieur de chacun de ces dialectes on distingue deux sousdialectes: le guègue septentrional et le guègue méridional, que se séparent approximativement par le cours du Mati; le tosque septentrional et le tosque méridional, qui ont comme limite géographique le cours de la Viose (sur le cours inférieur de la Viosa, le tosque septentrional franchit le fleuve et comprend aussi la zone de Selenica, les villages de Topalltia de Vlora et, dans la ville même de Vlora, la couche plus ancienne de la population).

Si l'on poursuit plus loin la division dialectale, on distingue comme groupes plus grandes de parlers le guègue du Nord-Ouest et le guègue du Nord-Est dans le sous-dialecte septentrional du guègue. Le groupe du Nord-Ouest commence à la rivière de Shala, pour s'étendre au Dukagjin, à la Malessia e Madhe, Shkodra et son disctrict: Bregbune, Zadrima, Lezha, et, au-delà des frontières politiques actuelles, à Kraja, Ulqini et Tuzi. Le groupe du Nord-Est s'étend au district de Tropoja (Nikaj-Mertur, Krasniqe, Gash, Bytyç), comprend la plus grande partie de Puka, rejoint Has et Kruma de Kukësi, pour s'étendre outre-frontière et comprendre tous les parlers du Rrafshi de Dukagjini et du Rrafshi de Kosova.

